



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

TRANSKRIPT

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 26 DHE 27 PRILL 2021

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 26. I 27. APRILA 2021. GODINE

PRILL - APRIL  
2021

## **Rendi i ditës**

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit nr. 08/V-006, datë 2. 4. 2021 për formimin e komisioneve parlamentare,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091 dhe
6. Debat parlamentar për gjendjen me pandeminë COVID-19 në Republikën e Kosovës.

## **Dnevni red**

1. Izjave van dnevnog reda,
2. Parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Izmena i dopuna Odluke br. 08/V-006, od 02. 04. 2021. god. o formiranju parlamentarnih komisija,
5. Prvo razmatranje Nacrt zakona o dopuni i izmeni Zakonika br. 04 / L-123 o Krivičnom postupku, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 06/L-091, i
6. Parlamentarna rasprava o stanju sa pandemijom COVID-19 u Republici Kosovo.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, znj. Glauk Konjufca.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2021.

Më lejoni që t'ju kujtoj rëndësinë e respektimit të masave për mbrojtje nga pandemia COVID-19. Duke u bazuar në Manualin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe rekomandimet e IKSHPK-së, përgjatë seancës është i obliguar përdorimi i maskave nga secili.

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, ju njoftoj se me kërkesë të Kuvendit, Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani-Sadriu, ka nxjerrë Vendim numër 15/2021, të datës 8 prill 2021 për zëvendësimin e deputetes të Kuvendin e Republikës së Kosovës, si në vijim:

Deputetja Yllëza Hoti, kandidate nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, e zëvendëson ish-deputeten Vjosa Osmani-Sadriu.

Ftoj deputeten Yllëza Hoti që ta japë betimin. Tekstin e betimit deputetja e ka para vetes.

Për të përmbushur këtë detyrim, lus deputeten që të ngritën në këmbë, ta dëgjojë tekstin që do ta lexoj unë dhe në fund ta shqiptoni fjalën: Beto hem!

*“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane”. Beto hem!*

Lus deputeten që personalisht ta nënshkruajë tekstin e betimit dhe t'ia dorëzojë Shërbimit të deputetëve. Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 70 deputetë, kështu që mund të procedojmë me punën e Kuvendit.

### **1. Deklarime jashtë rendit të ditës**

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në tridhjetë (30) minuta.

Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë (5) minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre (3) minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje fjalën e ka deputeti Artan Abrashi.

ARTAN ABRASHI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të mediave,

Dhe ju të tjerë që jeni prezentë në sallë.

Po bëhen dy muaj nga përfundimi i procesit zgjedhor të 14 shkurtit, si rrjedhojë e së cilës erdhën ndryshime rrënjësore në vendin tonë.

Krahas ndryshimit të raportit të forcave politike, jemi dëshmitarë të vendosjes së standardeve të reja në Kosovë. Një nga këto standarde është edhe avancimi i grave në jetën publike dhe politike.

Rritja e përfaqësimit të grave në Kuvendin e Kosovës në 40% të përbërjes nuk e pati rëndësinë vetëm të përmbushja apo tejkalimi i kuotave, rëndësia e saj reflektoi në kuptimin përmbajtjesor politik.

Në seancën e votimit të presidentes së Republikës së Kosovës, falë vendosshmërisë së grave deputete, të cilat refuzuan të jenë pjesë e skenarëve bllokues, Kosova e tejkaloi një krizë të rrezikshme dhe të panevojshme, por çka ndodhi më pas. Pasi fushata denigruese dhe linçuese e opozitës ndaj grave, herë me sulme përmes deklaratave në konferenca me linçime e etiketime, e herë si aksione.

Fillimisht ndaj presidentes së Republikës së Kosovës u përdor një gjuhë e ulët mizogjene që haptazi shpërfaqti urrejtje ndaj grave.

Pastaj në muret e shtëpisë së familjes së deputetes Adelina Granica u shkruan grafitë me përmbajtje fyese dhe seksiste, e të mos i përmendim presionet që i përjetuan deputetët e tjera në Kuvend e jashtë saj për t'i ndryshuar qëndrimet e tyre. Në vend se t'i dënojnë veprimet e tilla, çfarë bënë deputetët e opozitës. Ata me krenari i arsyetuan ato, me qasje destruktive në emër të një drejtësie false elektorale, një drejtësie që vlen vetëm për gra, sepse po të njëjtit nuk reagueshin në rastet e deputetëve burra, nuk reagueshin, për shembull, kur zoti Haxhi Shala në mandatin e kaluar nga Nisma kaloi në AAK, reagojnë të gratë, sepse duke jetuar me iluzione të dominimit, akoma nuk janë çliruar nga mentaliteti i mykur patriarkal që synon t'ua tregojë vendin grave, duke i bërë ato të nënshtruara dhe të dëgjueshme ndaj parisë së burrave.

Të nderuar deputetë opozitarë,

Problemet tuaja partiake, sikurse dështimi në reformimin e brendshëm, mungesa e hapësirës brenda partisë, ngecja e avancimit të rolit të gruas, nuk mund t'i mbuloni përmes denigrimit të

personalitetit dhe integritetit të njeriut, duket se dëshpërimi nga humbja që pësuar në zgjedhje ju ka ulur në atë pikë sa që edhe antifeminizmin si ideologji regresive po synoni ta normalizoni me diskursin publik, e pastaj ndoshta ta bëni edhe normë brenda institucionit.

Sulmet e egra ndaj Lëvizjes Vetëvendosje bëni sa të doni, nuk është se na bëjnë përshtypje. Opozitarizmin ndaj pushtetit besa e keni edhe obligim, por aman largohuni dhe distancohuni nga qasje të tilla primitive dhe të rrezikshme të kujdo qofshin ato dhe ngado qofshin ato.

Në luftën kundër diskriminimit dhe pabarazisë duhet të jemi bashkë. Objektivi për një shoqëri të barabartë dhe jodiskriminuese duhet të jetë i të gjithëve, fuqizimi i rolit të gruas në veçanti, sepse ju pëlqej apo jo, guximi dhe vendosmëria e shpërfaqur nga gratë pikërisht në këtë Kuvend për të vepruar sipas vullnetit të qytetarëve i dha kuptim rolit të deputetit të Kuvendit si përgjegjës dhe garantues i funksionimit të rendit kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, andaj këto vlera duhet t'i mbrojmë bashkë, e jo t'i luftojmë.

Me shpresë se do të reflektoni, faleminderit!

**KRYETARI: Faleminderit!**

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

**BLERTA DELIU-KODRA: Të nderuar kolegë deputetë,**

**Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,**

**Përfaqësues të mediave,**

Kosova këtë vit ka rënë për tetë pozita më poshtë se vitin e kaluar sipas raportit të Reporterëve pa kufij sa i takon lirisë së mediave në botë. Gjithnjë sipas këtij raporti, Kosova tashmë bën pjesë në mesin e vendeve me situatë problematike të lirisë së shtypit.

Në këtë situatë të ndjeshme me pandeminë në mesin e krizës shëndetësore, kur qytetarët më shumë se kurrë kanë nevojë që të informohen për sigurimin e vaksinës kundër COVID-19, Qeveria Kurti është Qeveria e parë e cila ka nisur përndjekjen e medias dhe përndjekjen e gazetarëve.

Kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, duhet të dalin para qytetarëve të Kosovës për t'u dhënë sqarime pse ka dështuar marrëveshja me kompaninë Pfizer, sepse shteti është përgjegjës për sigurimin e vaksinës, e shteti nuk do të duhej që t'i atakojë e të drejtojë gishtin te mediat.

Ndërhyrja flagrante e aparatit shtetëror në të drejtën e shprehjes së lirë për arsyen e vetme se mediat kishin publikuar dokumente që flasin për brengën më të madhe të shoqërisë sonë, sigurimin e vaksinës, është njollë e zezë mbi demokracinë e re të Kosovës. Ministra,

zëvendëskryeministra, deputetë, ish-avokatë të popullit, me veprimet e tyre dëshmuar se do të luftojnë pa zgjedhur mjete duke ushtruar ndikimin e tyre edhe në prokurori, edhe në polici, te të gjithë ata gazetarë, të cilët guxojnë të raportojnë për skandalet e njëpasnjëshme të kësaj qeverie.

Të dashur kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Në trajtimin e skandalit të vaksinave për këtë Qeveri më lehtë ishte të suspendonte demokracinë, duke i sulmuar direkt mediat, se sa të debatonte hapur për paaftësinë e saj që t'i sigurojë vaksinat për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Duke i sulmuar mediat, duke i paraqitur ato si burim i gënjeshtrove, ky pushtet autoritar tentoi t'i disiplinonte mediat dhe t'i paraqesë ato si armiq të pushtetit për t'i arsyetuar veprimet e tyre dhe për të relativizuar ndërhyrjen flagrante në rendin e demokracisë. Ky shembull, së bashku me shumë shembuj të tjerë të kërcënimeve ndaj mediave, është një tjetër ilustrim i zymtë i faktit, ndërsa gazetarët kontribuojnë në luftën kundër pandemisë COVID-19 me raportimet e tyre, ata bëhen vetë viktima të sulmeve nga kjo Qeveri, e cila tenton të përfitojë nga situata për t'i mbytur zërat kritikë.

Gazetarët që sa kohë kanë theksuar mungesën e përgjegjësisë publike të kryeministrit për të marrë pjesë në konferenca për gazetarë dhe për të qenë në studiot e hapura televizive. Në vend se fitorja t'i thellonte ndjenjën e përgjegjësisë kryeministrit, kjo veç i ka rritur sjelljen e tij megalomane dhe arrogante në raport me qytetarët në përgjithësi.

Po ashtu, heshtja e Presidencës së ashtuquajtur unifikuese, zonjës Osmani, përball një skandali të tillë tregon mungesën e hapur të guximit politik për të dënuar një ndërhyrje flagrante në lirinë e medias. Kosova nuk është shtet policor, andaj përndjekja e mediave, shoqërisë civile, opozitës, janë shenjat e para të kalimit nga një sistem demokratik në atë autoritar.

Partia Demokratike e Kosovës, ashtu siç u angazhua që të mbrojë burimet e gazetarëve me ligj, do të angazhohet në secilën mundësi dhe kapacitet të mbrojë rolin e mediave në shoqërinë tonë demokratike, ato duhet që të jenë të lira dhe të pavarura.

**KRYETARI:** Prej Grupit Multietnik, fjalën e ka kërkuar deputeti Erxhan Galushi.

**ERXHAN GALUSHI:** *(Përshëndetje në gjuhën rome)*

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Unë Erxhan Galushi, si përfaqësues i komunitetit rom në Parlamentin e Republikës së Kosovës, përmes Lëvizjes Përparimtare të Romëve të Kosovës, meqenëse është fjalimi i parë në këtë legjislaturë pas zgjedhjes së kryeministrit dhe presidentes së Republikës së Kosovës, më lejoni që në këtë Kuvend t'i drejtohem me disa fjalë kryeministrit të vendit, zotit Albin Kurti, e ku po ashtu gjatë fjalimit tim nuk do ta lë pa e përmendur edhe vdekjen e Elmedinit, djaloshit nga Fushë-Kosova, të cilësuar si vdekje e dyshimtë, deri në daljen e një raporti përfundimtar nga institucionet përkatëse.

I nderuar kryeministër, zoti Kurti,

Edhe një herë ju uroj sukses për pozitën tuaj si dhe gjithë suksesin e arritur duke uruar shëndet dhe punë të mbarë dhe të suksesshme për vendin si dhe interesin e qytetarëve në përgjithësi e pa dallim.

Më lejoni t'ju them se jam i lumtur se në romët e përzgjedhur nga vullneti i plotë i qytetarëve romë edhe një herë dëshmuam konstruktivitet në përzgjedhjen e institucioneve të reja në të mirë të vendit dhe të gjithë qytetarëve të saj pa dallim.

Në fakt konstruktiviteti i komunitetit rom është traditë e politikës të përfaqësuesve romë të zgjedhur përmes votës autentike të votuesve të saj. I pari, i cili e ka dëshmuar një gjë të këtillë ka qenë tashmë i ndjeri Haxhi Zylfi Merxha, i cili njëkohësisht ka qenë edhe nënshkruar i pavarësisht së Republikës së Kosovës më 17 shkurt të vitit 2008.

I nderuar kryeministër, zoti Kurti,

Ne romët e Kosovës nga ju presim vullnetin e mirë politik për hartimin dhe zbatimin praktik të politikave për qytetarët e komunitetit rom dhe jo vetëm duke iu referuar të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.

Në fakt, nga ju presim qasje të njëjtë, të përgjithshme, të barabartë, pa asnjë dallim duke i pasur parasysh më shumë nevojat e qytetarëve, e jo numrat e banorëve etnikë të qytetarëve në Republikën e Kosovës, sepse mendoj se vetëm duke vepruar në këtë mënyrë, ne mund të përmirësojmë statusin e cilindo qytetar me nevojë pa dallim etnie, por me nevojë ose në rend të parë nevoja, mandej numri.

Por, duke marrë parasysh se komuniteti rom, sipas statusit të Republikës së Kosovës njihet si komunitet i marginalizuar, e bën të qartë se nevoja më e theksuar për çfarëdo lloj ndihme është në anën e këtij komuniteti.

Por, nga praktikat e deritanishme një gjë e tillë shumë pak, madje asnjëherë nuk ka ndodhur.

Pasi është fjalimi im i parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më lejoni që sado pak t'ju njoftoj me romët, kulturën, historinë dhe vuajtjet e tyre për një jetë më të mirë.

I nderuar kryeministër, zoti Kurit,

Romët jo më larg se dy javë festuan 50-vjetorin e Ditës botërore të romëve, që nga viti 1971, në të cilin vit janë marrë vendime jashtëzakonisht të rëndësishme për këtë komunitet, pra është caktuar flamuri rom dhe dukja e saj, himni rom Gjellem gjellem, si dhe eliminimi i emërtimeve pezhorative, duke e quajtur veten me nacionalitet rom që e ka kuptimin “njeri”.

Që nga ajo kohë e deri më sot romët në përgjithësi botës i kemi dhënë shumë, por në fakt marrim shumë pak, madje asgjë. Botës ia dhamë ngjyrat e artit përmes Pablllo Picasso, aktorja e famshme...

*(Ndërprerje nga regjia)*

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)*

KRYESUESJA: Mund të vazhdoni.

ERXHAN GALUSHI: Pra, përmes artit, muzikës Elvis Prisli, Gjipsi Kings, Gjanko Rajnga e deri te e ndjera Esma Rexhepova u dhamë edhe vallëzimin më modern e më tërheqës, si Flamengo. Ndërsa politikës braziliene ia dhamë presidenti rom Zhezelino Kupqek, i cili ngriti ekonominë në atë nivel sa që në kohën në të cilën veproi ai, Brazili është bërë i njohur me nofken “Brazili modern”.

Ka dhënë shumë, e të mos flasim se sa viktima kemi dhënë gjatë Luftës së Dytë nëpër kasaphane të ndryshme, si Aushfic, Birkenau, Jasenovac, më shumë se një milion e gjysmë romë.

Krejt këto i dhamë për të marrë pak, duke i përmirësuar statusin e komunitetit rom në disa fusha, si mirëqenia sociale, punësimi, infrastruktura, po marrim shumë pak, e madje asgjë.

Ndërsa për Kosovën tonë të dashur duruam vuajtje, përbuzje, nënçmim, diskriminim e segregim, duruam dhe ende vazhdojmë të durojmë papunësi, afro 95% të papunësuar romë në institucionet publike të nivelit lokal e qendror, me mundësinë tonë kemi dhënë djem në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, disa prej këtyre edhe nga rrethi i familjarëve të mi...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, Bekë Berisha.



BEKË BERISHA: Ora policore është logjikë e kontrollit, jo logjikë e mbrojtjes së shëndetit publik.

Po i vendosim policët si kujdestarë politikë, po i maltretojmë pa asnjë efekt. Largojeni orën policore dhe lejojeni qarkullimin e lirë!

KRYESUESJA: Nga PDK, deputetja Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: Përshëndetje, të nderuar deputetë,  
Nënkryetare e Kuvendit,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar qytetarë,

Sot dua të flas me Adelinën, nuk po e shoh ku është, dhe për Adelinën, për gratë, përfaqësimin, vendimet për veten, për jetën, për hapësirën. Se a është e drejtë që një deputet nga një subjekt të shkojë në tjetrin, nuk dua të ndalem, por mënyra se si kjo bëhet, pse bëhet e kur bëhet, ka një rëndësi të veçantë, sepse ka një etikë në krejt punën që ne e bëjmë për shkak të besimit që na është dhënë dhe përfaqësimit të një subjekti politik që e përfaqësojmë dhe elektoratit të tij.

Të thuash nuk ke hapësirë në fillim të një mandati, kur hapësira të është dhënë të jesh pjesë e listës dhe besimi të është dhënë të jesh deputet me votat e një elektorati të një partie, kjo nuk qëndron. Sepse edhe tani je në Kuvend, e ke të njëjtën hapësirë, mund ta përdorësh mikrofonin e njëjtë, sepse kjo është hapësira që të është dhënë.

Nuk kujtoj që dikush nga PDK-ja e ka ofenduar këto ditë ndonjëherë zonjën Grainca, asnjëherë. Kemi diskutuar për mungesën e hapësirës së saj, si është deklaruar ajo. Kujtoj që ju keni kërkuar të keni më shumë hapësirë, hapësirën e keni pasur këtu, nuk e keni shfrytëzuar, arsytet i dini ju. Ndërsa ne kërkojmë kthimin e mandatit të vjedhur nga votuesit e Partisë Demokratike të Kosovës.

PDK nuk njihet si dikush që ka linçuar njerëz në historinë e saj, as nuk ka shkruar mbishkrime për asgjë nëpër muret e askujt. Këtë zakonisht e ka bërë partia që ka qenë gjatë në opozitë, e sot është në pushtet dhe e ka shumë të lehtë të identifikojë se kush i ka bërë ato mbishkrime. Ju kujtoj vetëm disa për të kthyer memorien. Linçimet ndaj Valdete Dakës, linçimet ndaj Aida Dërgutit, linçimet ndaj Edita Tahirit, linçimet ndaj Ganimete Musliu, ju madje keni shkuar aq lart sa që keni dhunuar dhe ambasadorin amerikan. Andaj, në emër të grave pikërisht në idenë e asaj se çka luftojmë ne për përfaqësim të barabartë të dinjitetshëm për të marrë vendime për veten tonë, të lutem ktheje mandatin e PDK-së.

KRYESUESJA: Nga AAK-ja, deputeti Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: I nderuar zoti kryeministër Kurti,  
Të nderuar deputetë,  
Qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Kemi hyrë në muajin e dytë të qeverisjes Kurti, një qeveri e cila për çudi për të gjithë është duke qeverisur pa program qeveritar.

Sot kur po e nisim një seancë, ku do të debatohet për pandeminë dhe për zhvillimin ekonomik, Qeveria Kurti dhe ministrat që udhëheq ky kryeministër nuk kanë arritur t'i paraqesin tri objektiva para qytetarit, secilin veç e veç. Në mungesë të këtij programi shihet shumë qartë dhe shumë saktë që të gjithë punët janë ad hoc, gjithë puna ndodh nga çka i shërbehet kryeministrit, ministrave në tavolinë, është e pajustificueshme që për 40 ditë, që nga 14 shkurti kur përfunduan zgjedhjet po bëhen 4 muaj të mos kemi një dokument, me cilin ju u adresoheni qytetarëve dhe çështjeve. Në mungesë po i lëvizni prioritetet, po e lëvizni dialogun nga pika e gjashtë në pikën e parë dhe po thoni se do të shkojë në Bruksel dhe pastaj do të bëjë një program qeveritar.

Kërkesa ime për ju, zoti Kurti, dhe për qeverinë që ju e udhëhiqni, është: mos bëni eksperimente në radhë të parë me çështjen e pandemisë, e keni mbyllur për 12 ditë, i kemi humbur me dhjetëra miliona pa asnjë efekt. Mos bëni eksperimente me orën policore, po lironi, ashtu siç e tha deputeti ynë, mos eksperimentoni me tema nacionale, me tema si dialogu, të mos ballafaqoheni siç ka ndodhur herën e kaluar. Kërkojmë nga ju që të na tregoni sot kur do ta prezantoni një program qeveritar, kur ne do të ballafaqohemi, kur ju do të jepni një përgjegjësi, një llogaridhënie para këtij Kuvendi dhe ju lus që ta largoni logjikën e arrogancës. Votimi i djeshëm në Tiranë nuk mendoj që e ka forcuar demokracinë në Shqipëri, nuk mendoj se i ka bërë ndonjë hair Kosovës, vetëm sa e ka forcuar argumentin kundër nga vendet mosnjohje, nga armiqtë e këtij vendi. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Nga Lëvizja Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, nënkryetare!

I nderuar Kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kolegët e mi nga opozita kur dalin në këtë foltore është mirë që përveç faktit se kanë përpara fjalimin ose pikat e përgatitura, të reflektojnë edhe një herë në pamjen e Kuvendit. Ajo çfarë ka ndodhur në zgjedhjet e 14 shkurtit në Kosovë, nuk mund të kalojë pa asnjë reflektim, siç po vërehet ose siç po e ndjejmë nga opozita tani.

Qytetarët e Republikës kanë kërkuar ndryshim. Këtë ndryshim nuk e kanë kërkuar vetëm në formatin se si ulemi ne këtu, por e kanë kërkuar edhe në mënyrën se si qeveriset, por përmbi të

gjitha, ajo çka juve duhet t'ju bëjë më të vëmendshëm në fjalimet tuaja është kjo pamje dhe ju inkurajoj që sa herë të keni mundësi të vini dhe ta shihni argumentin se çfarë do të thotë ndryshimi në Kosovë në mundësinë e forcës politike. Tash, disa prej pikave që u adresuan prej kolegëve të mi të opozitës, me krejt respektin dhe vlerësimin maksimal për ta dhe bashkëpunimin në të ardhmen që do ta kemi.

Sa i përket lirisë së mediave, ai indeks i cili është prezantuar reflekton në vitin 2020. Në vitin 2020 Kosova është qeverisur në pjesën gjysmën e dytë të vitit nga një qeveri e cila e dimë si e mori mandatin dhe pastaj u shpall jolegjitime nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së vendit. Të gjuhemi dhe të flasim vetëm për një fakt, i cili një adresim të ministrit, i cili po, se është sekret që nuk do të duhej të dilte nga një ministër i ish-Qeverisë, i cili ishte përgjegjës në mesin e tjerave edhe për lirinë, për arsye se sipas planeve të tij nuk dështoi sa duhet furnizimi me vaksina, por duhet tanimë edhe të bëhen spekulime, të cilat do të vënë hije të zezë në qeverinë aktuale.

Kolegu im, Artani, foli për qasjen ndaj grave.

Tash, ende më keq është kur gratë sulmojnë gratë. Secila e kanë momentin e vetë për t'u treguar, për të dëshmuar dhe për të vlerësuar. Përderisa fliste kolegja ime nga opozita, burrat po i njëjti grup parlamentar thoshin: "S'ka vendosë ajo, e ka shit' axha i vet". Po vazhdon argumenti se gruaja dhe deputetja është pronë, e cila shitet dhe blihet. Domethënë, në krejt këtë argument, të cilin një deputete, kolege, po mundohet t'ia rikujtojë koleges tjetër, kolegët, ju të tjerët, s'jeni të bindur. Ju kisha lutur që publikisht të mos flisni për gjërat, të cilat nuk jeni të bindur vetë, përderisa ajo është gjuha dhe ajo është fryma që ju brenda e ushqeni, si mund të thoni jo nuk jemi ne ata që e kemi shkruar...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESJA:** Regjia, vazhdojani fjalën!

**MIMOZA KUSARI-LILA:** Përderisa standardet e dyfishta ndryshojnë vetëm dy metra prej vendit nuk kemi çka të flasim. Edhe një për zotin Tahiri, ju që ishit bashkë Qeveria e PAN-it, a e mbani mend kur e ka prezantuar zoti Ramush Haradinaj në këtë Kuvend programin qeverisës? Më 10 shtator keni pritur pesë orë Listën serbe të vijë prej Beogradit të marrin amin-in e Vuçiqit për votim, pesë orë në orët e mbrëmjes është votuar. Më 7 dhjetor 2017 e ka prezantuar zoti Haradinaj programin qeverisës, më 7 dhjetor. Çka keni bërë prej 10 shtatorit deri më 7 dhjetor? Çka keni bërë, përveç faktit se keni deklaruar se me mandatin tuaj do të përmbylej dialogu me Serbinë?

Se me mandatin tuaj do të funksiononte sundimi i ligjit dhe zhvillimi ekonomik? Këto janë fakte dhe argumente, të cilat shihen lehtë, e për që i keni ndërruar ulëset dhe jeni zvogëluar, duhet të reflektoni më shumë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Fjalën e ka Arben Gashi nga LDK, në emër të grupit.

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Megalomania e numrave do të shihet në të ardhmen, ideja dhe ideologjia e blerjeve nuk mund të relativizohet pse dikush është grua e pse dikush është burrë.

Pikërisht duke tentuar të mbrohet një pazar politik për shkak të gjinisë, është mizogjeni, pra pazari ka ndodhur është deputete si të gjithë të tjerët, pa marrë parasysh a është grua a është burrë. Pra, është deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili ka ndërruar pozicionin politik për shkak të beneficioneve të pretenduara të deklaruara nga të tjerët, e para.

E dyta, opozita apo fjala “opozitë” është më diverse se sa pushteti. Pra, opozita i ka tri parti politike dhe kur i drejtoheni opozitës, është mirë të specifikoni se kujt po i drejtoheni, a po i drejtoni PDK-së, LDK-së apo AAK-së. Pra, mësojuni të komunikoni dhe të diskutoni. Sa u përket numrave që përdorni këtu, është e pavërtetë, po ashtu. Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka 41 gra, pra nuk i ka 40%, po i ka 41 gra prej 120 deputetëve.

Pra, prapë kemi pasaktësi në ato që deklaroni. Kur flasim për përfaqësim politik, i cili bëhet në Kuvendin e Republikës, mos tentoni të fshiheni prapa gjinisë, barabarësia është elementi bazik, gratë edhe burrat e këtij Kuvendi janë të barabartë, pra janë të barabartë dhe nuk mbrohet, e as sulmohet askush për shkak të gjinisë dhe thirrja deri në çirrje e klithma e partive të pushtetit është e paarsyeshme, s’ke nevojë të bërtasësh, i keni numrat, votoni, vendosni, pse bërtitni, sepse jeni fajtorë, sepse keni blerë. Pra, ju keni sulmuar, anatemuar dhe deri në degradimin e gjuhës në këtë Kuvend për shkak të blerjes. Ku qenka dallimi mes deputetit Haxhi Shala dhe deputetes Grainca? Ku është dallimi? Ku?

Pra, ju të nderuar, ruajeni qetësinë, qeverisni vendin, merrni përgjegjësinë. Ju tentoni ta bëni personale, kot e keni, se s’mundeni. Këtu jemi, këtu do të deklarohejmë, kur s’ju ndez ajo personalja, mundohuni ta shndërroni në gjinore. S’ka të bëjë me gjininë, është deputete, është deputet i këtij Kuvendi, pse? Se qenka deputete, po u vepruaka në bazë të bindjes, se qenka deputet, qenka blerë. Qysh mund të ndodhë kjo?

Pra, zotërinj të nderuar, ju jeni hiç më pak e hiç më shumë veç mashtrimi i deklaruar në këtë Kuvend, edhe para këtij vendi. Pra, mashtrimi që ju keni deklaruar dhe mashtrimi, të cilin ju e keni kthyer në kauzë, duke pretenduar të vërtetën absolute në këtë vend, është ajo që ju

përfaqëson dhe karakterizon. Përfaqësimi dhe karakterizimi nëpërmjet të pavërtetës dhe mashtrimit është i padenjë. Është pranuar nga shoqëria për aq kohë sa keni qenë në opozitë, tash jeni në pushtet, nuk ke nevojë të çjerrësh, nëse diçka është gabim, ndreqeni, rregullojeni, nëse diçka është që nuk funksionon, rregullojeni, silleni në këtë Kuvend, s'keni sjellë kurrgjë, asnjë propozim, përveç vazhdoni gjuhën e urrejtjes dhe gjuhën e mezogjinisë. Pra, trajtoni me dinjitet gratë e këtij Kuvendi, jo pse janë gra, po sepse janë deputete, sepse janë të barabarta, sepse kanë të drejtë deklarimi dhe vendimi mbi bazën e vullnetit të tyre, kjo është ajo që duhet dhënë këtij Kuvendi, e jo klithma, pse po e akuzoni, sepse qenka grua. Nëse është shitur, është shitur një deputet apo deputete, pa marrë parasysht përkatësinë gjinore apo partiake. I dënueshëm këtu është vullneti juaj për të blerë, kjo është ajo për të cilën ne të gjithë pajtohemi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Domethënë, ka përfunduar koha për deklarime jashtë rendit të ditës.

## **2. Pyetjet parlamentare**

Ju njoftoj se në bazë të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat deri në 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar shtatë pyetje parlamentare. Ftoj deputeten Ariana Musliu-Shoshi, pyetje për zëvendëskryeminstren dhe ministren Donika Gërvalla-Shvarc.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: E nderuar kryesuese, faleminderit!

Kurdo që ministrja gjen kohë të jetë prezente në këtë seancë, atëherë unë do ta bëj pyetjen. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në rregull! Faleminderit! Deputeti Fadil Nura, pyetje për kryeministrin Albin Kurti.

FADIL NURA: Faleminderit, kryesuese! Kolegë të nderuar, Kabinet qeveritar,

Zoti kryeministër, sipas njoftimit zyrtar të datës 12.04.2021, në një takim të ngrohtë dhe miqësor keni pritur përfaqësuesin special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, zotin Zahir Tanin. Sipas njoftimit zyrtar, ai ju ka përgëzuar për fitoren dhe ka theksuar se prioritete të tij janë ato që reflektojnë kërkesat e qytetarëve.

Gjithmonë, sipas njoftimit zyrtar, sipas këtij prioriteti që ka shpalosur kryeministri Kurti, se luftimi i pandemisë, luftimi i korrupsionit dhe sundimi i ligjit janë ato që reflektojnë kërkesa dhe shpresat e qytetarëve. Pyetje: Zoti Kryeministër, krahas prioriteteve që i keni prezantuar zotit Zahir Tanin, si përfaqësues i UNMIK-ut, a shtruat çështjen e përgjegjësisë për vrasjen e Mon Balajt dhe Arben Xheladinit? Nga se keni thënë se e keni gjithmonë prioritet, nëse po, cila ishte gatishmëria dhe përgjigja e tij? Faleminderit!

**KRYEMINISTRI ALBIN KURTI:** Ju faleminderit për pyetjen, deputeti Nura!

Në atë takim që është mbajtur një ditë para seancës së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ku aty foli edhe ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme së Diasporës zonja Donika Gërvalla, kishte vetëm dy tema. Tema e parë ishte ajo seanca e nesërme në fjalë dhe tema e dytë ishte raportet e Kosovës me Serbinë.

Si Kryeministër i Republikës së Kosovës konsideroj që me UNMIK-un duhet të fillojmë të flasim për vrasjen e Arben Xheladinit dhe Mon Balajt, pasi që Prokuroria jonë Speciale të fillojë hetimin, qoftë edhe për gjykim në mungesë të atyre kriminelëve nga radhët e policisë ndërkombëtare që i kanë vrarë aktivistët tonë. Në këtë pikë kjo çështje duhet të jetë gjyqësore dhe në degë të tillë, e ne nuk mund e as nuk duhet të kemi ndikim. Sa na përket neve si ekzekutiv, ne kemi bërë atë që mundemi. Ministria e Drejtësisë, zonja Albulena Haxhiu, i ka shkruar direkt Rumanisë për këtë çështje, por ende nuk kemi marrë përgjigje. Po ashtu, tashmë janë proceduar ndryshimet e nevojshme të ligjit në mungesë që në mungesë të trajtohen edhe rastet e tjera, përveç krimeve të kryera gjatë luftës, pra edhe raste të tjera penale, përfshirë këtu edhe rastin e Arben Xheladinit dhe Mon Balajt. Kjo gjë do të na mundësojë që ta iniciojmë rastin më pastaj përmes rrugëve gjyqësore.

**KRYESUESJA:** Faleminderit! A keni pyetje shtesë, zoti Nura? Regjia, të lutem, ia jep fjalën!

**FADIL NURA:** Nga ajo që dëgjuam nga kryeministri i Republikës së Kosovës, praktikisht në këtë takim nuk është shtruar kjo çështje dhe përkthyer ose thënë bukalisht, gjithë ajo që kuptuam në përgjigjen e tij, është ajo që zoti kryeministër e ka përdorur gjithmonë Mon Balajn e Arben Xheladinit, tap në fotelen e kryeministrit dhe harroi Mon Balajn dhe Arben Xheladinit. Kjo është ajo që unë pashë në përgjigjen e tij, marrë parasysh që vetë ky kryeministër më 2019 nuk e ka përkrahur gjykimin në mungesë, prezantuar në kuadër të plotësim-ndryshimit të Kodit Penal. Faleminderit!

**KRYEMINISTRI ALBIN KURTI:** Pas protestës së 10 shkurtit 2007, u pati publikuar një raport, asokohe i shefit të Shtyllës së Dytë të UNMIK-ut, kreut të Departamentit të Drejtësisë, Robert Din, në të cilën është konstatuar që vrasja e Arben Xheladinit dhe Mon Balajt ka qenë edhe e panevojshme, edhe e evitueshme. Paneli këshillues për të drejtat e njeriut në kuadër të UNMIK-ut e pati trajtuar këtë çështje me sukses të pjesërishtëm, jo tamam, mirëpo tash ne vlerësojmë si Qeveri që kjo duhet të marrë rrugën e drejtësisë, duhet të marrë rrugën e organeve të drejtësisë, prokurorisë dhe gjyqësisë, e ku ne duhet të ndihmojmë. Prej ekipit të policëve që kanë qenë më 10 shkurt 2007, 11 policë gjithsej, të Rumanisë, në kuadër të UNMIK-ut, me siguri prej 11 vetave, 2 janë vrasës. Po ata nuk janë më nën ombrellën e UNMIK-ut, ata janë në Rumani, prandaj edhe ministria Haxhiu i ka shkruar Rumanisë për këtë gjë dhe ende s'kemi marrë përgjigje.

Unë nuk mund ta ngre këtë çështje me UNMIK-un, pa vepruar një herë prokuroria jonë, sepse jemi joseriozë. Është koha prokuroria të veprojë, e më pastaj unë ta kërkoj UNMIK-un edhe si arkiv, edhe si instancë, si autoritet, nën ombrellën e të cilit kanë qenë ata policë asokohe. Fatkeqësisht, në shkurt të vitit 2007 policët ndërkombëtarë janë intervistuar vetëm si dëshmitarë dhe jo si të dyshimtë. Pra, si qeveri e re, si shtet i Kosovës, si republikë e pavarur, duhet t'i bëjë hapat një herë sistemi ynë i drejtësisë dhe më pastaj ta thërrasim UNMIK-un, sepse e kemi shpallur pavarësinë, sepse drejtësia nuk mund të na vijë prej UNMIK-ut.

**KRYESUESJA:** Deputeti Fitim Uka, pyetje për ministren Arbërie Nagavci. Regjia, fjalën deputetit, të lutem! Përmes kartelës së Arbër Rexhaj.

**FITIM UKA:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

E nderuar ministre Nagavci,

Studentët e disa institucioneve private të arsimit të lartë nuk janë të regjistruar fare në Librin Amë në Ministrinë e Arsimit dhe, si rrjedhojë, ata nuk mund të marrin një diplomë valide dhe mund të humbin kështu edhe mundësinë e tyre për të studiuar jashtë vendit.

Ne në mandatin e kaluar e kemi trajtuar këtë çështje në Komisionin Parlamentar për Arsim dhe aty ka pasur një seri të akuzave dhe kundërakuzave në mes të institucioneve private të arsimit të lartë dhe të Ministrisë së Arsimit, pra përgjegjësia bartet sa tek njëra palë sa tek tjetra, mirëpo e vërteta është që deri më tani nuk kemi pasur as edhe një veprim nga ana e ministrave të kaluar të Arsimit për të zgjidhur këtë çështje dhe unë dua të ju pyes nëse është paraparë ndonjë masë eventuale që të adresoni edhe papërgjegjësinë e institucioneve private të arsimit të lartë, por gjithashtu edhe papërgjegjësinë e secilit ministër, në mënyrë që studentët të mos i vuajnë këto pasoja.

**MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI:** E nderuar nënkryetare Bogujevci!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputete e deputetë,

I nderuar deputet Fitim Uka,

Ju falënderoj për pyetjen e shtruar, e ndaj të njëjtën brengë me juve dhe është një situatë tejet shqetësuese, e cila e ka vëmendjen time të plotë.

Më lejoni t'ju informoj se sipas njoftimit të zyrtarëve përgjegjës në ministri, çështja e mosvaliditetit të diplomave nga NARIK vjen si rezultat i shumë problemeve të krijuara dhe të trashëguara ndër vite tashmë. Disa nga to janë: mosdorëzimi i Librave Amë nga kolegjet e arsimit të lartë privat konform Udhëzimit Administrativ 33/2014, diplomat e lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë privat dhe publik në programet e paakredituara, diplomat e lëshuara nga institucionet private të palicencuara nga MASHT-i dhe diplomat e lëshuara nga

kolegjet e arsimit të lartë privat, të cilat fare nuk figurojnë në platformën SMIAL. Ky problem, besoj dhe jam e bindur tashmë se është edhe më i madh se sa që të gjithë ne e kemi menduar. Një numër i institucioneve të arsimit të lartë nuk i kanë dorëzuar fare në MASHT ose i kanë vonuar Librat Amë dhe kjo ka vazhduar për disa vjet. Për rrjedhojë, diplomat e këtyre studentëve nuk njihen nga qendra kombëtare për njohje të diplomave NARIK, rrjedhimisht, ato diploma nuk mund të njihen në asnjë vend jashtë Kosovës për qëllime studimi apo punësimi.

Te baza e regjistrimit të studentëve në MASHT janë edhe dy probleme të tjera, rritja e numrit të studentëve nga ish-ministrat e Arsimit, pa vendim të Agjencisë së Akreditimit dhe dorëzimet në ndryshimin e programeve akademike brenda sistemit të SMIAL-it në MASHT. Këto abuzime kanë të bëjnë me rastet kur një institucion i arsimit të lartë pranon studentë në një program të pa akredituar përkundër faktit se kjo është rreptësisht e ndaluar.

Ndërsa, në SMIAL i regjistron si studentë në një program tjetër të akredituar, duke kryer kështu një mashtrim tipik. Jam njoftuar se në lidhje me këtë çështje dhe të ngjashme me këto janë emëruar tashmë dy komisione në MASHT, paraprakisht, njëri me 6. 2. 2018, i cili ka dalë me disa rekomandime për sekretarin e përgjithshëm të MASHT-it, por ato rekomandime nuk janë implementuar dhe komisioni tjetër është emëruar më datën 30. 10. 2020, por akoma nuk ka dalë me një vendim përfundimtar nga puna e vet. Tani ju njoftoj se cilat janë veprimet e mia urgjente që kam ndërmarrë: e para, ju siguroj të gjithë juve deputetë që tani e tutje SMIAL është i sigurt dhe asnjë institucion i arsimit të lartë nuk do të mund të regjistrojë studentë jashtë procedurave ligjore dhe jashtë kuotave të përcaktuara nga Agjencia e Akreditimit. Ju siguroj se...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESJA:** Mund t'ia vazhdoni fjalën që ta përfundojë!

**MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI:** Ju siguroj që asnjë institucion i arsimit të lartë nuk mund të regjistrojë studentë mbi kuotat e përcaktuara nga Agjencia e Akreditimit, ndërsa regjistrimet e studentëve në programet e paakredituara do të kenë pasoja juridike për bartësit e arsimit të lartë dhe personat përgjegjës që bëjnë veprime të tilla. Sa u përket hapave të ardhshëm, për të garantuar ligjshmërinë e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë, duke e ditur kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e këtyre çështjeve, si dhe periudhën e gjatë kohore kur ende nuk është marrë ndonjë vendim, menjëherë do të formoj një komision gjithëpërfshirës e profesional, i cili do të trajtojë problemin e mosnjohjes së diplomave dhe do të përgatitë një raport me konstatime dhe rekomandimet për MASHT-in.

Pasi të marr këtë raport të komisionit, do të veprojmë në dy drejtime, nëse ka lëshime procedurale, do të thirren në llogaridhënie përgjegjësit e tyre, ndërsa në rastet kur vërehet se ka abuzime, do të procedohet me veprimet ligjore adekuate.



I nderuar deputet Uka,

Të nderuar deputete dhe deputetë,

Unë pres që të bashkëpunoj me Komisionin për Arsim këtu në Kuvend, me të gjithë deputetët dhe me institucionet tona që të garantojmë ligjshmëri në sistemin e arsimit në Kosovë.

**KRYESUESJA:** Deputeti Jahja Koka, pyetje për ministrin Hekuran Murati.

**JAHJA KOKA:** Zonja dhe zotërinj,

Jemi dëshmitarë të një dukurie sa të dhimbshme, aq edhe të rrezikshme, që manifestohet në udhëkryqe afër semaforëve, në të gjitha anët e Kosovës. Disa fëmijë lypës, disa dhe foshnja në duart e nënave, pothuajse gjithë të zhveshur, kurse disa fëmijë të tjerë lypsarë manifestohen në rrugë, duke punuar punë shumë të rënda.

Zoti ministër, ju posa erdhët në qeveri dhe mendojmë që është qeverisja e mirë, a keni mundësi që me kreativitetin tuaj intelektual intelektual në bashkëpunim me ministrat tjerë, të trajtoni këtë dukuri në dy drejtime. I pari është që të trajtohen njerëzit me nevoja të veçanta, kurse tjetri është në qoftë se ekziston ndonjë kompani për të cilën flitet që shpërdoron qeniet njerëzore, atëherë të merren masa adekuate, por që njëherë e mirë kjo dukuri që është e vjetër më se tri dekadash në këtë qeverisje të evitohet. Faleminderit!

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Faleminderit për pyetjen e qëlluar, i nderuar profesor!

Lidhur me çështjen, ne si Ministri e Financave, Punës dhe Transfereve jemi të përkushtuar dhe njëra nga objektivat e ministrisë sonë është luftimi i varfërisë dhe rritja e mirëqenies. Në këtë aspekt ne si ministri mbështesim strehimoret dhe organizatat tjera joqeveritare që merren me trajtimin edhe të fëmijëve, sidomos të rasteve të tilla sociale, dhe qëllimi ynë është që ta përforcojmë edhe më tutje këtë mekanizëm, pra që të ketë edhe më shumë investim në këtë aspekt, madje duke ndihmuar edhe komunat. Por, kjo merr paksa kohë dhe duhet të trajtohet edhe përmes Ligjit për financimin e pushtetit lokal.

Po ashtu, ne jemi të përkushtuar që t'i përmbushim edhe premtimet sa i përket edhe ndihmës së nënës dhe fëmijëve, pra kur jemi tek shtesat. Edhe kjo do të bëhet shumë shpejt. Ndërsa, sa i përket mundësisë së operimit të ndonjë rrjeti ilegal, që mund të abuzojë me ata fëmijë për të cilët e keni fjalën, kjo është çështje më tepër në fushën e sigurisë dhe hetuesisë, sesa që ka të bëjë me ministrinë tonë, por po shpresoj që si Qeveri do ta trajtojmë këtë problem ashtu siç duhet. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Zoti Kokaj, keni pyetje shtesë?

**JAHJA KOKAJ:** Faleminderit për gatishmërinë!

Me siguri se qeverisja e mirë do të reflektojë edhe në këtë aspekt. Por, jam koshient po ashtu, që është çështje e komunave. Shpeshherë disa kompetenca e ingerenca mbeten pezull në mes komunave dhe Qeverisë. Në mbledhjen vijuese kam dëshirë të prezantoj një dukuri tjetër, domethënë të ngjashme e shumë të dhembshme, por që shpeshherë trajtohet si nën kompetenca të komunave, të cilat nuk e kanë zgjidhur më se tri a katër dekada. Faleminderit për gatishmërinë e juaj!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Hajrullah Çeku.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesuese!

Unë po e lexoj pyetjen. Me propozim-amendamentin tim Kuvendi i Kosovës me Buxhetin e vitit 2019 ka ndarë 200 000 euro për shtatoren në Parkun Fadil Vokrri. Më pas Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka vazhduar me procedurat për përzgjedhje dhe punim të shtatores së legjendës së futbollit Fadil Vokrri dhe prej muajit tetor 2020 shtatorja e Fadil Vokrrit është përfunduar nga skulptori Agron Blakçori.

Por, edhe pse shtatorja është e përfunduar ajo ende nuk është vendosur në lokacionin e përcaktuar, tek stacioni Fadil Vokrri.

Në vizitën që kam bërë tek stadioni Fadil Vokrri kam parë se përveç punës në bazament të shtatores nuk ka asnjë fillim të punimeve për Parkun Fadil Vokrri në qendër të të cilit do të duhej të vendosej shtatorja. Më datë 9 qershor 2021 bëhen tri vite nga vdekja e legjendës së futbollit Fadil Vokrri, andaj pyes a është duke punuar Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që deri më datë 9 qershor 2021 të përfundojnë punimet në Parkun Fadil Vokrri dhe të bëhet vendosja e shtatores së Fadil Vokrrit, e cila tanimë është e gatshme që gjashtë muaj.

MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU: Faleminderit për pyetjen, deputet i nderuar! Zoti Haxhiu, Bazamenti është ndërtuar. Kanë mbetur vetëm detajet përfundimtare. Ndërsa, shtatorja është përfunduar, siç e cekët edhe ju. Unë kam kërkuar përshejtim të punimeve dhe jam besimplotë që shtatorja do të jetë gati dhe bashkë do ta përurojmë më datën 9 qershor, në përvjetorin e vdekjes së legjendës së futbollit dhe sportit kosovar, Fadil Vokrrit.

Në lidhje me parkun, ai nuk mund të ndërtohet. Arsye për këtë janë kufizimet hapësinore me stadiumin Fadil Vokrri. Përmbushja e kriterëve të UEFA-s për facilitetet e stadiumit na bënë të pamundur realizimin e idesë së parkut.

Pra, do të kemi shtatoren e Fadil Vokrrit në pjesën perëndimore të stadiumit, por jo edhe të parkut. Faleminderit!

KRYESUESJA: Keni pyetje shtesë, zoti Haxhiu?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, ministër, për përgjigjen!

Duke njohur edhe infrastrukturën e stadiumit, por edhe hapësirën përreth, pra ideja që të ndërtohet edhe parku afër stadiumit ka qenë mu për shkak të parcelës, e cila është pronë e Komunës përballë dhe mundësia që qytetarët edhe të vijnë e të fotografohen tek shtatorja, pra ka qenë një ide e tillë. Arsyeja pse është vendosur që shtatorja lokacioni të vendoset aty unë nuk e di saktë, ndoshta ju si ministër keni ndonjë informacion, por ideja ime fillestare ishte që përveç shtatores së legjendës të jetë edhe parku, ku edhe fëmijët, të cilët e kanë dhe do ta kenë edhe në të ardhmen idol Fadil Vokrrin, të kenë mundësi edhe të qëndrojnë pranë parkut dhe shtatores së tij.

MINISTRI HAJRULLA ÇEKU: I nderuar deputet,

Besoje që ideja fillestare ka qenë shumë e mirë, por unë tani e kam gjetur bazamentin aty, në pjesën perëndimore, brenda stadiumit dhe i dini kufizimet. Duke parë që ajo pjesë është për fascilitete përcjellëse, nëse bëhet parku e humbim mundësinë që ta ruajmë kategorinë IV dhe të bëjmë gara aty. Por, ka një pjesë të mbetur të fondit tanimë, sepse është realizuar vetëm shtatorja, ne mund ta bisedojmë mundësinë e parkut diku tjetër, ose të gjejmë një zgjidhje tjetër, por brenda stadiumit aty ku ka nisur dhe është vendosur bazamenti është e pamundur të bëjmë edhe parkun. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Bekim Haxhiu pyetje për ministrin Arben Vitia.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesuese!

I nderuar ministër,

Prej fillimit të Pandemisë COVID-19 profesionistët shëndetësor kanë qenë në vijën e parë të frontit të luftës me Pandeminë. Gjithashtu, në këtë betejë me Pandeminë punë të jashtëzakonshme kanë bërë edhe stafi mbështetës, Inspektorati dhe Policia e Kosovës. Në mandatin e kaluar me dy raste kam propozuar amendamente për të rritur pagat për këto kategori, pra për profesionistët shëndetësor, stafin mbështetës, Inspektoratin dhe Policinë.

Por, kjo nuk u mbështet nga partitë që ishin në pushtet. Dy qeveritë e kaluara, Kurti dhe Hoti, vendosën që profesionistëve shëndetësor t'u jepet pagesa shtesë 300 euro, ndërsa stafi mbështetës më vonë përfitoi nga shtesa në pagë vetëm pas protestave në kohë Pandemie. Ndonëse edhe shumë specializantë e profesionistë shëndetësor, punëtorë të sigurimit e pastrimit, nuk u përfshinë në pagesën shtesë, pas miratimit të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 Qeveria Hoti bëri një kategorizim të pagës shtesë për stafin shëndetësor, stafin mbështetës dhe kategoritë tjera.

Në mbledhjen e 8-të të Qeverisë së Kosovës, datë 21.04.2021 përveç zvogëlimit të shtesës për pensionistët u zvogëluan edhe pagesat shtesë edhe për profesionistët shëndetësor, ndërsa nuk u përfshinë stafi mbështetës, Inspektorati e as punëtorët e sigurimit e të pastrimit.

Përse keni zvogëluar pagesën shtesë për profesionistët shëndetësor? Pas më shumë se një vit pune të palodhshme do të duhej të rritej stimulimi për njerëzit që po përballen drejtpërdrejtë me Pandeminë e jo të zvogëlohet pagesa shtesë për ta. Përse keni bërë një veprim të tillë? Nuk jeni të kënaqur me punën e mjekëve apo çfarë ka ndodhur, që u janë zvogëluar shtesat profesionistëve shëndetësor?

MINISTRI ARBEN VITIA: E nderuara nënkryetare, zonja Bogujevci,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit shumë, zoti Haxhiu, për pyetjen e bërë!

Siç jeni në dijeni edhe në fillimin, në statet e para të fillimit të Pandemisë, Qeveria Kurti-1 ka marrë për shkak se njeh punën, angazhimin dhe sakrificën e të gjitha kategorive që ju i përmendët dhe natyrisht, ne jo se nuk jemi të kënaqur, përkundrazi. Kemi menduar se të ndihmojmë me të gjitha kapacitetet, aq sa mundemi, këto kategori.

Me ardhjen në detyrë më datë 23 mars të këtij viti unë kam marrë njoftimin, se shtesat për profesionistët shëndetësor dhe kategoritë tjera përfundojnë në muajin mars. Menjëherë kam kërkuar takim me zotin Murati nga Ministria e Financave dhe kemi biseduar se si mund të gjendet një mënyrë dhe një hapësirë buxhetore për të vazhduar këto shtesa dhe të mos ndalen në asnjë mënyrë, bash për atë që kemi gjithë respektin për sakrificën dhe punën e tyre.

Ministria e Financave në bazë të kapaciteteve buxhetore ka ardhur në propozimin që ka ardhur në mbledhjen e Qeverisë më datën 21. 4. 2021 dhe ai propozim është miratuar nga Qeveria, prapë po e përsëris, në bazë të kapaciteteve buxhetore.

Sa i përket inspektorëve, për shkak të kohës së shkurtër për të siguruar listat, Ministria e Financave në muajin maj do të bëjë pagesën e shtesave për dy muaj. Natyrisht, kjo pagesë do t'u bëhet të gjithë inspektorëve që kanë qenë të angazhuar në respektimin e masave anti-COVID. Faleminderit!

KRYESUESJA: Keni pyetje shtesë? Vazhdoni!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit për sqarimin, i nderuar ministër!

Në vendim inspektorët nuk janë të përfshirë dhe më vonë u kuptua që edhe Policia, një pjesë e tyre, janë të përjashtuar nga ky stimulim. Mirëpo, ajo çfarë ka ndodhur me këtë shtesë, pra është përgjysmuar. Prandaj ishte pyetja ime, se përse u përgjysmuan këto shtesa, sepse mjekët po e bëjnë punën e tyre në spitale tani e një vit. Vërtet janë stërlodhur.

Do të duhej edhe një sqarim. Përse u anulua konkursi, i cili parashihte që të ketë një rifreskim të stafit, sepse disa prej personelit shëndetësor edhe kanë ndërruar jetë në betejën me pandeminë e

disa të tjerë edhe janë infektuar dhe vuajnë pasojat e infeksionit dhe do të duhej të kishte një rifreskim të stafit, pas më shumë se një vit beteje me pandeminë.

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Faleminderit, zoti Haxhiu!

Ashtu siç e thash edhe më herët, në bazë të diskutimeve me Ministrinë e Financave, kapacitetet buxhetore kanë qenë këto që janë. Natyrisht, se ne për të rritur dinjitetin dhe për të treguar të gjithë atë maksimumin që ne mund ta bëjmë në raport me ngritjen e dinjitetit dhe pagën dinjitoze për profesionistët shëndetësor ne këtë do ta bëjmë në një mënyrë më të qëndrueshme në të ardhmen, përmes një ligji të pagave.

Përndryshe, për anulimin e konkursit, kjo është një çështje administrative për të cilën nuk kam pasur pyetje më herët dhe besoj se posa të marr një informacion nga administrata, ose në mbledhjen tjetër të Kuvendit, ose me shkrim, do t'ua nis përgjigjet pa asnjë problem. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Deputetja Tinka Kurti pyetje për ministren Albulena Haxhiu.

**TINKA KURTI:** Faleminderit, e nderuara nënkryetare Bogujevci!

E nderuara ministre Haxhiu,

Rastet e dhunës ndaj grave në familje dhe jashtë saj, sidomos në kohë të Pandemisë e të izolimit janë rritur shumë. Në përgjithësi, ndonëse me disa veprime të vogla, ende këto raste nuk trajtohen si duhet, nuk ka seriozitet nga institucionet e drejtësisë. Shtëpia pra nuk është vend i sigurt për të gjithë.

Cilat janë veprimet që keni marrë, ose do të merrni, si ministri për t'i trajtuar këto raste dhe për të lehtësuar raportimin?

**MINISTRJA ALBULENA HAXHIU:** Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

E nderuara zonja Tinka Kurti,

Në lidhje me përgjegjësinë e institucioneve, sa i përket dhunës në familje, aktualisht kemi kompetenca të shpërndara në institucionet e ndryshme. Bazuar në Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje asnjë institucion nuk është përgjegjës kryesor për këtë çështje.

Megjithatë, me Rregulloren më të fundit të Qeverisë për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së kryeministrit dhe ministrave, te shtojca 3 e kësaj rregulloreje në mes tjerash thuhet: “Ministria e Drejtësisë është institucion i vetëm, i cili sipas paragrafit 3, pika 13, ofron ndihmë për viktimat e krimit, veçanërisht për viktimat e dhunës në familje.

Për herë të parë adresimi i dhunës në familje dhe marrja e përgjegjësive institucionale është prioritet i Qeverisë. Gjatë këtyre ditëve secilin takim që kam pasur me krerët e institucioneve të drejtësisë u kam kërkuar angazhim maksimal në trajtimin e dhunës në familje apo në trajtimin e dhunës në baza gjinore. Kërkesa që kam adresuar në këto takime janë që:

- rastet e dhunës në familje të mos neglizhohen, pra të ketë veprime serioze për adresimin e këtyre rasteve;
- të ndërmerren masa disiplinore ndaj atyre që neglizhojnë rastet e dhunës në familje, sepse siç jeni në dijeni në të kaluarën ka pasur raste kur Policia, Prokuroria dhe gjykatat nuk e kanë kryer punën e tyre;
- dhe, ndaj kryerësve të shqiptohen dënime meritore.

Përveç takimeve të ndara me përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë, javën e kaluar për herë të parë kemi mbajtur mbledhjen e Grupit Ndërmintor si përgjigje e detyrave dhe përgjegjësive të secilës ministri përkatëse, ku kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të institucioneve tjera, ashtu siç edhe e parasheh Ligji në baza të rregullta do të vazhdojmë mbajtjen e takimeve edhe me grupin koordinues.

Në Ministrinë e Drejtësisë jemi duke punuar në:

- Hartimin dhe finalizimin e strategjisë nacionale për mbrojtjen nga dhuna në familje 2021/2025;
- Formimin e Grupit Punues për plotësim-ndryshimin e procedurave standarde të veprimit si udhëzues i ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive të secilit mekanizëm institucional në ofrimin e shërbimeve përkatëse;
- Zhvillimin e sekretariatit si përgjigje mbështetëse e Zyrës së koordinatorit nacional për mbrojtje nga dhuna në familje;
- Mbështetja e strehimoreve që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit me qenie njerëzor.

Jemi duke parë mundësinë dhe procedurat e adresimit të linjës së përhershme buxhetore, duke krijuar stabilitet financiar për të gjitha strehimoret dhe ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimeve të avancuara nga ana e Akademisë së Drejtësisë për institucionet përgjegjëse të drejtësisë. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Zonja Kurti, keni pyetje shtesë?

**TINKA KURTI:** Shumë viktimat heqin dorë nga drejtësia, për shkak të kushteve të rënda ekonomike. A keni menduar se si t'ua mundësoni atyre qasjen në drejtësi?

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Jam shumë e vetëdijshme edhe për këtë problem, që ekziston tek viktimat e dhunës në familje dhe viktimat në baza gjinore. Siç jenin ë dijoni, aktualisht mbrojtjen juridike në Republikën e Kosovës për këto viktima e ka vetëm një organizatë e Shoqërisë Civile. Pra, në vend se kjo të jetë institucionale, aktualisht vetëm Rrjeti i Grave, për aq sa unë jam e informuar, ndoshta ka edhe ndonjë organizatë tjetër, por nuk ka asnjë mekanizëm institucionale që u ofron mbrojtje juridike viktimave të dhunës në familje.

Në këtë drejtim, pra bazuar edhe në kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë, jemi duke adresuar plotësim-ndryshimin e Ligjit për Agjencinë për Ndihmë Juridike falas. Siç e dini, të drejtën për ndihmë juridike sipas këtij ligji e kanë qytetarët të cilët kanë standard të ulët, në mënyrë që edhe viktimat e dhunës në familje të gëzojnë mbështetje juridike nga shteti, siç parashihet në Ligjin për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Kjo ishte pyetja e fundit për sot.

Vazhdojmë me pikën e 3-të të rendit të ditës:

### **3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme**

Në sallë janë të pranishëm 79 deputetë. Të nderuar deputetë, pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet nga seancat e mbajtura më 22 mars dhe në seancat më 2, 3 dhe 4 prill 2021? A ka vërejtje?

Konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave të mbajtura më 22 mars dhe më 2, 3 e 4 prill 2021.

Vazhdojmë me pikën e 4-të të rendit të ditës:

### **4. Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit nr. 08/V-006, datë 2. 4. 2021 për formimin e komisioneve parlamentare**

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se në seancën plenare të mbajtur më 2 prill 2021 janë formuar komisionet parlamentare. Në ndërkohë, Grupi Parlamentar Grupi Multietnik i ka propozuar deputetët në komisione parlamentare, i cili u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj deputetin Enis Kervan që t'i prezantojë propozimet.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryesuese!

Grupi Parlamentar Multietnik propozon për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të komisioneve parlamentare deputetët, si në vijim:

- Komisioni për Buxhet dhe Transfere anëtare e komisionit zonja Duda Balje;
- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim zëvendëskryetar i komisionit zotëri Bahrim Shabani, anëtar i komisionit Enis Kervan, Fridon Lala dhe Bekim Arifi;
- Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit anëtar të komisionit zotin Erxhan Galushi;
- Komisioni për Integritet Evropian zëvendëskryetar i komisionit zoti Fridon Lala;
- Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë anëtar i komisionit zoti Bahrim Shabani;
- Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport zëvendëskryetar i komisionit zoti Enis Kervan;
- Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti zëvendëskryetar i komisionit zonja Fidan Jilla;
- Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor, anëtare komisionit zonja Semra Ilijazi;
- Komisioni për Shëndetësi anëtare e komisionit zonja Semra Ilijazi;
- Komisioni për Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media zëvendëskryetare e komisionit zonja Fidan Jilla;
- Komisioni për Çështje Sigurie dhe Mbrojtje zëvendëskryetar i komisionit Erxhan Galushi;
- Komisioni për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione kryetare e komisionit zonja Duda Balje;
- Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike zëvendëskryetar i komisionit Bekim Arifi;
- Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë anëtar i komisionit zoti Fridon Lala. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Ndërsa, edhe grupet tjera parlamentare kanë bërë propozimet për plotësimet dhe zëvendësimet në komisionet parlamentare, si në vijim:

- Grupi i Partisë Demokratike të Kosovës ka bërë propozimin për deputeten Ariana Musliu-Shoshi të emërohet anëtare e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Nëse ka edhe propozime të tjera, urdhëroni! Në rregull.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e propozimit të Grupit Parlamentar Multi-etnik dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së për emërimin në komisionet parlamentare.

Në sallë janë 91 deputetë. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen!

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?



Konstatohet se me 89 vota për, 3 vota kundër dhe 1 abstenim Kuvendi e miratoi propozimin e grupeve parlamentare për emërimin në komisione parlamentare.

Gjithashtu edhe nga Komisioni për Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media është propozuar që në vendimin e Kuvendit nr. 08/V-006, datë 2 prill 2021, për formimin e 14 komisioneve parlamentare, të ndryshohet emërtimi i Komisionit.

Komisioni ka kërkuar që emërtimi dhe fusha, nga: Komisioni për Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media, të emërtohet: Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e propozimit e për ndryshimin e emërimit të komisioneve në vendimin për formimin e komisioneve parlamentare.

Në sallë janë të pranishëm 81 deputetë.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Ju kërkohet falje, vetëm një përmirësim. Në fakt, ka qenë Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal.

Konstatohet se me 83 vota për, 0 vota kundër dhe 0 abstenime, Kuvendi e miratoi propozimin për ndryshimin e emërimit të komisioneve në Vendimin nr. 08/V-006, datë 2. 4. 2021 për formimin e komisioneve parlamentare.

Zoti Gashi, kanë qenë 93 deputetë prezentë, 89 kanë votuar. Mund të vini të sqarohemi nëse është e nevojshme, pa problem. 89 për kanë qenë. 83 më fal!

Vazdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

## **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ka propozuar që shqyrtimi i këtij Projektligji të bëhet me urgjencë, në dy lexime, përkatësisht shmangie nga afatet procedurale të parapara me

nenin 56 paragrafin 1, me nenin 57, paragrafët, 3, 5, 8 dhe 9 dhe nenin 64, paragrafi 4, të Rregullores së Kuvendit.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, z. Adnan Rustemi, që ta paraqes dhe arsyetojë propozimin e Komisionit, si dhe t'i propozojë afatet për shmangie.

**ADNAN RRUSTEMI:** Faleminderit nënkryetare e Kuvendit!

Komisioni për Legjislacion në mbledhjen e mbajtur më 19. 4. 2020 e ka shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë për shqyrtimin me urgjencë të Projektligjit dhe po ashtu ka shqyrtuar edhe Projektligjin në parim. Në fakt Komisioni për Legjislacion ka marrë dy vendime. Vendimin e parë e ka marrë për ta miratuar rekomandimin për Kuvendin e Republikës që të miratojë në parim projektligjin, ndërkohë që ka marrë edhe vendimin le të themi me unanimitet të plotë, respektivisht me dhjetë vota për nga të gjithë të pranishmit, që ta procedojë le të themi me procedura të përshpejtura.

Megjithatë, duke mos i ditur le të themi datën e seancës plenare, Komisioni nuk kishte hapësirë dhe mundësi për të precizuar afatet le të themi të këtij shqyrtimi. Unë konsideroj që Komisioni për Legjislacion e ka përmbushur le të themi përgjegjësinë që ka dhe rolin që ka për ta trajtuar me urgjencë dhe për ta proceduar në seancë, kështu që konsideroj që sot është e rëndësishme që të shqyrtohet rekomandimi i Komisionit për miratim të parim, ndërkohë që e tërheqim propozimin për ta shqyrtuar dhe miratuar në të dy leximet brenda ditës. Kështu që, për evidentim konsideroj që të procedojmë me rekomandimin e Komisionit për Legjislacion që të votohet në parim Projektligji nr. 08/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091. Ju faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)*

**KRYETARI:** Urdhëro kryetar i Komisionit, pasi po do edhe një herë.

**ADNAN RRUSTEMI:** Dy sqarime të veçanta për z. Gashi dhe z. Tahiri, mbase edhe për ju të tjerët.

Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë ka qenë për shqyrtim, për trajtim urgjent të Projektligjit dhe këtë gjë në fazën e parë komisioni e ka bërë, për të cilën natyrisht edhe i falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit që e kanë miratuar në mënyrë unanime. Natyrisht që vendimi i dytë që ka marrë Komisioni ka qenë propozimi për ta trajtuar me procedurë të përshpejtuar, duke rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në të dy leximet. Por, siç e thashë, duke qenë se Kryesia e Kuvendit nuk e kishte caktuar ende datën e seancës plenare dhe ne e kishim të pamundur për të definuar afatet e propozim-vendimit për shqyrtimin nga komisionet funksionale në mes të dy

leximeve, ne sot e tërheqim kërkesën për shqyrtim të përshpejtuar, duke e trajtuar në procedurë të rregullt. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Urdhëro edhe një herë kryetar i Komisionit, për arsye se duhet precizuar më mirë procedurat.

**ADNAN RRUSTEMI:** Është e qartë, po në raste të rralla, kur ka konsensus të plotë të Komisionit edhe konsiderohet nuk ka pengesa për procedim, Komisioni natyrisht që i qëndron propozimit për shmangie të Rregullores për shqyrtim në lexim të parë në këtë seancë, po jo për shqyrtimin dhe miratimin në të dy leximet brenda kësaj, brenda ditës. Kështu, për këtë jemi dakord dhe ky është propozimi edhe i Komisioni.

**KRYETARI:** Atëherë, e hap fjalën për t'u deklaruar shefat e grupeve parlamentare. Urdhëroni prej Lëvizjes Vetëvendosje, kush e ka fjalën. Shefja e Grupit, Mimoza Kusari-Lila, urdhëroni.

**MIMOZA KUSARI-LILA:** Faleminderit, kryetar!

Atëherë pas ika ndryshim të formatit, në fakt mënyrës sesi do të procedohet propozim-ndryshimi, propozoj që mund ta vendosim në votim, dhe me rrëzimin në votim, me vendimin fillestar çfarë e ka pasur në Kryesi, atëherë shkon me procedurë të rregullt.

**KRYETARI:** Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, Abelard Tahiri.

**ABELARD TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

Është krijuar një rrëmujë e panevojshme. Realisht, pra mes juve si mazhorancë këtu në Kuvendin e Kosovës. Ne e kemi diskutuar shumë mirë në mbledhjen e kaluar të Kryesisë, dhe meqenëse ka qenë kërkesë e prokurorëve të Prokurorisë Speciale që i trajtojnë krimet e luftës, pavarësisht që jemi opozitë, e kemi trajtuar dhe jemi pajtuar që të vijmë në seancë dhe kjo të trajtohet me urgjencë. Sot është e pashpjegueshme dhe e pakuptueshme pse po tërhiqen në këtë rast prej trajtimit në një procedurë të përshpejtuar një çështje kaq e rëndësishme.

Pra, e keni plotë fjalën luftë kundër korrupsionit, e keni plotë gojën që këta kriminelë të luftës t'i vendosni para drejtësisë, edhe duke i dënuar në mungesë dhe pse po ndodhin çështje të tilla? Prandaj, nuk është mirë të na vini në lajthitje as neve si shefa të grupeve dhe Kryesinë e Kuvendit që të trajtojmë tema të tilla kaq të rëndësishme dhe në raste të tilla kërkojmë një koordinim më të mirë dhe harmonizimi më të mirë mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe mazhorancës në këtë Kuvend.

Pra, situata të tilla, degjenerime të tilla janë të panevojshme dhe situata të tilla e humbin seriozitetin në një çështje kaq të rëndësishme qysh është pra gjykimi në mungesë. Edhe pse vlen të theksohet se po e përmirësojmë një gabim të cilin e ka bërë pikërisht pra Lëvizja Vetëvendosje

më 2019 që nuk e ka përkrahur propozimin tim që e kam sjellë, mirëpo e ka votuar një propozim të gabuar që sot po duhet ta ndryshojmë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën prej Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shefi i grupit, Arben Gashi.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit i nderuar kryetar i Kuvendit!

Për hir të së vërtetës këtu nuk ka një paqartësi. Po mundohem ta kuptoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion. Është ende fillimi si kryetar i Komisionit derisa të përshtatet me procedurat dhe rregullat e Kuvendit. Ai nuk e ka të qartë a propozoi mocion procedural në emër të grupit parlamentar apo foli në emër të Komisionit. Sepse të flasësh në emër të Komisionit, duhet të mbliidhet Komisionit ta autorizojë të flasë. Ajo çka kemi ne të shkruar këtu, thotë, ndër të tjera arsyetimi: duke u bazuar në konstatimet e theksuara, Komisioni i propozon Kuvendit që shqyrtimi i parë dhe i dytë i Projektligjit të bëhen me procedurë të përshtetshme. Ndërsa aty flet diçka tjetër, nuk po e kuptoj në emër të kujt po flet.

Tash le të kthehemi te çështjet më përmbajtjesore. Është e vërtetë që ky Projektligj është propozuar kohë më parë në këtë Kuvend, që të plotësohet dhe personat të cilët kanë kryer krime lufte dhe vepra të tjera penale të gjykohen në mungesë. Tash këtu pak më komplekse e bëri situatën Kryeministri kur foli në mëngjes në përgjigjen e deputetit, kur i tha që sot ne do ta shqyrtojmë një ndryshim në Kodin e Procedurës Penale, pra me një projektligj të veçantë, dhe kjo do të merret me fokus të veçantë me dënimin e vrasjes së dy aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje. Këtu fillon dhe bëhet ende më problematike çështja.

Zoti Kryeministër,

Për ty kam dy pyetje, disa pyetje, për të cilat ndoshta do ta sqaronin Kuvendin dhe opinionin. A e kuptoni që jeni Kryeministër i Kosovës? Dhe a e pranoni që jeni Kryeministër i Kosovës? Nëse po, atëherë këtu kemi problemin e motivit të asaj proteste që është organizuar dhe kemi lidhjen shkak-pasojë, që ka të bëjë me veprën penale të cilës ju iu referuat. Pra, ju keni pasur një motiv për të thirrur një protestë në sheshin e Prishtinës kundër Pakos së Presidentit Ahtisari.

Pra, për pasojë kundër shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kryeministër i së cilës ju sot jeni. Pra, motivi ka qeë kundër asaj pakoje, dhe janë vlarë disa njerëz në shesh, të tjerë janë plagosur, të tjerë janë dënuar. Më duket që edhe ju vetë jeni dënuar për organizim të paligjshëm të protestave, po këtu nuk jam shumë i sigurt. E di që ke qenë në arrati për një kohë të gjatë për shkak të kësaj vrasjeje.

Pra, kur jemi këtu, motivi i asaj proteste ka qenë protesta kundër Pakos së Presidentit Ahtisari, si pasojë e të cilës është shpallur pavarësia e Kosovës, kryeministër i të cilës ju jeni. Shkaku, dhuna në shesh nga të dyja palët. Kjo që po e them nuk e arsyeton në asnjë formë dhe në asnjë rrethanë vrasjen që kanë bërë policët e UNMIK-ut që vinin nga Rumania.

Pra, ne e përkrahim që edhe me procedurë të përshpejtuar të kalojë ky projektligj dhe ju të filloni procedurat e gjykimit edhe për këta policë. Pra e përkrahim si opozitë, besoj se jeni koordinuar edhe me të tjerët. Këtu kemi pasojën. Pasoja janë dy shtetas të Kosovës të vrarë, disa të lënduar, dëme të mëdha njerëzore dhe materiale, shumë të tjerë të dënuar dhe të cilët tash e 14-15 vjet nuk mund as të lëvizin jashtë Kosovës për shkak se janë kualifikuar si vepra penale akte terroriste etj.

Pra, a po e kuptoni se për çka po bëhet fjalë, si në aspektin procedural që e keni bërë një tollovi këtu dhe nuk po e dini se çka po kërkon, si në aspektin përmbajtjesor, ideor. Pra ideja e këtij shteti, e cila prej jush nuk është pranuar, dhe tani po thoni që është e mirë Pakoja e Presidentit Ahtisarit. Është mirë, është një evoluim i pranueshëm, i kënaqshëm nga ana juaj, por nëse ju iu referuat vetë në përgjigjet që i dhatë deputetit për raportet me UNMIK-un dhe i thatë se ai raport dhe ai diskutim me Shefin e UNMIK-ut është bërë për shkak të kësaj çështjeje, atëherë këtu gjërat komplikohet hale më shumë. Pra, ju po e takoni Shefin e UNMIK-ut të cilin e mohoni. Dhe shteti i Kosovës e mohon UNMIK-un sepse thotë është e tejkalluar Rezoluta 1244. Ju e riaktivizoni pas 15 vitesh këtë punë. Problemi tjetër që na del këtu zotëri Kryeministër, ka të bëjë me ngjarjet në sheshin e Prishtinës, me ngjarjet e organizuara nga ju, të cilat ju pretendoni që me këtë ligj do t'i dënoni pjesën tjetër, sepse një pjesë është dënuar.

Pra, pjesa e organizatorëve dhe e protestuesve në shesh, sipas vendimeve të gjykatave të Kosovës, janë gjykuar dhe dënuar. Pjesa tjetër, që kanë qenë përfaqësuesit e UNMIK-ut të cilët janë konsideruar se kanë imuniteti ndërkombëtar, të cilët edhe ju me të drejtë e cituat, nuk janë gjykuar dhe nuk kanë marrë verdiktin e gjykatës për këtë çështje. Ju po pretendoni se me këtë ligj t'i gjykoni dhe t'i dënoni këta persona.

Pra, tash po na del problemi akoma më kompleks. Çështjet po vijnë dhe po bëhen të paqarta. Pse po tërhiqeni tash, ne po ju përkrahim.

Pra, ne deklaram që ju përkrahim, me procedurë të përshpejtuar, sot t'i kryejmë të dy leximet.

Esenca e idesë së shtetit, e ardhur si rezultat i një procesi të negociuar ndërkombëtar, i cili normalisht nuk është i kënaqshëm dhe i dëshirueshëm prej asaj që kemi kërkuar dhe aspiruar ne si qytetarë të Republikës së Kosovës, ka ardhur si rezultat i një procesi të negociuar të Pakos së Presidentit Ahtisari, protestë ndaj të cilës ju keni organizuar. Aktet të cilat kanë ndodhur në shesh janë akte të dhunës dhe akte kriminale të vrasjes së dy qytetarëve të Kosovës, të dy qytetarëve të ndershëm, vullnetmirë dhe dashamirë të këtij vendi. Pra, nëse ju vërtet besoni se me këtë ligj do të dënohen këta persona, pse po tërhiqeni tash, e para. Dhe e dyta, komplet ideja e shtetit të Kosovës, të cilën ju e keni mohuar që në gjenezë, po vjen në pikëpyetje nga mënyra sesi ju po mendoni.

Pra, a mendoni se jeni kryeministër i kësaj Republike? Nëse po, atëherë a mendoni që në gjenezë e keni pasur problem organizimin e protestës së dhunshmet që ka shkaktuar dëme të mëdha materiale dhe jetësore për qytetarët e Kosovës. E treta, a e kuptoni që këtu ka, është vepër penale. Ekzistojnë tri elemente të cilat duhet patjetër të ekzistojnë: motivi, shkakut dhe pasoja. Pra ka një motiv, që ju keni organizuar një protestë dhe motivi ka qenë për të kundërshtuar Pakon e Presidentit Ahtisari. Shkaktari dhuna nga të dyja palët në sheshin e Prishtinës. Pasoja, vrasja e dy qytetarëve të Kosovë dhe plagosja e disa të tjerëve. Dhe këtu vijmë në përfundimin se komplet ajo çka është deklaruar në këto 15 vjet të fundit, ka qenë e pasaktë, e padrejtë, a pamoralshme, jopolitike dhe mashtrim. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Prej AAK-së, fjalën e ka shefi i grupit, Besnik Tahiri.

**BESNIK TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

A ka mundësi zoti kryetar i Komisionit dhe shefe e Grupit Parlamentar të jeni pak më serioz në këtë temë? A ka mundësi? Ne kemi pasur një debat shumë përmbajtjesor, shumë konstruktiv në Komisionin për Legjislacion për këtë temë. Pra, për shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale. Kemi diskutuar dhe e kemi trajtuar temën dhe është thënë që ndryshimi i dy neneve në këtë ligj me procedurë të përshpejtuar, e ndihmon të drejtën dhe të vërtetën në Kosovës të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke e mundësuar gjykimin në mungesë. Kjo ka qenë tema, kjo ka qenë përmbajtja.

Tani, vijmë në një situatë, kur pas fjalimit të Kryeministrit ndërlihet edhe një temë tjetër që është shumë përmbajtjesore, është shumë e dhimbshme për qytetarët e Kosovës, lidhet me përfaqësues të UNMIK-ut, diskutohet një përmbajtje tjetër, e cila nuk është diskutuar në Komision, e qe besa nuk është diskutuar as në Kryesinë e Parlamentit të Kosovës, në Kryesinë që kemi diskutuar ne. Si parti opozitare ne e kemi mbështetur dhe në asnjë moment nuk e kuptojmë tash njëfarë situatë ta qesim para aktit të kryer, të kërkojmë, të ndryshojmë, të tërheqim këtë procedurë. Pse?

Në qoftë se duhet ndryshuar përmbajtja, kjo përmbajtje nuk ndryshohet në seancë, kjo përmbajtje ndryshohet në Komision, ku ne ulemi, diskutojmë, debatojmë. Ndoshta ka edhe ndonjë temë tjetër që duam ta fusim këtu, po jo të na sillni në një situatë ku kërkoni njëherë këtë për procedurë të përshpejtuar, pastaj kërkoni votën për një procedurë të rregullt. A po e shihni që nuk po dini?! A po e shihni që e keni qasjen ad hoc? A po e shini që po merrni hyxhym që të sillni ligje, njësoj sikurse me Ligjin për zgjedhje, edhe nuk keni konsensus as brenda vetvetes.

Ju lutem, nuk jemi kundër, jemi që t'ju mbështesim në tema që e sjellin të vërtetën, që e trajtojnë të drejtën tonë elementare që buron nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në qoftë ka qenë kërkesë e ministres, është legjitime. Është shumë legjitime që një ministre të komunikojë me grupin e vet parlamentar, dhe ta ketë një kërkesë për tërheqje, por kjo nuk bëhet me këtë

ballafaqim bre. Kjo bëhet kur ne ulemi bashkë, e diskutojmë sikurse e kemi diskutuar në Komision për Legjislacion.

Bashkohemi shefat e grupeve parlamentare, e diskutojmë dhe e mendojmë që për një të mirë më të madhe për shtetin, duhet që ky ligj të zgjerohet apo të ngushtohet, por jo në këtë formë. Nuk është kjo formë, ju lutem!

Unë e pashë që edhe shefja e grupit parlamentar ishte shumë nervoz kur diskutuam për temat që janë reale, që janë praktike, për mungesën e planit, për mungesën e veprimeve, por nuk duhet të jetë ajo nervozë, duhet të merret përgjegjësia.

E keni fituar pushtetin, veproni qeverisni, të mos gjykoni.

**KRYETARI:** Nga Partia Demokratike e ka fjalën deputeti Hajdar Beqa.

**HAJDAR BEQA:** Faleminderit kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

E kam kuptuar më 2019-ën, tash ministren që është aktualisht, zonjën Haxhiu, e cila ngutej në procedura për këtë plotësim-ndryshimin e ligjit, respektivisht Kodit të Procedurës Penale, sepse në atë kohë ishte në opozitë.

E kishte qeveria, ku ishte ministër zoti Tahiri, e kishte një propozim të bërë një ndryshim të Kodit të tërësishëm, ku u rregullonte dhe kjo çështje, mirëpo ishte një nguti e Lëvizjes Vetëvendosje atëherë, pikërisht te neni përkatës të cilën po kërkojnë që ta ndryshojnë të njëjtit aktorë, dhe nuk e di se pse po nguten sot.

Kryetari i komisionit, e kam një sugjerim, ne në komision e kemi shqyrtuar këtë çështje. Jemi dakorduar në fund që ta bëjmë plotësim-ndryshimin e neni përkatës, respektivisht të Kodit të Procedurës Penale, po kur e merr një vendim komisioni, atëherë kryetari i komisionit nuk ka të drejtë që të tërhiqet në emër të komisionit, vetëm nëse ka ndonjë votim nga Kryesia e Kuvendit apo nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e tij të fundit ka vlerësuar se propozimi për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht ndryshimi i një neni të vetëm, i cili lidhet me gjykimin në mungesë, është i rëndësishëm.

Megjithatë, edhe pse në komision e kemi përkrahur në parim, më lejoni që t'i informoj edhe kolegët e tjerë deputetë, se Qeveria e ka sjellë këtë plotësim-ndryshim pa e zhvilluar ndonjë konsultim, pa e bërë një analizë të qartë e të saktë, dhe pse ka ardhur deri te ky propozim.

Duke e trajtuar në procedurë të përshpejtuar është cenuar rëndë parimi gjithëpërfshirës i konsultimeve dhe ai i transparencës, për arsye se është propozuar ndryshimi i njërit prej ligjeve vitale të drejtësisë. Ndërkohë, neve si deputetë na mungon një shpjegim i shterues e me argumente se çfarë nuk shkon në zbatimin e nenit përkatës.

Ne e kemi parë që ministria e ka sjellë shkresën për urgjencë. E ka sjellë edhe një mendim apo një shkresë të një prokurori përkatës, por ne ende nuk e dimë se a është qëndrimi i një prokurori apo është qëndrim i Këshillit Prokurorial, apo vetëm është dashur të bëhet një veprim i tillë.

Ne në parim pajtohemi. Po ashtu, të mos harrojmë që rreth tri vite më parë, pikërisht nenin që sot është në fuqi për gjykimin në mungesë, për të cilin sot po kërkohet plotësim-ndryshimi i tij, edhe në atë kohë ka ardhur nga deputetët e opozitës.

Për informimin e publikut, kjo që shkresë që ka ardhur nga Prokuroria, e që i është bashkëlidhur letrës së ministres së Drejtësisë, nuk përmban as edhe ermin e autoritetit që e ka propozuar. Pra, nuk e dimë se këtë ndryshim e ka propozuar, thash edhe më herët, se a e ka propozuar në emër të vet apo në emër të Këshillit Prokurorial.

Nuk do të ndalem më tutje. Megjithatë, e them ashtu siç e tha e dhe zoti Tahiri, ne e kemi thënë edhe në Komision për Legjislacion, ku e kemi mbështetur plotësim-ndryshimin në procedurë të përshpejtuar, e mbështesim edhe sot çdo propozim që i përshpejton procedurat për hetimin dhe gjykimin e krimeve në mungesë dhe zbardhjen e të vërtetës së hidhur e të munguar për më shumë se dy dekada.

Ne e dimë që deri në përfundimin e mandatit të EULEX-it, respektivisht e kanë gjykuar prokurorët, ka qenë në kompetencë të prokurorëve ndërkombëtarë të EULEX-it dhe të UNEMIK-ut, dhe dëshiroj që sot ta kemi këtë plotësim-ndryshim në procedura të përshpejtua, ashtu siç kemi vendosur në komision.

Po ashtu, dëshiroj që Ministria e Drejtësisë ta sjellë Kodin e Procedurës Penale, sepse Kodi i Procedurës Penale ka nevojë për një plotësim dhe ndryshim të tërësishëm. Faleminderit!

**KRYETARI:** Prej LDK-së e ka fjalën Armend Zemaj.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryetar!



KRYETARI: Armend, nëse e ka Lidhja Demokratike e Kosovës qëndrimin që e pati zoti Gashi, a po kalojmë te komisioni dhe ta mbyllim këtë çështje, sepse ka pajtueshmëri? Si të duash.

ARMEND ZEMAJ: Kemi pajtueshmëri të plotë, po nëse po flasim për procedurë dhe po i referohemi procedurës, këtu kemi të bëjmë jo vetëm në aspektin teknik edhe procedural, por edhe shumë përmbajtjesor.

Nuk e dëgjuam që ka ndonjë ndryshim nga ministrja apo Ministra e Drejtësisë, qoftë apostrofimin në të kaluarën apo në të tashmen. Problemi është te qëndrimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, cili është shumë konfuz dhe në kundërshtim edhe me pjesën teknike që e paraqiti kryetari i Komisionit për Legjislacion, qoftë me vetëdije apo pa vetëdije të plotë.

Ky është sqarimi që duhet ta japë Qeveria si sponsorizuese e këtij plotës-ndryshimi edhe qëndrimi politik i shumicë parlamentar, i cili duket që jo vetëm që nuk është i koordinuar, por ka ndryshuar nga ditët apo nga takimet që vetëm u proklamuan këtu nga shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, dhe qëndrimet e tjera të subjekteve politike opozitare.

KRYETARI: Meqenëse po e shoh që ekziston një konsensus duke iu dëgjuar se çfarë po flisni të gjithë, fjalën edhe një herë në mënyrë përfundimtare e ka kryetari i komisionit, Adnan Rrustemi, dhe të shkojmë në procedura të votimit më shpejtë.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

E falënderoj secilin deputet nga grupet parlamentare për kontributin!

Qëllimi i qartë, po e shpjegoj para se të kaloj në propozim-vendim që Komisioni për Legjislacion përveç miratimit, le të themi, të rekomandimit për shqyrtim dhe miratim në lexim të parë, ka marrë vendimin për shqyrtim dhe miratim, le të themi, me procedurë të përshpejtuar.

Por, megjithatë nuk ishte precizuar, le të themi, periudha, për shkak të mungesës së datës së seancës. Sidoqoftë, kthehemi te propozim-vendimi i Komisionit për Legjislacion.

Komisioni për Legjislacion propozon që shqyrtimi i parë dhe shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091, të bëhet me procedurë të përshpejtuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 15.7, nenin 56, paragrafi 1, me neni 57, paragrafët 3, 5, 8, 9, dhe nenin 64, paragrafi 4, të Rregullores së Kuvendit si në vijim:

Shqyrtimi i parë Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.06/L-091, të bëhet në seancë plenare më 26 prill 2021.

Pas miratimit në shqyrtim të parë, amendamentet për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123, të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091, mund t'i adresohen Komisionit FunkSIONAL, deri më 26. 4. 2021, ora 14:00.

Komisioni FunkSIONAL, deri më 26. 4. 2021, ora 15:00, duhet ta shqyrtojë projektligjin, dhe raportin e rekomandimit duhet t'ia paraqesë komisioneve të përhershme.

Komisionet e Përhershme, deri më 26 prill, ora 14:00, duhet ta shqyrtojnë projektligjin, dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit FunkSIONAL. Komisioni FunkSIONAL, deri më 26 prill 2021, ora 16:30, duhet ta paraqesë raportin me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancë plenare. Propozoj që të hedhet në votim propozim-vendimi i komisionit. Ju faleminderit!

*(Ndërprerje e incizimit)*

KRYETARI: A ka mundësi që të ofrohen shefat e grupeve për një konsultim të shkurtër.

*(Ndërprerje e incizimit)*

Mund t'i zini vendet, edhe qetësi, ju lutem!

Atëherë, për shkak të mungesës së konsensusit të grupeve parlamentare lidhur me afat të cilat u lexuan dhe për të cilat nuk ka pajtueshmëri të plotë e ka dallime, i vetmi emërues i përbashkët që e arritëm është që dokumenti i cili është shpërndarë faktikisht, edhe i cili është nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrje e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e cili i është shpërndarë deputetëve, por i cili është pa afate të cilat i lexoi zoti Rrustemi, po e procedojmë përmes shmangies së Rregullores së Kuvendit të Kosovës, me 2/3, nëse ajo i merr votat e nevojshme, natyrisht.

Atëherë, kërkohet deklarimi me votim për miratimin e propozimit të Komisionit FunkSIONAL, që shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr.04/L-123, të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091, të bëhet me procedurë të përsheptuar, pra shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1.

Po jua kujtoj nenin 84 të Rregullores së Kuvendit: Për t'iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm. I lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimin. Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatohet se me 92 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet propozimi i Komisionit FunkSIONAL që shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123, të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091, të bëhet me

procedurë të përshpejtuar, pra shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 565, paragrafi 1, të Rregullores së Kuvendit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zonjën Albulena Haxhiu që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

**MINISTRJA ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Konjufca!

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Paraqes para jush Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L -091.

Para dy viteve, duke e pasur parasysh që kishin kaluar dy dekada dhe krimet e luftës nuk ishin trajtuar seriozisht, me iniciativën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Kuvendi kishte votuar ndryshimin që lejonte hetimin, akuzimin dhe gjykimin e pandehurve në mungesë, duke respektuar standardet e së drejtës për gjykim të drejtë dhe parimeve tjera të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Ky ndryshim lejonte hetimin, akuzimin dhe gjykimin në mungesë të atyre që dyshohen që kanë kryer vepra kundër të drejtë ndërkombëtare humanitare dhe kundër të drejtës ndërkombëtare penale, në situatat kur ata nuk mund të vihen në dispozicion të autoriteteve të Republikës së Kosovës sipas parimeve të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.

Ky ndryshim vlerësohej si mundësi e madhe për trajtim serioz të rasteve të krimeve të luftës në Kosovës, duke pasur parasysh faktin që ende nuk ka drejtësi për krime të luftës dhe ende kriminelët e luftës enden të lirshëm dhe Serbia nuk i dorëzon ata

Pavarësisht që ka kaluar shumë prej kur ky ndryshim kishte hyrë në fuqi, ende asnjë rast nuk është gjykuar në mungesë, pasi që Prokuroria Speciale po e konsideron që për shkak të vështirësive të hasura në praktikë, nuk ka mundur që i njëjti ndryshim të zbatohet.

Në mandatin e kaluar, pra në mandatin e parë të Qeverisë Kurti 1, unë isha në dijeni sa i përket kësaj pengese nga Prokuroria Speciale. Pra, edhe asokohe kur kam pasur takim, pra para një viti, kur kam pasur takim me prokurorët specialë, e kanë adresuar këtë pengesë.

Menjëherë, nëse ju kujtohet e besoj që ju kujtohet, Ministra e Drejtësisë ka ndërmarrë veprime për adresimin e këtij ndryshimi me urgjencë, mirëpo për shkak të rrëzimit të Qeverisë së asaj kohe, pastaj Kuvendi nuk pranonte asnjë projektligj në trajtim nga Qeveria Kurti 1. Rrjedhimisht, me t'u ndryshuar qeveria, Qeveria Hoti kishte tërhequr nga procedurat këtë projektligj.

Nuk i di arsyet se pse e ka bërë këtë, por megjithatë Qeveria Hoti e kishte tërhequr këtë projektligj nga procedurat.

Me të marrë detyrën tash sërish si ministre, në takim që kisha me përfaqësuesit e sistemit prokurorial, u adresua nevoja e disa ndryshimeve, pra të cilat edhe i kemi sjellë. Për t'ju përgjigjur deputetit Hajdari, është e vërtetë, ky propozim është bërë pa ndonjë konsultim, sepse nuk besoj që ka nevojë për konsultime të tjera shtesë pas dy dekadave për nevojën për adresimin e krimeve të luftës, meqë është vetëm një nen i cili po ndryshohet dhe po ashtu e adresoj çështjen se cili prej prokurorëve specialë ka kërkuar apo Këshilli Prokurorial apo Prokuroria Speciale.

Në takimin që e kam pasur me kryeprokurorin e Shtetit, zotin Aleksandër Lumezi, po ashtu i pranishëm ka qenë kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, zoti Blerim Isufaj dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, zoti Kujtim Munishi, dhe në këtë takim ata kanë paraqitur nevojën e trajtimit urgjent të këtyre ndryshimeve dhe menjëherë pas atij takimi kam nga Departamenti Ligjor përbrenda Ministrisë së Drejtësisë që t'i nisë ndryshimet e njëjta që i kishim proceduar në vitin e kaluar.

Pra, meqë ishte kërkesë dhe nevojë e Prokurorisë Speciale, ne si ministri menjëherë jemi angazhuar për adresimin e këtyre kërkesave nga Prokuroria Speciale, me të cilat e kemi njoftuar edhe Komisionin për Legjislacion, për çka sot, i falënderoj jashtëzakonisht shumë për unanimitetin e treguar në mbështetjen e këtij ndryshimi.

Qëllimi i këtyre ndryshimeve është si në vijim: së pari, siç e dini, kompetencën për adresimin e krimeve të luftës dikur e kishte UNMIK-u, pastaj EULEX-i. Me përfundimin e mandatit ekzekutiv të EULEX-it, lëndët nga ky mision kanë kaluar nën kompetencën e institucioneve vendore.

Në kohën kur kanë kaluar tek institucionet vendore, janë disa lëndë e jo pak, janë goxha shumë, për të cilat ishte nxjerrë aktvendim për nisjen e hetimeve, por për të cilat nuk ishte marrë aktvendim për pezullim.

Në mënyrë që Prokuroria Speciale të ketë kohë dhe mundësi që të t'i trajtojë këto raste dhe të mos rrjedhë afati, atëherë është i rëndësishëm ndryshimi që është propozuar si në projektligj.

Ndërsa ndryshimi tjetër ka të bëjë me atë, se një nga kriteret për t'u gjykuar dikush në mungesë, ishte edhe kërkesa që pesë herë duhet të kërkohet personi në fjalë në vendin ku supozohet se gjendet.

Këtë kriter Prokuroria Speciale e ka konsideruar vështirë të implementueshëm, andaj në mënyrë që të hiqen pengesat që mund të vështirësojnë adresimin e rasteve të krimeve të luftës, është propozuar largimi i këtij kriteri.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Kanë kaluar më shumë se dy dekada prej kur ka përfunduar lufta në Kosovë, dhe deri tani nuk ka pasur trajtim serioz të krimeve të luftës. Drejtësia në Kosovë ka qenë në shpërputhje me të vërtetën.

Duket që mungesa e vullnetit politik, ka bërë që kjo mungesë të reflektojë edhe tek institucionet e drejtësisë. Një nga prioritetet e Qeverisë sonë, është adresimi serioz i krimeve të luftës. E kemi vendosur si prioritet. Pra, në vijë vetëingun, në vijë me luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në vijë me adresimin e mekanizmave institucional kundër dhunës në familje është edhe adresimi i rasteve të krimeve të luftës.

Në maj do të nisim punën me themelimin Institutit për Krimet e kryera gjatë luftë së fundit në Kosovë, si dhe do të fuqizojmë kapacitetet e Prokurorisë Speciale në adresimin e krimeve të luftës.

Aktualisht në Prokurorinë Speciale janë vetëm katër prokurorë që trajtojnë të gjitha lëndët e krimeve të luftës, e konsiderohet që janë afër 800 apo 900 lëndë që janë të kërkuara nga EULEX-i.

Sa i përket adresimit të gjykimit në mungesë për të gjitha veprat e tjera sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ju njoftoj që ne si ministri jemi duke punuar në draftin e ri të Kodit të Procedurës Penale, që është duke u zvarritur diku që dy vjet dhe jemi duke i adresuar edhe disa çështje, të cilat ose janë vendosur gabimisht ose nuk janë adresuar.

Prandaj, kërkoj mirëkuptimin tuaj që për shkak të urgjencës të votohet një herë ky ndryshim dhe pastaj besoj që shumë shpejt, ndoshta brenda dy muajve, ne do të procedojmë me Kodin e Ri të Procedurës Penale, ku parashihet edhe gjykimi në mungesë për të gjitha veprat e tjera dhe jo vetëm për rastet apo krimet e luftës.

Edhe një herë ju falënderoj për unanimitetin e treguar dhe ju ftoj që ta mbështetni këtë ndryshim.

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Adnan Rrustemi, që ta paraqesë dhe të arsyetojë raportin e komisionit.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill ka shqyrtuar edhe kërkesën e ministres së Drejtësisë, por edhe projektligjin e proceduar si dhe ka miratuar në unanimitet, siç e thashë, për të rekomanduar Kuvendin që ta shqyrtojë dhe ta miratojë në parim në lexim të parë.

Siç e shihni, projektligji ka gjithsej tre nene, realisht një nen substancial dhe dy nene të tjera që përcaktojnë qëllimin dhe aspekte përcjellëse.

E kështu siç tha edhe ministrja Haxhiu ka për qëllim të tejkalojë pengesa të identifikuar nga Prokuroria Speciale në lidhje me mundësinë e zbatimit të hetimit, akuzimit dhe gjykimit në mungesë për krimet e luftës në Kosovë.

Përkundër që Kodi i Procedurës Penale ka ndryshuar në vitin 2019, gjithmonë me synimin për të adresuar trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë, disa pengesa, siç ka qenë pamundësia, le të themi, për pezullimin e hetimeve dhe afatet kohore, por edhe dy elemente të tjera, respektivisht kriteret siç ka qenë obligimi ose detyrimi për të dorëzuar pesë herë radhazi kërkesat shtetit apo shteteve ku supozohet që ndodhet i pandehuri dhe vetëm në rastet kur refuzohet ose neglizhohet në mënyrë të hapur, mund të procedohen procedurat e gjykimit në mungesë.

Po ashtu dhe obligimi ose detyrimi për të bashkëpunuar me të gjitha kanalet ndërkombëtare policore, duke përfshirë Interpolin dhe Europolin, e ka bërë të vështirë nisjen e procedurave dhe gjykimit në mungesë.

Kësisoj ky projektligj, megjithëse me tri nene e me përmbajtje teknike, ka efekte të rëndësishme në adresimin e krimeve të luftës.

Komisioni i rekomandon Kuvendit që të miratojë në lexim të parë projektligjin, ndërsa në përputhje me qëndrimin ose dakordimin e grupeve parlamentare, leximi i dytë të bëhet pas mbledhjes së Komisionit për Legjislacion, në një moment tjetër.

KRYETARI: Faleminderit! Tash koha e grupeve parlamentare, Lëvizja Vetëvendosje, urdhëroni zoti Rrustemi!

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Para dy vjetëve ishte miratuar Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale, përmes të cilit parashihej dhe përcaktohej mundësia e gjykimit në mungesë.

Ky ishte një ndër ndryshimet më të rëndësishme në Kodin e Procedurës Penale për sa i përket adresimit të krimeve të luftës në Kosovë që krijonte mundësinë e hetimit, akuzimit dhe gjykimit në mungesë për ata që kanë kryer vepra penale kundër të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të drejtës ndërkombëtare penale.

Me gjithë këtë, që nga atëherë e deri tani nuk është zbatuar asnjëherë për asnjë rast të krimeve të luftës në Kosovë. Krejt kjo me arsyetimin se disa prej kritereve që përmbante ky ligj në kontestin e Kosovës nuk mund të gjejnë zbatim ose vështirësonin hetimin, ngritjen e akuzave dhe gjykimi në mungesë.

Kushtëzimi i hetimit, akuzimit dhe gjykimit në mungesë të të pandehurve me shterimin e mundësive, siç ishte kërkesa po së paku pesë herë drejtuar shtetit strehues dhe vetëm pasi një kërkesë e tillë të jetë refuzuar apo neglizhuar tërësisht nga organet e shtetit pranues, në rastin tonë ku i pandehuri ndodhet në Serbi, bëhet e pamundur.

Po ashtu, detyrimi që të jetë dhënë në shfrytëzim paraprakisht çdo kanal i bashkëpunimit ndërkombëtar policor dhe një kanal i tillë të ketë dështuar për ta ndaluar personin nën hetim, nënkupton të gjithë mekanizmat policorë, përfshirë Interpol dhe Europol, me të cilët bashkëpunimi është i ndërlikuar për arsye që dihen dhe kësi soj bëhen peng për fillimin e gjykimit në mungesë.

Në anën tjetër, pamundësimi për pezullimin e hetimit dhe lejen në fuqi të afateve kohore që kufizonin periudhën e hetimit, pengonte mbylljen e hetimeve dhe ngritjen e akuzave brenda afatit ligjor prej dy vjetësh dhe gjashtë muaj shtesë me vendim gjykatë.

Aq më tepër, siç arsyeton edhe vetë Prokuroria Speciale, që ka një numër të rasteve të krimeve të luftës, për të cilat prokurorët ndërkombëtarë të EULEX-it apo UNMIK-ut kanë nxjerrë aktvendime për fillimin e hetimeve, por që nuk i kanë përmbyllur ato brenda afateve ligjore, ndërsa prokurorëve vendorë pas transferimit të përgjegjësive iu ka mbetur kohë e shkurtër për t'i përfunduar ato.

Gjykimi në mungesë për krimet e luftës në Kosovë është i domosdoshëm, është e kuptueshme që gjykimi në mungesë nuk shpague viktimat dhe nuk përmbush pritjet për drejtësi. Sidoqoftë, gjykimi përgjegjësve të krimeve të luftës në Kosovë, qoftë edhe në mungesë, është detyrim moral e institucional i shtetit të Kosovës për të bërë atë çfarë ka mundësi të bëjë dhe për të reflektuar edhe formalisht përmes proceseve gjyqësore të vërtetën e krimeve të Serbisë në Kosovë.

Në Kosovë gjatë luftës janë bërë një numër i madh i krimeve, krime kundër njerëzimit dhe krime të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare, në formë të vrasjes së civilëve, zhvendosjes së detyruar të popullatës civile, burgosjes së paligjshme, torturës, dhunës seksuale, trajtimit çnjerëzor, grabitjes dhe shkatërrimit të pasurisë, objekteve kulturore dhe religjioze dhe veprave penale të tjera të ngjashme, të cilat janë kryer në Kosovë në mënyrë sistematike dhe në shkallë të gjerë.

Përkundër faktit të ditur botërisht se Republika e Serbisë ishte agresori, kurse Kosova viktimë, ndjekje dhe gjykime penale ndaj shqiptarëve kanë qenë shumë evidente se sa ndaj serbëve dhe ndaj zyrtarëve serbë që kanë kryer krime luftën në emër të Republikës së Serbisë. Të gjithë e dimë se krimet e Serbisë në Kosovë kanë qenë të ideuara, të projektuara dhe të ekzekutuara nga mekanizmat shtetërorë të Serbisë.

Në këtë drejtim, përballë disbalancit të madh etnik dhe numrit të viktimave nga lufta e fundit në Kosovë, paradoksalisht në hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë ky disbalanc ndryshon kahun tërësisht. Kësisoj dhe krejtësisht kundër realitetit dhe të vërtetës së krimeve të luftës në Kosovë gjatë periudhës kohore tetor 1999 - qershor 2020, nga gjyqtarët e UNMIK-ut, EULEX-it dhe atyre vendorë me aktgjykimet e formës së prerë janë dënuar gjithsej 40 persona, prej tyre 35 janë shqiptarë dhe vetëm katër serbë, apo 87,5% janë të etnisë shqiptare dhe vetëm 10% prej tyre janë të etnisë serbe.

Këto shifra pa dyshim që shpërfitojnë të vërtetën e krimeve të luftës në Kosovë. Kjo gjendje është e tillë si përgjegjësi e prokurorëve dhe gjyqtarëve ndërkombëtarë, por edhe për shkak të mosangazhimit të prokurorëve vendorë.

Në raportet e ndryshme që pasqyrojnë punën e sistemit të drejtësisë, e në këtë rast po përmend vetëm një, raportin hulumtues të Institutit Kosovar të Drejtësisë, rezulton se misioni për sundim të ligjit në Kosovë, EULEX, ka transferuar dhe është duke transferuar në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës afro 900 lëndë të krimeve të luftës. Gjithashtu afro 2 000 lëndë për persona të zhdukur janë transferuar dhe janë në vijimësi të transferimit nga Njësia për Krimet e Luftës e Policisë së EULEX-it në Njësinë Hetuese të Krimeve të Luftës të Policisë së Kosovës.

Pavarësisht faktit se ka kaluar një periudhë e gjatë që nga kryerja e krimeve dhe qasja te dëshmitarët bëhet e vështirë, provat vjetërsohen e dëmtohen, ky ndryshim ligjor që mundëson gjykimin në mungesë është i domosdoshëm, nga se mundëson nisjen pa humbur kohë të proceseve hetuese e gjyquese dhe kështu mundëson nxjerrjen para përgjegjësisë, qoftë edhe në mungesë, të të gjithë atyre që kanë kryer krime të luftës në Kosovë.

Ky projektligj që po e shqyrtojmë sot, sado ndryshim teknik, ka efekte të rëndësishme në drejtim të adresimit të krimeve të luftës, duke fshirë pjesën e dispozitës së Ligjit për detyrimin e



parashtrimin të kërkesës për së paku pesë herë ndaj shtetit apo shteteve, ku supozohet se ndodhet i pandehuri. Duke ndryshuar po ashtu kufizimin e bashkëpunimit me secilin mekanizëm ndërkombëtar e si zëvendësim me bashkëpunim ndërkombëtar policor, si dhe veçanërisht duke larguar nenin për pezullimin e hetimeve, si nen i dërguar dhe duke larguar kufizimin kohor, ne sot i heqim pengesat e identifikuar nga vetë Prokuroria Speciale për zbatimin dhe realizimin e gjykimeve në mungesë, duke hequr kësi soj edhe justifikimet për mosnismen e gjykimeve në mungesë.

Natyrisht që ky ndryshim nuk mjafton dhe nuk duhet të jetë veprim i vetëm në adresimin e krimeve të luftës në Kosovë.

Por, është një veprim i domosdoshëm në kuadër të një strategjie më të gjerë të veprimit që përfshin mbështetje institucionale për Prokurorinë Speciale e për departamentin special që gjykon rastet e krimeve të luftës, shtimi i prokurorëve, i hetuesve, i zyrtarëve ligjorë, i bashkëpunëtorëve profesionalë është po aq i nevojshëm. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nga PDK-ja e ka kërkuar fjalën shefi i Grupit Parlamentar, Abelard Tahiri.

**ABELARD TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Pra, gabimin që e ka bërë Lëvizja Vetëvendosje në vitin 2019, po mundohet ta përmirësojë sot. Mirëpo, realisht edhe ky është një gabim i radhës që po e bën, sepse e kemi propozuar në atë kohë, ka kaluar në lexim të parë Kodi i Procedurës Penale, ku është gabim që të dalim dhe ta specifikojmë dhe të kufizohemi në gjykimin në mungesë vetëm të krimeve të luftës.

Pra, gjykimi në mungesë duhet të vlejë edhe për vepra të tjera, që për rendin tonë, për sundimin e ligjit janë jashtëzakonisht të rëndësishme.

Po ia përkujtoj kryeministrit Kurti që e tha atë më herët që do të kërkojmë që policët, të cilët kanë kryer krimin ndaj dy qytetarëve të Republikës së Kosovës në vitin 2007, të gjykohen dhe të dënohen në mungesë dhe unë po i tregoj që me këtë propozim që e ka bërë ministrja e Drejtësisë, pjesë e Qeverisë së tij, nuk mund të ndodhë një gjë e tillë. Prandaj, ose s'jeni koordinuar, ose nuk po dini çka po propozoni, prandaj po ju them edhe një herë, sillni Kodin e Procedurës Penale, të cilin jua kemi lënë gati, nuk ka nevojë të zvarritet. Prita realisht një prezentim më të qartë për temën të cilën doli ministrja e Drejtësisë, mirëpo kjo doli më shumë për kronologjinë e ngjarjeve çka ka ndodhur në Qeverinë Hoti, çka ka ndodhur më vonë, e kështu me radhë.

Pra, është shumë e rëndësishme që Kodi i Procedurës Penale, të cilin e kemi miratuar në vitin 2019 në leximin e parë dhe që është kthyer pas dorëheqjes së kryeministrit Haradinaj, të vijë për

votim në Kuvendin e Kosovës, të cilit i mungon dënimi dhe gjykimi në mungesë edhe për vepra të tjera, që lidhen me krim të organizuar, me korrupsion, me vrasjen e Monë Balaj dhe Arben Xheladinajt dhe me shumë çështje të tjera që janë të rëndësishme, prapë po e them, për rendin tonë demokratik.

Çështje tjetër që është shumë e rëndësishme që të vijë për votim Kodi i Procedurës Penale është edhe pezullimi i zyrtarëve që janë në aktakuza. Pra, nëse po duam një angazhim më të madh në luftë kundër korrupsionit dhe në keqpërdorimin e detyrës zyrtare, sot të gjithë ata zyrtarë që janë nën aktakuza duhet të pezullohen prej detyrave, gjithmonë po flasim me vendimin e gjykatës. Pra, kjo është një çështje që duhet të adresohet sa më parë, është në koordinim të plotë, e kemi bërë edhe në vitin 2019 në koordinim të plotë me Bashkimin Evropian, në këtë rast, me Zyrën e Bashkimit Evropian në Republikën e Kosovës dhe është në linjë të plotë me ‘acquis communautaire’, me të cilën ne normalisht që duhet të koordinohemi.

Çështje tjetër që po ashtu është shumë e rëndësishme, është edhe zgjatja e afatit të hetimeve, pra edhe kur flasim për hetimin e krimeve të luftës, mendoj që janë shumë specifike dhe duhet të zgjatet afati, pra gjithmonë me vendim të gjykatës. Ju e dini që tash janë dy vjet, plus gjashtë muaj me vendim gjithmonë të gjyqtarit të procedurës paraprake dhe kjo duhet të shkojë deri në katër vjet. Pra, gjithmonë flasim me vendim të gjykatës, hetimet duhet të shkojnë deri në katër vjet. Pra, kjo e ndihmon edhe çështjen, kauzën mbi të cilën ne po thirrmi që duhet t’i nxjerrim para drejtësisë këta kriminelë, të cilët i kanë kryer krimet e luftës në Republikën e Kosovës.

Pra, janë bërë edhe çështje të tjera në kuadër të këtij projekt-kodit të procedurës penale që lidhen me procedurat e konfiskimit të pasurisë, që lidhen me deklaratat e të pandehurve dhe të dëshmitarëve që gjithmonë janë për rritjen e efikasitetit të organeve tona ligjzbatuese në Republikën e Kosovës.

E përmendi ministrja e Drejtësisë, që realisht më shumë fliste si opozitë se sa ministre e Drejtësisë, çështjen e prokurorëve, numrit të vogël të prokurorëve në departamentin special. Po, unë po jua përkujtoj që ka qenë Qeveria e parë, Qeveria Kurti, e cila e ka shkurtuar buxhetin për Këshillin Prokurorial, e cila e ka pamundësuar rekrutimin të prokurorëve të rinj në Prokurinë Speciale, do të duhej të rritej numri edhe në Departamentin Special, i cili i heton rastet e krimeve të luftës.

Pra, nuk mund të ankoheni e të thoni se janë veç tre prokurorë, sepse ju jeni Qeveri dhe ju duhet trajtuar, ju duhet ta rritni buxhetin për Këshillin Prokurorial, ju duhet ta rritni buxhetin për Këshillin Gjyqësor, ju duhet ndihmuar këtyre institucioneve në rekrutimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, ju duhet ndihmuar Policinë e Kosovës në specializimin e policëve tonë hetues në çështjet e tilla. Pra, nuk jeni opozitë, jeni Qeveri dhe trajtoni, sillni rishikimin e buxhetit, ta rrisim buxhetin për Këshillin Prokurorial, sillni rishikimin e buxhetit, ta rrisim buxhetin për

Policinë e Kosovës, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës që të jemi më efikas në trajtimin e këtyre çështjeve.

Pra, unë ju kërkoj që edhe një herë ta sillni Kodin e Procedurës Penale, Kodin Penal e kemi miratuar në prill, ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2019 dhe nuk ka kuptim të vazhdohet tutje me procedurat e vjetra që janë në fuqi të Kodit të Procedurës Penale që të ketë një efikasitet më të madh, atëherë silleni sa më shpejt javën tjetër, mos u vononi më shumë, silleni që tani. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën nga Lidhja Demokratike e Kosovës e ka deputeti Driton Selmanaj.

**DRITON SELMANAJ:** Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka trajtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale dhe në funksion të asaj që çështjet të cilat janë ngritur ose kërkesat që kanë dalë nga organet ndjekëse si vështirësi në zbatimin e këtij kodi, e sidomos për këto çështje specifike, ne si grup parlamentar e mbështesim në parim. Normalisht do të shohim nëse eventualisht ka diçka për të shtuar gjatë punimeve që do t'i zhvillojmë në Komisionin Parlamentar.

Por, unë do të shtoj edhe diçka tjetër, sepse u tha këtu që Qeveria e kaluar e ka tërhequr këtë projekt-kod. unë po ju them kështu që kjo ka ndodhur për shkak, të them, sugjerimeve dhe bashkëpunimin që ne kemi pasur me faktorët ndërkombëtarë dhe sidomos me Departamentin e Drejtësisë të SHBA-së dhe pse ka ndodhur kjo.

Ne kemi inkorporuar nenet për gjykim në mungesë pas opinionit të Komisionit të Venecias. Është dashur që t'i inkorporojmë nenet e suspendimit të zyrtarëve publikë kur u ngritet aktakuzë për vepra penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit. I kemi bërë disa përmirësime të gabimeve teknike që janë bërë më herët, për shembull, me Ligjin për gjykimin në mungesë është gabuar një nen në referencë dhe iu ka pamundësuar prokurorisë që të hetojë në mungesë. Po ashtu na është dashur të përpilojmë disa nene inovative për t'iu përshtatur situatës së pandemisë që po ndodh, që gjykimet ndodhin edhe përmes teknologjisë informative, edhe këto të gjitha janë bërë në bashkëpunim me miqtë tanë ndërkombëtarë.

Ajo e fundit çka më intereson mua, e nderuar ministre, kjo çështje që lidhet me gjykimin në mungesë, a është e kufizuar vetëm për krimet që kanë ndodhur, për krimet e luftës, apo është si parim i drejtësisë që do të vlejë për të gjitha rastet e tjera, sepse kryeministri pak më herët tha që edhe në rastin e vrasjes së dy aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, me këtë projekt-kod parashihet që të rregullohet ose të dënohen edhe pjesëtarët e policisë së UNMIK-ut të asaj kohe, që zoti Kurti i cilësoi kriminelë akoma pa pasur vendim në gjykatë. Pra, pyetja ime është, a vlen

vetëm për një periudhë të caktuar, apo është si parim i drejtësisë për të gjitha rastet e tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën prej Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka deputeti Bekë Berisha.

BEKË BERISHA: Faleminderit!

Po saktësoj, shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit numër 04/L-123 të procedurës penale, i ndryshuar dhe plotësuar në Ligjin numër 06/L-091.

Ne në Komisionin Legjislativ i kemi thënë “po” këtij plotësim-ndryshim, në seancë e sqaruam dhe jemi për, gjithmonë jemi për t’i zbardhur krimet e luftës, dihet kush ka bërë krime në Kosovë. Lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë, e vërteta duhet të vërtetohet dhe për çdo iniciativë të këtij interesi dhe interesit kombëtar i keni votat tona. Faleminderit!

KRYETARI: Shumë faleminderit, zoti Berisha! Ministrja e do fjalën, Albulena Haxhiu.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit edhe një herë, kryetar i Kuvendit, S’po di, bre Abelard, kur po e lexon fjalimin a më ke dëgjuar paraprakisht çka kam thënë ose pavarësisht çka kam thënë unë, ti prapë qëndron prapa fjalimit që e ke shkruar. Tash, shumë prej çështjeve të cilat i adresove, unë edhe i pata në fjalim. Kështu që ke mundur ta shpenzosh kohën për çështje të tjera.

Megjithatë, është një çështje që dua ta adresoj sërish. U tha këtu që gabimin që e keni bërë para dy vjetëve, po doni ta rregulloni tash, kjo nuk qëndron. Të paktën ne, para dy vjetëve kemi bërë diçka për t’i gjykuar kriminelët e luftës, ju qe sa kohë keni qenë në pushtet, asnjëherë nuk ju ka rënë ndërmend t’i adresoni gjykimet e luftës, edhe duke i lënë pa kapacitete institucionet e drejtësisë, deri tani buxhet për institucionet e drejtësisë është ndarë vetëm 1,80% e totalit buxhetor, pra as 2% e totalit buxhetor nuk është ndarë për institucionet e drejtësisë. E, tash për ato që i keni shkaktuar ju që 20 vjet, po kërkonit zgjidhje për një muaj nga Qeveria Kurti, nuk është fer, as nuk është në rregull, të paktën kuptojë zotimin e qeverisë tonë, besoj që për këtë je në dijeni, për t’i fuqizuar institucionet e drejtësisë për adresimin e këtyre krimeve dhe jo vetëm.

Sa i përket Kodit të Procedurës Penale, gabimi yt ka qenë në atë kohë që Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale nuk i ke sjellë në të njëjtën kohë, nuk ka asnjë logjikë të vijë Kodi Penal në Kuvend të Kosovës e të mos vijë Kodi i Procedurës Penale dhe problemet që i kemi pasur edhe në atë kohë dhe që vazhdojnë ende janë këto: e para, zgjatja e afatit të hetimeve për prokurorinë, prapë mendoj që është gabim. Sepse, nëse Prokurorisë ia lejon katër vjet të hetojë dikë, kjo e cenon sigurinë juridike. Mund të dakordohemi për veprat që janë të rënda, që i parasheh Kodi Penal i Republikës së Kosovës, ta zëmë, krimet e luftës, terrorizmin, por nuk mund ta mbash për të gjitha veprat penale dikë në hetime për katër vjet, për të gjitha është, Abelard Tahiri, qysh e ke

bërë në atë kohë, ende mbetet ashtu, por nuk do të vijë në Kuvend ashtu, mund të dakordohemi për veprat më të rënda që parasheh Kodi Penal, por jo për të gjitha veprat penale, sepse kjo e cenon sigurinë juridike dhe, siç e kam thënë edhe në atë kohë, kjo i vendos në një komoditet prokurorët. Kur prokurorët e dinë që i kanë katër vjet në dispozicion me leje të gjykatës për të hetuar dikë, kjo është goxha në shpërputhje edhe me Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Pra, kjo do të adresohet.

Suspendimi i zyrtarëve me aktakuza. Aktualisht në Kodin e Procedurës që është si të thuash 70% gati, që është në Ministrinë e Drejtësisë, suspendohen të gjithë zyrtarët që kanë aktakuza për të gjitha veprat. Ju e dini shumë mirë që shumica dërrmuese, mbi 50% e aktakuzave që ngriten dalin me aktgjykime liruese. Pse? Jo, unë kam pasur një analizë për sistemin e drejtësisë referuar edhe në raportet e tjera vendore, ku mbi 50% të aktakuzave pas disa vjetëve dalin me aktgjykime liruese. Mund të kemi pajtim të plotë që për veprat penale kundër korrupsionit dhe terrorizmit të kemi suspendim të zyrtarëve nga detyrat që i kanë, por nuk është korrekte, bre, për të gjitha veprat penale t'i suspendojmë zyrtarët, duke marrë parasysh që pas disa vjetëve ata po dalin të pafajshëm.

Pra, me këtë qëndrim ka qenë edhe në mandatin kur kemi diskutuar për Kodin e Procedurës Penale. Ne kërkojmë që t'i fuqizojmë institucionet e drejtësisë në raport që aktakuzat që i ngrit prokuroria të konfirmohen nga gjykatat. Të jenë aktgjykime dënuese dhe jo aktgjykime liruese, qysh ka ndodhur deri tani për lloj-lloj veprash penale, qoftë edhe ato të rënda, del dhe shpallen të pafajshëm, tash a është faji te prokuroria, a është faji te gjyqësia, unë nuk e di. E di që problemin këtu e kemi pasur me shtetin e kapur që vendimet janë marrë varësisht prej urdhrave që i ka pasur politika, por kjo nuk do të ndodhë më, e di që është sfidë, por nuk do të ndodhë më.

Tjetra ka qenë gjykimi në mungesë. Pse, Abelard, nuk po e pranon që gjykimin në mungesë e keni kushtëzuar në Kodin e Procedurës Penale me praninë e të pandehurit apo personit që akuzohet në seancën fillestare. Qysh mund t'i sjellësh kriminelët e luftës kur ti e kërkon që të paktën ata të jenë në seancën fillestare? Nuk do të vijë ky propozim kështu, prandaj edhe sa i përket kontrollit gjyqësor për aktvendimet për hedhje poshtë të aktakuzave, ju e dini që, në fakt, një kallëzim penal sot mund të hidhet poshtë nga prokuroria pa asnjë kontroll gjyqësor. Nuk mund të bëhet kështu, sepse mund të ketë abuzime, të paktën duhet të ankimohet prokuroria për kallëzimin penal që po e hedh poshtë, dhe çështja tjetër, rastet që mbyllen nga policia pa konfirmimin e prokurorisë, edhe kjo do të adresohet. Pra, nuk mund të na përcaktoni ju datën ose ditën se kur mund ta sjellim draftin e ri të Kodit të Procedurës Penale, varësisht prej programit tonë qeverisës, ne e bëjmë planifikimin. Evidente është që në strategjinë legjislative Kodi i Procedurës Penale është si projektligj që do t'i procedohet Kuvendit, por na lejoni që të punojmë me grupet e ekspertëve përbrenda Ministrisë së Drejtësisë, në mënyrë që të mos i kemi problemet me të cilat ballafaqohemi tani.

Sa i përket pyetjes që adresoi zoti Selmanaj, e adresova edhe fjalën time hyrëse, aktualisht ky ndryshim ka të bëjë me gjykimin në mungesë për krimet e luftës. Në Kodin e Procedurës Penale që do të vijë në Kuvend gjatë këtij viti, e unë thashë më herët brenda 2 muajve do të lejohet gjykimi në mungesë për të gjitha veprat penale, përfshirë edhe për krimet e luftës dhe kjo është në përputhje të plotë edhe me rekomandimet e Komisionit të Venecias, sepse Komisioni i Venecias ka thënë se mjafton që personi ta dijë që po kërkohet nga institucionet e sigurisë apo të gjyqësisë. Prandaj, edhe një herë ju falënderoj dhe kërkoj përkrahjen tuaj!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Abelard Tahiri.

**ABELARD TAHIRI:** Faleminderit, ministre!

Prapë, realisht prita të jesh të paktën më e sinqertë dhe të mos thuash gjëra të pavërteta. Shiko, po thirrsh në praktika ndërkombëtare dhe unë po ta them, një praktikë që vjen prej Britanisë së Madhe që e ke përmendur ditëve të fundit sa i përket çështjes së hetimit dhe konfiskimit të pasurisë.

Pra, afati për hetime të tilla është 10 vjet, imagjino, ti po thua 2 vjet janë pak në Kosovë, ndërsa afati në Britaninë e Madhe është 10 vjet për të arritur të jenë efikas, të hetohet një pasuri, një shpëlarje parash, e cila e çon te konfiskimi. Kjo po tregon që ti le që as nuk je duke lexuar, as nuk je duke i parë praktikat ndërkombëtare, por të paktën dëgjoji se i ke disa njerëz të mirë në Ministri të Drejtësisë dhe t'i tregojnë, ndoshta e ke më lehtë t'i mbash në mend.

Pra, hetime të tilla të thuhën më shumë se dy vjet është shumë, është marre për një ministre të Drejtësisë, sinqerisht është marre, sepse nuk po flasim ne për çështjet për kundërvajtje, po flasim për shpëlarje të pasurisë, po flasim për pasuri që duhet konfiskuar që është në Maqedoni, në Shqipëri, në Gjermani, që është në vendet e tjera. Hetime të tilla 2 vjet, plus gjashtë muaj janë të pamjaftueshme edhe për krime lufte.

Pra, është më se e domosdoshme, jo që të abuzohet, gjithmonë të lihet në vendim të gjykatës, pra për raste të tilla që janë më komplekse, që duan angazhim më të madh të drejtësisë, të shkohet deri në katër vjet.

Sa i përket çështjes që e përmende te paraqitja fillestare, është lënë qartë që në seancën e parë kërkohet, sepse është duke mos e cenuar të drejtën dhe sigurinë e çdo qytetari në Republikën e Kosovës, kërkohet prezenca e tij në seancë dhe nëse s'arrihet herën e parë, atëherë në seancën e dytë të procedohet më tutje me procedurat, të cilat do të çojnë deri në dënimin në mungesë të këtyre personave.

Pra, po flisni diçka që është e pavërtetë. Kodin e Procedurës Penale do ta krahasoj kur te sjellësh në Kuvend, e do ta sjellësh të njëjtin që e ke miratuar në vitin 2019, pra imagjino çfarë reforme

të thellë penale kemi bërë 2017-2019, në dy projektligjet më të rëndësishme në luftë kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit. Pra, jua kemi lënë të gatshme dhe sot ju s'po e merrni mundimin të paktën t'i lexoni dhe të shihni çfarë dokumentesh të rëndësishme keni në sirtarët tuaj dhe t'i sillni për votim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ato nuk bëhen për individë, as për kategori të caktuara, ato bëhen për krejt shoqërinë.

Prandaj, po të them, sille sa më shpejt, sepse Kodi Penal është i mangët pa atë dokument dhe sikur të kishte vazhduar ritmi i qeverisjes në atë kohë, normalisht, në qershor të 2019-ës është miratuar në lexim të parë dhe do të ishte miratuar në lexim të dytë, mirëpo edhe ti në atë kohë si kryetare e komisionit e vonoje me grupet punuese dhe i është kthyer prapë qeverisë, të cilës ti je pjesë e saj.

Pra, mos u thirrni në procedura dhe trajtoni qartë dhe drejt çështjen e këtyre projektligjeve që janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Ky arnim që po mundohesh ta bësh sot është i kotë, është i kotë sa që edhe fjalimi i kryeministrit në njërën anë që po kërkon, që po thotë "këta dënohen në mungesë", edhe qëndrimi yt që sot po e bëjmë për krime lufte, e nesër pastaj e sjellim atë tjetrin, po tregon njëfarë moskoordinimi të madh mes jush.

Pra, unë po të them, ne jemi opozitë, ne jemi për t'ju kritikuar, për t'ju kërkuar punë, ne jemi për t'ju korrigjuar. Pra, kuptoje pozicionin tënd se tashmë je ministre. Nuk është e lehtë as për mua si qytetar ta shoh gjysmë dite në gjykatë ministren e Drejtësisë duke u ballafaquar me bëmat e saj dhe gjysmë dite në Ministri të Drejtësisë. Të kishte qenë në bujqësi apo diku tjetër, ndoshta s'do të ishte ndonjë farë problemi, por të paktën nuk është mirë, sepse nuk është mirë të jetë lajm ndërkombëtar ku ministrja e Drejtësisë së një vendi gjysmën e ditës e kalon para prokurorit dhe gjyqtarëve dhe gjysmën e ditës e kalon në ministri. Nuk është e mirë ajo, nuk është e hijshme për këdo, s'na bën nder, pavarësisht a jemi në pozitë apo në opozitë.

Por, megjithatë, meqenëse ju keni fytyrë të bëni një gjë të tillë si qeveri, atëherë vazhdoni, po të paktën punët e mira që janë bërë, që i keni në sirtarë, qysh është edhe Kodi i Procedurës Penale, sille sa më shpejt, sepse është e rëndësishme çdo person që është i akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare, për abuzim të parasë publike, të suspendohet, nuk po flasim këtu për çështje të tjera, po flasim për keqpërdorim të parasë publike, për keqpërdorim të taksave.

Pra, ata njerëz, të cilët akuzohen, kanë aktakuza, duhet suspenduar, nuk bën të jenë në detyrë, sepse e pengojnë hetimin.

Pra, është në përputhje të plotë me *acquis communautaire*. Po të them prapë, e ke edhe dokumentin që e kemi marrë nga Zyra e Bashkimit Evropian në kohën kur e kemi proceduar në Kuvend. Prandaj, ne po kërkojmë çdo person që akuzohet për korrupsion të suspendohet prej detyrës, të mos i lejohet ta pengojë punën e prokurorëve ose t'i manipulojë provat.

Prandaj, për ta lehtësuar punën e atij shteti të kapur që ju po e quani, sille, edhe duhet suspenduar e larguar sa më shpejt ata njerëz. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën nga Lidhja Demokratike prapë e ka Driton Selmanaj, tash në cilësinë e deputetit.

**DRITON SELMANAJ:** Faleminderit, kryetar! Në fakt, për mua është shqetësim normalisht mosdakordimi i kryeministrit dhe i ministres, sepse as një orë nuk pati kur kryeministri tha që projekt-kodin që duhet kaluar na e mundëson zbardhjen e rasteve, të cilat kanë ndodhur në demonstrata. Megjithatë kjo flet për një mosdakordancë, për një, të mos them as koordinim të brendshëm të kësaj qeverie.

Nga ana tjetër, ideja ose tendenca e ministres për të thënë që në Kosovë mund të ngrihen aktakuza dhe ne duhet pritur aktgjykimin final për të ndërmarrë veprime ndaj një zyrtari publik, unë mendoj që është shumë gabim. Janë ndër parimet themelore demokratike në vendet demokratike kur personat me aktakuzë të lirojnë detyrat. Unë ju kuptoj juve, ministre, sepse jeni vetë e përfshirë në rast të tillë, keni aktakuzë, e çka është edhe më e keqja, ne kryeministrin e kemi me aktgjykim dënues. Kryeministrin e vendit e kemi dhe zoti Kurti, në promovimin e parë të kësaj qeverie pati thënë: “Ministrja e Ekonomisë dhe Financave s’mund të flasë shumë për ekonominë që ka ndodhur 20 vjet, sepse atë qasje e gjeni veç në librat e kriminalistikës”.

Unë po i them kryeministrit të vendit që në librat e kriminalistikës gjen edhe diçka tjetër që shkruan aty: “Kushdo që kryen vepër penale, është kriminel”, kështu shkruan, pavarësisht veprës. Dhe, tash ne këtu kemi një ministër tjetër me aktakuzë për shpërdorim të detyrës zyrtare, shefen e grupit parlamentar e keni për korrupsion me aktakuzë dhe tash pse standardet që ju i keni promovuar që 20 vjet nuk po i shtyni. Unë jam për, jam mbrapa jush dhe kam qenë gjithmonë në favor të këtyre parimeve, kushdo që ka aktakuzë, edhe nëse përfundon me aktgjykim lirues, derisa të shpallet aktgjykimi, duhet të lirojë detyrën, sepse janë parimet themelore, janë elementare, janë kërkesa bazike këto për të promovuar qeverisjen e mirë.

Prandaj, po ju lus që Projekt-kodin e Procedurës Penale ta sillni jo me urgjencë të trajtohet këtu, po ta sillni ju me urgjencë këtu dhe ne më pas e trajtojmë me ngadalësi, sepse kemi çka të bëjmë aty, kemi shumë punë, por ju dy ligje që i keni sjellë deri sot, Ligjin për zgjedhje dhe këtë ligj, na thoni hajde kryeni shpejt brenda ditës, çka është kjo nguti, çka është ky zor? Ejani, sillini, bisedojmë, keni numra, ju ndihmojmë aq sa mundemi, por s’mund të veprojmë kundër parimeve themelore të demokracisë, për të cilën ju keni qenë promovuesja kryesore, ndoshta bashkë me kryeministrin e vendit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën nga Lëvizja Vetëvendosje e ka Fatmire Kollçaku.



FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj, kryetar i Kuvendit!

Është e qartë që nuk e kam pasur ndërmend ta marr fjalën, por hipokrizia e disa deputetëve të shtynë, së paku para qytetarëve të Republikës së Kosovës të jemi të sinqertë.

Kur një ish-ministër i Drejtësisë del këtu dhe apostrofon një zonjë, e cila qenka, sipas tij, e ulur në bankën e drejtësisë, për çfarë arsye, pse këtu në këtë institucion mbrojti këtë shtet, Republikën e Kosovës, integritetin dhe sovranitetin e këtij vendi, ndërsa ministrat tuaj për 20 vjet paradite ishin në banka nëpër gjykata për krim dhe korrupsion, për afera korruptive dhe normalisht vinin herë këtu, herë nëpër seanca gjyqësore, por për krim dhe korrupsion.

Prandaj, qytetarët e Republikës së Kosovës votuan kaq bindshëm për këtë ndryshim dhe duhet të pajtoheni me këtë gjë. Ne jemi mësuar t'ju dëgjojmë këtu që të flisni, vetë apostrofoheni për shumë në të kaluarën, për keqqeverisje, keqmenaxhim të parasë publike, për krim dhe korrupsion. Ka ardhur koha për njerëz të ndershëm që i kemi përballë këtu dhe respekt për zonjën Haxhiu, për këtë iniciativë dhe me siguri që të gjitha gabimet që i kanë pasur si Kodi Penal, si Kodi i Procedurës Penale do të korrigjohen dhe ata që vërtet kanë keqpërdorur dhe keqmenaxhuar, sidomos kanë keqpërdorur paranë publike, do të përgjigjen para organeve të drejtësisë.

KRYETARI: Nga radhët e PDK-së, fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, Bedri Hamza. Replikë, Abelard Tahiri!

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, zonja Mulhaxha-Kollçaku!

Unë ju kuptoj kur mungon materia, tani ju duhet lëshuar kështu në fyerje e në çështje të tjera, në arrogancë, por ne po flasim për një projektligj, ndoshta ti e ke problem ta kuptosh që është shumë i rëndësishëm pikërisht për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, po flasim për suspendimin e zyrtarëve të lartë publikë që janë me aktakuza prej pozicioneve të tyre.

Përrjashtë në këtë rast zonjën Haxhiu, pra që është shumë joetike ta drejtojë Ministrinë e Drejtësisë një person që çdo ditë shkon në gjykatë, por në anën tjetër, e ke ministrin e Ambientit që është me aktakuzë pikërisht për korrupsion, zotin Liburn Aliu. Pse zoti Liburn Aliu duhet drejtuar një ministri kaq të rëndësishme që menaxhon një shumë jashtëzakonisht të madhe të taksave të taksapaguesve të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Pra, ku ia gjetët ta bëni bash në atë ministri ku i menaxhon më shumë se 200 milionë euro një njeri me aktakuzë për korrupsion. Kjo është fytyra juaj e vërtetë, ne nuk kemi problem me ju si individë, mirëpo kemi problem me atë që e keni thënë deri sot, e keni proklamuar, dhe e dërgoni ministër t'i menaxhojë 200 milionë euro, një person me aktakuzë pikërisht për keqpërdorim të detyrës zyrtare, pra që lidhet me korrupsion. Pra, ne në këto raste unë nuk po mund t'ju kuptojmë

dhe, në anën tjetër, nuk ke nevojë t'i dalësh as në përkrahje, as në ndihmë, sepse çështje të tilla i keni ngritur, i keni proklamuar për 20 vjet.

Pra, nëse ne e kemi bërë gabimin në të kaluarën, qeveritë e kaluara që ka pasur ministra me aktakuza, pse po e bën ti? Pse po e bën Albin Kurti një gabim të tillë? Pse po lejon njerëz me aktakuzë të jenë pjesë e qeverisë së tij? Pse po lejon t'i menaxhojë 200 milionë euro dikush me aktakuzë për korrupsion? Kjo është pyetja ime.

**KRYETARI:** Kundër-replikë ka kërkuar zonja Fatmire Kollçaku.

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Faleminderit, kryetar!

Nuk kam nevojë ta mbroj ministrin që e apostrofon, sepse ai ka vepruar për interesin publik, këtë do ta dëshmojë koha. Aty nuk kemi nevojë avokatinë e askujt, unë e mora fjalën vetëm që ta pengoj një diskurs, hipokrizinë tuaj këtu, sepse jam krenare me gjithë ministrat dhe punën e tyre të deritanishme, e kush nuk e njeh materien, duhet ta kuptojë ti se ka ardhur koha të gjykohen zyrtarët e lartë për keqpërdorime, e jo veç qytetarët e rëndomtë që nuk kanë pasur krah deri tani.

**KRYETARI:** Nga AAK-ja fjalën e ka kërkuar Besnik Tahiri.

**BESNIK TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

Po dua të kthehem edhe një herë në temë, atë që e diskutuan në radhë të parë për shpejtimin e procedurës, pra shmangien nga procedura dhe përmbajtjen. Pyetja ime për krejt ju është a jemi duke folur për përmbajtje apo procedurë? A jemi duke folur për dy nene që i kemi diskutuar në Komisionin Legjislativ, apo jemi duke diskutuar për një amendament të një ligji të plotë, kjo është tema.

Nuk ka logjikë as parlamentare, e asnjë logjikë as për ligjin që po flasim që të hyjmë në tema, atë që e nisi së pari kryeministri me çështjen shumë të dhimbshme, një çështje që na dhemb të gjithëve dhe pastaj me tema të tjera, të cilat nuk janë temë. Temë janë amendamentimi i dy neneve në gjykimin në mungesë, kjo është tema. Në qoftë se doni debat për Ligjin për reformën gjyqësore, eja ta bëjmë, por jo në këtë formë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Prej Lëvizjes Vetëvendosje, fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni-Kaloshi.

**HYDAJET HYSENI:** I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kryeministër dhe ekip qeveritar,

E nderuar ministre e Drejtësisë,

Të nderuar deputetë,

Ju përshëndes të gjithëve e posaçërisht do të doja të përshëndes deputetët e opozitës! I përshëndes veçanërisht kur janë kritikë dhe konstruktivë, po jo edhe kur kthehen pa asnjë nevojë

në kohën e Ahtisaarit dhe përpiqen të problematizojnë atë që veç është e kaluar dhe është mësimdhënëse. Përpiqen të justifikojnë qasjet që i nderuari ambasador Ahtisaari i quante “kompromis i dhembshëm për shumicën shqiptare”, kurse bashkëpunëtori i tij i parë, zoti Rohan, thoshte jo një herë, se ka pasur shumë anomali që kanë dëmtuar Kosovën, po kërkoni zgjidhjen te ecja përpara. Dhe, ecja përpara nuk mund të bëhet duke bekuar fjetjen në kompromiset, që Ahtisaari i quante “të dhembshme” dhe problematizimin e atyre që janë përpjekur t’i korrigjojnë dhe t’i avancojnë, t’i normalizojnë. Po besoj që në të ardhmen do të kemi raste për t’i diskutuar këto edhe në forma të ndryshme.

Megjithatë, më lejoni të kthehem te tema.

Zonja dhe zotërinj, unë përshëndes e mirëpres procedimin dhe amendamentimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të propozuara të dispozitave gjegjëse të Kodit, bazuar në arsyetimin dhe shpjegimet e dhëna të ministres dhe të sponsorizuesve, natyrisht duke u mbështetur edhe në sqarimet dhe shpjegimet e dhëna nga përfaqësuesi i komisionit. Mendoj se janë dispozita që duan miratuar dhe besoj edhe do të miratohen në procedurë të paraparë. Por, më lejoni vetëm të theksoj faktin se po krijohet bindja sikur krejt puna e Drejtësisë është tash te afatet që duhet t’i ndryshojmë, duhet t’i heqim, e tjera.

Mendoj që nuk është këtu problemi. Prandaj, është e natyrshme që edhe ky ndryshim minimal duhet t’i shtrohet leximit, shqyrtimit adekuat dhe me këtë rast besoj edhe do të korrigjohen, do të përshtaten, por do të na jepet edhe mundësia për të theksuar faktin, se ky problem i vogël nuk mund të zgjidhet pa zgjidhur edhe problemet madhore që e bëjnë të pamundshëm edhe funksionimin e ndryshimeve të propozuara.

Më lejoni vetëm të theksoj së paku tri fusha kalimthi, Ligjin dhe praktikën e ekstradimit, Ligjin tonë të famshëm të amnistisë, Ligjin për dhomat e specializuara për krimet e luftës dhe ka edhe të tjera. Pa i trajtuar këto në ndërlidhje e përplotësim nuk besoj që mund ta ndryshojmë rrënjësisht, madje as seriozisht, gjendjen në fushën e Drejtësisë.

Në pajtim me aktet universale ndërkombëtare edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka një nga postulatet themeltare të drejtën e barazisë para ligjit dhe gjyqit. Për arsyet që dihen, qytetarët e Kosovës dhe jo vetëm të Kosovës kanë qenë në vijimësi të privuar nga kjo e drejtë themelore dhe për fat të keq, në aspekte të ndryshme vazhdojnë që edhe sot të jenë në shumë forma të pabarabartë para ligjit, madje edhe këtu në Kuvend.

Ligji për amnisti, zonja e zotërinj, siç e dini, u falë krimet, tekstualisht më lejoni ta lexoj një pjesë të saj, “kryesve të veprave penale të listuara në nenin 3 të Ligjit, të cilat janë kryer para datës 20 qershor 2013 u jepet lirim i plotë nga ndjekja penale apo nga ekzekutimi i dënimit, në përputhje me kushtet e parapara në nenin 3 të këtij Ligji”. Po theksoj vetëm disa prej krimeve që amnistohen. “Lirohen plotësisht nga ndjekja penale apo vuajtja e plotë e dënimit kryesit e

veprave të mëposhtme penale: veprat penale sipas Kodit të Republikës së Kosovës; sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës; kryengritja e armatosur; rrezikimi i tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës; rrezikimi i rendit kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike; spiunazhi; bashkimi për veprimtari kundër-kushtetues; kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare, e tjera; nxitja e urrejtjes, përçarjes dhe mosdurimit kombëtar,” e tjera... Për të mos marrë kohë, ju lutem lexojeni këtë ligj dhe krahasoni çka është amnistuar, kush ka përfituar nga ky amnistim dhe kush është privuar nga ky amnistim dhe pse është bërë krejt kjo, ose pse është bërë ky amnistim segregativ, diskriminues, madje disi edhe vetdiskriminues dhe krejt jo proporcional, krejt jo asimetrik?

Dhe çështja e dytë, gjykimi në mungesë ka rëndësinë e vet, por nuk e kuptoj si mund të funksionojë pa instrumentin e ekstradimit, kurse Kosova jonë nuk posedon, as kapacitete, as hapësirë dhe as mundësitë e ekstradimit, as praktike normale e reciproke të trajtimit të ekstradimit. Shteti fqinj që strehon më së shumti borxhlinj dhe autorë të krimeve në Kosovë nuk po i ekstradon madje as delikuentet ordinerë, madje edhe kur kërkohen nga Drejtësia Amerikane. Ligji për gjykatën në mungesë nuk bën të diskriminojë nga politika etnike kriminelët dhe delikuentet nga vendet që ekstradohen dhe nga vendet që janë ekstraduar.

Çështja e tretë, zonja e zotërinj. Jemi të informuar se ndryshimet e propozuara në Kodin Civil e Penal, Kodin e Procedurës Penale, për Ligjin për gjykimin në mungesë është përkrahur madje edhe kërkuar nga prokurori i dhomave speciale. Është mirë, por duhet pasur parasysh edhe faktin për ne që na ka pas ndodhur, që pikërisht në adresa të tilla, nga faktorë të tillë, të imponohet e të sheqerohet edhe i ashtuquajtur i “gjykim special” (Gjykata Speciale). Prezantohej si një e mirë për Kosovën, si një pastrim i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Luftës Çlirimtare. Si po funksionon tani?

Dhe, a nuk duhet të shtrohet pyetja, a mund të na ndodhë me përvojën që kemi, që siç ka ndodhur me Gjykatën Speciale që po kthehet në një vetëgjykim të Kosovës dhe dëmtim të imazhit të saj, të ndodhë edhe me gjykimet në mungesë?

Pa hyrë në atë kush e themeloi, si u themelua, pse u themelua, e të tjera, Gjykata Speciale na u imponua edhe me instrumentin e joshjes, me...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Zoti Hyseni, nëse mund ta përmbyllni fjalimin do të kishte qenë mirë. Zgjatjani një minutë, zotit Hyseni.

**HYDAJET HYSENI:** U arsyetua dhe u gëlltit pikërisht me joshje dhe kërcënime. Me joshje se po ndihmohej Kosova dhe Lufta e saj Çlirimtare e me shtrëngime e kërcënime, se nuk do të ketë

viza e liberalizim, se nuk do të ketë integrim në Evropë dhe madje, se do të bartej çështja në Këshillin e Sigurimit. Dhe, nuk mund të përjashtohet mundësia që gjykimet në mungesë të jenë po ashtu, diskriminuuese dhe joproporcionale. Nuk e shoh si mund të jetë ndryshe me formatin që kemi krijuar. Për të mos u kuptuar keq, jam për ndryshimet e propozuara...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Faleminderit! Nga Partia Demokratike e Kosovës, zonja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë jam anëtare e Komisionit për Legjislacion ndoshta, e tha edhe shefi i Grupit Parlamentar, rëndësinë e plotësim-ndryshimit të këtij projektligji dhe faktin që krimet në mungesë duhet të dënohen, sepse ne tashmë jemi në muajt e përvjetorëve të shumtë që po ndodhin në Kosovë dhe po e përmend vetëm rastin e fundit të kriminelit Dikoviç, i cili është përgjegjës për Masakrën e Rezallës, por edhe shumë kriminelë të tjerë, të cilët besoj shumë që me këtë procedurë të përshpejtuar do të arrijnë që të marrin dënimin e merituar nga institucionet tona dhe, po, është përkratur unanimisht edhe në mbledhjen e komisionit bashkë me kolegët deputetë.

Po, meqë kolegja parafolëse e përmendi çështjen e grave dhe gjatë gjithë paradites sot u diskutua edhe për përgjegjësitë që gratë i kanë në politikë, unë dua të them që të qenit grua assesi nuk të amnistion nga përgjegjësitë dhe obligimet që i ke dhe po ashtu, edhe barrën që sot e kanë disa gra që janë të angazhuara në politikë. Po e gjykoj veç faktin, që një ministre e cila udhëheq me Ministrinë e Drejtësisë, në të njëjtën kohë gjendet e ulur edhe në bankën e të akuzuarve për vepra të kundërligjshme dhe për vepra penale.

Do të doja të di, nëse ky fakt e konteston legjitimitetin e saj për të drejtuar një resor kaq të rëndësishëm, por sa i përket përgjegjësisë që gratë kanë ne duhet të respektojmë bazën ligjore dhe Ligjin, të jemi të përgjegjshme karshi obligimeve të cilat i kemi si deputete të Parlamentit të Kosovës, sepse ishte debat që u strukturua sot, por kjo nuk na amnistion nga përgjegjësitë dhe obligimet tona, sidomos kur ne në të njëjtën kohë ushtrojmë pozicione kaq të rëndësishme dhe jemi në të njëjtën kohë edhe pjesë në bankën e të akuzuarve.

KRYETARI: Atëherë, unë propozoj që të kalojmë në votim të këtij projektligji.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr.04/L-123 të procedurës penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 06/L-091.

Lus deputetët, që me ngritje dore të deklarohen për projektligjin.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Tash e marrim rezultatin. Konstatohet se me 90 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr.04/L-123 të procedurës penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatet e parapara me Vendimin e Kuvendit të miratuar në seancën plenare të mbajtur më 26 prill 2021 ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Urdhëroni, zonja Kusari! Keni diçka të veçantë, sepse duhet të procedojmë?

MIMOZA KUSARI-LILA: Kryetar, faleminderit!

Për këtë pikë, jo.

Megjithatë, e kërkoja fjalën në mënyrë që të prezantoj ndryshimet në komisionet parlamentare, të cilat Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje i ka bërë dhe e cila nuk është lexuar në kohën kur janë votuar ndryshimet në dy komisione parlamentare në pikën e 3-të të rendit të ditës.

Kërkoj mirëkuptim, natyrisht edhe tuajin, edhe të grupeve parlamentare, për këtë çështje! Nëse pajtoheni!

KRYETARI: Pra, nëse është në formë të një përmirësimi dhe i cili është gabim teknik, ju lutem, lexojeni versionin e vërtetë dhe...

MIMOZA KUSARI-LILA: Kryetar, nuk është gabim teknik për arsye se nuk janë lexuar fare. Do të thotë, me fjalë të tjera i bie që të jetë propozim i ri një votim për atë propozim dhe pastaj, që të bëj njoftimin në seancë për ndryshimet që Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje i ka bërë në komisionet funksionale. Ju nuk ishit në kryesim të mbledhjes, ishte nënkryetarja.

KRYETARI: Mirë, atëherë lexoni emrat që Administrata e Kuvendit të merret me akomodimin e tyre në komisionet përkatëse.

MIMOZA KUSARI-LILA: Kryetar, së pari duhet të miratojmë seanca propozimin, që unë t'ia lexoj emrat.

KRYETARI: Urdhëroni, i lexoni pra!

*(Ndërprerje nga regjia)*

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit!

Atëherë, kjo është vazhdimësi e një pike të mëhershme, në të cilën nuk u lexuan emrat e anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe ndryshimet.

Në mbështetje të Rregullores së Kuvendit, neni 63, pika 2, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje propozon:

- Në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere tërheq deputeten zonjën Arta Bajralija dhe në vend të saj propozon deputeten Yllëza Hoti.
- Në Komisionin për Punë të Jashtme dhe Diasporë, tërheq deputetin zotin Avni Dehari dhe në vend të tij propozon deputeten zonjën Adelina Grainca.
- Në Komisionin për Integritet Evropian plotësohet pozita e një deputeti nga ana e Lëvizjes Vetëvendosje, deputeti Driton Hyseni, si dhe
- Në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike plotësohet pozita e një anëtari të komisionit me deputeten Jetmira Vrenezi.

**KRYETARI:** Në rregull! Me një votim formal, kush është për?

Këto janë procedura të brendshme të Kuvendit të cilat konsideroj që mund të bëhen në çdo kohë, kështu që nuk është problem.

Kush është kundër? A ka abstenim? E marrim rezultatin.

Me 81 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, deputetët e propozuar dhe të lexuar nga shefja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje zëvendësohen në komisionet përkatëse.

Tash, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

## **6. Debat parlamentar për gjendjen me pandeminë COVID-19 në Republikën e Kosovës**

Të nderuar deputetë,

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-s, Abelard Tahiri, në emër të nëntë deputetëve, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me çështjen e lartpërmendur.

E ftoj z. Abelard Tahiri që ta paraqetë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Në vend të kësaj, deputeti Uran Ismaili.

**URAN ISMAILI:** Faleminderit shumë i nderuar kryetar!

Kabinet qeverisës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Partia Demokratike ka thirrur këtë debat parlamentar sepse është e nevojshme të jepen përgjigje për këtë situatë. Ne kemi parë të ndërrohen tri qeveri, por jo edhe të ndryshojë situatë që po e rëndon jetën e qytetarëve gjithnjë e më shumë.

Asnjëra prej këtyre qeverive nuk dha përgjigje për çështjen e vaksinimit, për investimet, për blerjen e barnave me çmime shumë të shtrenjta, ashtu siç në krejt këto sfida as nuk krijuan rrethana lehtësuese për qytetarët. Pra, tri qeveri një mori masash të pamenduara dhe zero përgjigje adekuate. Rezultati mijëra të vdekur, dhjetëra mijëra të infektuar dhe qindra biznese të falimentuara.

Prandaj kemi thirrur këtë debat për t'i artikuluar brengat e mëdha të qytetarëve dhe për të adresuar mungesën toatale të përgjegjësisë së qytetarëve.

Fatkeqësisht edhe Qeveria Kurti 2 po ecën hapave të Qeverisë Hoti, duke zgjedhur heshtjen, ikjen dhe fshehjen, në vend të transparencës dhe veprimit. Kryeministri Kurti dhe shumica e ministrave që janë sot në kabinetin qeveritar nuk janë të rinj në menaxhimin e pandemisë. Nuk janë duke u provuar për herë të parë me një situatë të tillë. Janë përballur me pandeminë edhe gjatë 122 ditëve të Qeverisë Kurti 1, ndërsa sot i kanë bërë 156 ditë në detyrë në pandemi.

Pra, problemi i pandemisë nuk është i panjohur për këtë Qeveri. Problemi është që Qeveria Kurti 2 është një qeveri që mungon në veprim. Mungon në veprim në Kosovë. Sepse ajo që e pamë prej formimit të kësaj qeverie, ishte se prioritet politik i Albin Kurtit dhe kësaj qeverie ishin zgjedhjet në Shqipëri. Prioritet për të ishte Boikeni dhe jo qytetari i Kosovës. Qytetarin e Kosovës dhe shëndetin e tij, ai e vendosi nën hijen e kotësisë së votës për Bokienin. Të largohesh nga pandemia për të bërë fushatë në Shqipëri, është e turpshme dhe e pafalshme. I pafalshëm është refuzimi i vaksinave të kryeministrit të Kosovës nga Shqipëria. I pafalshëm është rivalizimi dhe përplasja me liderët e Shqipërisë dhe e pafalshme është mbjellja e farës së përçarjes mes dy shteteve tona.

Prandaj, ky debat i thirrur sot nga Partia Demokratike ka për qëllim që ta kthejë në Kosovë vëmendjen e Qeverisë së Kosovës, ta kthejë Qeverinë e Kosovës nga qytetarët e saj, qytetarët që edhe sot janë duke u përballur me shumë vështirësi, pa asnjë ndihmë nga Qeveria. Xhepi i qytetarëve është zbrazur në përballje me pandeminë. Çdo ditë ata blejnë barna të stërshtrenjta, sepse të gjitha qeveritë, Kurti 1 dhe Kurti, ajo Hoti, krijuan favore për tregtarë të barnave të cilët plaçkitën qytetarët në kohë pandemie.

Çdo ditë kemi qytetarë që në rrjete sociale kërkojnë plazma gjaku për të dashurit e tyre, sepse Qeveria është pasive në kërkesat e spitaleve për më shumë barna e më shumë pajisje. Çdo ditë kemi qytetarë që duhet të paraqiten në spitale, ambulanca private, sepse shërbimet e nevojshme janë zvogëluar në mungesë të testeve të shpejta. Kjo është një situatë ku Qeveria Kurti 2 ashtu



si Qeveria Hoti trajton shëndetin e qytetarëve të rëndësishëm vetëm si argument politik, e jo si prioritet për të vepruar. E njëjta është edhe situata me vaksinim. Në Kosovë të paktën një vaksinim, një episod i shkurtër i vaksinimit. Në mungesë të vaksinave, që disa ditë qendra e vaksinimit në Prishtinë është e mbyllur. Jemi kryeqyteti i vetëm në Evropë që nuk kemi vaksinim aktiv. Më e keqja kemi heshtje totale nga Qeveria e Kosovës për problemin e mosvaksinimit.

Sot Qeveria nuk përgjigjet as në çështje tejet të thjeshta, sa vakcina na vyejnë neve në Kosovë? Me një llogaritje të thjeshtë, nëse marrim personat mbi 18 vjet, Kosova ka nevojë për dy milion e 500 mijë vakcina, në mënyrë që të vaksinohet e tërë popullata e Kosovës.

Pra, jo 25 mijë vakcina, jo 500 mijë vakcina, jo një milion, 2.5 milionë është kërkesa dhe nevoja e qytetarëve për vaksinën. Pra, arsyeja pse qeveria mban fshehtë edhe këtë kërkesë, këtë nevojë kaq të lehtë, është sepse Kryeministri Kurti dhe ministri Vitia po përpiqen të paraqesin si sukses edhe një kontingjent minimal prej 25 mijë vaksinash, kur e dinë që në realitet kërkesa reale është dy milion e 500 mijë. A e kuptoni sa është qesharake të mbash konferencë për shtyp me 25 mijë vakcina? Me 25 mijë vakcina donacion.

Pra, ajo 25 mijë vakcina është për të mbuluar, 0,01 për qind të popullatës së Kosovës. Në një situatë normale, Kosova me këtë popullatë të vogël është dashur ta ketë minimum 30 për qind të popullatës së vaksinuar, jo 0,01 sa është sot. Pra, nuk ka kohë për lavd, është përqindja më e ulët në Evropë.

Të nderuar qytetarë,

Në Kosovë pashmangshëm do të vijnë vaksinat, sepse kanë ardhur në të gjithë Evropën, në të gjithë rajonin, do të vijnë edhe tek ne. Është detyrë e secilës Qeveri, në secili vend që t'i sjellë vaksinat dhe shumë qeveri në botë e mos të them të gjitha gati janë duke e realizuar. Problemi është se ne e kemi një qeveri që është tejet duke u vonuar. Edhe nesërë po t'i sjellin vaksinat, prapë është vonë. Pra, Qeveria Kurti 2 ka para vetes një detyrë të thjeshtë, t'i blejnë 2 milion e 500 mijë vakcina. Dihet që kjo punë është detyrë ekskluzive e Qeverisë. Kompanitë e vaksinave i shesin qeverive vaksinat e tyre, në mënyrë që qytetarët t'i marrin falas. Po mënyra se si po sillen Kryeministri dhe ministri i Shëndetësisë, duket se këta janë duke tentuar të zbulojnë një vaksinë e jo ta blejnë.

Ju lutem, çështja është më e thjeshtë! Ju lutem, mos e komplikoni, blijini vaksinat, e të cilën çdo shtet është duke e bërë. Qysh nuk ka përgjigje as në çështje esenciale, sa vakcina na vyejnë, kur vijnë vaksinat. E patëm një episod të vaksinimit tejet të shkurtër, me shumë pak vakcina, fare pak transparencë. Nuk dihet fare kush është vaksinuar dhe nuk dihet për sa janë dhënë ato vakcina, nga sa vakcina janë dhënë në ditë. Duket që vaksinimi në Kosovë ka ndodhur nga 800 vakcina në ditë. Pra, prapë është ritmi më i vogël në Evropë. Me këtë ritëm i bie që Kosova do ta kryejë vaksinimin me 2,5 milionë vakcina për katër vjet e katër muaj.

Të nderuar qytetarë,

Kjo është rëndësia dhe esenca e këtij debati. A do të vazhdohet me modelin e vjetër të menaxhimit të pandemisë, me zero transparencë, me konferenca për media pa rezultate, me mungesë investimesh në sistemin shëndetësor e me shpenzime të mëdha për xhepin e qytetarit.

Sot nuk kemi asnjë informatë cilat janë planet e Qeverisë. Nuk i dimë planet as për sektorin e shëndetësisë e as për qytetarin. Sot nuk kemi asnjë informatë kur do të vaksinohen qytetarët, kur do të jetë radha e tyre, apo ku do të vaksinohen. Qytetarëve u duhet përgjigje nga Albin Kurti dhe Arben Vitia të cilët duhet të japin përgjegjësi për pasivitetin e madh, shpërqendrimin e prioritetëve dhe mungesën e transparencës. Qytetarët duhet të dinë se kur është muaji që Kosova do të përfundojnë vaksinimin. Kur është muaji që Kosova mund të hapet dhe t'i kthehet normalitetit. Këto afate kanë filluar të vendosen në tërë Evropën. Pas këtyre sfidave, vështirëve që kanë kaluar dhe po kalojnë, meritojnë një përgjigje të sinqertë nga Kryeministri Kurti dhe ministri Vitia. Këto përgjigje i presim sot.

Prandaj, grupi parlamentar për këto dhe shumë arsye të tjera ka parashtruar këtë mocion për debat me tekstin e rezolutës të cilin e keni të gjithë dhe u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Presim komente dhe bashkëpunim për të gjitha këto që ta harmonizojmë tekstin dhe ta miratojmë këtë rezolutë, në një kohë tejet të rëndësishme për qytetarët, tejet të vështirë dhe fatkeqësisht duket që Kryeministri Kurti nuk e pa të arsyeshme që një debat të rëndësishëm siç është pandemia të jetë edhe ai prezent, edhe pse dihet që jetë njerëzish janë duke u humbur, edhe pse dihet se kemi një sistem shëndetësor që nuk është gjendje ta përballojë nevojën e madhe, duke e ditur që edhe qeveria e kaluar, edhe kjo qeveri nuk kanë investuar fare në sistemin shëndetësor, pra ata janë lënë, mjekët dhe infermierët të vetëm të përballen me këtë gjendje. Kryeministri Kurti prapë nuk është këtu sot me ne. Mendoj që është një papjekuri politike dhe një papërgjegjësi tepër e madhe e tij që të mungojë sot në debatin e sotëm. Faleminderit shumë!

**KRYETARI:** Faleminderit! Tash është radha e grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje fjalën e do Fatmire Kollçaku.

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Ju falënderoj kryetar!

Kolegë të nderuar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Vërtet sot po flasim për një temë shumë të rëndësishme. Besoj një temë e rëndësishme jo vetëm për Qeverinë, për deputetët, por në rend të parë për qytetarët e Republikës së Kosovës. Ballafaqimi me epideminë COVID-19, apo më mirë thënë pandeminë në nivel global, e gjeti të papërgatitur edhe shtetet që ishin me një situatë shumë më të mirë, me një sistem shëndetësor shumë më të zhvilluar, me buxhete shumëfish më të larta, që investohet në shëndetësi, e për Kosovën e cila e kishte një sistem aq të brishtë shëndetësor, normal që ishte sfidë shumë më e madhe.

Por të flasim sot në një seancë për këtë temë, nëse do të ftohej ministri aktual i cili posa e mori detyrën, do të ishte e qartë se ne do të kërkonim vërtet përgjigje për atë se cilat janë planet dhe si e gjeti fillimisht Ministrinë e Shëndetësisë, cilin buxhet e trashëgoi, cilën gjendje, si i siguria dhe si u veprua në këtë ndërkohë. Më duket se këtu është harruar që nga Qeveria Kurti deri te Qeveria Kurti 2 kishim një qeveri tjetër. E pakta sot nga ftuesit e seancës do të duhej të adresohet te ish-ministri dhe ish-Qeveria, sepse më shumë se hipokrizi, është ta ftojme në përgjegjësi ministrin i cili posa e ka marrë detyrën, dhe normal që ditët e para është dashur së paku ta skanonte gjendjen, se nuk mund të paraqitesh ti sot një projekt këtu para deputetëve pa e ditur sa ke buxhet, se ti mund të bësh shumë, të kesh dëshira të mëdha, ta menaxhosh situatën me hapa të përshpejtuar, por ajo varet shumë edhe nga gjendja e trashëguar.

Pra, unë këtij ministri do t'i adresohem më vonë, po fillimisht do të kthehem disa ditë më herët, apo muaj më herët, kur ish-ministri pat lëshuar një komunikatë në emër të Ministrisë së Shëndetësisë që shkruhej kështu: lidhur me interesimin e mediave dhe qytetarëve për vaksinat anti COVID-19, Ministria e Shëndetësisë informon edhe një herë se ka marrë konfirmimin nga kompania Pfizer për sigurimin e 535 mijë vaksinave kundër COVID-19. Përveç vaksinave nga Pfizer, siç është bërë e ditur këtë javë 600 mijë vakcina të tjera janë siguruar përmes shtetit të Austrisë, derisa 720 mijë doza të tjera do të merren falas nga mekanizmi Covax. Vaksinat e para kundër COVID-19 do të arrijnë në Kosovë në muajin shkurt, për të filluar me vaksinimin e grupeve prioritare dhe mundësia për vaksinim do t'u jepet të gjithë qytetarëve sipas planit të imunizimit.

Pra, hiç më pak as më shumë ishin këto fjalët apo në fakt komunikata e Ministrisë së Shëndetësisë e lëshuar për media, që besoni edhe një herë u sigurova, se besoni aq optimistike ishte kjo e po e dimë çfarë arriti, një kontingjent me 25 mijë dhe tani thuhet pse u bë kaq gëzim i madh, po u bë se nga ish-Qeveria nuk e patëm asnjë vaksinë. Së paku filloi imunizimi dhe e tillë jam e bindur dhe jam e sigurt që top prioritet i Qeverisë Kurti është parandalimi përhapjes së SarsCov-2 apo COVID-19, sigurimi i vaksinave, duke vazhduar edhe masa të tjera parandaluese, po është e qartë me një baraspeshë edhe për ekonominë, sepse njerëzit kanë nevojë krahas masave kufizuese, edhe masa ndihmëse. Por jo milionerëve që jo vetëm që përfituan dhe e rritën fitimet, sepse mos harroni shumë prej kompanive kanë gjeneruar fitime të mëdha në kohën e COVID-19, përderisa ka pasur normal edhe shumë kompani apo ndërmarrje që kanë pësuar humbje të mëdha. Ndiha është dashur të shpërndahet ekuivalent me ata që kanë humbur më shumë, por jo ata që jo vetëm që s'kanë përfituar, po nuk ia kanë falur asnjë borxh qytetarëve të Republikës së Kosovës. Mos t'i listoj këtu sepse ka shumë dhe në një debat tjetër do të përmenden të gjithë ata.

Pra ne presim, meqenëse kemi sfidim në përballimin dhe menaxhimin e krizës, jo siç thash edhe bota ishte e papërgatitur asokohe, pra përgjigja ndaj pandemisë, diagnostifikimi i hershëm, izolimi, gjurmimi i kontakteve, testimi dhe menaxhimi i rasteve të sëmundjes vërtet është

prioritet mbi prioritete, po edhe koordinimi në të gjitha nivelet siç thonë ekspertët, formimi dhe përfshirja e qytetarëve me një edukim shëndetësor të mirëfilltë, sepse vaksina nuk do ta zgjidhë brenda natës problemin. Ne e dimë që edhe kapacitetet buxhetore janë të limituara dhe siç jemi informuar nga ministrja, ashtu siç e ka gjetur situatën, besoni që vërtet do të duhet të shumë mund dhe djersë që të dalim nga kjo situatë.

Pra, ne patëm shumë sfida, por çfarë bëri ky ish-ministër. Është e qartë që ne kemi pasur nevojë për staf shtesë edhe gjatë epidemisë. Por, çfarë u bë? Kishim edhe specializantë apo më mirë të them mjekët të cilët punonin nëpër qendrat e mjekësisë familjare, qendra kryesore dhe qendra e mjekësisë familjare, por me një vendim të ndahen specializimet fare në shpërpushje të plotë me konceptin e kujdesit parësor shëndetësor dhe strategjinë e mjekësisë familjare ku pretendohen që 80 për qind të rasteve të trajtohen në nivel të kujdesit parësor shëndetësor dhe orientimi apo strategjia e Ministrisë së Shëndetësisë të orientohet drejt ndarjes së specializimeve për këtë nivel, ne e pamë që u bë një lajm bombastik se kinsë u nda një numër shumë i madh i specializimeve po një numër i madh me vetëfinancim.

Pra, duke mos i parë nevojat reale, u nda një numër i madh i specializimeve që tani i lihen barrë kësaj qeverie, që për ata që nënshkruan që do të shkojnë me vetëfinancim, tani duhet gjetur mënyra se di t'u dalim në ndihmë njerëzve, sepse në njërin anë u detyruan ta lënë vendin e punës, t'i lënë vendet e zbrazëta nëpër qendrat e mjekësisë familjare, krijojnë probleme shtesë, në anën tjetër u ndërpritet paga, kalojnë në vetëfinancim. Është e qartë që është problem për ata, por është problem edhe për këtë shtet, sepse asnjëherë në këto vitet e fundit nuk është bërë ndarja e specializimeve në bazë të nevojave dhe të prioriteteve. Pra, i mbetet barrë kësaj Qeverie.

Çka u bë? Fillimisht top tema ishte testimi, pse s'po bëhet testimi. Me një analizë që e kam bërë veç nga ueb-faqja e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike e kam parë që në 30 ditët e qeverisjes tani Kurti 2 është rritur numri i testeve. Në përgjithësi, nëse i krahasojmë, sepse tani bëhet testimi mos harroni nëpër qendrat kryesore të mjekësive familjare, nëpër ordianca private dhe në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike.

Pra, nuk qëndron që është zvogëluar numri i testeve, por në dy javët e fundit janë regjistruar ulje e numrit të rasteve, edhe pse nuk po flas me optimizëm, sepse vazhdimisht duhet të ndërmerren masa, sepse nuk guxojmë të lirohem. Është e qartë që deri në vaksinim të qytetarëve, ne duhet të vazhdojmë me masat. Por vetëm t'ju listoj disa raste. Numri i rasteve të infektuarve dhe të vdekurve kur Qeveria Kurti 1 ka dorëzuar detyrën më 3 qershor të 2020 ka qenë 1 142 raste të infektuarve dhe 30 raste të vdekjes. Ndërsa numri i rasteve të infektuarve dhe të vdekurve nga COVID-19 kur Qeveria Kurti 2 e mori detyrën më 23 mars 2021 është 83 713 raste, pra ditën kur e mori, se tani janë shumëfish më shumë, dhe 1786 raste të vdekjes nga COVID-19. Pra sepse po testohen siç e ceka shumë dhe me përgjegjësi të plotë mund të them se kërkesa e ministrit aktual përmes institucionit siç është Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike

është që të testohet secili qytetar edhe në bazë të kërkesave edhe pa udhëzime të mjekut. Çdo njëri që ka dashur ka mundur të futet në radhë pranë Institut Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe të testohet. Pra, nuk qëndron që ka kërkesë për zvogëlim, por është e kundërta.

Vdekshmërinë edhe numrin e infeksioneve më të mëdha gjatë pandemisë dhe e cila periudhë kohore ka shënuar ditë më zeza të pandemisë në Kosovës, nëse e marrim si ilustrim, më datë 2 dhjetor 2020 është shënuar më i lartë i vdekjeve, pra me 22 raste, ndërsa numri më i lartë i rasteve ishte në fillim të marsit të vitit 2021.

Nuk do të shkoj më tepër me shifra të tjera, sepse nuk qëndron që ka ndryshim për të keq, por përkundrazi në këto 30 ditët e para të qeverisjes Kurti 2 apo ministrit Arben Vitia, i cili ministër, mund të themi me përgjegjësi të plotë, në mandatin e parë, i cili padrejtësisht u ndërpre, shënoi rezultatet të cilat ishin të lakmueshme dhe nëse iu kujtohet, kishte marrë lëvdata nga institucionet relevante botërore dhe evropiane për menaxhimin e pandemisë.

Të mos harroni në atë kohë pandemia konsiderohej si një armik shumë i panjohur, sepse edhe shtetet shumë të forta se ne e kishin të vështirë menaxhimin e pandemisë.

Në duam ta marrim mesataren e numrit të rasteve ditore, kemi rënie prej 283 rasteve ditore apo 36,4% më pak në periudhën e fundit, sepse sipas raportit të fundit nga IKPSHK-ja, të datës 23 prill të vitit 2021, në periudhën 8 prill 2021- 22 prill 2021, në Kosovë janë raportuar 6 mijë e 912 raste dhe mesatarja është 494 raste pozitive.

Ndërsa, në periudhën 25 mars 2021...

**KRYETARI:** Faleminderit! Nga Partia Demokratike e ka fjalën Enver Hoxhaj.

**ENVER HOXHAI:** I nderuar, zoti kryetar,

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Ka qenë e udhës që këtë diskutim që e kemi sot, këtë debat që e kemi sot, ta ftonte Qeveria e vendit, jo ta ftonte opozita, sepse çdo qeveri e përgjegjshme dhe e ndërgjegjshme do të duhej ta kuptonte drejtë që beteja me pandemi, nuk është një betejë politike, por është një betejë shëndetësore dhe sociale.

Nuk duhet të ndodhë një rrafsh dogmatik, por në një rrafsh real dhe nuk duhet të ndodhë në një frymë të izolimit, por në një frymë të bashkëpunimit. E dini pse po i them këto fjali? Kur unë kam takuar kryeministrin në ardhje Kurti, ai më ka thënë mua që do të bashkëpunojë me pozitën

për pesë tema: dialogu, siguria nacionale, pandemia, arsimi, energjetika, dhe sot nuk e shoh kryeministrin kur ne flasim për pandemi, dhe mendoj që kjo është çështje goxha e rëndësishme.

Të pakët, do të duhej të na informonte se çfarë hapash janë ndërmarrë për ta siguruar vaksinën, apo do duhej të shtronte edhe debatin në frymën se si e ka shtruar se ku mund të bashkëpunonim.

Pati nevojë që ne si opozitë ta ftojmë një debat të tillë pas një muaji të qeverisjes, meqë kjo qeveri, jo vetëm që ka dështuar që t'i sigurojë vaksinat, po për më shumë nuk po shohim plan, nuk po shohim veprim konkret se në çfarë forme mund të sigurohen vaksinat.

Temë që kemi hapur është temë goxha jetike. Jetike, sepse ka të bëjë me jetën e qytetarëve. Ne mund të kemi tema të ndryshme këtu, por qytetarët e Kosovës po e humbin jetën dhe kush e merr vaksinën është shumë e rëndësishme meqë ata që e marrin vaksinën, të paktën nuk vdesin nga COVID-19, dhe kjo është tema kryesore.

Prandaj, ne nuk e kemi ftuar këtë debat parlamentar që të hapim për të gjitha temat e mundshme, por e kemi ftuar këtë debat parlamentar që tua shpjegojmë qytetarëve të Kosovës që kjo Qeveri i ka braktisur ata. Që ata po ndihen të vetmuar, pa adresë, pa mbështetje në përballje me COVID-19.

Për më shumë, ata e kanë parë këto ditë se Qeveria, në fakt ka prioritete të tjera, sepse nuk ka ndodhur askund se si e pamë të dielën, dje pamjen, që kryeministri i vendit thotë, unë kam shtetësi të dyfishtë, po shtoj shtetësinë e dyfishtë, kur shtetasit e tij po vdesin në Kosovës.

Kur njerëzit po vdesin në Kosovë, ai po merret me ushtrimin e shtetësisë së dyfishtë. Kur është votuar Qeveria më 22 mars, kryeministri është zotuar se deri në fund të vitit do ta vaksinonjë 60% të popullatës. Sot, mund t'ju them që janë vetëm, diku 1% e popullatës e vaksinuar, 25 mijë vaksina nuk janë asgjë tjetër veçse ndihmë, dhe sot kur e kemi këtë debat, në Kosovë ka zero vaksina.

Prandaj, qytetarët e Kosovës duhet ta kuptojnë që ne jemi të fundit në rajon dhe të fundit në botë për sa i takon vaksinimit të popullsisë. Nuk po flas për raporte afrikan, po në botë jemi prej më të fundmëve dhe të fundit në rajon.

Një qeveri e përgjegjshme dhe e ndërgjegjshme do të duhej ta nxirrte Kosovën nga kjo hartë e dështimit dhe nga kjo hartë e vdekjes së njerëzve. Dhe, nuk mendoj se ka temë më të rëndësishme se sa sot të vinte kryeministri dhe të debatonte me neve.

Shihni vetëm Shqipërinë e cila prinë në Ballkan. Shihni Maqedoninë e cila nuk i ndalë përpjekjet për të siguruar vaksinën. Malin e Zi apo Kroacinë. Vetëm Bosnja edhe Kosova kanë siguruar zero vaksina vetë. S'po flasim për ndihma.

Prandaj, ne e kemi një shqetësim serioz se ku është kjo Qeveri, mos i ka humbur frekuencat kjo Qeveri. Mos iu kanë ngatërruar kabllot kësaj Qeverie, sepse është goxha larg realitetit me të cilin ne po ballafaqohemi.

As nuk po duan, as nuk po dinë, as nuk po provojnë të mësojnë, sepse të paktën sot, deputetët e Kuvendit dhe qytetarët do të duhej të informoheshin se nëse kanë dështuar t'i sigurojnë vaksinat, kur i presim vaksinat. Nëse kanë dështuar t'i sigurojnë vaksinat, është mirë që të na tregojnë se kur i përmyllin negociatat. Më kë kanë folur, kë e kanë thirrur në telefon. Cilin vend ta vizitojnë. Më mirë se sa të rrinë në Lezhë, Gjirokastër e Tiranë, do duhej të ishin në Bruksel, Berlin e Paris, që të sillëshin vaksinat në Kosovë, dhe të mos bëjnë përpjekje që nëpërmjet uljes së numrit të testeve, realisht ta ulin dhe ta ndërrojnë perceptimin se nuk po ndodhë asgjë.

Duhet ta di çdokush që është në Qeveri që njerëzit janë lodhur prej pandemisë, dhe kanë lodhur seriozisht prej pandemisë. Do të duhej ta di çdokush në Qeveri se çdo individ dhe familje që sot e ka virusin dhe përballat me pandeminë, nuk ka aleatë tjetër përveç Zotit edhe fatit, por nuk e ka në krahë qeverinë.

Prandaj, ne e kemi ftuar këtë debat, jo si situatë dobësie, por si situatë urgjence. Që jo Qeveria të reflektojë, por të veprojë tash, know, menjëherë, dhe ta di se cili është plani i saj për ta vaksinuar popullatën.

Ne e kemi ftuar këtë debat që t'i themi Qeverisë dhe zotit Kurti i cili nuk është këtu, që të mos dorëzohet nga përgjegjësia që ka. Që t'i marrë përgjegjësitë që i ka ose që të heq dorë prej përgjegjësisë që i ka. Përndryshe, është duke e marrë popullin, njerëzit në qafë.

**KRYETARI:** Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka Lumir Abdixhiku.

**LUMIR ABDIXHIKU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo pamje flet shumë. Një Qeveri që në temën më të rëndësishme, me siguri të Kosovës në 20 vitet e fundit, nuk e ka kryeministrin në seancë. Tregon se ka një kryeministër të pa interesuar për pandemi.

Një Qeveri që e lë ministrin e Shëndetësisë vet, tregon se sa pak e kupton pandeminë, sepse pandemia s'është veç çështje shëndetësore, është çështje e arsimit, e ekonomisë, e infrastrukturës, e politikës së jashtme për të siguruar vaksina.

Një fjalim i shumicës parlamentare në fillim që flet ende për testim, kur bota flet për vaksinim.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po bëhen një muaj e katër ditë që kur është votuar Qeveria e re e Republikës së Kosovës, dhe këto 34 ditë qeverisje, s' do të kishin peshën e vet të numërimit me saktësinë e tyre ditore, sikurse të mos ishim në krizën më të rëndë shëndetësore në 100 vitet fundit, pra në pandemi.

Por, ja që jemi. Jemi në pandemi dhe në këtë krizë të thellë shëndetësore, ekonomike, politike, shoqërore, ditët më s'kanë rëndësi, rëndësi kanë orët, sepse çdo orë në Kosovë, çdo dy orë, një qytetar i yni vdes për shkak të pandemisë. Mbajeni në mendje! Çdo dy orë vdes një qytetar i Kosovës për shkak të pandemisë.

Kur kjo seancë të të ketë mbaruar, dy qytetarë tanë, prindër e fëmijë të dikujt do të kenë ndërruar jetë për shkak të COVID-19, dhe dy të tjerë pas tyre, e deri në mbrëmje 10 qytetarë tanë nuk do të jenë mes nesh. Ky cikël përsëritet çdo ditë. Për 34 ditë qeverisje, rreth 340 qytetarë tanë kanë ndërruar jetë.

Tani, që të jem i drejtë dhe ta kuptoni. Unë nuk prej që ju si klasë politike, si pushtet, të bëni mrekulli menjëherë, por pres që ta kuptoni seriozitetin e kësaj ngjarjeje. Pres që kryeministri të jetë këtu, kur brenda ditës 10 qytetarë të tij ndërrojnë jetë për shkak të pandemisë.

Unë nuk pres që ju të jepni zgjidhje të menjëhershme, ndonëse zgjidhja shpejt duhet të mbërrijë, vaksinat duhet të vijnë, e sidomos tani kur ka vaksinë, e kur nuk vijnë gjëja e fundit që duhet të bëni është t'i vërsuleni mediave e të gjeni fajtor për këtë dështim.

Pra, në këtë fillim nuk pres zgjidhje, por gjithashtu pres përkushtim. Gjëja e fundit që pres është që në kulmin e pandemisë, në rekordet më të larta të vdekjeve në vend, tregoni mungesë të plotë ndjeshmërie e përkushtimi për gjendjen me të cilën qytetarët tuaj ballafaqohen në këtë vend.

Ndjeshmëria tregon përkushtim, përkushtimi tregon përpjekje, e kryeministri ynë s'po përpiqet fare. Ka humbur, është zhdukur dhe s'e gjen askush, sa herë që bëhet fjalë për pandeminë.

Kur çdo dy orë një kosovar vdes, deputetët e këtij pushteti që i ka krejt, kanë zgjedhur organizimin e protestave për hidrocentrale në Lumin e Thirres në Shqipëri.

Të tjerët rend, kur çdo dy orë një kosovar vdes, shpërndajnë fletushka fushatash bë Lezhë, Gjirokastrë e në Tiranë. Merreni me mend. Jo të interesuar për qytetarët nga ku burojnë vet, për kushtet e medikamentet e mijëra njerëzve në këtë vend, po të nisen nga këtu si pushtet, e të përfundojnë si opozitë në një shtet tjetër.



Kur çdo dy orë një kosovar këtu vdes, kryeministri i tyre i yni pa dallim, ka vendosur të bëjë fushatë në Shqipëri. Në dy javë ditë kohë, ky kryeministër ka vizituar Shqipërinë katër herë, e Klinikën Infektive këtu, repartet përreth, të mbushura me 975 pacientë, shumica në gjendje të rëndë, as edhe njëherë. I bëj thirrje që ta bëjë këtë vizë sa më parë që ta kuptojë nga afër gjendjen e njerëzve tanë, pacientëve, mjekëve dhe të tjerëve që përballen me këtë krizë. Ju bëj thirrje që punën e parë në çdo mëngjes ta nisë nga QKUK.

Njëmijë kosovarë të shtrirë në spitale këtu, janë 10 minuta larg zyrës së tij, nuk ia vlen që të merr vëmendje para tyre një fushatë e pakuptimtë, e pakohë, e paprecedent, në Qarkun e Lezhës, Gjirokastrës e Tiranës. Njëmijë pacientë për një Boiken, nuk ia vlen. Ai i shkreti as aq votues nuk i ka.

Dhe, as që dua të flas për pasojat politike e diplomatike kur një kryeministër i Kosovës, interferon në një proces zgjedhor të një shteti tjetër, të një shteti mik të Kosovës.

Kjo pjesëmarrje e paprecedent do të mbetet njolla më e rëndë e zyrës që ai përfaqëson, e na përfaqëson. Ajo tregon dobësi.

Kryeministri i Kosovës, si pozitë e si individ, s'ka dallim, duhet të kujtojë se para vetes ka vetëm një shtet, një qëllim, një punë, Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj.

Ai ka për detyrë t'ju japë shembull fëmijëve, të rinjve, se shteti i tyre ka vlerë. T'ju jep shembull votuese se puna për ta është e pazëvendësueshme. T'i jap bindje secilit se për të e secilin tjetër në kabinetin e tij, shtet rezervë nuk ka.

T'ju jep shembull të infektuarve në Kosovë, të 975 të hospitalizuarve dhe të familjeve që humbin të dashurit e tyre çdo ditë, se kryeministri i Kosovës edhe kur s'mund të bëjë gjë, është me ta, afër tyre në përpjekjet e njëjtë të tyre.

Qytetarët e Shqipërisë i dhanë përgjigje një aventure të tillë, disa qindra vota për të gjithë fushatën në kulmin e pandemisë. Ata e kanë qeverinë e vet, do t'i kenë politikanët e vet. I kanë edhe vaksinat që po iu vinë vazhdimisht, edhe hapjen ekonomike që iu vjen në verë.

Qytetarët e Kosovës ndërsa, mbesin në pritje për të parë punën e premtuar kaheerë. Mbesin në pritje të vaksinave, të ekonomisë së mbyllur, të vdekjeve në vazhdimësi.

Këta votues tuaj e tanët pa dallim, duan ta ndjejnë dorën e shtetit, duan ta ndjejnë dorën e kryeministrit. Të vaksinohen, të hapen, t'i kthehen normalitetit.

T'iu dilni zot kryeministër, ty të kanë për presë, edhe kur s'mundesh, përpiqu, së paku përpiqu. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka zotëri Ramush Haradinaj. Regjia, mund t'ia kaloni fjalën zotit Haradinaj. Nëse nuk punon aparatura, atëherë...Mirë është.

RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Është shumë i rëndësishëm ky diskutim i sotëm. Është për një temë me rëndësi edhe do t'i jap disa mendime të para lidhur me këtë temë e më pastaj edhe kolegëve, doktor Dreshaj, e kolegë të tjerë do ta kenë pjesën e vet.

Ajo që dëshiroj sot që t'ia tërheq vëmendjen Qeverisë, është që të fokusoheni te sigurimi i vaksinave, vakcina të sigurta, jo me origjinë të dyshimtë, por edhe pa vonesë. Pra, mos humbni kohë, ju lutem!

Njëkohësisht, deri në sigurim të vaksinave, bëni kujdes që të siguroni ilaçet, medikamentet falas për pacientët me COVID. Ju e dini koston për çdo pacient.

E shoh se është tepër me rëndësi, pra në kohë të pandemisë, në kohë të një krize shëndetësore që të bëhet kujdes me ekonominë. Pra, vazhdoni siguroni pako financiare për të prekurit nga kriza ekonomike në vazhdimësi sa të zgjatë pandemia. Pra, ta keni një plan të vazhdueshëm të pakove financiare. Njëkohësisht, ta keni një plan të vazhdueshëm për lehtësira fiskale dhe nxitje për bizneset në Kosovë për t'i ruajtur vendet e punës apo edhe për të hapur vende të reja.

Ndalen menjëherë, pra ndërprisni menjëherë presionet ndaj bizneseve edhe gjobat ndaj qytetarëve. Nuk është një praktikë e duhur në kohë krize ekonomike dhe në kohë vështirësie për secilin, ndëshkimi financiar.

Merrni kredi të buta. Pra, veproni me urgjencë. Merrni kredi të buta dhe mos lejoni zbritjen e pagave, të pensioneve apo sikurse vepruat së fundmi edhe zbritjen e shtesave për pensionistët, por edhe për profesionistët e tjerë që janë në front e përballen me pandeminë përditë.

Pra, pandemia po vazhdon, shtesat duhet të vazhdojnë. Të mos lejoni që të zbritni këto shtesa. Legalizoni të gjitha tregjet që sjellin të hyra në buxhet edhe që krijojnë vende të reja të punës. Pra, të mos ndërmerri masa represive, po nxitni, sillni të hyra në buxhet nëpërmjet të gjitha veprimeve administrative të cilat e forcojnë buxhetin në këtë kohë krize.

Përkrahni komunat. Të mos u hiqni projektet komunave. Keni vepruar keq, keni filluar që t'i ndërprisni projektet e tyre zhvillimore, kapitale, të investimeve. Të mos e bëni këtë. Do të shkaktoni zinxhirë të krizës ekonomike. Do të kthehet nga poshtë, lartë. Është i pashpjegueshëm një veprim i tillë.

Hapni gastronominë. Lejoni sallat e mëdha. Çdo sallë, edhe ajo e dasmave nuk është më e madhe se kjo sallë. Nuk hyjnë më shumë njerëz se në këtë sallë. Hapini sallat, por me masa mbrojtëse.

Njëkohësisht, hiqeni orën policore. Ora policore ua vështirëson jetën njerëzve. Nuk ka arsye që të mbahet orë policore në këtë kohë, ndalim qarkullimi pas orës 22:30.

Ju lutem! Shumica prej këtyre masave nuk kanë kosto. Pra, janë kryesisht fokusim në punën tuaj, në atë për të cilën keni kërkuar besimin, e që ua ka dhënë qytetari i Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Tash do të shkojmë në pushim prej orës 14:00 deri në orën 15:00. Faleminderit!

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*  
*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca*

KRYETARI: Deputetët të kthehen në sallë, sepse po e vazhdojmë seancën.

Nga Lista serbe nuk është askush. Prej Grupit Multietnik nuk po më duket dikush që e ka kërkuar fjalën.

Fjalën e ka ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia.

MINISTRI ARBEN VITIA: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Konjufca,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Qytetarë të dashur,

Ju falënderoj sinqerisht për mundësinë e dhënë për t'u paraqitur këtu para jush me këtë ekspozitë pune 30-ditore të Ministrisë së Shëndetësisë që nga marrja e detyrës. Më lejoni, ju lutem, në minutat në vazhdim e në radhitje si më poshtë të shpalos një raportim të shkurtër.

Paraprakisht ngushëllimet më të sinqerta për të gjithë ata që kanë humbur të dashurit e tyre nga sëmundja COVID-19 dhe shërim sa më të shpejtë të gjithë pacientëve që po trajtohen në institucionet shëndetësore publike dhe private apo në shtëpitë e tyre.

Përkundër vështirësive evidente dhe të njohura të shkaktuara nga pandemia, gjendja në sektorin e shëndetësisë në përgjithësi, e në veçanti në menaxhimin e pandemisë falë angazhimit të palodhshëm dhe sakrificës së punonjësve shëndetësorë është nën kontroll dhe me tendencë përmirësimi.

Që nga marrja e detyrës nga data 23 mars, objektivat tona imediate kanë qenë të qarta: lufta me pandeminë.

I gjithë fokusi ynë në këto 30 e pakë ditë ka qenë i orientuar në këto fusha të rëndësishme të veprimi: menaxhimi i situatës epidemiologjike me COVID-19, sigurimi i vaksinave, shtimi i kapaciteteve të nevojshme të shërbimeve shëndetësore, sigurimi i barnave nga Lista esenciale dhe materialit shpenzues.

Raportet e ardhura së bashku me rekomandimet nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës në fund të muajit mars kanë ngritur alarmin për rritjen e numrit të rasteve të reja dhe mbingarkesën e sistemit tonë shëndetësor.

Projeksionet në analizën e dërguar nga ky institut më 3 prill kanë parashikuar brenda muajit prill që këto kapacitete të arrijnë në limitet e tyre:

715 raste në ditë mesatarja për periudhën kohore 28 mars 2021 - 10 prill 2021 dhe mbi 10 mesatarja e vdekjeve në ditë.

Mesatarisht 900 pacientë të shtrirë në spitalet tona për këtë periudhë, mesatarisht nga 650 pacientë në nevojë për oksigjen dhe mbi 97% të mostrave të testuara të rezultuara me variantin britanik.

Të gjendur para kësaj situate, me shifra të sakta nga profesionistët tanë shëndetësorë, me rekomandime të qarta nga ata dhe në pajtueshmëri me të gjitha rekomandimet e organizatave kredibile shëndetësore, ne vepruam konform përgjegjësisë tonë si Ministri e Shëndetësisë dhe si Qeveri e Kosovës.

Udhëzime të reja dhe masa kufizuese, me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit dhe humbjen e jetës së qytetarëve tanë.

Jam i vetëdijshëm që marrja e masave kufizuese nuk është veprim që pëlqehet në masë. Jam plotësisht i vetëdijshëm edhe për vështirësitë ekonomike që bizneset dhe qytetarët tonë po kalojnë. Andaj, jemi munduar që bashkërisht me ta dhe me ministritë përkatëse të mbulojmë sado pak vështirësitë që po i kalojmë.

Duke pasur parasysh shtrëngimin e masave në nivel global, sidomos pas paraqitjes së formave mutante të virusit, masat e ndërmarra edhe në nivel rajonal, por edhe në Evropë, pastaj rekomandimet nga përfaqësitë e partnerëve tanë strategjikë, por mbi të gjitha rekomandimeve të bazuara në evidencë nga institucionet përgjegjëse, ishim të obliguar të ndërmarrim veprime konkrete.

Kjo është periudhë e vështirë për të gjithë ne, por ne kemi përgjegjësi për jetën dhe shëndetin e qytetarëve tanë.

Në këtë moment kur po flasim, masat kufizuese janë në funksion të lehtësive të caktuara, do të jenë të tilla, përkundër që kemi lajme të mira, por akoma jo të dëshirueshme nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe nga spitalet tona. Këto masa do të përditësohen çdo dy javë, varësisht nga situata epidemiologjike në terren dhe niveli i respektimit të masave aktuale.

Raportimet zyrtare në këto ditë të fundit flasin se kemi një ulje të rasteve të reja me COVID, ulje të hospitalizimeve dhe ulje të vdekjeve. Hospitalizimet nga mbi 900 në fundin e muajit mars, në 700 sipas raportimeve të fundit.

Rastet e rënda me oksigjenoterapi nga mesatarisht 700 ose 750, sa i kishim në fund të muajit mars, në 500, respektivisht 550, sipas raportimit në ditët e kaluara. Vdekje nga mbi dhjetë raste në ditë, në më pak se 10 raste njëshifrore, domethënë në disa ditë radhazi.

Kapacitetet tona spitalore gjatë kësaj kohe janë liruar për 22%. Raporti i fundit i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, datës 22 prill, flet edhe për ulje të rasteve pozitive për 36% dhe ulje pozitivitetit për 22%.

Krahas rënies së numrit dhe përqindjes së të infektuarve, tashmë vërehet qartë edhe ngritja e numrit të të shëruarve. Andaj, duhet të vazhdojmë së bashku, por të përgjegjshëm në këtë rrugëtim të vështirë për të gjithë ne.

Jetën e më të dashurve tanë nuk mund t'ua kthejmë. Andaj, t'i ruajmë e të veprojmë bashkë e të mbështesim njëri-tjetrin në këtë betejë, t'i respektojmë masat dhe t'i ndihmojmë njëri-tjetrit.

Krahas përgatitjeve për vendimin e datës 05 prill 2021 mbi bazën e të gjeturave të analizës epidemiologjike të institutit, kemi krijuar grupe punuese të udhëhequra nga profesionistë dhe ekspertë shëndetësorë, bartës institucionalë, përfaqësues të sektorëve të klasifikuar, të cilët kanë përgatitur dhe përditësuar udhëzuesit e përkohshëm për aplikimin e masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 për secilin nga këta sektorë.

Udhëzuesit janë hartuar për institucionet e kujdesit shëndetësor, institucionet arsimore të të gjitha niveleve, institucionet korrektuese, qendrat e azilit dhe të mbajtjes për të huaj, për tubime, ceremoni martesore, fetare, varrime, punëtori dhe aktivitete kulturore, për aktivitete rekreative dhe sportive, për gastronomi, hotelieri, sektorin e shitjes dhe qendra tregtare, për sektorin e shërbimeve personale, bizneseve, industrisë, administratës publike dhe OJQ-ve, për aviacionin civil dhe për transportin publik. Duhet përmendur se këto janë dokumente dinamike dhe do të përditësohen konform situatës epidemiologjike dhe asaj në terren.

Në anën tjetër, testimet në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe laboratorët privatë vazhdojnë sipas indikacioneve epidemiologjike dhe kritereve të tjera të definuara nga ky institut.

Nëse krahasojmë 28 ditët e kabinetit të ri të Ministrisë së Shëndetësisë nga data 23 mars deri më 19 prill, janë testuar në total 111 mijë e 536 raste, kurse në 20 ditët paraprake nga data 23 shkurt deri më datën 22 mars 2021 janë testuar 98 mijë e 140 raste, domethënë për 13.64% është testuar më shumë në këtë periudhën e fundit.

Bashkë me Organizatën Botërore të Shëndetësisë gjatë këtyre 30 ditëve është finalizuar edhe metodologjia e hulumtimit seroepidemiologjik dhe gjatë javës së ardhshme do të fillojë puna në terren.

Ky hulumtim bazuar në evidencë do të japë të dhëna të vlefshme për shkallën e përhapjes së infeksionit në gjithë Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, ne kemi krijuar mundësinë që të zgjerojmë testimin dhe me testime oportune apo të rastësishme. Në këtë linjë tanimë veç ka filluar mbikëqyrja aktive epidemiologjike përmes testeve të rastësishme të grupet që hulumtimi epidemiologjik i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik i ka identifikuar si super shpërndarës të infeksionit. Kjo tashmë ka filluar.

Është ngritur një grup punues që po e rishikon strategjinë e testimit. Strategjia e rishikuar do të sigurojë teste më të mira, më të shpërndara në mënyrë aktive gjeografikisht, duke u mundësuar të gjithë qytetarëve testimin sa më afër të vendbanimeve të tyre. Neve na duhen rezultate të cilat janë bazuar në evidencë për të ndërmarrë veprime konkrete bazuar në këto rezultate.

Në këtë mënyrë, përmes standardeve për detektim, testim, izolim dhe gjurmim të kontakteve, të vendosura nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, do të na mundësohet të krijojmë një pasqyrë edhe më të qartë të situatës epidemiologjike, e cila do të na ndihmojë akoma më shumë në vendimmarrje.

Njëkohësisht jemi duke punuar në mënyrë intensive në fuqizimin dhe zhvillimin e sistemit elektronik të grumbullimit të të dhënave dhe mundësisë së kryerjes së analizave të mirëfillta...

*(Ndërprere nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia zgjatni ministrit fjalën edhe dy minuta që ta përmbyllë fjalimin.

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Që të ndihmojë në vendimmarrjen e bazuar në dëshmi.

Sipas raportit për imunizim në nivel vendi, nga data 29 mars deri më datën 22 prill në 29 komuna janë vaksinuar 21 mijë e 282 persona, prej të cilëve 5 mijë e 78 profesionistë shëndetësorë.

Pika më e shndritshme e sistemit tonë shëndetësor është procesi i imunizimit, por duhet pasur parasysh që ky proces i vaksinimit është më specifik dhe dallon nga procesi i vaksinimit me vaksina të tjetra. Kjo ka kërkuar përgatitje më të mirë të ekipeve të vaksinimit dhe organizimin e një procesi sa më efektiv të vaksinimit.

Në procesin e vaksinimit ishin të angazhuar 66 ekipe, në 38 qendra të vaksinimit.

Pavarësisht kësaj, mungesa e stafit shëndetësor në qendrat e vaksinimit nëpër Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare ka qenë sfidë me të cilin jemi përballur.

Bazuar në këta tregues, komitetet e ngritura për vaksinim tash po përgatisin planin e resurseve humane për distribuimin dhe administrimin efikas dhe efektiv të vaksinave që do të vijnë së shpejti.

Kemi bërë plotësim-ndryshimin e domosdoshëm të rregullativës ligjore për t'i hapur rrugë importit të vaksinave, gjë e cila parashihet nga gjithë prodhuesit e vaksinave në nivel global.

Ndërkohë presim edhe kontigjentin e dytë të vaksinave nga COVAX dhe tani jemi në bisedime të drejtpërdrejta me të gjitha kompanitë prodhuese dhe me disa nga to jemi në rrugë të mirë për të pasur një marrëveshje shumë optimiste.

Më vjen keq që për shkak të obligimit për ruajtjen e konfidencialitetit të negociatave dhe marrëveshjeve sot nuk jam në gjendje t'ju jap më shumë hollësi, por mund t'ju siguroj që jemi në rrugë të mbarë që me të gjithë aktorët që po na ndihmojnë, të sigurojmë vaksinimin e nevojshëm për imunizimin e 60 për qind të grupmoshave të qytetarëve, të cilëve u lejohet vaksinimi deri në fund të vitit.

SHSKUK, në anën tjetër, ka në dispozicion 1150 shtretër për të sëmurit me COVID, të distribuara kryesisht në klinikat e profilizuara që trajtojnë të sëmurit me COVID si Klinika Infektive, Pulmologjia...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ministër, nëse nuk të ka mbetur edhe shumë, gjatë debatit mund të shpalosni shumë pjesë të rëndësishme të kësaj që je duke i shpjeguar. Zgjatja edhe dy minuta ministrit që ta përmbyllë fjalën e tij.

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Përditësimi, udhërrëfyesi dhe protokolle të trajtimit të pacientëve me COVID-19 në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor janë kusht për të siguruar trajtim të standardizuar e të sigurt.

Gjithashtu kostimi dhe buxheti i tyre, gjë që ka munguar deri më tani, është e domosdoshme që këto dokumente të zbatohen. Kjo ndikon dirket në zvogëlimin e shpenzimeve nga xhepi i qytetarëve. Prandaj, kemi themeluar grup punues për përditësimin dhe arsimin e këtyre dokumenteve.

Kemi përparime të jashtëzakonshme, për shkak të kohës po i lë në debat.



Dhe krejt në fund, po jo më pak e rëndësishme, ne gjatë kësaj periudhe kemi qenë të detyruar të merremi intensivisht edhe me sigurimin e barnave nga Lista esenciale dhe materiali shpenzues, të munguar sidomos nëpër komuna, pra në institucionet e KPSH-së.

Për të qenë të sigurtë me publikun, ashtu sikur pritej në këtë kohë pandemie dhe sfida të shumëfishta jo vetëm politike dhe ekonomike gjendjen në Ministrinë e Shëndetësisë sa i përket furnizimit me barna nga Lista esenciale e kemi gjetur, butësisht thënë, të keqe.

Fatkeqësisht, kur kemi pranuar detyrën, kemi gjetur një buxhet të përgjysmuar për barna dhe material shpenzues për nevoja të institucioneve të KPSH-së nga 11 milionë në vitin 2020, në 5,5 për këtë vit. Një listë të barnave esenciale të plotësuar në gati nivelin më të ulët të pasluftës, 11,59% nga Lista e barnave esenciale, apo 15,45% të produkteve të listës primare.

Prandaj, bashkë me Ministrinë e Financave dhe me Projektin e Bankës Botërore të Huamarrjes për Shëndetësi jemi duke punuar për të sanuar këto probleme që vështirësojnë tepër punën e profesionistëve shëndetësorë në komunat respektive dhe rrezikojnë seriozisht efektshmerinë e punës së tyre.

Për më tepër, specializimet e ndara pa një analizë dhe plan të resurseve humane kanë lënë institucione e KPSH-së dhe komunat pa mjekë dhe kanë vënë në rrezik serioz funksionimin e tyre, ndërkohë që kanë vështirësi...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Po konsiderohet që pjesa më esenciale zhvillohet gjatë debatit, e të gjitha ato ide dhe koncepte që do t'i përballni gjatë seancës, konsideroj që kështu do të zhvillohet edhe rrjedha.

Deri tash vetëm Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes dhe i AAK-së ma kanë sjellë rendin e folësve. Kështu që sa u përket PDK-së dhe LDK-së, unë do t'i thërras ashtu siç jeni lajmëruar.

Fjalën nga PDK-ja e ka Blerta Deliu-Kodra.

**BLERTA DELIU-KODRA:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të dashur kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në fakt, para se të filloj këtë fjalim, dua të shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta të gjitha 2129 familjeve kosovare që kanë humbur më të dashurit e tyre gjatë këtyre 13 muajve të pandemisë në vendin tonë nga virusi COVID-19.

Fatkeqësisht, e tëra që na mbetet është që si deputetë, po edhe si njerëz të bashkëndejmë dhe të ndajmë dhimbjen me ju, sepse ata që do të duhej të punonin për sigurinë e këtyre familjeve, kanë vendosur të mos bëjnë asgjë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Më 11 dhjetor 2020, më shumë se 5 muaj më parë vaksina Pfizer mori aprovimin për t'u përdorur nga qytetarët amerikanë si mburojë nga COVID-19.

Nga ajo ditë e deri më sot zyrtarisht 995 qytetarë të Republikës së Kosovës kanë vdekur nga COVID. Kosova ende nuk e ka asnjë kontratë për blerje të vaksinës. Më 27 dhjetor 2020, Kroacia si shtet nisi vaksinimin e popullatës së saj. Nga ajo ditë, 820 qytetarë të Republikës së Kosovës kanë vdekur nga COVID, Kosova ende nuk ka asnjë kontratë për blerje të vaksinës. Më 11 janar 2021 Shqipëria nisi vaksinimin e popullsisë së saj, prej asaj dite 746 qytetarë të Republikës së Kosovës kanë vdekur nga COVID, Kosova ende nuk ka asnjë kontratë për blerje të vaksinës.

Kolegë deputetë, dje derisa Kryeministri i Republikës së Kosovës ishte për të votuar në zgjedhjet në Shqipëri, Shqipëria ka arritur në 400 mijë vaksina për qytetarët e saj, Kosova ende nuk ka asnjë kontratë për blerje të vaksinës. Ky është bilanci njëvjeçar i suksesit të tri, jo të një qeverie, po të tri qeverive të fundit të Republikës së Kosovës, zero vaksina, zero kontrata, zero përgjegjësi. Më 28 mars në Kosovë erdhën 24 mijë doza të vaksinës së prodhuar nga AztraZeneca si donacion prej programit Covax i Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Me t'u pranuar ato vaksina, natyrisht që të parët që përfituan ishin kryeministri dhe pjesëtarë të tjerë të Lëvizjes Vetëvendosje, ndërkaq nga ato që mbetën nisi kinse një lloj vaksinimi për të moshuarit mbi 80 vjeç. Vaksinimi ishte i thjeshtë, e tëra që duhej të bënin pleqtë në moshë të shtyrë ishte të hapnin kompjuterin, të plotësonin formularin, të prisnin një thirrje nga Ministria e Shëndetësisë në telefonatat e tyre private për përcaktim të terminit, të merrnin veturën dhe të shkonin në qendrën e vaksinimit. Të gjitha këto kjo qeveri pritet që t'i bënte nga një gjysh e nga një gjyshe jona në moshë të shtyrë. Marrëzi!

Edhe për këto pak vaksina që erdhën si ndihmë, u krijua një sistem, i cili privilegjonte disa, e madje ky sistem i diskriminonte disa të tjerë. Po, Qeveria diskriminoi gjyshërit e prindërit kosovarë në bazë të statusit të tyre social, qasjes në shërbimet e tyre shëndetësore dhe të drejtës për të qenë të barabartë. Metodologjia që përdori Ministria e Shëndetësisë për të përzgjedhur përfituesit e vaksinës ishte hiç më pak e as më shumë se sa skandaloze dhe tërësisht e padrejtë. Natyrisht që kjo qeveri nuk siguroi vaksina për 170 mijë pensionistë, si kategoria më e rrezikuar nga virusi.

Por, të paktën nga ato 20 mijë copë që erdhën si ndihmë nga jashtë t'u jepej mundësia e barabartë secilit prej këtyre pensionistëve. Janë tri fakte, të cilat qeveria nuk i mori parasysh para

se të vendoste për shpërndarje të vaksinës. Kosova i ka 170 mijë pensionistë, 120 mijë prej tyre marrin vetëm pensionin bazë prej 90 euro. Rrjedhimisht, shumë prej tyre nuk mund të përballojnë as shpenzimet bazike, në qasjen në internet dhe udhëtimet jashtë vendbanimeve tyre. Në Kosovë paralogarit se janë rreth 250 mijë persona me aftësi të kufizuara, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë mbi 65 vjeç, dhe tërësisht të pa aftë për të lëvizur. 25 mijë familje apo rreth 105 mijë qytetarë të Kosovës janë në skema sociale, pra jetojnë në varfëri. Shumë prej tyre janë në moshë të shtyrë.

I nderuar ministër, si prisni ju, ju lutem ma thoni, që këta të moshuar, të cilët hynë në njërin nga këto kategori, të mund të aplikojnë në serverin tuaj, të mposhtin problemet e tyre të mëdha shëndetësore, e më pas të tejkalojnë edhe sfidat e tjera ekonomike për t'u vaksinuar. Më lejoni t'ju pyes edhe diçka, zoti ministër, Ramë Sylja, Gjylda Kurtishi, Hajriz Sadiku, a do të thonë diçka këta emra për ju, zoti ministër? Ndoshta, t'ju ndihmoj unë. Këta të tre të moshuar që janë mbi moshën 70-vjeçare jetojnë të vetëm në njërin prej lagjeve të Prishtinës, në lagjen Hajvalia, në njërin prej lagjeve në të cilën është lindur e është rritur ministri i Shëndetësisë së Republikës së Kosovës. Ata nuk e kanë askënd. Derisa vaksinat që kanë qenë të destinuara fillimisht për personat mbi moshën 80-vjeçare janë harxhuar, këta persona, madje askush deri më tash nuk ka shkuar që t'ua hapë derën dhe t'i vizitojë, e të evidentojë nëse ata janë kontrolluar, e pse jo edhe të kenë mundësi edhe për t'u vaksinuar. Unë i përmenda vetëm tre të moshuar nga lagjja ku banon ministri, por paramendojini, të dashur deputetë, se sa e sa të moshuar të tjerë në gjithë Kosovën janë, të cilët jetojnë pa përkujdesje, pa u thirrur asnjëherë nga Ministria e Shëndetësisë dhe pa pasur asnjëherë mundësi që në kushte të rënda të asistencës sociale të marrin vakcina.

Pra, shqetësimi që unë po e shtroj te ju sot është ky: ku janë ekipet mobile të vaksinimit të këtyre kategorive të të moshuarve, ku është skanimi i gjendjes për të cilën ju shumë gjatë keni folur, pra a keni skanuar gjendjen në terren që në momentin kur të vijnë këto vakcina, nëse ato natyrisht vijnë ndonjëherë, këta të kenë mundësi që të vaksinohen.

Hajde që sigurimi i vaksinave nuk paska qenë krejt në dorën tuaj që të sigurohen, ama shtimi i kapaciteteve për të cilat ju shumë gjatë keni folur dhe hartimi i planit të mirëfilltë të imunizimit, po. Ku është plani për zgjerimin e kapaciteteve logjistike? Ku është sigurimi i regjistrave demografikë dhe krijimi i data bazave dhe aplikantëve në nivelin komunal, madje edhe në atë qendror, për qëllime të vaksinimit efektiv të këtyre qytetarëve, të cilët unë po i përmend sot. Po ju them unë që ky nuk është dhe nuk do të jetë askund. Ju nuk jeni duke bërë asgjë, zoti ministër, as ato punë, të cilat ju takojnë që jeni ngarkuar me përgjegjësi si ministër i Shëndetësisë dhe as punët për të cilat ju tashmë jeni deklaruar shumë herë. Po i numëroni viktimat, a është kjo e gjitha që duhet ta bëjë një ministër?

Pra, tani jetët e qytetarëve të Republikës së Kosovës janë bërë në numra, merreni me mend, ministri i Shëndetësisë flet për jetën e qytetarëve duke e përmendur numra të shifrave të

qytetarëve që e humbin jetën nga virusi COVID. Ministër, këta numra që po i postoni çdo ditë e që kanë humbur jetën, e që kanë arritur në 2 mijë e 129, po mirë e thashë, 2 mijë e 129 jetë të humbura, këta persona kanë familje, kanë histori, kanë pasur ëndrra, e kanë pasur dëshira, të cilat kanë pritur që t'i realizojnë. Na thoni, pra, a keni ndonjë numër tjetër në mendje. Sa duhet të arrijë numri i viktimave në Republikën e Kosovës që ju në fund të bëni detyrën tuaj si duhet. Duhet të shkojë në 3 mijë? 4 mijë? Apo 5 mijë qytetarë që humbin jetën nga virusi COVID në Kosovë. A jeni në dijeni që për momentin qytetarët e Republikës së Kosovës nuk kanë as 50% të barnave esenciale dhe materialeve shpenzuese në QKUK dhe në spitalet e përgjithshme. Shkoni nëpër komuna dhe shihni, do të thotë qytetarët e Republikës së Kosovës në këtë gjendje të rëndë me pandemi, kanë mungesa të barnave esenciale dhe ju sot këtu flisni se si po e përkrahni qytetarin e shkretë me përkrahje që Ministria e Shëndetësisë nuk ia ofroi kurrë.

Nuk po flas unë për ilaçet për trajtimin e virusit COVID, ne jemi dëshmitarë sa gjatë kemi folur, sepse kemi qenë edhe vetë, kemi vuajtur edhe vetë nga infektimi me virusin COVID dhe kemi folur gjatë për koston e lartë të trajtimit që e kanë përballuar një pjesë e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe e cila ka qenë e papërbalueshme për një pjesë të madhe të tyre që janë detyruar t'i shesin pajisjet e tyre: traktorë, vetura, të shesin pjesë të familjeve të tyre, pasurisë së tyre familjare që të arrijnë që të mbijetojnë dhe të mos jenë viktimat e radhës nga virusi COVID. Ministër, larg qoftë, por me trendin me të cilin ne sot jemi duke shkuar, pa ilaçe, pa vaksina, të cilat nuk duken askund, edhe këto shifra që i përmendëm më lart të vdekjeve druaj se do të arrijnë një numër më të lartë. Duke shpresuar që Kosova të përfitojë së shpejti edhe nga ndonjë ndihmë ndërkombëtare dhe tjetër kontingjent i vaksinave...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia zgjasni deputetes fjalën edhe një minutë, ju lutem!

**BLERTA DELIU-KODRA:** Po ju propozoj këtu që të merrni masa urgjente në tri prej çështjeve themelore. Zoti ministër, t'i shtoni kapacitetet logjistike në Ministrinë e Shëndetësisë vetëm për projektin e imunizimit të popullatës, të krijoni ekupe së bashku me ministrinë e tjera gjegjëse dhe të bëni sigurimin e regjistrave demografikë, krijimin e data bazave, aplikacionin në nivel komunal dhe qendror për qëllim të vaksinimit më efektiv, të plotë dhe pa dallim të të gjithë qytetarëve të Kosovës, po e ri përsëris, pa dallim të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Merrini veturat, e autobusët e shkoni e vaksinoni popullatën nëpër shtëpi, nëpër lagje e nëpër shtëpitë e tyre në fshatra ku ata jetojnë, siguroni urgjentisht furnizim të plotë me barna esenciale dhe materiale shpenzuese të QKUK-së, spitalet rajonale dhe ndihmoni gjeni të gjitha QKMF-të në nivelin e vendit. Janë mbi 300 mijë qytetarë të Republikës së Kosovës që bëjnë pjesë në njërin prej këtyre kategorive me aftësi të veçanta, jetojnë në varfëri të skajshme dhe....

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: 20 sekonda s'kemi, por një minutë!

BLERTA DELIU-KODRA: E mbylla, nëse nuk i merrni parasysh këto rekomandime shpejt me seriozitet dhe përgjegjshmëri, mbajeni mend që do të dështoni përsëri në procesin e vaksinimit të radhës. Në fund, nuk mund ta përmbyll këtë fjalë pa e përmend fjalën e një miku të Prishtinës, i cili e humbi jetën në përballjen e tij me virusin COVID, ishte postimi i tij i fundit para se ai të ndërrojë jetë: “Ec more vaksinoje popullatën, e leni këto palaçollëqe e maskarada politike. Boll ma!”.

KRYETARI: Tash fjalën prej Vetëvendosjes e ka deputeti Mirsad Shkreta.

MIRSAD SHKRETA: I nderuar kryetar Konjufca!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht kur mora ftesën për të diskutuar për pandeminë, isha i entuziazmuar, sepse mendoj që është një mundësi që i jepet qeverisë dhe si deputet, pavarësisht prej partive nga vijmë, do të mund të japim imputet tona lidhje me mënyrën se si do të duhej në përgjithësi të funksiononte shëndetësia, por edhe si t'i qasemi kësaj pandemie, e cila nuk është shqetësim vetëm yni, po është shqetësim global.

Dhe, mendoj që është një hap cilësor thirrja e kësaj seance për të debatuar për këtë temë, duke pasur parasysh që e njëjta opozitë dikur, një vit më përpara, bënte thirrje për mosrespektim të masave në pikun e pandemisë. Sa i përket cilësisë së propozimit në draft rezolutën, ajo lë shumë për të dëshiruar, për faktin që një pjesë e tyre tashmë janë adresuar, e një pjesë e atyre që aty figurojnë në rezolutë dhe janë në procesim e sipër. Tërë kohën u diskutua këtu që të mos bëhet politikë me pandeminë, nëse ju keni dëgjuar ndonjë propozim konkret, nuk e di, ishte tërësisht politikë, bile politikë edhe me të sëmurë, edhe me të vdekur.

Duhet ta sqarojmë opinionin publik, sepse e kemi për obligim, të gjitha masat e marra nga ministritë, ministrat e Shëndetësisë në ministri, vijnë si pasojë e rekomandimeve nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe pasi kalojnë si rekomandime, ata kalojnë edhe një filtër tjetër, i cili është Komiteti për menaxhimin me pandeminë COVID-19. Më shumë se të diskutohet për cilësinë e masave, duhet të diskutojmë për mosmarrjen eventuale të masave çka kishte ndodhur. Të gjithë ata që janë shqetësuar kaq shumë për këto raste, duhet të kishin lexuar raportin e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, i cili paralajmëronte që në prill numri i të vdekurve mesatarisht shkon në 14. Si mendoni që një ministër mund të shkojë në zyrë dhe të mos marrë asnjë masë dhe kur ka një shifër nga profesionistët shëndetësorë që shkon në tendencë rritje numri i të vdekurve?

Tha edhe ministri, “masat nuk janë kurrë popullore”, mirëpo mes gastronomisë dhe jetëve të njerëzve, ne kemi zgjedhur ta dëmtojmë gastronominë, duke kërkuar këtu mirëkuptim nga qeveria dhe nga Ministria e Financave, që e njëjta të subvencionohet që të mos ketë trauma të pariparueshme. Përpara 6 prillit, kolegë të nderuar, kishim një situatë ku kishim 1 mijë të infektuar dhe cili është shqetësimi i profesionistëve shëndetësorë dhe i Ministrisë së Shëndetësisë? Shqetësimi i vetëm është, nuk është vetëm virusi, nuk është vetëm infeksioni, është stërlodhja e personelit shëndetësor, është mbingarkesa e kapaciteteve spitalore dhe kjo çon në një kolaps të mundshëm të sistemit shëndetësor, e cila për pasojë mund të ketë kaskadë të ndryshimeve dhe ngjarjeve, të cilat janë të pariparueshme apo vështirë të riparueshme, të cilat ndikojnë qoftë në jetën e qytetarëve, qoftë në atë shëndetin ekonomik.

Edhe ata që kanë qenë skeptikë në masa, edhe brenda nesh, në diskutimet tona të brendshme, ka pasur kundërshtime, mirëpo përfundimi ka qenë se vetëm masat mund ta ndërpresin këtë zinxhir, i cili kishte vetëm tendencë rritjeje dhe rezultatet tashmë i kemi konkrete. Mjekësia bazohet në fakte, testet kanë treguar që në përqindje, jo në numër të testeve, në përqindje kemi pasur rënie të rasteve nga 19 në ditët e para të qeverisjes tash shifra është 10% e atyre të testuarve. Gjithmonë do të kemi raste, sepse tashmë ato janë të shtrira dhe po të lexoni revistat më prestigjioze, po t'i lexoni punimet shkencore, i nderuar deputet, ju rezulton që rasti i vdekjeve nuk zbret menjëherë pas marrjes së masave, sepse tashmë kemi pacientë në gjendje të vështirë, të shtruar në spitale nga mosmarrja e masave.

Kështu që para se të diskutoni për masat, duhet të diskutoni për mosmarrjen e masave, çka kishte ndodhur nëse s'kishim marrë masa? Dhe, ministri është i obliguar me ligj që nëse Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe Komiteti i profesionistëve rekomandon marrjen e masave, është i obliguar ta bëjë atë. Në aspektin menaxherial besoj që ka pasur një sukses dhe e gjitha kjo është e faktuar.

Për ta përfunduar, këtu tërë kohën u fol që Kabineti qeveritar ka mungesë përvoja. Ore, përvoja juaj në qeverisje nuk është shumë e lavdishme që ta përdorni ju atë punë. Ju keni qeverisur për 20 vjet dhe akoma sistemi shëndetësor në Kosovë e ka buxhetin më të ulët në rajon, asnjëherë s'ka qenë prioritet. Kështu që, përvoja ka kuptim në mënyrën se si e përdor, përvoja nuk ka kuptim vetëm ta përmend si të tillë në varësi...

**KRYETARI:** Ju lutem, qetësi, sepse mund ta dekoncentroni deputetin duke folur!

**MIRSAD SHKRETA:** Absolutisht! U përmend edhe nga kolegët këtu që ministri është lënë vetë dhe nuk ka mbështetje. Ministri e ka përballë gjysmën e Kuvendit e po ashtu ministri e ka që po na përcjellin tash prej televizioneve 107 mijë votues sa i gjithë grupi parlamentar i të apostrofuarit aty. Kështu që ministri e ka mbështetjen, e ka ekipin dhe bashkërisht, sepse

pandemia gërsheton fatet e secilit prej nesh, do ta luftojmë pandeminë dhe do të realizojmë edhe të shumëpriturën, vaksinimin e popullatës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën nga Lidhja Demokratike e Kosovës e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Konjufca!

Kolegë deputetë. pa përjashtim,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Sot në këtë seancë të parë kushtuar angazhimit të Qeverisë për sigurimin e vaksinave anti-COVID, do të paraqes shkurt qasjen time, duke theksuar atë se nuk kemi arritur atë që kemi synuar për të gjithë ata muaj, por studimet tona kanë prodhuar sukses.

Personalisht jam krenar me qytetarët tanë që respektojnë rekomandimet dhe Ligjin për pandeminë COVID-19. Jam krenar me mjekët, infermierët, stafin teknik dhe institucionet qendrore e lokale që përkrahën shëndetësinë. Më së paku jam krenar me politizimin e skajshëm dhe banal që ka ndodhur vitin e kaluar në situatën pandemike në vend, shumica nga ju jeni këtu dëshmitarë.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Ne kemi staf profesional, me dije e vullnet shembullor, ata kanë nevojë vetëm për kushte, në rend të parë dhe respekt meritore në pajtim me misionin e tyre. Ky respekt nuk jepet me doza të kufizuara, as si lëmshë e trajtim të dorës së dytë të shtetit tonë. Më 23 mars 2021 i kam dorëzuar detyrën ministrit Arben Vitia, ashtu siç kam vijuar me punën e tij kam pritur që do ta vijojë aty ku kam mbetur. Personalisht jam thellësisht i dëshpëruar me situatën e krijuar, jo që nuk e vijoi, por duket që e degradoi thellësisht gjatë këtyre 30 ditëve. Këtë nuk e meriton shëndetësia, por nuk e meritojnë as qytetarët tanë. Mosvijimi i kontratave menjëherë, kontakteve të arritura dhe zbatimit të zotimeve, pa arsytim racional, është tejet dëshpërues. Askush nuk duhet të sulmohet për shkak të kërkesës për transparencë. Për këto 30 ditë, të nderuar kolegë, janë 21 mijë e 039 persona të infektuar të rinj, me 353 vdekje, asnjë fjali për 30 ditë nga qeveria, së paku një ngushëllim. Janë shpenzuar vaksinat dhe salla "1 Tetori" është mbyllur. Tash duhet të keni vëmendje, ashtu siç e kishit në vëmendje 15 prillin për nënshkrimin e kontratës, por edhe 8 qershorin, është afati i marrjes së vaksinës së dytë të Astra Zeneca.

Për këto 30 ditë transparenca rreth furnizimit me vakcina është zero, madje edhe llogaridhënia ndaj qytetarëve është zero, përpos këtij debati të sotëm. Ku dhe si qëndrojmë me furnizim me barna, e dëgjuam një arsytim, për 30 ditë të qeverisjes është anomali të shpenzohen 5,5 milionë për blerje dhe furnizim të barnave. Ky shpjegim nuk do arsytim tjetër, përpos arsytim banal

dhe me tendencë të zvogëlimit të përkrahjes buxhetore për sektorin e shëndetësisë, aty i keni edhe 10 milionë të tjera të aprovuara në janar nga Qeveria e Republikës së Kosovës si shtesë buxhetit apo sektorit të shëndetësisë në përballje me pandeminë.

Angazhimet për furnizim dhe zbatimin e kontakteve të zhvilluara më tej janë të panjohura, mbeten të panjohura edhe sot. Vetëm sot kemi dëgjuar, u tha këtu, se numri 5 mijë e 500, u potencua, u theksua e u deklarua edhe nga ministri se numri 5 mijë e 500 është më i vogël se numri 2 mijë dhe 3 mijë i testimeve. Paramendoni, u dëgjua edhe nga deputetët, kjo ulje e paarsyeshme, racional i numrit të testimeve që mbetet hulumtimi, testimi dhe përcjellja e situatës epidemiologjike duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme dhe intensive, jo me ditë, me javë apo me muaj. Ulja e testimeve në veçanti kur ka rritje të numrit të infeksionit ndikon në rritjen e rasteve të reja, numrit të vdekjeve dhe dëmton shëndetin. Paramendojeni tash kur nuk kemi teste dhe nuk dëgjomë teste as të mësimdhënësve, nxënësve e kategorive të tjera të shpenzuara, dëgjojmë vetëm insistim për planifikim të testimeve.

Në kohën kur përballja me pandeminë ishte në pikun më të lartë, testimet ofroheshin falas edhe në sheshin e kryeqytetit të Prishtinës. Furnizimet me material shpenzues dhe mjete mbrojtëse janë dobësuar. Klinika Infektive theksohet nuk ka dezinfektues për duar, non sens. Konkursi për të fuqizuar stafin e mesëm shëndetësor kundër virusit është ndërprerë, 28 pacientë mbesin nën mbikëqyrjen e një infermieri, edhe pse me staf të mesëm gjatë vitit të kaluar, sistemit tonë shëndetësor iu shtuan më shumë se 608 profesionistë shëndetësorë. Pas një viti në luftë të pandërprerë dhe punë e përkushtim, përkrahja financiare për punonjësit shëndetësor është zvogëluar. Nuk dëgjuam ndonjë arsye apo shpjegim. Kjo tregon vetëm mosinteresim dhe mosshpërbllim për punën e bërë. Infektimet janë rritur, rastet e vdekjeve nga virusi janë rritur, statistikat janë në përqindje dhe numri i testimeve jo në ulje të testimeve, fshehje të numrit të rasteve dhe ngulfatje të zërit të profesionistëve shëndetësor.

Ju po punoni të udhëhiqni me logjikën e përjashtimit, ekskluzivitetit, regresit dhe asnjëherë ndërtimit të një fronti të përbashkët për ta mundur virusin COVID-19, atë që e bëmë gjatë një viti me mund dhe sakrificë. Nuk guxojmë ta ndalim jetën me mbyllje para asnjë arsytimi. Jo shtet i mbyllur, jo biznese të mbyllura, po të hapur por me zbatim rigoroz të masave.

Menaxhimi i Pandemisë me qytetarë të mbyllur është më i lehtë, me pak raste dhe me shumë efektivitet formal. Por, ne nuk mund të kthehemi në pikën zero, nuk mund të kthehemi në pikën kur për 52 ditë të Pandemisë keni bërë vetëm 15 mijë teste, duke i mbajtur qytetarët të mbyllur. Mosnjohja me virusin është arsye dhe me praktikën apo njohuritë e reja, por tanimë nuk ka arsye. E potencuat, zoti ministër, edhe në fjalimin e juaj, se keni më shumë se njëmijë shtretër. Në kohën e qershorit, kur kishim vetëm 126 shtretër, kur nuk kishim oksigjen, kur nuk kishim respiratorë, kur nuk kishte resurse humane, kur nuk kishte kapacitete testuese. Sot nuk është problemi i oksigjenit, nuk ka problem për respirator, nuk ka problem për oksigjen frymues, nuk



ka problem për rëntgen mobil, nuk ka problem për barna, nuk ka problem për kapacitete testuese. Ato janë shumëfishuar, janë dhjetëfishuar, e qind për qind janë fishuar. Domethënë, kjo është përgjigja dhe gjendja në të cilën ju e keni gjetur Pandeminë.

Ajo që duhet të dëgjohej dhe ta dinë qytetarët është përkushtimi juaj, i cili nuk po shihet, për mandatin dhe besimin që keni marrë për të bërë më të mirën, tash menjëherë, për të gjithë, pa dallim, në tërë vendin. Qytetarët, është e vërtetë, nuk e duan përçarjen e as demagogjinë. Nuk ka vend për fjalë të bukura apo tregues të fuqisë së numrave, ndërsa kontributi dhe puna askund.

Të nderuar deputetë, të gjithë ne do të jemi faqebardhë kur ta largojmë virusin vdekjeprurës nga vendi ynë. Andaj, përpjekja jonë do të duhej të ishte dhe duhet të jetë e jona dhe e juaja. Fshehja pas numrave tregon paaftësinë për ta luftuar dhe parandaluar virusin. Menaxhimi i Pandemisë duhet të jetë prioritet dhe të ketë vullnet. Planifikimet nuk janë mandatorë, planifikimet janë përtej një mandati. Fatkeqësisht, kur dëgjon profesionistë shëndetësorë mënyrën se si i atribuohen procesit të fuqizimit të kapaciteteve profesionale apo resurseve humane, kur dëgjon sot pas pesë vitesh apo gjashtë vitesh mungesë të specializimeve akoma që ka njerëz që atakojnë një proces të shumëpritur nga mjekët e rinj. 1 500 mjekë të rinj ti impenjuar në sistemin tonë shëndetësor mendoj që janë vlerë e përbashkët. Nuk janë vlerë personale e askujt.

Planifikimi, konkurrimi, përfaqësimi, shpërndarja, kërkesat kanë ardhur nga baza, qoftë nga kujdesi parësor dhe qoftë nga kujdesi dytësor dhe Qendra Klinike Universitare. Asnjë fjali e vetme. Kundërshtimi ka ardhur nga nepotistët, nga kontrabanduesit, nga ata që me logjikën e klientelizmit e dëmtuan shëndetësinë kosovare në shumë vite. Ata të cilët mendojnë që janë specialistë për vete dhe dëshirojnë ta ruajnë një vend të përjetshëm për t'i shërbyer vetëm ai person...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Grupi yt po do pesë, por unë veç dy minuta mund të t'i jap. Faleminderit!

ARMEND ZEMAJ: ...ndërsa mjekët e rinj të ikur nga Republika e Kosovës, nga familjet e tyre me mund dhe sakrificë të cilët i kanë shkolluar. Ata që tentojnë të minimizojnë apo ta sulmojnë këtë proces e kanë gabim, se do të përballen me 1 500 mjekë dhe me ata që kanë pritur pesë vite, katër vite, tri vite e shumë të tjerë. Vendenis Lahu mund të ju tregojë sa vite ka pritur dhe si është specialist sot me nder e përkushtim por edhe me profesionalizëm edhe shumë të tjerët sikurse ky.

Andaj në fund, kolegë të nderuar, Qeveri, çfarë mund të presim nga ju? A keni votuar dje në Shqipëri? Keni mundur edhe sot t'i prisni atje rezultatet, sepse nga puna juaj, si me juve si pa juve, është e njëjta situata pandemike, dëshpëruese.

KRYETARI: Ministri Vitia e ka kërkuar fjalën për një ndërhyrje.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, kryetar!

Për besë, është pak shqetësuese gjithë ato kundërthënie gjatë një fjalimi. Tash, a kemi barna, a s'kemi barna? U thatë që ju kemi lënë barna, mbas 30 ditëve po thoni që tash s'keni barna. Ju shumë mirë e dini, se si bëhet prokurimi dhe si bëhen planifikimet për barna. Unë po ju them saktë atë çfarë kam gjetur në Ministri të Shëndetësisë. 11,59% është plotësuar lista e barnave esenciale. Kjo nuk mund të bëhet për 30 ditë, as përmirësimi as kurrgjë. Kjo është dashur të bëhet disa muaj më herët.

Në anën tjetër, folët për specializimet, gjoja s'ka pasur që 50 vite. Po, gjëja më e lehtë është të nënshkruhet një dokument për të nënshkruar 1 400 - 1 500, e pse jo edhe 2 000 specializime, por nuk është e vërtetë, ju lutem, se është bërë në bazë të një plani dhe një analize. Në kohë pandemie të merren 1 400... nuk mund të analizohet, zoti Gashi, faleminderit për ndërhyrje. Në një kohë Pandemie të merren 1400 punëtorë, ushtarë të kësaj Pandemie nga vendet ku punojnë dhe merren drejtpërdrejtë me pacientët në terren e të vendosen në QKUK, ku nuk kanë çfarë të bëjnë, se nuk ka mentorë të mjaftueshëm, ku nuk e marrin as dijen e duhur që duhet ta marrin dhe për çka janë të thirrur aty. Po, ky është një dëm shëndetësor, që nuk riparohet!

Përndryshe, konstatimi se u është bërë presion kolegëve, ose dikujt tjetër, për të ulur testet apo diçka... për besë, është ogurzi. Nuk po mund të besoj, që dikush që ka qenë në Ministrinë e Shëndetësisë të vijë në një konstatim të tillë të pabazuar dhe komplet është shpifje.

Zoti Zemaj, ju kuptoj në petkun e opozitarit edhe krejt ato që i thatë, më beso, i marr si të mirëqena. Edhe nga ky petk çdo kritikë tuajën do ta marr me seriozitet, çdo ofendim tuajin do ta marr me shumë sportivitet, por nuk mund të ju kuptoj në petkun e ministrit në kohën kur keni qenë si ministër, sepse është e pafalshme dhe kalon dimensionet edhe personale dhe morale, zoti Zemaj.

Ju mund edhe të shpifni sot, edhe të kritikoni dhe plotësisht ju kuptoj, por asnjëherë nuk do të ju kuptoj pse në kohë Pandemie, zoti Zemaj, e keni përgjysmuar buxhetin nëpër komuna nga 11 milionë në 5 milionë euro? Pse keni thënë se do të ndërtoni spitalin e Podujevës pa pasur asnjë cent të buxhetuar? Pse keni filluar procedurat për ndërtimin e spitalit COVID pa pasur fare mjete, duke shkaktuar edhe dëme buxhetit të shtetit për 400 mijë euro. Keni hapur 1400 specializime në kohë pandemie dhe keni larguar komplet mjekët nga fronti dhe keni sjellë në korridoret e SHSKUK-së në QKUK pa pasur as kush t'i mësojë, zoti Zemaj. Keni blerë autoambulanca me 20% më shtrenjtë se normalja që kanë qenë standardi për shumë vite, nga viti 2017, ose 2018, në mos gabohem.

E për t'i vënë pikë gjithë kësaj pune në një kohë kur kemi nevojë për barna, siç thatë ju, po, por çka ju desh një qendër e mjekësisë familjare në Strelc, në vendlindjen e juaj, zoti Zemaj? A do të thotë që ta ndërtoj edhe unë një në Marec tani edhe të shkojmë me këtë logjikë, zoti Zemaj?

Më beso, mund të keni qenë dhjetë muaj si ministër, mirëpo e keni bërë si të ishit dhjetë vite sa i përket dëmet që i keni shkaktuar sistemit shëndetësor. Dhe ky dëm, më besoni, se nuk do të jetë i riparueshëm as për dhjetë vite, sidomos karshi specializimeve që do t'i ndjejmë edhe më shumë se dhjetë vite, zoti Zemaj. Edhe për këto, më besoni se keni me u bind edhe ju vetë, sikurse kanë me u bind qytetarët edhe pas dhjetë e sa viteve të tjera. Faleminderit!

**KRYETARI:** Replikë, deputeti Armend Zemaj.

**ARMEND ZEMAJ:** Me të vërtetë është për të ardhur keq nga një profesionist shëndetësor, kur dëgjon këtë gjuhë të urrejtjes ndaj mjekëve të rinj, me të vërtetë është për të ardhur keq, pavarësisht personalizimit të debatit.

Unë e di që nuk ke kohë, mund të ketë edhe mosdije, ndoshta edhe përkushtim, ndoshta edhe je i kapur nga dikush aty, që nuk ke kohë me i lexua dokumentet bazike. Edhe një herë, e ke dokumentin zyrtar nga kanë ardhur propozimet për specializime, si kanë ardhur, si janë evidentuar dhe si janë saktësuar e si janë menaxhuar nga Bordi për Shkollim Specialistik, jo nga ministri. Për këtë arsye këtu të mungon njohuria bazike me procedurën administrative. Këto i ke faktike. Nëse dëshironi me pas kohë unë i lexoj, edhe vendimin, edhe arsyetimin.

E dyta, zoti ministër, me përgjegjësi të plotë morale, autoambulancat i kam gjetur të blera nga Qeveria kur ke qenë ti. I kam gjetur të blera, edhe një herë po them. Nëse nuk kanë qenë të blera, unë sot e dorëzoj mandatin e deputetit. 20% më shtrenjtë nga ju, jo nga unë. Kështu që, merr informacione të sakta. Edhe një herë po e them me përgjegjësi të plotë, 3 autoambulanca, a katër, nëse nuk gabo, kanë qenë të blera në mandatin tuaj si ministër, e iniciuar procedura, e blerë, e përfunduar, vetëm i kemi shpërndarë. Kaq! 10 autoambulanca i kam marrë donacion nga BE-ja, ato janë shpërndarë, e di, nëpër spitalet rajonale, nëse të kanë treguar, sipas nevojave të emergjencës.

Për barna, edhe një herë po të them, e ke të evidentuar, 10 milionë t'i kam lënë buxhet të pashpenzuara asnjë cent. I ke 10 milionë për pandemi, 5,5 milionëshi është i planifikuar, i buxhetuar, shumica e kontratave janë në vazhdimësi. Ka kontrata që është me tri-katër vite, atë nuk e din, sigurisht që nuk e din! Për këtë arsye është planifikimi dhe rishikimi i Buxhetit.

**KRYETARI:** Ministër, e dëshironi fjalën? Atëherë, fjalën e ka deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, dr. Shemsedin Dreshaj.

SHEMSEDIN DRESHAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit,  
I nderuari Kabinet Qeveritar,  
Të nderuar deputetë,  
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës.

Vërtet ka lezet kur opozita kritikon, e ngjallë pak ambientin, jep pak gjak të ri. Vërtet si opozitë ne duhet të kritikojmë nga pak, por njëkohësisht do të ishte mirë që në ato kritika tona të dalin disa përfundime me qëllim që t'i ndihmojmë këtij vendi.

Qytetarët janë tanët. Ky është vit i Pandemisë dhe jemi të gjithë të qartë që do të jetë vit i Pandemisë. Çdo ditë vërtet regjistrohen me qindra raste të reja, dhjetëra vdekje, mbingarkesë e tejskajshme e spitaleve me COVID, qofshin ato qendrore apo rajonale. E tërë kjo rezultoi me mbylljen parciale të një vendi, të vendit tonë, si dhe me karantinizimin e pjesshëm për 12 ditë. Impakti i saj apo impakti i këtij veprimi vërtet nuk ishte i mirë. Rezultuan diku rreth 50 mijë qytetarë që dolën jashtë vendit, diku me rreth 30 milionë humbje të Buxhetit të vendit. Nuk e di ku u mor ky 12 ditësh, kur inkubacioni maksimal është 14, ndërsa dyfishi i tij që ishte dashur të përdorej për menaxhim të Pandemisë është 28 ditë.

Çfarë bëri Qeveria në këtë mandat prej një muaji? Do t'i numëroj, edhe pse janë thënë shumica nga kolegët e mi më herët.

1. Refuzoi nënshkrimin e një kontrate për blerjen e vaksinës.
2. Mbylli vendin.
3. Vuri orën policore.
4. Uli subvencionet për profesionistët e involvuar drejtpërsëdrejti në menaxhimin e Pandemisë dhe atë e uli për 100%, të cilat madje edhe i tatimoi në mënyrë të kundërligjshme. Subvencionet nuk tatimohen.

Duke bërë kështu ajo bëri edhe një ofendim të rëndë për shumicën e shtresave të popullatës, të cilat janë në menaxhimin e drejtpërdrejtë të Pandemisë, jo vetëm tek mjekët. Preku edhe pensionistët si kategorinë më të ndjeshme të vendit.

Ndër profesionet më të prekura, si në aspektin e përkushtimit, si në aspektin e sakrificës ishin matelbardhët. Nga 13 marsi i vitit të kaluar e deri më sot pa asnjë ditë pushimi, me shumë viktima në radhët e tyre, vërtet na quajtët heronj, por heronj në letër. Ata u ofenduan rëndë me këtë veprim, me uljen e atyre pak mbështetjeve subvencionale që i kanë pasur. Për katërmëdhjetë muaj të Pandemisë, ua përkujtoj se 34 mantelbardhë kanë humbur betejën me COVID-in duke punuar në vendin e punës. Ua përkujtoj se prej tyre janë 18 mjekë, janë 5 stomatologë, janë 10 infermierë, i fundit para tre-katër ditësh një anesteziolog, e dini.

Vetëm në Qendrën Klinike Universitare ju informoj se 60% e stafit janë të infektuar me COVID, kjo vlen për Klinikën Infektive, Klinikën e Pulmologjisë, Klinikën e Neurologjisë, Klinikën Interne dhe ... Edhe qendrat tjera shëndetësore nuk qëndrojnë më mirë, edhe pse për to nuk kemi të dhëna të sakta. Dora e shtetit në përkujdesje ndaj këtyre njerëzve nuk bëhet me subvencione të limituara dhe të tatimuar kundërligjshëm, por me paga dinjitoze, me stimulim dinjitoz. Kjo mund të bëhet përmes Ligjit të pagave, të cilin e kemi dhe të cilin duhet ta amendamentojmë dhe ta aprovojmë.

Pandemia dhe menaxhimi i këtillë kanë prekur edhe shumë segmente tjera të shoqërisë. Neve sot nuk përmendim arsimin. Ju them, dëmet janë të mëdha, vështirë të matshme, por me to do të ballafaqohemi me vitet në vijim. Në veçanti kjo vlen për profesione të aplikuara, që kërkojnë shkathtësi praktike, ato nuk jepen përmes sistemit online.

Ekspertët lokalë kanë parashikuar diku një rënie të punësimit apo rritje të papunësisë prej 25 - 45 mijë persona, të cilët paraqesin po aq numra familjesh. Arsyeja se përse vendet e rajonit do të performojnë më mirë, kjo është vlerësim për tek ti. Do të performojnë më mirë në punësim, në normën e rritjes ekonomike është për shkak se qeveritë e tyre me kohë kanë bërë blerjen e vaksinës.

Për t'ua rikujtuar se ku jemi me vaksinën deri më datën 24 prill, pra ua përkujtoj se fqinji ynë verior 28% të popullsisë e ka vaksinuar me vaksinën e dytë, Mali i Zi me 6% me dozën e parë, ndërsa ne nuk jemi as afër 1%-shit. Mënyra e vetme për stabilitet afatgjatë është sigurimi i vaksinave, nuk është as karantinizimi, as ora policore. Çdo vonesë e vaksinimit pas datës 30 qershor, ta dini, Kosovën e sjell në një getto. E them këtë, për shkak se nga ajo datë do të fillojë të përdoret pasaporta vaksinale për të udhëtuar jashtë Kosovës. Nuk do të kemi mundësi as në vendet e rajonit, pra te fqinjët tanë të parë të shkojmë.

Shkencërisht është e dëshmuar se vaksina mbron, dhe atë ulë numrin e rasteve të vdekjeve, formës së rëndë të sëmundjeve, rasteve të ndërlikuara, ulë koston e trajtimit. Një pjesë e madhe e juaja e keni kaluar COVID-in dhe e dini sa kushton. Unë vetëm ua përkujtoj, trajtimi shtëpiak së bashku me analiza tejkalon 1 500 euro për individ. Ka këtu prej atyre që kanë qenë edhe pacientë të mi mjaftë. Nëse ka nevojë për spitalizim tejkalon 3 000 euro, pa llogaritur shërbimet shëndetësore dhe materialin që është brenda spitaleve.

Që të dalim të suksesshëm na duhet urgjent ta sigurojmë vaksinën. Të fillohet vaksinimi masiv sipas planit strategjik të hartuar, ku në ditë duhet të vaksinohen së paku 20 mijë pacientë, 20 mijë doza të ordinohen. Kjo ka qenë edhe në qeverisjen paraprake e paraparë.

Të bëhet promovimi i benefiteve nga vaksina e jo në mediat tona për çdo ditë t'i kemi efektet anësore të vaksinës. Ua përkujtoj që nga 32 milionë të vaksinës Astra Zeneca, të cilat janë dhënë

në botë, diku 174 raste janë të evidentuara me ndërlikime. Nëse e kthejmë në përqindje i bie: një rast në 200 mijë banorë. Ndërsa ne në Kosovë nëse llogarisim numrin e testeve pozitive, pra pacientëve të infektuar, diku rreth 100 e disa mijë sa i kemi dhe i kemi 2 100 e sa të vdekur, pra do të thotë i bie diku shkalla e vdekshmërisë 21 raste në 1 000 të infektuar.

Të aprovohet Ligji i pagave sa më shpejtë që është mundur. Të bihet dinjiteti i punëtorëve shëndetësor në vend dhe njëkohësisht ua përkujtoj, se më i mirë është çdo ligj sesa pa ligj. Të amendamentohet aty ku duhet.

Të sigurohet lëvizja e lirë e qytetarëve, pasi që pas pasaportave shtetërore, së shpejti do të na nevojiten edhe pasaportat vaksinale, të cilat nuk do t'i kemi pa i marrë dy doza vaksinë.

Të sigurohet arsim cilësor, në veçanti në drejtimet profesionale, pra domethënë të mundësohet vaksinimi i mësuesve dhe profesorëve, ashtu që nxënësit dhe studentët, në veçanti profilet që janë aplikative, të kenë mësim me kontakt fizik.

Qëndrojmë në pozitën më...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Vazhdoja fjalën edhe dy minuta, ju lutem!

**SHEMSEDIN DRESHAJ:** Vetëm një minutë. Faleminderit!

Qëndrojmë në pozitën më të keqen në Rajon, me rritjen ekonomike, me varfërinë më të madhe, si dhe me vaksinimin më të ulët të popullacionit. E vetmja mënyrë afatgjatë për të minimizuar efektet e COVID-19-shit, si dhe për të stabilizuar afatgjatë vendin është vaksinimi. Mbajeni mend, Pandemia na bashkon. Edhe pse opozitë, jemi mbështetës në secilin segment, qoftë në segmentin e furnizimit, qoftë në segmentin e implementimit, qoftë në segmentin e promovimit të vaksinës dhe të vaksinimit masiv të popullatës në Kosovë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministri i Financave, Hekuran Murati.

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

U bë temë çështja e shtesave dhe disa vendimeve që u morën në njërin nga mbledhjet e kaluara të Qeverisë dhe në vazhdimësi po tentohet të manipulohet publiku, por edhe përfituesit, gjoja se Qeveria paska ulur shtesa apo nuk paska ndjeshmëri për një kategori të caktuar. Problemi është se ato shtesa kanë qenë vendim i marrë në fillim të këtij viti, në kohë fushate zgjedhore dhe kanë qenë me afat deri në fund të muajit mars. Siç e sqaroi edhe ministri Vitia, pra nuk ka pasur shtesa

më tutje. Dhe kërkesa e ministrit Vitia për personelin shëndetësor ka qenë që të gjejë një mënyrë me gjithë kufizimet buxhetore dhe me gjithë shtrëngimet që i kemi në aspektin fiskal, ta gjejmë një mënyrë dhe një hapësirë që të paktën të sigurojmë edhe për ca kohë, përdërisa mbretëron kjo situatë, vazhdimin e shtesave për personelin shëndetësor. Edhe jemi munduar e kemi gjetur atë hapësirë dhe kemi marrë vendim si Qeveri në muajin e parë.

Pra, në 30-ditëshin e parë është marrë vendimi për shtesa për personelin shëndetësor, për shtesa për personelin e sigurisë, pra policinë, për të bërë shtesat edhe për pensionistët të cilët po ashtu po të mos ishte ai vendim do t'i kishin marrë 90 euro pensionin, e pensionet me aftësi të kufizuara do të ishin nga 75 euro. Por këtë muaj, për shkak të atij vendimi, kanë marrë nga 100 euro.

Pra, jemi duke folur për një buxhet i cili nuk është se është në gjendjen më të mirë, sidomos tani në kohë pandemie, por po ashtu marrë parasysh edhe obligimet që qeveri e qeveri me radhë i kanë lënë të akumuluar. Pra ka qindra miliona fatura të papaguara që datojnë prej v. 2013 e tutje. Qindra milionë janë, më shumë se 200 janë totali. Tash ku qëndron hipokrizia këtu? Se të gjithë këta që po ankohen i kemi parë në qeverisjet e kaluara çka kanë bërë. D.m.th. edhe Aleanca. Po ne ju tregova çka kemi bërë. Në muajin e parë kemi marrë vendim për shtesa, të cilat kanë qenë vendime të qeverive të kaluara.

Pra, nuk ka pasur vendim të tillë. I është dashur diku gjashtë muaj për të marrë vendim për shtesa të pensionistëve. Ndërsa në qeverinë që ka udhëhequr tash ky zotëri Dreshaj deputeti nuk qenka këtu edhe me siguri që ndoshta nuk e di, se nuk ka qenë asokohe pjesë e Aleancës, por në Qeverinë që ka udhëhequr Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, vendimi i parë për rritje të pagave ka qenë për t'ia rritur pagën vetes, kabinetit qeveritar, jo personelit shëndetësor. Pajtohem që një gjë e tillë duhet të bëhet me ligj të pagave, e jo me manipulime siç janë bërë deri tash, gjoja me amendamente me Ligj të Buxhetit. Ajo duhet të bëhet me Ligj të pagave, me një ligj të mirëfilltë, jo sikur ai ligji që është bërë me manipulime asokohe po ashtu për fushatë zgjedhore dhe për qëllime elektorale dhe në fund u pa si përfundoi i pazbatueshëm, sepse është bërë një ligj sipas dëshirave dhe tekeve dhe elektoratit e jo një ligj që zbatohet.

Pra, këtu qëndron problemi. Të gjithë juve ju kemi parë, vite e vite keni qeverisur e deri sot s'ju ra në mend as për personelin shëndetësor e as për pensionistët, kurse një qeveri që në muajin e parë të qeverisjes mori vendime për t'ia rritur, për të aplikuar shtesa edhe për personel shëndetësor edhe për pensionistë, ju gjeni kohë të kritikoni.

Te çështja, u përmend edhe çështja e masave dhe pse gjoja ato masa paskan rezultuar që disa qytetarë në një fundjavë të shkojnë në Shqipëri, edhe u përmendën shifra dhjetëra milionëshe gjoja se kanë humbur. Unë nuk po e di se me çfarë matematike i bëni këto llogari, por qarkullimi mujor, pra për tërë muajin i sektorit të gastronomisë është 12 milionë euro.

Pra qarkullimi për tërë muajin është 12 milionë euro. Tash unë nuk e di nga e keni marrë 20 milionë euro për dy ditë. D.m.th. shihet se ka problem me matematikë kjo çështje. Për më tepër, ne shteti i Kosovës për çdo ditë importon nga 9 milionë euro, çdo ditë. Për çdo ditë shteti i Kosovës ia çon Serbisë nga një milion euro. Pse deri sot nuk e dëgjova askënd duke e bërë problem këtë farë pune, por po thonë pse me një fundjavë paskan shkuar në Shqipëri. Për më tepër, në Shqipëri e kishim një rast. Veç pak zotëri Haxhiu. Pra, për më tepër, kemi një situatë ku ne.

KRYETARI: Ju lutem, mos e pengoni ministrin! Do t'ju vijë radha secilit.

MINSITRI HEKURAN MURATI: Ju lutem, veç pak!

Mjetet financiare janë për vaksinat siç e sqaroi edhe ministri. Pra, ai është një proces, një çështje në procedurë e sipër. Shumë shpejt do të vijnë vaksinat, siç edhe kanë ardhur vaksinat e para në këtë Qeveri. Nuk kemi pasur, pra kemi pasur muaj e muaj të qeverisë së kaluar që nuk kanë ardhur vaksinat. Pra, çështja është si nuk u problematizua deri sot asgjë, as pensionet, as shtesat për mjekë, as pagat e mjekëve, po tash në 30-ditëshin e parë të Qeverisë Kurti po tentohet që të zgjidhen të gjitha problemet që ju i keni shkaktuar që njëzet vite. Faleminderit!

KRYETARI: S'ka replikë. Fjalën e ka Haxhi Avdyli, sipas radhës.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sigurimi i vaksinimi nuk është një proces i lehtë, për shkak të kërkesave të mëdha, por edhe për shkak edhe të kufizimit të prodhimit të tyre. Në një shtet stabil dhe të pjekur demokratik dhe politik çdoherë ministri paraprak dhe ministri aktual do të duhej t'i bashkonin forcat që të lehtësonin ardhjen e vaksinave, mbarëvajtjen e këtij procesi, i cili është një vazhdimësi.

Sigurimi i vaksinave në botë më shumë është edhe një garë mes shteteve e jo garë apo luftë politike mes ministrave. Mendoj që rreth sigurimit të vaksinës dhe luftës ndaj pandemisë do të duhej të ishim bashkë, sepse kjo është një fitore e përbashkët e jona, sepse sëmundja dhe pandemia COVID nuk po i zgjedh askënd pa marrë parasysh çfarë dallime e bindje politike kemi. Natyrisht ballafaqimi me pandeminë COVID në botë nuk është i lehtë, siç nuk është i lehtë edhe te ne. Numri i viktimave ka qenë i madh edhe në shtetet e ndryshme siç ka qenë edhe te ne. Por të bëhet politikë me viktima dhe të përmenden viktimat këtu në këtë Parlament nuk na bën nder dhe nuk i nderojmë ato viktima atje, sepse janë nënat dhe baballarët e dikujt. Është joetike që të akuzohet tani një ministër i cili paska ardhur para katër javësh. Unë edhe ndoshta do t'i bashkohesha kritikave edhe të z. Hoxha, edhe ministrit të kaluar Zemaj nëse Qeveria e kaluar do të kishte arritur së paku gjysmën e punës së vendeve fqinje ta bënë në sigurimin e vaksinave.



Por, vaksinat në të kaluarën, apo deri para disa javësh kanë qenë zero. Kjo është fakt. Po ashtu, edhe unë do t'i isha bashkuar kritikës së z. Vitia nëse sot do ta kishim këtu z. Vitia pas gjashtë muaj mandat, por sot i kemi vetëm katër javë dhe mendoj që ky proces nuk është i lehtë, veçanërisht kur bëhet ndërrimi i Qeverisë dhe unë pres që në këtë rast të dy ministrat, po edhe të tjerë aktorë të ndryshëm që të bashkoheshin dhe t'i shkëmbejnë informatat e deritashme rreth sigurimit të vaksinave, t'i shkëmbejnë edhe e-mailet, dhe jo e-mailet të shkëmbejnë me portale, po të shkëmbejnë ndërmjet vete dhe të shikohet deri ku ka mbërri puna. Nuk është marre të thuhet që kompanitë farmaceutike na i kanë luajt fjalët. Nuk është marre, sepse edhe dinë t'i luajnë, sepse kërkesa, ato janë firma private, ato dinë edhe shpeshherë të bëjnë me vakcina, sepse ka shtete që ofrojnë shumë më shumë, shumë më shtrenjtë edhe ne nuk kemi arritur.

Tani, është shumë për keqardhje, që përveç vaksinave ne kemi zvogëluar edhe buxhetin farmaceutik. Ne nuk kemi vaksinat, por edhe ata të cilët do t'i trajtonim dh në v. 2020 i kishim mbi 11 milionë euro, ne e kemi sjellë buxhetin farmaceutik në pesë milionë euro. Në të njëjtën kohë ne kemi shtuar buxhetin për ndërtimin e qendrave të mjekësisë familjare. Kemi ndërtuar objekte. Nuk kemi investuar në teknologji, nuk kemi investuar në barna, po në objekte. Sipas studimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Kosova më së paku ka nevojë për objekte. Më shumë ka nevojë për resurse humane, më shumë ka nevojë për investime në teknologji dhe barna. Shpërndarja e objekteve të mjekësisë familjare, por edhe shfryzueshmëria e kapaciteteve spitalore në Kosovë është e vogël. Ka ambulanca nëpër fshatra që nuk kanë mjekë, ka ambulanca të fshatrave që nuk kanë as teknikë, por nuk ka as pacientë. Dhe ne në të njëjtën kohë po shkojmë duke ndërtuar objekte të reja.

Të nderuar deputetë,

Përvoja ne kemi pasur gjatë kësaj sezone të pandemisë, kemi marrë dhe kemi blerë vakcina për gripin sezonal. Ju lutem, 69.325 vakcina të gripit sezonal të cilat kanë kushtuar nga 11,6 euro për një vaksinë, janë të pashfrytëzuara. Dhe këto vakcina, çka do të ndodhë? Do të hedhen. Me llogaritjen që e bëra, janë 800 mijë euro. D.m.th. këto vakcina të gripit sezonal nuk janë shfrytëzuar, nuk është llbim te njerëzit apo marketing dhe që të merren këto vakcina, së paku të mbrohemi nga vakcina e gripit sezonal, ose së paku të mos bliheshin fare.

Të flasim pak edhe për resurset humane, se u përmendën shumë këtu. E vërteta është që pesë vjet nuk ka pasur specializime dhe është dashur që në këtë drejtim ndoshta edhe të punohej që të ketë specializime, sepse nevoja ka qenë e madhe dhe ka pasur shumë mjekë të rinj të cilët janë dëshpëruar dhe kanë ikur. Por, është e pakuptimtë që në mes të pandemisë të jepen 1 500 specializime, pa analizë, pa një strategji, një plan. Dhe çka po ndodh sot nëpër klinika të nderuar, sepse i përkas edhe një drejtim shumë specifik sikurse është neurokirurgjia, ku kemi me dhjetëra mjekë të rinj shumë të aftë, të cilët nuk po kanë shanse as të afrohen te pacienti. Nuk ka pacientë për ta. 100 mjekë janë në kirurgji të gojës, në kirurgji orale, që e kanë marrë specializimin. 35 dëgjova se janë në Oftalmologji dhe më thanë ata specialistët, më thanë doktor nuk po kemi as

çantën ku ta lëmë, jo të kenë shans së afrohen te pacienti. E specializimi dihet si bëhet. Specializimi është edukim. Dhe ne do t'ia shohim sherrin nëse këta djem dhe vajza shumë të aftë, pas pesë vitesh kur ta kryejnë specializimin, nuk do të jenë në gjendje ta kryejnë një operacion. Veç nëse ministri Vitia ndërmerr hapa shumë urgjentë dhe i rekomandoj që të krijojnë lidhje me shtetet e ndryshme në Evropë dhe në shtetet fqinje, që të krijojnë mundësi për trajnimin e tyre dhe dërgimin në specializim, sepse nuk kemi kapacitet t'i trajnojnë këta mjekë. Këta doktorë nuk kanë as mentor klinik, nuk kanë as raste për t'u futur në sallë të operacionit apo për të bërë një trajnim, e kirurgjia e mjekësia mësohet vetëm me punë praktike. Mos të flasim vetëm për teori, sepse edhe për teori duhen mentorët klinikë. Dhe ne po mendojmë që i kemi ndihmuar perspektivës së të rinjve. Po i kemi ndihmuar, po në të njëjtën kohë do të nxjerrim kirurgë jo të mirë.

Po në të njëjtën kohë e kemi tronditur thellësisht sistemin primar shëndetësor, apo mjekësinë familjare. 85 për qind të shërbimeve shëndetësore në botë, por edhe sipas statistikave dhe rekomandimeve të OBSH-së jepen në shëndetin primar, d.m.th. në mjekësinë familjare. 85 për qind, dhe ne çka kemi bërë, kemi marrë 85 për qind të këtyre mjekëve i kemi sjellë në QKUK dhe shëndetin primar, ambulancat ku do të duhej ata t'i shërbenin pacientëve, edhe të sëmurëve me COVID, dhe ata pos-COVID, ne nuk kemi mjekë. Tani i kemi lënë fshatrat dhe shumë lagje pa mjekë dhe e kemi koncentruar numrin e tyre në QKUK dhe tërë ditën ata nuk kanë mundësi, edhe pse dëshira e tyre për t'u edukuar është e madhe, nuk ka mundësi, sepse në botë edhe specializimi bëhet edhe në bazë të numrit të rasteve që ti i kryen. Nuk kanë mundësi t'i kryejnë p.sh. njëqind apendiksa për një muaj ditë, sepse nuk ka, sepse janë pesëdhjetë, ndërsa një apendiks bëhet në javët ose pesë në javët. Nuk kanë shanse ata të hyjnë vetëm të shohin.

Në të njëjtën kohë ka ndodhur që të mbingarkohet stafi administrativ, që është një anomali në vetvete, sepse janë bërë rekrutime të panevojshme të stafit në administratë, edhe në emër të monitorimit të manualit të COVID-it, edhe shumë e shumë gjëra të tjera. Mbi të gjitha, është premtuar që ne do ta kemi spitalin COVID. A e dini çka është duke ndodhur me atë spitalin COVID? Herë nisët si emergjencë, pastaj kalohet në reparte të tjera dhe tani ia ngjitëm emrin spitali COVID. Për ju që nuk e dini, është ai objekti mes ortopedisë dhe kirurgjisë ai objekti i madh, dhe aty janë dhënë disa herë tenderë dhe janë anuluar, janë bërë punë dhe janë prishur punë dhe është bërë një numër i shpëlarjeve të parave të disa tenderëve të caktuar, jo vetëm të ministrit të kaluar, po edhe më herët dhe akoma ai objekt ka mbetur një objekt fantazmë. Është premtuar se do të bëhet spitali COVID dhe nuk është bërë, dhe nuk ka pasur shanse të bëhet, po së paku nuk është dashur të premtohet kjo se do ta bëjmë atë spital. Po në të njëjtën kohë janë dhënë edhe 400 mijë euro në emër të studimit të një fizibiliteti, i cili nuk di çfarë kuptimi ka pasur.

Sidoqoftë, ne këtu duhet të jemi bashkë, përkundër të gjitha ne që mund të kemi kritika për njëri-tjetrin. T'i bashkojmë forcat, kushdo që ka mundësi të ndihmojë ministrit aktual që t'i sigurojë

vaksinat e pastaj edhe nëse i sigurojmë vaksinat ne pastaj mund të bisedojmë edhe të kritikojmë nëse këto vijnë.

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Thirrja e kësaj seance të Kuvendit nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është bërë për të sensibilizuar së pari Qeverinë pastaj edhe opinionin për mungesën e vaksinave dhe të vaksinimit në Kosovës. Më së paku opozita është duke bërë politikë me këtë temë. Fatkeqësisht, disa prej ministrave, në mungesë të argumenteve pse nuk kanë arritur t'i sigurojnë vaksinat këtu, ia nisën të na flasin për importin me Serbi. Kjo është politikë. Unë po i them ministrit lëre importin me Serbinë, tregona për vaksinat kur do t'i blesh, e për Serbinë tash je në Qeveri. Shko edhe merre vendimin për reciprocitet, kështu e ashtu ka qenë premtim i juaj elektorale, çështje javësh, por tani u bënë edhe muaj. Shkoni atje e pastaj flasim për politikë.

Prej fillimit të pandemisë janë më shumë, ose në fakt janë 104.196 raste pozitive me të dhënat e sotme. Ndërsa prej ardhjes së Qeverisë Kurti 2 janë 22.011 raste pozitive, apo kthyer në përqindje 21 për qind e rasteve të përgjithshme pozitive, për një muaj. Janë 2140 raste të vdekjes prej fillimit të pandemisë, apo prej se ka ardhur kjo Qeveri janë 380 raste të vdekjeve. Prej se ka ardhur Qeveria Kurti 17,7 për qind e rasteve të përgjithshme të vdekjeve. Këto janë shifrat zyrtare sot. Dhe për vaksinim, nuk po flasim, çka të flasim? 22 mijë të vaksinuar në Kosovë. Mesatarisht prej fillimit më dt. 29 mars e deri sot në ditë janë vaksinuar 603 persona. Me këtë ritëm të vaksinimit, Kosovës i duhen 10 vjet e gjysmë të përfundojë vaksinimi në krejt popullatën. Ndoshta juve s'po ju ngutet, veç njerëzit po vdesin çdo ditë. Nuk janë këto politikë me numra ose me vdekje, këta janë njerëz, janë qytetarë tanë këta që po vdesin, nuk mund t'i fshehim. Këto janë raste pozitive, pasojat edhe të rasteve pozitive që shpëtojnë, do t'i paguajnë qytetarët e këtij vendi.

Kosova lëre që nuk ka siguruar ndonjë kontratë për vaksinat, por edhe ato që i kishte të negociuar, nuk i nënshkroi. Duke qenë se sipas të dhënave të publikuara, nga mesatarja në Evropë janë vaksinuar 29 qytetarë për 100 banorë, ndërsa kjo shifër në Kosovë është për mjerim 0,01. Pra ende asnjë qytetar në 100 banorë nuk e kemi të vaksinuar. Normalisht që ky proces edhe më vonë do të ndodhë. Sigurisht i keni përcjellë mediat që Bashkimi Evropian ka kontraktuar 1,8 miliard vakcina me Pfizer. Unë po besoj që më vonë do të na ndihmojnë, qysh na ndihmoi Gjermania me një premtim prej 100 mijë vaksinave, Covax me 95 mijë dhe të tjera që do të vijnë. Nuk do të jetë më ndonjë lajm nënshkrimi i kontratës, sepse është diçka që do të ndodhë. Mund të bëhet lajm sikur rasti i San Marinos t'i japë gol Gjermanisë pahiri dhe ndodh

bëhet lajm. Po nuk do të duhej këtë çështje ta bëni të nivelit të tillë, sepse ka përgjegjësi në udhëheqje.

Pra, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Ministria e Shëndetësisë kanë miratuar një plan të vaksinimit. Plani ekziston dhe e mund të vejmë mbi 10 mijë vaksinime në ditë, me personelin shëndetësor që e kemi, me resurset që i kemi ne mund të bëjmë më shumë se dhjetëmijë vaksina në ditë, sepse kjo Qeveri nuk ka siguruar vaksina e as kontratë për të bërë një vaksinim të tillë. Kosova ka kapacitetet dhe ato do të duhej të shfrytëzohen. Qytetarët me të drejtë pyesin pse nuk ka vaksina në Kosovë. Sepse sigurimi i vaksinave nuk ishte prioritet për këtë Qeveri. As kontratat e gatshme nuk i nënshkruan, as mundësinë që ua dhamë nuk i shfrytëzuan. Në vend që të shfrytëzohen ofertat dhe mundësitë që ua dhamë, zgjodhën të bëjnë politikë me jetën e qytetarëve të Kosovës, duke i trajtuar qytetarët e Kosovës si qytetarë të rendit të dytë. Ndërsa kandidatët për deputetë nga Lëvizja Vetëvendosje në Shqipëri ishin prioritet për Qeverinë Kurti. Ata ishin prioritet. Këta qytetarë të Kosovës u trajtuan si qytetarë të rendit të dytë.

Kosova dhe bota janë në luftë me pandeminë dhe unë si humanist dhe çlirimtar i këtij vendi, në një luftë të këtillë nuk di të iki. Në beteja për vendin nuk kam ikur asnjëherë. Kam kontaktuar shoqatat e mjekëve në Evropë, në Amerikë dhe njerëzit tanë me ndikim në diasporë dhe përmes tyre kemi arritur të sigurojmë ofertë për Qeverinë e Kosovës për sigurimin prej 500 mijë deri 3 milionë vaksina. Kam kaluar barrierat politike të ndërtuara ndër vite për t'ia dhënë një mundësi më shumë qytetarëve të Republikës së Kosovës në këtë betejë me pandeminë dhe një mundësi më shumë Qeverisë së Kosovës në këtë betejë me pandeminë.

Por, Ministria e Shëndetësisë as e-mail nuk i ka dërguar as kërkesë kompanive të cilat na kanë ofruar mundësi të tilla. Ne edhe mund t'i injorojmë, edhe të mos i vlerësojmë ca partnerë, por Presidentja e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen pas sigurimit të kontratës prej 1.8 miliard vaksinave, ka falënderuar jo vetëm Pfizer, por edhe partnerët e saj që i mundësuan një kontratë të tillë. Kurse ne i kemi anashkaluar.

Pra, Kosova dhe kjo Qeveri në këtë situatë ka neglizhuar, përveç injorancës dhe paaftësisë, ka shkuar deri aty sa që të refuzojë edhe vaksinat nga Shqipëria, se janë të Kinës. Ndërsa unë po jua rikujtoj, Qeveria Kurti 1 mori njëmijë teste nga Serbia të prodhuara në Rusi, ndërsa Qeveria Kurti 2 refuzoi vaksinat nga Shqipëria.

Kur jemi te kjo temë, unë kam një kërkesë për Qeverinë e Shqipërisë, që të hapë një pikë të vaksinimit për qytetarët e Kosovës në pikën kufitare në Morinë dhe aplikimin online për qytetarët tanë që kush dëshiron prej qytetarëve të Republikës së Kosovës t'u mundësohet vaksinimi në pikën kufitare që të shpëtojmë nga ky virus vrastar se Qeveria jonë ka dështuar. Derisa qytetarët tanë çdo ditë po vdesin nga koronavirusi, Qeveria e Kosovës është marrë me

fushatën në Shqipëri. Në kohën kur Albin Kurti po votonte në Shqipëri, unë te qendra e mbyllur e vaksinimit 1 Tetori në Prishtinë takova qytetarë që po ktheheshin, jo vetëm në mungesë të marrjes së vaksinës, po edhe në mungesë të marrjes së një informate për ata që kanë pasur reaksione pas marrjes së vaksinës. Kjo është ajo që ka ndodhur nga kjo Qeveri.

Të nderuar qeveritarë,

Pas një pune vetëmohuese të mjekëve dhe të profesionistëve shëndetësorë, stafit mbështetës, inspektoratit, policisë, përse i përjashtuat nga shtesat edhe kategoritë e tjera? Pse demotivuat profesionistët shëndetësorë dhe stafin mbështetës? Pse nuk menduat edhe për ata punëtorët e pastrimit që i heqin mbetjet COVID, edhe për punëtorët e sigurimit që rrinë në dyert e klinikave dhe nuk kanë asnjë mbështetje nga Qeveria?

Përse me të emëruar politikë, po i përndiqni punëtorët e QKUK-së? Përse larguat nga detyra shefin e kujdesit intensiv, doktor Naim Kuçin, i cili nuk është me asnjë parti, por është profesionist i vërtetë, dhe ju, pas më shume se një vit pune vetëmohuese të tij dhe të shumë mjekëve, e larguat.

E larguan të emëruarit tuaj politikë, të cilët marrin edhe shtesa me nga një kujdestari në muaj. Por, ata çdo ditë vishen me veshje mbrojtëse e u rrinë gati pacientëve, i larguat nga detyra.

Me këtë keni rrezikuar edhe jetën e qytetarëve dhe të pacienteve në kujdesin intensiv, dhe qytetarët do të duhej që të protestonin për këtë dëm që ua keni shkaktuar.

Kërkesa ime për Qeverinë është...

**KRYETARI:** Vazhdoja një minutë deputetit.

**BEKIM HAXHIU:** Kërkesa ime për Qeverinë është; pasi përfunduan zgjedhjet në Shqipëri, a mund ta kthejë vëmendjen te qytetarët e Kosovës? Virusi po vret çdo ditë dhe ai nuk po pyet për partitë politike.

Janë 2140 raste të vdekjeve, dhe këto janë jetë njerëzish dhe ju duhet të mendoni për qytetarët tanë. Çdo ditë e humbur në vaksinim, është humbje e jetëve të qytetarëve tanë, dhe OBSH-ja në javën e kaluar doli me komunikatë zyrtare dhe tha se prej vaksinimit pra, tani incidenca te moshat e shtyra ka rënë, te ata mbi 80 vjeç. Pra, sa i rëndësishëm është procesi i vaksinimit.

Prandaj, po e them me përgjegjësi se populli i Kosovës në këtë pandemi ka vetëm dy aleatë; punëtorët shëndetësorë edhe Zotin. Për këtë Qeveri, vaj halli!

**KRYETARI:** Fjalën e ka ministri Vitia.

MINISTRI ARBEN VITIA: Deputet Haxhiu, po më duket maska e juaj ka rënë.

Të nderuar deputetë,

Ju faleminderit edhe një herë për kritikën, për këshillat edhe për çdo sugjerim që po na e jepni. Faleminderit, zonja Deliu! Nuk po e shoh këtu. OK.

Unë vetëm e kam një bindje që fjalimi i saj ishte pa e dëgjuar fjalimin tim. Po, të gjitha ato që tha që duhet të bëhen, janë bërë të gjitha, jo vetëm nga ne, po edhe nga më herët dhe janë duke u bërë. Kështu që, mirë për këshillat, po jeni të mirëseardhur secili prej jush që të ndihmoni në këtë proces.

Nga fillimi secili që ka kontaktuar, e kanë qenë me dhjetëra, i kam takuar dhe kemi se si të bëhemi bashkë në këtë luftë të përbashkët kundër pandemisë. Përndryshe, pajtohem me konstatimin e secilit se kjo nuk është luftë vetëm e një qeverie, por është e të gjitha partive politike, po edhe e qytetarëve, e të gjithëve.

Në anën tjetër, nga profesori kam mësuar shumë si student dhe vazhdoj të mësoj çdoherë, edhe e falënderoj, mirëpo profesor, megjithatë, konstatime se kam refuzuar nënshkrim, sinqerisht i pres nga zoti Haxhiu që ma ka thënë edhe më herët, por jo nga ju, sepse e di që çdoherë ju bazoheni në dëshmi. Dhe, unë ju garantoj këtu që unë si ministër i Shëndetësisë, në asnjë moment nuk kam refuzuar asnjë nënshkrim i cili do të dëmtonte procesin e sigurimit të vaksinave.

Për këtë, jam i gatshëm, ashtu sikurse paraardhësi im, që nëse ka ndodhë diçka e tillë që unë kam refuzuar të nënshkruaj diçka që rrezikon një proces të tillë, unë jap dorëheqje nga ministri. Mirëpo në anën tjetër, unë nuk do të kërkoj dorëheqje nga ju, megjithëse sa u përket autoambulancave, procedura ka filluar në gusht të vitit 2020 kur ne nuk kemi qenë këtu. Është nënshkruar në pjesën e dytë, më 13 tetor 2020 dhe kontrata përfundimtare është nënshkruar në janar 2021. Asgjë nuk është iniciuar dhe as nënshkruar nga ne.

Në anën tjetër zoti Haxhiu, faleminderit që po shpreh gatishmëri që të na ndihmosh. Faleminderit shumë! Edhe në takimin që kishim, besoj që e kishim një takim të frytshëm dhe pas shumë takimeve paraprake edhe nga shumë qytetarë dhe bashkatdhetarë që kemi pasur, natyrisht se ne duhet t'i pyesim ata që duhet pyetur, prodhuesit e vaksinave. Dhe, përgjigjja nga të gjithë prodhuesit pa përjashtim, ka qenë se negocimi bëhet ekskluzivisht vetëm me prodhues. Asnjë kompani distributore nuk është e autorizuar që të negociojë për vakcina, askund në botë.

Përkundër asaj, bile njëra prej kompanive me të cilën më së paku kemi pasur kontakt, na ka thënë shprehimisht, nëse ndonjëra prej këtyre kompanive ju kontakton, duhet t'i lajmëroni autoritetet lokale, sepse mund të jetë një rast i mashtrimit.

Prapë në aspektin e mosnënshtrimit, ju lutem të keni edhe pak durim! Unë e dhashë një premtim publik, në momentin që del që unë nuk kam nënshkruar diçka që rrezikon këtë proces, mbaj përgjegjësi të plotë morale, bile edhe penale ligjore për rrezikimin e procesit të vaksinimit. Nëse del diçka e tillë, para jush, para qytetarëve, ballëhapur po e jap një premtim të tillë, kështu që të kemi vetëm edhe pak durim derisa të mbarojnë disa procese.

Po zoti Haxhiu, ka qenë një ritëm i ngadalësuar i vaksinimit. Po, kemi thënë nga fillimi që ky është një vaksinim specifik me një vaksinë e cila për herë të parë po përdoret në botë pa një testim paraprak, dhe duhet një edukim i stafit për vaksinimin.

Profesionistë tanë shëndetësorë janë, pjesa e imunizimit po flas, të gjithë ata që merren me shëndetësi në këtë sallë të nderuar e dinë, është pika më e shndritshme dhe unë jam i sigurt që në momentin kur të fillojnë të vinë vaksinat e para të kontingjentit të dytë të Covac-it në maj, pastaj ta Phizer-it nga Komisioni Evropian për Ballkanin Perëndimor, nuk do të ketë më ndalje të procesit, zoti Haxhiu, deri në fund dhe bashkërisht, jo ne, ne vetëm duhet tua lehtësojmë dhe tua lirojmë rrugën, po profesionistët shëndetësorë edhe ekipet tona të vaksinimit në terren, do të jemi të gjithë dëshmitarë se do ta kryejnë punën ashtu siç është më së miri.

Dhe për fund, edhe njëherë, pajtohem plotësisht profesor, dora e shtetit duhet të subvencionojë mantelbardhët. Nuk duhet t'u japim lëmoshë ose të ndjehen ose të presin nga ne, dhe natyrisht bashkë me zotin Murati, edhe kur jeni ulur dhe kemi diskutuar, është i vetmi një ligj i pagave që do t'ju mundësonte në mënyrë të dinjitetshme pagesat e tyre dhe të mos keni nevojë për shtesa të tilla, që më shumë janë harrnime ndoshta, se sa diçka konkretet që do të kishte kontribuar në rritjen e dinjitetit të mantelbardhëve. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi. Pë replikë, zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, kryetar!

Ministër i nderuar,

Gatishmëria që ta ndihmoj këtë proces, e thash, buron nga profesioni im, nga Betimi i Hipokratit, për t'i ndihmuar qytetarët e Republikës së Kosovës. Një gatishmëri e tillë, nuk po vërehet te Qeveria.

Po jua rikujtoj vetëm deklaratën e presidentes së Komisionit Evropian kur nënshkroi 1.8 miliardë vaksina dhe premtoi vaksinim të 70% të qytetarëve të Evropës deri në korrik, dhe tha, falënderojmë Phizer dhe partnerët e saj që na e mundësuan këtë kontratë dhe na e dhanë këtë mundësi.

Pra, përveç prodhuesve të vaksinave, ju duhet ta kuptoni procesin ti të tillë, sepse edhe në fazën e hulumtimeve shkencore këto kompani kërkojnë partnerë dhe këta partnerë, sigurisht që pastaj edhe mund të sigurojnë vaksinat për qytetarët. Kjo është mënyra.

Normalisht që kompanitë sikur të mundnin që t'ju linin të prisnit, ju lënë të prisni deri më 2023. Nëse ju nuk jeni të aftë që ta siguron, rri ti prit aty, por qytetarët po vdesin çdo ditë dhe sigurimi i vaksinës është shpëtim i jetëve të qytetarëve.

Normalisht që ju duhet ta sqaroni a keni urdhëruar ekipet e vaksinimit që ta zvogëlojnë numrin e vaksinimit, sepse ajo që njihet si me vlerë, pra ekipet e imunizimit janë të afta. Të mos i ofendoni, t'ju thuhet se jemi duke i edukuar që ta japin një vaksinë sot.

Njerëzve me përvojë 25-30 vjeçare t'ju thuhet, ne jemi duke mësuar ata se si ti japin vaksinat, prandaj... A e keni bërë të thoni, se s'ka vakcina në Kosovë, se ditën e tretë kur kanë arritur vaksinat, këtu s'do të kishte vakcina. I keni mbajtur disa lajme kështu, hajt se po vaksinojmë ndopak, por rezultatet janë për keqardhje. Jemi më keq se Bangladeshi.

**KRYETARI:** Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar...Aha replikë. Zoti Zemaj, urdhëroni!

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryetar!

Ministri siç duket në këtë pjesën e dytë ishte vetvetja, nuk ishte ministër me porosi. Në kuptimin e marrjes së instruksioneve se si duhet të sulmohet një ish-ministër apo një deputet opozitar, dhe këtë tregues e ka pasur të garantuar atë ditë kur kam dorëzuar mandatin, se sa i përket, së paku për vaksinën, jemi të gatshëm apo jam gatshëm 24 orë në dispozicion për të sqaruar progresin, procedurat, por edhe marrjen dhe ardhjen e vaksinës.

Këto i faktoi vet, të tri proceset, qoftë me Covac-in, qoftë me Phizer dhe qoftë me Komisionin Evropian. Andaj, kështu duhet të jetë një ministër, jo një ministër që vepron me porosi dhe me inate të atyre, të cilëve për një moment nuk iu ka pëlqyer apo nuk iu pëlqen ndërrimi i pushteteve.

Vetëm për sqarim! Zoti ministër, fshati Strelle apo dy Strellecat dhe që përfshinë edhe fshatin Lëbushë, janë pjesët më të banueshme në Komunën e Deçanit, janë 10 mijë banorë që gravitojnë në atë pjesë.

Kërkesa për shërbime, sidomos të kujdesit parësor është politik nacionale dhe e avancuar e Republikës së Kosovës. Jo pse unë jetoj, apo kam lindur, sepse nuk jetoj, por ka qenë kërkesë tërë vitin në vazhdimësi. Kështu që, nuk është mirë të ketë kësi lloj atakime të ulëta, banal, por unë jam krenar me atë pjesë, sepse është krenare edhe Republika e Kosovës, qoftë me emrin dhe qoftë me kontributin e qytetarëve apo banorëve që jetojnë në atë pjesë.



Kështu që, e meritojnë. Nuk është diçka e dhuruar, por është meritore.

**KRYETARI:** Ministri Vitia, a do që të flasësh lidhur me këto pretendime?

**MINISTRI ARBEN VITIA:** E para, më lejoni të shpjegojem. Asnjë dokument nuk e kam gjetur për procesin e negociimit të vaksinave në Ministrinë e Shëndetësisë, asnjë të vetëm, fare, as edhe një.

Në raportin që e kemi kërkuar nga kryesuesi i grupit negociator që ka qenë në kohën e ministrit paraprak, kanë dërguar një e-mail me tre rreshta: Me këtë kompani kemi pasur tri takime, me këtë dy, më këtë një. Domethënë kaq kemi pasur informacione për këto negociime.

Ato dokumente, zoti Zemaj, nuk janë tuajat, ato ishin të ministrisë edhe duhet të jenë të Ministrisë së Shëndetësisë. Ato duhet të lihen aty ku e kanë vendin në ministri, dhe jo të merren me vete, dhe për t'ju ftuar pastaj për të m'i treguar ato dokumente.

Zoti Zemaj, gabim jeni. Në asnjë moment nuk iu kam sulmuar. Edhe kur kam menduar që e keni gabim, gjatë gjithë kohës sa keni qenë ministër, në asnjë moment nuk iu kam sulmuar, sepse kam menduar se mund të dërgojmë një mesazh dual te qytetarët që do t'i shtinte qytetarët që të mos i respektojnë masat. Ju jeni ai që keni sulmuar, zoti Zemaj. Shihni veten në pasqyrë. Është hera e parë që po flas me juve në relacion të tillë. Edhe kurrë nuk do t'ju sulmojmë. Çdoherë, sa herë të kemi nevojë, ne do të bashkëpunojmë për të mirën e qytetarëve.

Edhe një gjë të fundit. Në këto dokumente që nuk i kam gjetur në Ministrinë e Shëndetësisë, fatkeqësisht unë nuk kam gjetur as marrëveshjen e konfidencialitetit, të cilën ju e keni nënshkruar diku në dhjetor të vitit 2020. Dhe, në këtë marrëveshje, zoti Zemja, ju e dini shumë mirë se çfarë klasifikohet si konfidenciale aty brenda. Nuk është ajo çfarë keni thënë nëpër media. Çdo informacion brenda asaj marrëveshjeje klasifikohet si konfidenciale.

Zoti Zemaj, më vjen keq, por unë e kam respektuar tuaj shumë më shumë se sa ju nënshkrimin tuaj. Unë në asnjë moment nuk e kam folur asnjë fjalë për atë që ju e keni nënshkruar. Kurse ju megjithëse e keni marrë barrën mbi vete me nënshkrimin e asaj marrëveshjeje dhe duke e ditur se çfarë ka brenda dhe çfarë klasifikohet si konfidenciale e kemi bërë këtë. Ju lutem! Ju faleminderit, kryetar! Kërkoj ndjesë deputetë, keni plotësisht të drejtë. Faleminderit shumë!

**KRYETARI:** Zoti Zemaj, sipas Rregullores së Kuvendit nuk e keni mundësinë e pakufishme që të replikoni, kështu që u përmbyll kjo punë. Në emër të LDK-së fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Thënë të drejtën, kjo është njëra prej temave për të cilën unë nuk isha dashur dhe nuk dua të bëj politikë ditore, të kapemi mes vete dhe të përplasemi.

Unë e pashë që sa herë që doli ministri këtu të flas, tha më lejoni të sqaroj, dhe nuk sqaroi kurrëgjë. Pra, ju që merrni vesh atje shumë. Ju që merrni vesh shumë atje, unë po jua bëje disa pyetje dhe dilni sqaroni.

E kemi këtë ministër që e ka mbajtur një konferencë në orët e vona të natës, duke deklaruar që një gazetë online në Kosovë, po thotë të pavërtetën dhe po shpifë. Po në të njëjtën konferencë thotë që po nxjerrë dokumente konfidenciale.

A po shpifë apo po nxjerrë dokumente konfidenciale? Cila është e vërteta o ministër? A ka qenë ai material i vërtetë apo jo, sepse atë material i cili është publikuar e kemi lexuar të gjithë ne, dhe në atë material, njëri ndër e-mailat është, kur ish-ministri Zemaj, u drejtohet përfaqësueseve të Phizer dhe u thotë: Unë nuk jam më ministër, ministër është Arben Vitia, i cili është i bashkëngjitur në këtë e-mail. Ju lutem vazhdojini procedurat e prokurimit dhe të negocimit me të, dhe këtu i keni kontaktet e tij.

Pas kësaj vjen e-maili tjetër i cili thotë: Që kjo do të jetë forma e kontratës dhe jaku lutem të përgjigjeni brenda 15 ditës. Kontrata i ka afatet e dsitribuimit të vaksinave prej 270 mijë apo sa ishte.

A ekziston ai material ai material apo nuk ekziston? A është i vërtetë apo i rremë? Na e sqaroni këtë, e para. E dyta, ju po thoni këtu, edhe këta të dijshtmit, disa prej tyre këtu që po bëjnë zhurmë në emrin tuaj, po thoni që ne po vazhdojmë negociatat e bisedat, ndërkohë ajo që po kuptohet prej sqarimeve tuaja janë dy çështje; e para, që prisni të vijë pjesa tjetër e vaksinave Covax falë, dhe e dyta, që po prisni që vaksinat Phizer, po ashtu të vijnë prej Bashkimit Evropian.

A keni negociuar ju? A keni nënshkruar kontratë? A po prisni të nënshkruani kontratë me ndonjë kompani? A ka buxhet apo s'ka buxhet? Këto janë çështjet. Jo këtu fjalë të tjera, faleminderit, ç'faleminderit. Njerëzit duhet ta kuptojnë qartë se çfarë ka ndodhur.

Nëse e-mailat e publikuar janë të rremë, atëherë duhet ta padisni gazetën online për shpifje, por nuk mund ta padisni për nxjerrje të sekretit zyrtar nëse dokumenti është i rremë. Nuk ka logjikë. Qysh mund t'i thash, keni nxjerrë një dokument zyrtar ku aty shkruhet konfidenciale kërkesa që brenda 15 ditëve të nënshkruhet kontrata me afatet e distribuimit e me krejt, po të njëjtën kohë i thua, që është e pavërtetë është shpifje.

Këtu është nonsens logjik total dhe njerëzit po vdesin. Vetëm sot kanë vdekur 11 veta. Pra, bëjini detyrën tuaj. Silluni si ministër dhe mbi të gjitha si një profesionit shëndetësor dhe si një njeri, sepse po flasim për jetë njerëzish.

Ne që po flasim këtu, po kapemi mes vete me të drejtë apo me pa të drejtë, njerëzit atje po vuajnë. Njëmijë vetë janë në trajtim spitalor, e mijëra të tjerë në trajtim shtëpiak.

Unë mesa kuptova prej krejt asaj çfarë deklaruat deri tash, ju nuk e keni as ndërmend që ta nënshkruani ndonjë kontratë. Ju po prisni prej Covax-it që tua falë dhe po prisni prej Bashkimit Evropian, po ashtu që tua falë vaksinat. Pse po ndodhë kjo? Nuk ka para? Nëse s'ka buxhet, kallëzoni.

Mundemi me urgjencë ta ndryshojmë buxhetin e vendit edhe t'i çojmë paratë te vaksinat. Ai është prioritet mbi të gjitha prioritetet. T'i lini këto të tjerat, sepse me të vërtetë është shqetësuese kjo punë.

Unë e di që këtu përpara i keni ulur dy zhurmagjinjë që kanë qejf të bëjnë zhurmë, por këto punë sqaroni. Janë shumë të thjeshta, sqaroje. Nëse gazeta online Insajderi ka rrejt, padite për shpifje. Nëse gazeta Insajderi ka nxjerrë material konfidencial, s'ke çfarë i bënë, sepse ka publikuar material konfidencial të cilin ju nuk e keni nënshkruar. S'keni nënshkruar kontratën. Ka mbrojtur interesin madhor publik. Pra, e ka bërë punën e vet dhe duhet të shpërblehet. Ka bërë punën e vet dhe duhet të shpërblehet, sepse ka publikuar që ju nuk po e nënshkruani kontratën për të cilën jeni i detyruar dhe po prisni që Covax-i të na i falë edhe nja 20 mijë vaksina dhe po prisni që Bashkimi Evropian të na i falë të tjera.

Ju, a keni në plan të nënshkruani? A keni ndonjë plan dinamik se kur e nënshkruani kontratën, sepse ne të gjithë e dimë se dikur ajo vaksinë apo ato vaksina do të vijë.

Do të vijë këtu, njerëzit do të vaksinohen, por çdo ditë e humbur është jetë e humbur. Veç sot kanë humbur 11 jetë. Veç sot 11 jetë kanë humbur. Të tjerat janë të parëndësishme se kur është bërë një ambulante apo s'qenka bërë. Çoje në prokurori këdo që e ka bërë atë punë. Merru me vaksinën.

Sot ju kemi thirr për vaksinën. Janë edhe dy debatet parlamentare që Grupi Parlamentar i opozitës, në këtë rast PDK-ja, i ka thirr. Edhe për gjendjen ekonomike edhe tjetrën për arsimin, më duket, në kushtet e pandemisë.

Fokusojuuni në çështjen që e kemi përpara dhe çështja që e kemi përpara; pse nuk ka vaksina? Pse nuk po nënshkruhet? Pse nuk është nënshkruar marrëveshja që është ofruar nga Pfizer? A është çmimi i lartë apo çfarë është në pyetje? Unë nuk jam duke e kuptuar dhe po besoj që shumica e

qytetarëve të Kosovës nuk janë duke e kuptuar, përveç disa të të gjithëdijshmëve që i ke përpara këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Arbeni a? Jo, kjo mund të jetë e koordinuar. S'ka replikë! Fjalën e ka Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Këta, anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje e kanë të instaluar në kokën e tyre një usb. Po, e keni të instaluar nju usb në kokën tuaj, por formatizojeni more se tash jeni pozitivë nuk jeni opozitë.

Se edhe në pozitën që jeni, në pozitë, po silleni si opozitë. Edhe ministrat që po dalin e po flasin, nuk duhet të na drejtojnë neve, se ne e mbikëqyrim punën e Qeverisë, dhe jo Qeveria punën e ekzekutivit.

Jeni duke fjetur në gjumë edhe duke bërë ne opozitarizëm po ju çojmë pak prej gjumit edhe ndoshta punoni diçka e bëni më të mirë. E me këtë rast, ministri i Shëndetësisë i nënshkruan këtë marrëveshje për vaksina edhe përfiton edhe populli, sepse pa vaksinë s'ka jetë.

Po shohim sa është numri i të infektuarve dhe sa është numri i të vdekurve në mungesë të vaksinimit.

Kushdo që po del kundër jush, qoftë opozita, qoftë gazeta, po i shpallni armiq të popullit dhe po doni që t'i linçoni dhe të gjithëve po doni të na çoni nëpër gjykata, po nuk e di a na zënë gjykatat edhe a mund të na çoni të gjithëve në burg. Ne do ta kryejmë detyrën e opozitarizmit dhe do t'ju kritikojmë.

Ministër Vitia, prej punëve, po thoni mos e politizoni pandeminë, mos e politizoni tash se s'është vendi për politizim. Po ju vetë e keni politizuar, sepse po heq një sheh të Intensivës së COVID-it që ka bërë një punë të shkëlqyeshme dhe tash e ke vendosur një veç pse është i Lëvizjes Vetëvendosje, a është politikë kjo në pandemi? Kjo është politikë, unë s'di qysh është politika tjetër e qysh është politizimi i këtij veprimi.

Ka kaluar më shumë se një vit që nga shfaqja e rasteve të para me pandeminë COVID-19. Për këtë kohë jemi ballafaquar me situata të vështira, në të gjitha aspektet jetësore.

Pandemia COVID-19 ka ndikuar negativisht në të gjitha sferat e jetës sonë. Kur filloi pandemia, e dinim që zgjidhja e vetme do të ishte vaksina. Sot e dimë që zgjidhja e vetme për pandeminë në Kosovë do të ishte që Qeveria të fillonte të angazhohej në sigurimin e vaksinës për qytetarët e Kosovës dhe nëse, edhe deputetët sot në këtë debat, dhe krejt ajo çka po kërkojmë, po kërkojmë

të menaxhohet mirë pandemia dhe të sigurohen vaksinat në mënyrë që të imunizohen qytetarët e Kosovës.

Pse keni bërë zvogëlim të numrit të testimeve, para janë bë diku rreth 5.000 testime në ditë, tash për të zvogëluar numrin e të infektuarve, prej 5.000 testimeve kemi rënë në 1 500 testime.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Albin Kurti, gjatë fushatës zgjedhore thoshte se prioritet do të jetë menaxhimi i pandemisë COVID-19, premtonte që brenda muajit qershor 70-80% e popullsisë në Kosovë do të vaksinohen, premtime veç për vota.

Në raste të rralla, thujse asnjëherë se shohim kryeministrin e këtij vendi duke dalë para qytetarëve të vendit të tij e të flasë për situatën me pandemi në Kosovë. S'e kemi parë asnjëherë duke folur për gjendjen në spitalet tona, për situatën ekonomike, të bizneseve të vendit tonë, të cilat shumë prej tyre janë buzë falimentimit.

Sot zgjidhje nuk është izolimi, e izoluam vendin për 12 ditë, duke i prekur dhe dëmtuar bizneset që ishin më të dëmtuara që nga fillimi i pandemisë. Ju lus të tregoni përse e mbyllët vendin për 12 ditë dhe cila është lidhja në mes të kësaj mbylljeje 12-ditore dhe asaj të përhapjes së pandemisë. Kur e dimë që periudha e karantinimit sipas të gjitha të dhënave shkencore është 14 ditë. Pra, e keni mbyllur vendin duke mos u bazuar as në fakte shkencore, as në situatën aktuale.

Me ardhjen e kësaj Qeverie në pushtet filloi të ulet edhe numri i testimeve, kur mjekët tanë nga klinikat spitalore ankoheshin çdo ditë për fluksin e jashtëzakonshëm me pacientë që kërkonin trajtim spitalor, kjo Qeveri ulin numrin e testimeve, me qëllim të ulen rastet pozitive. Pse ka ndodhur kjo? Përderisa në shtetet e rajonit tashmë ka filluar vaksinimi masiv i qytetarëve me vaksinën COVID, Kosova është ndër vendet e vetme që ende s'ka arritur të sigurojë vaksinën për qytetarët e saj. Madje, u raportua në media që ministri i kësaj Qeverie, në këtë rast zoti Vitia, ka refuzuar nënshkrimin e marrëveshjes dhe zoti Vitia është mirë që sot të na tregojë pse s'ka nënshkruar një marrëveshje të tillë.

Në kohë të pandemisë kemi një qeveri, e cila s'ka as program qeverisës të prezantuar para këtij Kuvendi e para qytetarëve të Kosovës. Duket që për Qeverinë Kurti më e rëndësishme se sa jeta e qytetarit, po del pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare në Shqipëri.

Kryeministër Kurti,

Izolimet dhe ora policore nuk janë zgjidhje për momentin, angazhohuni dhe siguronit vaksinat për qytetarët tanë, merrni masa dhe ndihmoni bizneset e afektuar nga mbyllja 12-ditore. Nuk është as koha për uljen e pensioneve të pensionistëve të këtij vendi, e as koha për ulje të shtesave për policët tanë.

Dhe, në këtë kohë pandemie, kur mjekët dhe stafi tjetër shëndetësor po bëjnë një punë kolosale, ne në vend që t'i falënderojmë dhe t'i stimulojmë, çka kemi bërë me pakon e re ekonomike. Mjekët nga 250 euro shtesë, tash marrin 150 euro shtesë, infermierët nga 150 euro shtesë, tash i kanë 100 euro. 2 000 hetuesve u janë ndaluar krejt shtesat, pjesëtarëve të policisë gjithashtu u janë zvogëluar, pensionistëve po ashtu u janë hequr 20 euro.

Pra, a kështu menaxhohet pandemia, a kështu udhëhiqet në këtë shtet. Populli meriton më mirë, angazhohuni, punoni, jeni në Qeveri dhe realizoni të gjitha ato premtime, me të cilat edhe keni marrë vota. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti i PDK-së, Fadil Nura.

FADIL NURA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të dashur,

U bë një vit e gjysmë që kur vendi ynë u përfshi nga pandemia COVID-19 dhe nga atëherë deri më sot gjendja ka degraduar rëndë dhe sot vendi është zhytur në një krizë të thellë shëndetësore, ekonomike e arsimore. E gjithë kjo si produkt i një papërgjegjësie të një kaste politike, të cilët me arsytetime bizare vunë shëndetin publik buzë humnerës për të kënaqur ambiciet e sëmura politike në dy parë cikle zgjedhore dhe për të jetësuar interesat krejtësisht personale, me të vetmin preokupim se cila do të jetë Qeveria 1 apo 2, se kush do t'i fitojë 50 apo më shumë të votave, kush do të bëhet president, e gjithë kjo u manifestua në dritëhijet e ceremonive mortore e me hapje varresh, ndërkohë që ekonomia vazhdonte rënien e lirë.

Për fatin e keq të këtij vendi, edhe sot po shohim vazhdimësinë e maskaradës së mendësisë së njëjtë ndaj gjendjes së rëndë shëndetësore, aty ku i kishte lënë në fillim Qeveria paraprahe Kurti1, pa një plan konkret, pa vizion të qartë se si të përballet me pandeminë COVID-19, përveç asaj që kanë dëshmuar se dinë të bëjnë - mbylljen e vendit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot në grafikonët e institucioneve të specializuara ndërkombëtare Republika e Kosovës renditet e fundit sa i përket vaksinimit dhe menaxhimit të gjendjes së përgjithshme me COVID-19 dhe është shndërruar në 'vrimë të zezë' jo vetëm në rajon, por dhe në Evropë e më tej. Sa që shtetet e ndryshme kanë filluar t'ua ndalojnë qytetarëve të tyre, edhe pse të imunizuar, ta vizitojnë Republikën e Kosovës.

Kjo vërteton qartë se Republika e Kosovës në vlerësime ndërkombëtare, për fat të keq, por me të drejtë sot po kualifikohet si kantier i kontaminimit me COVID-19, përderisa të gjitha shtetet, përfshirë edhe ato të rajonit, kanë bërë hapa gjigantë në sigurimin e vaksinave për qytetarët e vet dhe menaxhimin e përgjithshëm të pandemisë.

Kulminacionin e marrëzisë dhe absurditetit kjo Qeveri e shpërfaqti tri ditë pas themelimit të saj, e cila e injoroi gjendjen tepër të rëndë, duke manifestuar papërgjegjësi dhe mungesë të vullneti të pashpjegueshëm për një angazhim sistematik qoftë në sigurimin e vaksinave apo menaxhimin e përgjithshëm me pandeminë COVID-19. Mbylli vendin dhe eksponentët e saj marshuan në fushatën elektorale në Shqipëri për të shtrirë dhe rritur ideologjinë politike.

Një ekspeditë e tillë ta kujton historinë analoge të Dushan Mugoshës e Miladin Popoviqit pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Veçse atëherë Kosova, për dallim nga tash, ishte e mbyllur nën administrimin ushtarak jugosllav.

Të nderuar qeveritarë,

Zgjedhjet në Shqipëri do të rikthehen pas katër vjetësh, por jetët e qytetarëve tanë nuk rikthehen më, ndërsa qytetarët e Republikës së Kosovës sot kanë mbetur në mëshirën e fatit...

**KRYETARI:** Zoti deputet, një vërejtje për fjalorin, nëse përdorni kësi krahasime, mund t'ju ndërpritet fjala, vetëm po ju jap vërejtje fillestare dhe po ju lajmëroj.

**FADIL NURA:** Ndërsa qytetarët e Republikës së Kosovës sot kanë mbetur në mëshirën e fatit dhe të lëmshave që komuniteti ndërkombëtar ndan për vendet e varfra. E gjithë kjo jo pse nuk ka fonde dhe buxhet të mjaftueshëm për sigurimin e vaksinave për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, sepse ishte Partia Demokratike e Kosovës që përkrahu dhe votoi në legjislaturën e kaluar këtë buxhet, të vetëdijshëm për këtë dhe me të vetmin qëllim që qytetarët tanë të mos mbesin në mëshirë të fatit, të paktën jo për arsye financiare, përderisa kjo mazhorancë që dje ishte në opozitë, jo që nuk përkrahu, por na akuzoi pse e votuam këtë buxhet.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot jemi në mëshirën e fatit, jo për mungesë të fondeve, po për faktin se kemi një Qeveri të paditur e të papërgjegjshme, e cila as një muaj nuk ka madje një përgjigje kur mund të sigurohen vaksinat anti-COVID.

Në një gjendje të tillë, ku numri i vdekjeve dhe infeksionet vazhdojnë të jenë shqetësuese, kësaj Qeverie nuk po i ngutet, as nuk po shqetësohet, ngase këta vetë si duket janë vaksinuar, falë atyre vaksinave donacion për të varfrit, e për të cilat vrapuan t'i presin në aeroport.

Në mungesë të një plani qeverisë, me komoditet po iniciojnë tema e prioritete të tjera popullsitë, duke shpërfillur realitetin e rëndë dhe të dhimbshëm mbi numrin e madh të vdekjeve dhe gjendjen e klinikave të stërmbushura me qindra pacientë të hospitalizuar në gjendje të rëndë, si në QKUK, ashtu edhe në spitalet regjionale.

Në një situatë të tillë gjithashtu gjendet edhe komunat e Republikës së Kosovës, të cilat kanë mbetur të vetmuara në ballafaqimin me luftën me pandeminë COVID-19.

Marrë parasysh se autoritetet lokale janë dera e parë e qytetarit, janë hallka kyçe dhe jashtëzakonisht të rëndësishme në luftimin e pandemisë, ato sot po ballafaqohen në mungesë të përkrahjes nga Qeveria qendrore, duke u mbështetur vetëm në kapacitetet e tyre, jashtëzakonisht të limituara financiare, krahas nevojave dhe kërkesave me të cilat ato ballafaqohen në këtë situatë të jashtëzakonshme.

Prandaj, sot zoti ministër, në shumë QKMF mungon oksigjeni dhe shumë pajisje e furnizime të tjera të nevojshme medicinale, përfshirë ofrimin e shërbimeve dhe asistencave të nevojshme për familjet e prekura me COVID-19.

E mbase nuk e keni ditur, të nderuar qeveritarë, sepse keni qenë të angazhuar në fushatën zgjedhore në Shqipëri, mos harroni, sot në Republikën e Kosovës në zona rurale, në jo pak komuna po ndodhin vdekje të patrajuara e të paregjistruara nga pandemia COVID-19.

E gjithë kjo pasqyron vetëm një pjesë të gjendjes reale, në të cilën ndodhet sot Republika e Kosovës, pa e përmendur trendin e kolapsit ekonomik, gjendjen në arsim, ndërsa në anën tjetër, shohim një Qeveri e cila po operon jashtë këtij realiteti me yryshe ndaj mediave të pavarura e me nisma aventureske legjislativë. Po, do ta trajtojmë, do ta bëjmë Ligjin për zgjedhje, edhe ligjin famoz për konfiskimin e pasurisë, edhe gjithçka tjetër që vlerësojmë se është në interes të qytetarëve.

Por, sot mbi të gjitha, interesi mbi interesa, prioritet mbi prioritetet janë jetët e njerëzve, ato janë më të rëndësishme se gjithçka tjetër.

Të shohësh sot promovimin e një procesi të njëanshëm vetingu nën dritëhijet e ceremonive mortore dhe të një gjendje katastrofale ekonomike dhe shoqërore të shkaktuar nga COVID-19, është tregues i qartë i mungesës së njohurive mbi një proces të tillë, sepse një proces i mirëfilltë vetingu, në kushte normale, para së gjithash kërkon konsensus politik e shoqërore, fonde të mëdha e ekspertizë të jashtëzakonshme, e përtej këtyre shtrohet pyetja: kush po garon të udhëheqë njëanshëm një proces të tillë kaq kompleks dhe të ndjeshëm në një gjendje të tillë pandemie? Një kryeministër me precedent penal, një ministër e Drejtësisë me precedent penal, të dënuar me aktgjykim të formës së prerë nga institucionet gjyqësore dhe një udhëheqëse e grupit mazhoritar, po ashtu me precedent penal. Çfarë kredibiliteti mund të ketë një proces i tillë, cila gjendje ose cila mendje e shëndoshë mund t'i besojë një aventure të tillë. A njeh dikush precedent të tillë në historinë e shteteve demokratike, qoftë të atyre të sistemit të së drejtës anglosaksione apo eurokontinentale, kur një strukturë e inkriminuar kriminale ka udhëhequr procese të tilla të sistemit të drejtësisë.



Prandaj, të nderuar qeveritarë,

Keni marrë besimin dhe përgjegjësinë që krahas çdo iniciative, qoftë edhe popullsitë, me prioritet të angazhoheni ditë e natë të siguronit vaksinat, në mënyrë që të ndalen vdekjet e qytetarëve. Mjaft më me popullizma, mashtrime e gënjeshtër.

Presidenti i 16-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Abraham Linkoln, në vitet 1860 politikanëve të tillë u kishte thënë: “Mund të gënjeni të gjithë për pak kohë ose dikë përgjithmonë, por nuk mund t’i gënjeni të gjithë përgjithmonë”. Faleminderit!

**KRYETARI:** Nga Lëvizja Vetëvendosje fjalën e ka deputetja Labinotë Demi-Murtezi.

**LABINOTË DEMI-MURTEZI:** Faleminderit për fjalën, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fillim të vitit të kaluar COVID-19 kishte përfshirë gjithë botën dhe në mars po të atij viti OBSH e shpalli pandemi.

Fillimi i kësaj pandemie gjeti vendin tonë përball një rreziku të madh sfidues si të gjitha vendet e botës, po edhe më sfidues kur kemi parasysh faktin se vendi ynë krahas buxhetit të vogël, edhe më sfidues mbetet fakti që kishim numër të pamjaftueshëm stafit shëndetësor dhe sistem tejet të brishtë shëndetësor, po ashtu.

Paniku i madh dhe frika e pakontrolluar në popull përball realitetit të hidhur edhe nga vetë ata tejkalohet e menaxhoet vetë me transparencë e mirëbesim nga një qeveri që sapo ishte formuar dhe kishte brenda saj emrat më profesionalë të fushave.

Kështu kryeministri Kurti me përgjegjësi të lartë, bashkë me ministrin e Shëndetësisë Vitia dhe ministrin të tjerë kishin bërë një plan të mirëfilltë menaxhues, me të cilin plan edhe qytetarët e bizneset operonin mirëfilli, konkretisht e me orare të caktuara.

Shtu kësaj faktin se Ministria e Shëndetësisë kishte prioritet në vendime, këshilla dhe vendimet e IKSHPK-së jepte seriozitetin e duhur të një trajtimi të mirëfilltë të kësaj situatë. Qeveria e atëhershme, në krye me ministrin Vitia, tashmë ishin lajmë i mirë nëpër botë dhe shembuj për t’u marrë se si menaxhoet pandemia COVID-19.

Kur po flasim për pandeminë, e cila vazhdon edhe më tutje, është e pashmangshme nevoja për të bërë kronologjinë e menaxhimit në fillim dhe atij në vazhdim, sepse sfida vazhdon dhe në këtë drejtim duhet të jemi bashkë për njëri-tjetrin, pa dallime.

Po në këtë periudhë të këtij rreziku permanent, Qeveria e atëhershme e Kosovës u rrëzua me mocion të suksesshëm mosbesimi në Kuvendin e Kosovës, paniku u rrit, pasiguria u shtua, por edhe Qeveria në detyrë nuk e ndali përkushtimin për punë dhe për menaxhim deri në ardhjen e Qeverisë së re, e cila më vonë u shpall jokushtetuese, pikërisht siç edhe e mendonim ne që në fillim të saj.

Si anëtare e Komisionit për Shëndetësi, bashkë me kolegët e tjerë të grupit tonë parlamentar dhe partive të tjera opozitare, meqë kishim qenë komision i themeluar dhe ishim në rrjedha të menaxhimit të pandemisë, që në fillim të mandati të asaj Qeverie kemi shprehur gatishmërinë për të vazhduar punën tonë me Kuvendin dhe me Ministrinë e Shëndetësisë, jo për t'i kërkuar llogari ministrit në krye të 3-4 ditëve të marrjes së detyrës, por për t'i ofruar bashkëpunimin në menaxhimin e pandemisë COVID-19.

Po ashtu krahas ideve për menaxhimin, kemi punuar vazhdimisht dhe kemi shtyrë përpara si opozitë edhe Ligjin kundër pandemisë COVID-19, në përpilimin e të cilit kishim ftuar të gjitha institucionet relevante shëndetësore për kontribut profesional, përfshirë këtu edhe Ministrinë e Shëndetësisë, e cila vazhdimisht ligjin e munguar e quante të pamjaftueshëm dhe me tendenca politike. Kjo ishte e mjaftueshme dhe e kuptueshme për të ditur edhe ne qytetarët se në çfarë niveli dhe me çfarë profesionalizmi po menaxhohej pandemia.

Dhe, gjatë gjithë kohës së pandemisë, nëse ka pasur diçka banale, banale kanë qenë pikërisht votat e munguara në fillim të deputetëve të pozitës për të votuar Ligjin kundër pandemisë COVID-19, me të cilin ligj do të duhej të operonte dhe vazhdoi të operonte vetë ajo Qeveri.

Gjendja e klinikat e QKUK-së, po ashtu edhe ajo me spitalet regjionale, flisnin shumë qartë se menaxhimi nuk ishte i duhuri. Masat ad hoc të atypëratyshme që nuk jepnin asnjë rezultat, ishin kulmi i reflektimit të bartjes së përgjegjësisë nga Komiteti menaxhues te komitetet e tjera, te koordinatorët për menaxhim, të disa prej pjesëtarëve të Qeverisë, kështu krijohej një tollovi dhe jo një vijë lineare profesionale, siç kishte qenë në fillim.

Nevoja e madhe për teste shtoi nevojën për licencimin e shumë laboratorëve privatë, për të cilët u shtruan shumë dilema e nuk pati asnjëherë transparencë të mirëfilltë.

Shtrohet pyetja, ku jemi sot? Jemi para një situatë që vazhdon të mbetet ende shumë e rëndë, me numër të vazhdueshëm të vdekjeve dhe uljes solide të të infektuarve, fatkeqësisht me shkurtrim buxhetor për barna nga Qeveria e kaluar dhe me furnizim të Listës esenciale të barnave në nivelin më të ulët që vendi ynë ka pasur ndonjëherë, shtu kësaj pastaj të gjitha sfidat e procesit të marrëveshjes për furnizim me vaksina.

Derisa përpjekja vazhdon për një marrëveshje që do të duhej të ishte e përfunduar dhe kur sot Qeveria jonë ka vetëm 34 ditë të votuar, mungon durimi dhe transparenca për një marrëveshje konfidenciale.

Jemi të informuar tashmë publikisht se krahas lobimit për blerjen e vaksinave, Ministria e Shëndetësisë ka punuar edhe në legjislativ, përkatësisht në Udhëzimin administrativ për t'i hapur rrugë procesit të blerjes së vaksinave, nga se Udhëzimi administrativ i mëhershëm ka pasur kundërthënie brenda vetes.

Si Komision për Shëndetësi sërish mbesim të përkushtuar për punë dhe bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë, e sidomos Ministrinë e Shëndetësisë, për çka që në mbledhjen e parë konstituive nuk e kemi kursyer as ministrin aktual në kuptimin më të mirë të fjalës, por e kemi ftuar për takim për të bashkëpunuar, për t'i ofruar përvojat tona, dijen tonë për menaxhimin e pandemisë COVID-19. Fatmirësisht, kësaj radhe ministri është përgjigjur në kohë rekorde, për çka e falënderoj publikisht dhe i ofrojmë mbështetjen tonë të rezervë, me ç'rast falënderoj edhe profesor Dreshajn që si deputet i ri të Kuvendit të Kosovës ka shprehur gatishmërinë e tij profesionale për plotësim-ndryshimin e Ligjit aktual për pandeminë, ngase gjatë rrugës nevojat kanë treguar se ligji ka nevojë të ndryshohet.

Të dashur qytetarë,

Të dashur heronj të kohës moderne, mjekë e infermierë, staf ndihmës e mbështetës, policë e zjarrfikës, të gjithë ju shërbyes të vetëmohuar tashmë mbi një vit, Qeveria e Kosovës është këtu për ta artikuluar me prioritet kërkesat e domosdoshme brenda mundësive buxhetore, kuptohet me prioritet të veçantë pandeminë. Jemi këtu si Kuvend dhe Qeveri me përgjegjësinë e lartë karshi mbështetjes suaj në zgjedhjet e 14 shkurtit të këtij vit. Përkushtimi ynë reflekton te mirëbesimi juaj dhe në këtë mandat që sapo kemi marrë qeverisjen, mbesim vullnetmirë dhe transparentë për të vazhduar bashkëqeverisjen. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)*

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Tani radhën e ka Rrezarta Krasniqi.

**RREZARTA KRASNIQI:** Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Gjendja me pandeminë COVID-19 është rënduar mjaft shumë gjatë ditëve dhe javëve të fundit për shkak të paaftësisë së Qeverisë Kurti për të menaxhuar situatën pandemike.

Shëndeti i qytetarëve është vendosur në rrezik nga dita në ditë, kur në krye të shtetit ka ardhur kjo qeveri, me këtë kryeministër dhe me këta ministra që nuk menduan për gjendjen

shëndetësore të qytetarëve tanë, por u shfaqën të pangopur për pushtet, duke marrë pjesë në garën zgjedhore në Shqipëri.

Pra, këta lanë në rend të dytë shëndetin e qytetarëve, e në rend të parë i vendosën ambiciet për pushtet më të madh edhe përtej kufijve të vendit. Për më keq, në ditët kur kjo qeveri dhe njerëzit e kësaj qeverie lëviznin në Shqipëri, duke bërë fushatë elektorale, mbyllën qytetarët tanë dhe bizneset duke u pamundësuar qarkullimin financiar.

Por, në fund i gjithë angazhimi i tyre u kurorëzua me dështim. Kandidatët e Vetëvendosjes dështuan në zgjedhjet si deputetë, ashtu siç dështoi edhe Albin Kurti t'i sigurojë votat e nevojshme, dështim ky i cili do të përcillet edhe në zgjedhjet e ardhshme parlamentare në vendin tonë, sepse qytetarët janë zhgënjyer nga ai dhe nga sjellja e njerëzve të tij. Në fillim të këtij muaji, konkretisht nga data 7 deri më 18 prill, ministri Vitia vendosi të mbyllë vendin pa asnjë analizë, pa asnjë bazë studimore, ndonëse numri i rasteve të reja me COVID nga dita në ditë rritej, sikurse edhe rastet e vdekjeve. Ngjashëm siç veptoi me mbyllje, pa një analizë veptoi edhe me rihapje të gastronomisë. Kësisoj kjo qeveri me këta ministra është duke luajtur me ndjenjat e qytetarëve dhe po ua rrezikon shëndetin në çdo moment.

Nëse i shohim të dhënat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë, vërejmë se janë ulur edhe testimet për COVID-19, nga 5 mijë siç bëheshin në ditët kur ministër i Shëndetësisë ishte zoti Zemaj, tani bëhen 2 mijë deri në 3 mijë teste, pra është përgjysmuar numri i testeve, derisa numri i rasteve të infektimit dhe vdekjeve vazhdon të jetë i lartë. Derisa nën qeverisjen Hoti, si rezultat i menaxhimit të mirë të pandemisë numri i testeve ishte më i lartë, kurse numri i të infektuarve ishte dukshëm më i vogël dhe gjendja ishte në tërësi nën kontroll dhe pa mbyllje. Ne sot lirshëm mund të konstatojmë se situata me pandeminë ishte dukshëm më e mirë nën menaxhimin e ministrit Zemaj, i cili pavarësisht presioneve të shumta nga opozita e atëhershme, arriti ta mbajë gjendjen nën kontroll. Një tjetër fakt shqetësues për qytetarët tanë është edhe mungesa e vaksinave anti-COVID-19. Kosova radhitet ndër vendet më të fundit në botë për vaksinimin e popullsisë. E, në vend se ministri Vitia të angazhohej më me përgjegjësi për të siguruar vaksinat, ai shfrytëzon këtë situatë për të bërë spektakle mediale, duke u paraqitur në konferenca e duke bërë edhe luftë me media që çdo ditë raportojnë për situatën e renduar. Ai këtë e bën edhe për të zhveshur vëmendjen nga dështimet e tij dhe të kryeministrit Kurti që ende nuk kanë as idenë më të vogël se çfarë janë duke bërë apo çfarë duhet të bëjnë në mungesë të plan programit të qeverisë.

Këta aq sa janë të papërgjegjshëm, janë edhe të padijshëm, nuk është as logjike të nisësh një punë pa e ditur se si do ta përfundosh apo çka do të bësh me të. E, këta bash kështu janë duke vepruar, nuk po dinë çka të bëjnë e si të veprojnë tutje. Një qeveri praktikantësh që rrezikon shëndetin e qytetarëve, duke bërë prova e eksperimente në përmirësimin e gjendjes shëndetësore. Për më keq, ju vendosët t'u vështirësoni jetën edhe më shumë gjyshërve tanë, duke mos ua

vazhduar pensionin që në vendimin e kryeministrit Hoti ishte rritur nga 120 sa ishte 90. Pra, në një rën anë ua rrezikoni shëndetin, duke mos siguruar vaksinën, e në anën tjetër ua zvogëloni pensionet duke u pamundësuar edhe sigurimin e barnave dhe gjërave elementare për jetesë. Kësisoj siç jeni duke vepruar jeni bërë më të rrezikshëm se vetë virusi COVID-19. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Tani radhën e ka Albena Reshitaj.

**ALBENA RESHITAJ:** Faleminderit! Atëherë, e nderuar nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Menaxhimin e pandemisë duhet ta shikojmë si betejën tonë të përbashkët në mbrojtje të shëndetit qytetar, ashtu siç është duke e vlerësuar e duke vepruar e tërë bota në luftë të përbashkët në mbrojtje të njerëzimit ndaj këtij armiku të padukshëm COVID-19.

Është mirë t'ia kujtojmë vetes që beteja me pandeminë nuk ka mbaruar dhe gabohemi shumë rëndë nëse nënvlerësojmë situatën. E them në këtë mënyrë, sepse neglizhimi eventual, qoftë institucional, apo qytetar, mund të na sfidojë me situata nga më të ndryshmet. E kam përsëritur vazhdimisht që nuk duhet lejuar askënd të bëjë politikë me shëndetin e qytetarëve tanë, sepse në të kundërtën, do të jetë disfatë e të gjithëve, kur për interesa politike lejuam të rrezikohet shëndeti publik e jeta e qytetarëve. Gjykuar nga një analizë e mirëfilltë vërejmë që ditëve të fundit, përpos dhjetëra jetëve të humbura nga COVID-19 dhe një numri të madh të të infektuarve, gjithashtu kemi një gjendje të rënduar të shëndetit mendor të një pjese të qytetarëve, ndjellje frike e dështimi për sigurimin e vaksinave, ndonëse kemi edhe reagimin e miqve ndërkombëtarë në përkrahje për sigurimin e disa dozave. Kjo gjendje duhet të na bëjë përgjegjës para çdo fjale që guxojmë t'ia lejojmë vetes ta themi sot, por edhe para çdo vendimi që duhet ta marrim me kohë dhe me përgjegjësi. Më mirë të punohet e të zgjidhet heshtja, kur nuk ka çka për t'u thënë, se sa të bëhet zhurmë e politikë mbi shëndetin publik qytetar.

Kjo situatë në këtë brishtësi, përpos shëndetësore, qytetarët i ka vendosur edhe në një presion të madh emocional që po ndikon edhe në shëndetin mendor të tij. Prandaj, jodomsdoshmërisht secila temë në interes qytetar duhet të shndërrohet në debat politik. Kjo situatë duhet të trajtohet mbi interesat politike, sepse prek shëndetin dhe jetën e secilit nga ne, e secilit qytetar. Tani, pa dashur për të paragjykuar edhe vonesat për sigurimin e vaksinave, përderisa shumë shtete janë afër mbylljes së procesit të vaksinimit, ne në këto momente duhet të luftojmë së bashkë për sigurimin sa më të shpejtë të tyre, derisa për të vërtetën besoj që do të kuptohet nga një llogari e përgjegjësi ndaj të gjithë atyre që nëse për mosangazhim e mospërkushtim kanë sjellë deri te kjo vonesë e vaksinave për mbrojtjen nga COVID-19. Dikush, nëse ndaj askujt, duhet të ndëshkohet për shqetësimin qytetar, për stresin që po ia japim gjithë popullatës sonë këto ditë.

Mendoj që për momentin janë dy çështje urgjente që i duhen qeverisë dhe skenës politike në përgjithësi. E para, bashkëpunim politik e ndërinstytucional, jashtë politizimit të çështjes së vaksinës dhe vaksinimit. Një angazhim serioz i të gjithëve dhe atyre që mund të ndihmojnë për furnizim dhe vaksinim në masë shumë më të gjerë të qytetarëve, derisa nuk është bërë tepër vonë për ne. E dyta, vendit i duhet një menaxhim i pandemisë me hapje të kontrolluar të jetës sociale dhe ekonomike, e cila kërkon bashkërendim të aktiviteteve të përbashkëta me të gjithë aktorët ligjorë, madje bashkëpunim mes qeverisë dhe opozitës, me qëllim që të gjejmë zgjidhjen më të mirë për menaxhimin efikas të parandalimit dhe luftimit të pandemisë COVID-19 në Kosovë.

Kjo do të tregonte një nismë të një pjekurie politike, të paktën në tema kaq të ndjeshme, kaq të rëndësishme, siç është shëndeti i popullit tonë. Sa u përket shtesave të personelit shëndetësor, Inspektoratit dhe personelit ndihmës, po jua përkujtoj që kërkesa ime gjatë krijimit të Ligjit për pandeminë COVID-19 ishte caktuar shtesa financiare minimumi 50% i pagës minimale të tyre, mirëpo kjo nuk u përkrah nga disa nga ju. Sikur ta kishim këtë pjesë të ligjit, sot nuk do të kishim nevojë të shqetësonim në mes të pandemisë as personelin shëndetësor, as Inspektoratin Shëndetësor, as personelin ndihmës me vendime e shfuqizime vendimesh. Prandaj, pres nga Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në plotësim-ndryshimin e ligjit ta ketë parasysh këtë çështje.

Dhe, një çështje krejt në fund, kërkoj nga qeveria, nga Ministria e Shëndetësisë që të trajtojë me një ndjeshmëri më të lartë kategorinë e familjeve që kanë humbur kryefamiljarin e tyre në betejën me COVID-19. Në ato familje kur ka humbur jetën kryefamiljari që ka mbajtur familjen me kushte, të jetë prioritet, të ketë, të ndajë shteti ndihmë financiare në një periudhë derisa ata të kenë mundësi të jetojnë me paga apo të ketë mundësi shteti t'u ofrojë ndonjë mundësi tjetër.

Kategori shumë e ndjeshme në këtë rast janë edhe ato familje që kanë humbur kryefamiljarin dhe janë fëmijë nën moshën 18-vjeçare. Prandaj, të mos lejojmë që përpos dhimbjes që kanë ato familje me humbjen e babait, vëllait apo motrës, ta kenë stresin dhe frikën edhe të sigurojnë kafshatën e bukës. Prandaj, edhe një herë kërkoj nga qeveria, nga Ministria e Shëndetësisë ta trajtojë me një ndjeshmëri më të lartë këtë kategori. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Tani radhën e ka Burim Karameta.

**BURIM KARAMETA:** Faleminderit, e nderuar nënkryetare!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Përballja me pandeminë COVID-19 ka qenë dhe është një sfidë e veçantë shëndetësore për vendin tonë, por gjithashtu edhe në nivel global.

Tani po futemi në vitin e dytë të saj, me mbi 2 mijë jetë të humbura dhe mijëra të tjerë të sëmurë, të cilët kanë vuajtur dhe kanë kaluar katrahurë të sëmundjes. Në këtë rast shpreh gatishtërinë time dhe ngushëllimet për familjet e tyre dhe shërim të shpejtë për ata, të cilët lëngojnë. Më 13 mars 2020 erdhi virusi tek ne, filluam të përballemi me të, ashtu siç u shpërfaq, edhe sistemi jonë shëndetësor filloi marrjen e masave dhe trajtimin e tij. Më herët filloi më larg nesh dhe nëpër shumë shtete të tjera të zhvilluara e më pak të zhvilluara. Pra, na atakoi sëmundshmëri e panjohur deri më tani, si Kosovën, gjithashtu edhe botën.

Por, Kosova kishte një dallim, derisa në vendet e tjera, në shtetet e zhvilluara u bashkua tërë skena politike, u përbashkuan pozitë e opozitë, ngjallën ndjenjën e solidaritetit dhe i bashkuan forcat, idetë, mendimet ndryshe për të vetmin qëllim: luftimin dhe përmbysjen sa më të mirë të pandemisë. Duke vlerësuar se kishin vetëm një armik të përbashkët, e ai ishte COVID-19. Në Kosovë dallimi ishte sinjifikant, kundërshtimet pozitë e opozitë vetëm sa u thelluan deri në politizimin e skajshëm të kësaj gjendje shqetësuese për shëndetin e qytetarëve tanë. Mirëpo, vlerësoj se nuk është vonë, derisa qeveritë e tjera u bënë një, hajde edhe ne tani e tutje të vëmë në qendër të vëmendjes qytetarin tonë, të llogarisim se mjekësia e shëndetësia është mbi të gjitha, bile mbi politikën dhe shkencën.

Dramat e shumta politike dhe mosbërja bashkë edhe në këto momente, vetëm sa e rëndojnë më tepër kurrizin e punëtorëve shëndetësorë, ndërsa të cilët i qëndruan stoikë pandemisë dhe atëherë kur të tjerët iknin nga kjo. Unë e di se shkenca dhe politika është vështirë të përafrohen, por s'e kam besuar që kaq të pamundur e kemi ne në Kosovë, për dallim nga vendet e tjera. Situata ndikon negativisht në informatën bindëse dhe të saktë tek individit, me ç'rast sjellja e individit është çelësi për të mposhtur virusin. Patëm restriksione, kufizime dhe lirim të masave, ashtu siç u vlerësuan nga udhëheqës të ndryshëm.

Atëherë kur nuk kishim dhe nuk kemi më shtretër për pacientë, kur dhomat ishin plot e klinikat e stërmbushura, kur qytetarët tanë trajtohen nëpër korridore, kur filloi të infektoheshin me të madhe edhe punëtorët shëndetësorë, kur kishin probleme edhe me oksigjenin dhe me oksigjenimin, tani çfarë u desh të bëhej tjetër, përveç marrje të masave, të cilët ishin në shërbim të qytetarëve dhe jo për tjetër, por vetëm për të ruajtur shëndetin dhe jetën e qytetarëve tanë. Pas lirimit të masave menduam se u kthyem në normalitet: kënaqeshim në ambientet e mbyllura dhe ndaj makiatos, hajt se kalojnë. Lejimi i aktiviteteve derisa ne kënaqeshim, por u shtua dhe u ngrit dita-ditës shumë e më shumë lakorja statistikore epidemiologjike. Tani nga këto masa 12-ditore kanë rezultuar me rënie të rasteve të të infektuarve dhe të vdekjeve, nga 15, 17, 13, e 20 vdekje më herët, këtë javë kemi rënie të të vdekurve në 4, 5 e 7 raste. Gjithashtu, është sinjifikant përmirësimi nëse krahasojmë me dy muajt e mëhershëm, kur për dy muaj kishim rreth 648 vdekje.

Mesatarja e rasteve ditore të të infektuarve është 36.4% më pak. Në spitalet tona kishte më shumë se 900 të hospitalizuar, ndërsa tani, pas këtyre masave numri ka rënë në 700 e më poshtë. Më radikalisht kam vepruar të gjitha shtetet e tjera të zhvilluara e në zhvillim. Kishin qasje të ndryshme, si për shembull: gatishmëria milimetrike gjermane, injorimi nga Brazili, Suedia duke pretenduar imunitetin e tufës, karantinimi radikal në Zelandën e Re e në Australi, disiplina ushtarake kineze, jemi dëshmitarë që të gjitha ato vende që kanë ndërmarrë shtrëngim të masave, kanë kaluar me më pak raste të të infektuarve dhe më lehtë.

Pra, bëhet fjalë për shtetet që kanë investuar shumë e më shumë në shëndetin publik. Paramendojeni, sikur të kemi vetëm lirinë e lëvizjes ose të eksperimentonim edhe ne si Suedia, duke pretenduar të arrinim imunitetin e tufës. Deri më tani parashihet, përllogaritet që të do të kishim rreth 12 mijë vdekje në shtetin tonë. Logjika që “hajt se s’ka dert, hajt se s’ka problem”, mund edhe të infektohem, e hajt se e kalojmë, e me shumë “hajt” të tjera, shtohen dhe do të shtojnë numrin e sëmundshmërisë dhe të vdekjeve. U krijua nevoja për një baraspeshë mes shëndetit, ekonomisë dhe të drejtave të njeriut, ku edhe ashtu është baraspeshë e brishtë. Kjo jobaraspeshë preku edhe kuletën e çdo qytetari, pati rënie edhe të ekonomive familjare në çdo shtëpi, humbje të pjesëve të pasurisë, na u pakësuan edhe klientët. Të gjitha këto mund të shprehen në numra dhe të përllogariten, por vetëm jeta jo. Jeta nuk ka çmim, ajo është e drejtë para çdo të drejte tjetër, edhe para asaj të lëvizjes dhe plotë të tjera simotra.

Liritë, të cilat e cenojnë jetën e njeriut e rëndon edhe gjendjen më shumë të shëndetit mendor. Kufizimet mund të arsyetohen, pasi që akoma edhe vaksinat nuk arritur në shtetin tonë. Vaksina është i vetmi produkt mjekësor në histori të mjekësisë, e cila ka çrrënjësuar dhe eliminuar sëmundjet. Vaksina është drita e vetme në fund të tunelit, me të cilët fillon rrugëtimi ynë drejt normalitetit. Këtë e dimë të gjithë ne, të gjithë qytetarët, por më së miri e dinë ish-ministri dhe ministri i Shëndetësisë tani. Vaksina në këtë kohë të pandemisë u gatua me shpejtësi nga fabrikat farmaceutike, por jo edhe distribuimi i saj, njëkohësisht me prodhimin e vaksinës, na u paraqit edhe fenomeni i ashtuquajtur “nacionalizmi i vaksinës”. Pra, kanë ndarë për vete pjesën më të madhe të vaksinave, bile më tepër se sa kanë pasur nevojë.

Njëkohësisht kanë vënë në vështirësi për sigurimin e vaksinave për shtetet më të varfra, përfshirë këtu edhe Kosovën. Vështirësi tjetër që mendoj dhe e vlerësoj si shumë të arsyeshme, ka qenë edhe fakti që Qeveria e Kosovës nuk ka shprehur interesimin që për qytetarët e saj të ofrojë vaksina të pamiratuara për përdorim nga organizatat relevante botërore, si FDA, EMA dhe OMS, siç janë vaksinat Sputnik nga Rusia apo Sinofran-i i Kinës, me të cilat filluan vaksinimin disa shtete fqinje në Ballkan.

Të nderuar deputetë, edhe unë sikur të gjithë ju, kemi familjarët tanë në mërgatë në vende shumë të zhvilluara. Në Londër kam motrën time Linditë, ku ajo para katër ditësh është vaksinuar me vaksinë Astra Zeneca, aty ku kjo vaksinë merr edhe jetën, fillon edhe jetën e saj. Ndërsa, në



Gjermani kam motrën Shkëndijë, e cila së bashku me familjen e saj akoma nuk është vaksinuar, edhe pse aty prodhohet vaksina Fizzer, për shkak se kjo pandemi nga SARS-COV-2 kërkon procedura të kontrolluara të distribuimit të saj.

Përgëzoj ministrin Vitiaa, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike për shpërndarjen e 24 mijë vaksinave dhe vaksinimin e qytetarëve tanë në mënyrën më të mirë të mundur dhe pa asnjë problem e vështirësi. Siç besoj, që Qeveria Kurti shëndetësinë tani e tutje nuk do ta ushqejë më me trosha, siç ka qenë deri më tani, pasi që ka ndërruar standardi politik dhe do të ndërrojë edhe standardi i qasjes ndaj Shëndetësisë.

Njëkohësisht për të përfunduar, kam dy kërkesa nga ministri Vitia, që me angazhimin...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESJA:** Edhe një minutë, Regjia, të lutem!

**BURIM KARAMETA:** Kam kërkesë që me trajtimin e pandemisë dhe vaksina do të finalizojë marrëveshjen kontraktuale me Fizzer deri në fund të kësaj jave, në mënyrë që për dy apo tri javët e ardhshme qytetarët tanë të vaksinohen, deri në 60% të popullatës së saj. Dhe, duke pasur parasysh, ministër, që ambulancat tona kanë probleme të jashtëzakonshme me listën e esenciale të barnave dhe produktet e listës së saj, siç e thatë, që vetëm 11,59% është e pasuruar nga barnat dhe 15,45% me produktet e saj, të merrni masa nga linjat tuaja buxhetore dhe të ndërhyri në kornizën tuaj të brendshme buxhetore dhe nga linja të ndryshme të derdhni para, në mënyrë që qytetarët tanë të marrin shërbime, duke pasur parasysh, se të gjitha ambulancat dhe të gjitha qytetet e Kosovës janë duke u ballafaquar me probleme të tilla. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Vetëm një sqarim, për shkak se kam ngatërruar radhën, kështu që Partisë Demokratike i shkon fjala, domethënë pas Abelard Tahirit është Eliza Hoxha.

**ABELARD TAHIRI:** Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Është e papranueshme në radhë të parë me u zhvillua një debat i tillë dhe mos me pas prezencën e kryeministrit të Republikës në këtë debat.

Pra, ajo që qytetarët e Republikës duan të dëgjojnë është pikërisht qëndrimi i një kryeministri, angazhimi i tij, puna e tij që ka bërë gjatë këtij një muaji, një prej çështjeve më të rëndësishme pra për sigurimin e vaksinës. Zoti Kurti gjen kohë për gjithçka tjetër, edhe për Shqipëri, edhe për Lezhë, edhe për Krujë, edhe për Bojkenin, edhe për atë tjetrin, edhe këtë tjetrën, por për vaksinë e cila shpëton jetën qytetarëve, për atë s'gjen kohë.

E tha një prej deputetëve të mazhorancës që shtetet janë në garë për sigurim të vaksinës. Po, normalisht që janë në garë për sigurim të vaksinës, se janë në garë për të shpëtuar jetë. Ne s'jemi kurrkund, as në garë për sigurim të vaksinës, as në garë për trajtim më të mirë të pacientëve tanë. Pra, shihni vdekjet në Republikën tonë, shihni vdekjet dhe matni statistikën me vdekjet që ndodhin në Rajon me njerëzit që intubohen. Pra, vdekshmëria te ne është mbi 90%.

Shihni Maqedoninë sa është, shihni Shqipërinë, ndër 50%. Kjo është tmerr! Kjo është tmerr dhe kjo është përgjegjësi e kësaj Qeverie, sepse Pandemia nuk ka qenë para dhjetë viteve dhe vendi qeveriset konform rrethanave të reja të krijuara, që ka krijuar Pandemia e jo qysh të teket ty. Këtu shohim një papërgjegjësi jashtëzakonisht të madhe.

Këtë debat, të nderuar deputetë, e kemi thirrur për shkak të gjendjes jashtëzakonisht të rëndë në Republikën tonë, të krijuar nga Pandemia dhe në anën tjetër, mosmarrjen e masave nga kjo Qeveri dhe nga ky kryeministër. Këtë më së miri e ilustroi prezantimi i parë i ministrit të Shëndetësisë. Pra, ministri i Shëndetësisë foli 20 minuta në prezantimin e tij të parë dhe prej 20 minutave 19 minuta foli për gjithçka tjetër, edhe për një ambulancë në Strelc, edhe për specializantë, për gjithçka, vetëm një minutë, më pak se një minutë, foli për vakcina.

Pra, kjo tregon me çfarë papërgjegjësie udhëhiqet ky vend. Është e papranueshme ministër të flasësh 20 minuta, 19 minuta të flasësh për gjithçka tjetër, vetëm një minutë të flasësh për vaksinën, sepse ajo është që sot më së shumti na intereson. Ne e dimë, që një ditë do t'i kemi në Republikën tonë, sepse falë edhe COVAX, pra Aleancës Botërore të Vaksinimit, edhe Komisionit Evropian, edhe presidentit Biden, tashmë kemi zotime dhe realisht po më duket vetja sikur me jetua në vitin '99/2000, kur i kemi pritur vetëm ndihmat. S'kemi pasur shtet dhe kemi pritur kush po bën rahmet të na ndihmojë neve. Pra, në këtë situatë e ka prurë sot Albin Kurti dhe kjo Qeveri vendin tonë.

I nderuar ministre, nuk po e di a po e jeton realitetin që po e jetojmë ne! A jeni duke i parë rastet e vdekjes, që vërtet janë alarmuese? Pra, nuk ju kemi parë që po i merrni seriozisht këtë gjendje dhe këtë situatë që po krijohet çdo ditë e më e rëndë në vendin tonë. Janë bërë më shumë se një vit, prejse Pandemia ka goditur vendin tonë dhe gjatë këtij viti kemi pasur tri qeveri. Pra, qeveritë janë ndërruar, por përpjekjet për ta luftuar Pandeminë janë zero, fatkeqësisht. Dhe, për këtë nuk po flasim ne thjesht pse po duam, mirëpo po flasim faktet që po i lexojmë çdo ditë.

Pra, i nderuar ministër, deri më sot ju iu keni shmangur këtyre fakteve, ju keni dëshmuar se keni lexuar gabim gjithë këtë situatë që ka ndodhur në vendin tonë dhe kur na flisni për moral dhe kur na flisni për dorëheqje, ajo është më e fundit që ti duhet të flasësh, zoti ministër. Ti është dashur të japësh dorëheqje në mandatin e parë të Qeverisë Kurti. Pra, si rezultat i masave tuaja kundërkushtetuese ka humbur jetën Agon Musliu. Ti atëherë është dashur të japësh dorëheqje.

Pra, këtu është marre për juve, është marre për juve me bë zhurmë kur përmendet emri i Agon Musliut, është marre për juve!

Prandaj, sot nuk mund të flasë Arben Vitia për dorëheqje, sepse e ka treguar që nuk i bën përshtypje këtij shëndeti i qytetarit, qysh s'i ka bërë përshtypje vdekja e Agon Musliut, që ky është dashur të japë dorëheqje, morale të paktën, nëse s'ka pasur përgjegjësi penale, dhe nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Pra, edhe sot të vdesin 11 veta prej Pandemisë COVID-19 në Republikën tonë për të është krejt situatë normale. Edhe për Albin Kurtin, është krejt situatë normale.

Pra, kjo është gjendje e padurueshme, është gjendje e patolerueshme në vendin tonë, zoti ministër.

Çështje tjetër, që është me rëndësi për ta diskutuar, është edhe krahasimi i vendit tonë me vendet e rajonit, sa i përket vaksinimit.

Pra, 400 mijë vakcina në Shqipëri, ose më mirë me thënë, janë vaksinuar 14 në 100 qytetarë. Ku jemi ne? As 1% s'e kemi mbërri! 60 mijë vakcina në Mal të Zi. Janë vaksinuar 10 në 100 qytetarë. Ku jemi ne? S'po krahasohem me Slloveninë, as me Lubjanën, por po krahasohem me këto vende që të paktën e kemi një zhvillim të përafërt. Pra, shihe në çfarë pozicioni jemi ne! Ju asnjë hap, asnjë angazhim konkret nuk e keni bërë dhe nuk jeni duke e bërë në këtë drejtim.

Ne shohim, prapë po them, shyqyr që ka një angazhim shumë të madh edhe të aleatëve tanë dhe do të na ndihmojnë në këtë proces, por nëse është e mundur sot të mos vdesin 11 veta për shkak të vaksinës, është shumë me rëndësi. Jeta e secilit qytetar në këtë vend është shumë e rëndësishme, por fatkeqësisht, jo edhe për juve, jo edhe për kryeministrin Kurti.

Pra, a e din ku gjendet Republika jonë, sa i përket sigurimit të vaksinave? Republika e Kosovës që udhëhiqet nga Albin Kurti sot është në rang me Libinë, Kamerunin, Sirinë, Kirgistanin dhe Zambinë. Këto janë vendet që ne jemi në rang me to për sigurimin e vaksinës. Po ua përmend edhe një herë, është Libia, Kameruni, Siria, Kirgistani dhe Zambia. Kosova është në mesin e këtyre sa i përket sigurimit të vaksinës. Kjo është Kosova e Albin Kurtit.

Dhe e fundit, zoti kryeministër, po ua përkujtoj që edhe Republika e Malit, një vend që tashmë është në luftë civile, ka arritur të vaksinohet më shumë popullsinë sesa Republika jonë. Kjo është një papërgjegjësi jashtëzakonisht e madhe, kjo është një papërgjegjësi që besoj se qytetarët po e shohin çdo ditë, edhe mospjesëmarrjen tuaj në këtë rast unë e kuptoj, sepse nuk ke çfarë t'u thuash qytetarëve. Nuk ke, sepse ata s'janë të interesuar të dinë rezultatin e zgjedhjeve në

Shqipëri, që për ty është shumë i rëndësishëm. Ata nuk janë të interesuar të dinë çfarë ka ndodhur me Bojkenin. Për ty është e rëndësishme, por për ta s'është.

Pra, edhe një herë po ju bëj thirrje, edhe si mazhorancë, edhe si Qeveri, edhe si kryeministër, të ktheheni në krye të përgjegjësisë suaj, për të cilën ju kanë votuar qytetarët e Republikës së Kosovës. Është e pamoralshme, është e pandershme, me u çua sot në mungesë të kompetencës, në mungesë të punës, me e bë krahasin me atë qeveri, me këtë qeveri... Ju keni fituar pikërisht duke i akuzuar të tjerët për dështime dhe sot po thoni "Hajt, se edhe ne jemi sikur krejt këta të tjerët, kanë dështuar këta, kemi dështuar edhe ne...". Po, për atë arsye ti i ke marrë 50%, për të ndryshuar, për të mos qenë si ai apo ky tjetri. Pra, këtu shihet edhe një herë qartë degjenerimi, degradimi, që ka sjellë kjo Qeveri. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Replikë nga zonja Kusari-Lila, në emër të Grupit.

**MIMOZA KUSARI-LILA:** Po vazhdoj atëherë në reagimin, se kjo seancë... ose po dal atje po flas. Përderisa në këtë foltore po përmenden emrat e të vdekurve, atëherë më duhet me ua rikonfirmua edhe një herë, që është tepër e turpshme, që në proces kur të humb njerëzia edhe përmenden viktimat, ashtu siç e keni bërë me Komisionin Hetimor e ai komision i cili ka zbuluar probleme të shumëfishta, që nuk kanë pasur të bëjnë me menaxhim të sistemit. Tash unë po të tregoj.

*(Debat në sallë)*

**KRYESUESJA:** Zoti Tahiri, ju lutem uluni në vend!

**MIMOZA KUSARI-LILA:** Sa u përket rasteve efektive në Kosovë, 100 mijë pacientë i kemi pasur me COVID, 90% janë të ish-qeverisjes. Sa i përket këtij menaxhimi, ose këtij administrimi, me 900 raste të hospitalizuara e ka marrë ministri Vitia, sot i ke 600. Me 14 mijë raste aktive sot i ke 11 mijë. Me 30% rënie për një muaj. Çka po doni tash? Çka po doni? Për një muaj me 30% rënie. E tepruar dhe e papranueshme është rasti i përmendjes së viktimave. E filloi zonja Deliu, e vazhdove ti, zoti Tahiri. Ajo e filloi me një të ndjerë nga COVID-i, ti e vazhdove me rastin e Agon Musliut. Për mua është e papranueshme si një person, si një nënë, si një qytetare, si një deputete, që kam pasur rastin ta udhëheq Komisionin Hetimor, për arsye se i kam parë manipulimet të cilat janë munduar të bëhen me rastin tragjik. Edhe asnjë rast i vetëm nuk e tregon, se djali ka ndërruar jetë për arsye të keqmenaxhimit, e kundërta. E kundërta, është e dhembshme se në çfarë mënyre ne si shoqëri e trajtojmë shëndetin mendor.

E sot, keni fytyrë të dilni dhe prapë ta përmendni emrin e tij! A nuk ju doli boll? Hajde! Çka tjetër? 30% ka rënie të rasteve për vetëm një muaj.

KRYESUESJA: Kundër replikë, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: T'i duartrokasësh atyre që amnistojnë vrasjen e Agon Musliut është turpi më i madh, që mund të ndodhë në një Parlament dhe kjo ndodh veç me Lëvizjen Vetëvendosje. Pra, kur e ka marrë, kur është bërë ministër Arben Vitia, një ditë pa u bërë ministër ky, numri i testimave në ditë ka qenë 5 049, sot është 1 559. Kjo është Qeveria juaj efikase. Pra, shihni sa ka rënë numri i testimave.

Prandaj, edhe sot e kësaj dite ju keni punuar dhe jeni angazhuar që me pengua hetimin për vdekjen e Agon Musliut. Prandaj, ju jeni përgjegjës, Qeveria Kurti dhe Arben Vitia edhe sot e kësaj dite do të mbahen gjithmonë përgjegjës për vdekjen e Agon Musliut. Kjo është e tmerrshme.

KRYESUESJA: Zoti Tahiri, keni kujdes me fjalorin, të lutem! Fjalën e ka ministri Vitia.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, nënkryetare Bogujevci!

Po bre, nuk kemi vaksinë! Po bre, nuk kemi as barna! Janë 30 ditë që kemi ardhur dhe mund të ju garantoj, që nga dita e parë intensifikimi, dinamizimi i procesit për sigurimin e vaksinave ka marrë një rrugë komplet tjetër. Edhe prapë mund të ju them, që shumë shpejt, kini veç pakë durim, ju lutem! Shumë shpejt, asnjë gjë nuk do të shkojë pa e vërejtur dhe pa e pa se çfarë ka bërë Arben Vitia kur të përfundojë i gjithë procesi.

Në anën tjetër, qëndrimi i kryeministrit Kurti, nga fillimi në baza ditore i raportoje për punën e vaksinimit dhe për punën e procesit të sigurimit të vaksinave kryeministrit Kurti. Ai ka caktuar zëvendëskryeministrin Bislimi si koordinator ndër-institucional, ndër-ministor, për të bërë të gjithë këtë komunikim negocim dhe raportim drejt kryeministrit. Përveç kryeministrit Kurti është edhe zonja Vjosa Osmani, presidente e vendit, e cila vazhdimisht prej ditës së parë ka qenë e implikuar dhe ka intensifikuar edhe ajo këtë negocim. I gjithë Kabineti Qeveritar bashkë me presidenten e kanë mbërri këtë dinamizim që po flasim. Dhe, ju garantoj edhe atë që të gjitha ato që kanë qenë për t'u nënshkruar, asgjë nuk kanë refuzuar, përkundrazi. Ua garantoj edhe atë që jam edhe më optimist sesa që kam qenë në fillim, krahasuar me dozat dhe me kohën se kur do të vijë vaksinat.

Në anën tjetër, puna e masave, infeksionet intra-hospitalore, zoti Tahiri, është një çështje e vjetër. Atë e din edhe ish-ministri dhe një prej arsyeve kryesore të vdekjeve të gjithë atyre personave që janë intubuar është edhe infeksionet intra-hospitalore, për të cilën për shumë vite, 20 vite nuk është bërë asgjë. Dhe, ne kemi filluar tani, për 30 ditë, zoti Tahiri.

Në anën tjetër, një arsye tjetër pse vdesin arsyet e intubuar është se udhërrëfyesi klinik nuk ka derivuar protokolle se cilin nivel duhet mjekësia primare, cilin nivel duhet mjekësia sekondare,

në cilin nivel duhet të shkojë pacienti në mjekësinë terciare dhe ku është koha që duhet intubuar. Dhe, këtu nuk kanë faj profesionistët tanë shëndetësorë, po ajo është duke u bërë zoti Tahiri dhe ka filluar e shumë shpejt do të bëhen edhe këto protokolle.

Në anën tjetër, puna e masave, zoti Tahiri. Nga nëntori 2020 Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka rekomanduar që të ketë shtrëngim të masave, sepse në nëntor të vitit 2020 ka qenë mbi një mijë pacientë numri i të shtruarve nga 1150 që kanë qenë komplet.

Po, nuk më keni parë, është e vërtetë. Nuk kam qenë publikisht dhe nuk jam parë, sepse me ju thënë të drejtën, vaksinat dhe vetëm vaksinat kanë qenë ajo me të cilën jemi zgjuar dhe me të cilën kemi shkuar në shtëpi, nga dita e parë deri më tani dhe këto rezultate do t'i vëreni së shpejti.

Po, Republika e Kosovës, nuk e kam lexuar, mund të radhitet edhe me Kamerunin, edhe me Zambinë e me shumë shtete të tjera, është shumë e vërtetë dhe ju besoj parimisht. Atë çfarë e di, është se po, jemi në vendin e fundit në sigurimin e vaksinave. Po, ju e dini një gjë, zoti Tahiri, e dini të gjithë qytetarët, e dini edhe ju deputetë të nderuar, kush shkon i pari – del i pari. E kemi humbur hapin, fatkeqësisht, e kemi humbur hapin në fillim të negocimit edhe natyrisht, ky hap i humbur nuk mund të kthehet më. Kur kam kontaktuar... Po, vaksina kur ka dalë? Vaksina nuk ka dalë në muajin prill të vitit 2020!

Në momentin kur nuk ka pasur negociim dhe fillim të negocimit në muajt e parë, natyrisht se e kemi humbur hapin dhe natyrisht se do të mbetemi nga vendet e fundit, mirëpo fatmirësisht falë miqve tanë ndërkombëtarë, të cilët i falënderoj, dhe fatmirësisht falë dinamizimit të procesit nga kryeministri Kurti dhe zonja Osmani, tash jemi në rrugë të mirë dhe doza shumë më të mëdha të vaksinave t'i sigurojmë. Dhe, ju garantoj, nuk do të dështojmë, zoti Tahiri. Jo për shkak diçka... Nuk do të dështojmë, se këtë ia kemi borxh, e kemi obligim ndaj qytetarëve. Dhe, po qe nevoja, ditë e natë, me gjithë ekipin, e gjithë ekipi qeveritar, jo vetëm Ministrinë e Shëndetësisë, do të punojmë dhe të ju garantojmë se ne nuk do të dështojmë dhe vaksinat do të sigurohen edhe më shpejt sesa që kanë pritur edhe optimistët më të mëdhenj e mos të flasim për disa nga skeptikët, të cilët nga fillimi kanë thënë se kjo nuk do të bëhet në asnjë moment.

Ju lutem për edhe pak durim, dhe më besoni se do të bindeni me këtë që po ju them! Faleminderit!

KRYESUESJA: Abelard Tahiri, replikë dy minuta.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Zoti ministër,

Po flisni për vaksinën sikur me qenë një ilaç që është për diabetin. Pra, nuk e di a jeni duke e parë sa emergjente është kjo. Secila jetë e qytetarëve është shumë me rëndësi. Unë e di që pas një muaji, jam i bindur që ka me fillua vaksinimi, sepse as Evropa s'ka me e lënë një vatër të burimit të infeksionit Kosovën me COVID. Pra, i kemi gjithë këta partnerë ndërkombëtarë që më shumë se vet Qeveria jonë po na ndihmon, fatmirësisht.

Pra, më shumë po na ndihmojnë partnerët tanë dhe më shumë janë të interesuar për shëndetin e qytetarëve tanë, sesa ju. Pra, nëse mund të bëhet sot, pse duhet të bëhet nesër?

Prandaj, ne po kërkojmë që të jetë prioritet i prioriteteve të kryeministrit dhe prioritet i prioriteteve tuaja, që fatkeqësisht nuk është. Pra, ne po e kërkojmë dhe ti nuk mund të thuash “të keni durim”. Po qysh more të kemi durim? A është e parëndësishme për ju të vdesin 11 vetë, 12 vetë në ditë, edhe me e ulë prej 5 mijë numrin e testeve në 1 mijë. Pra nuk mundesh bre, më beso duhesh me u ndje keq me atë që po e thua. Të kemi durim, le të vdesin edhe nesër 12, edhe pasnesër 13, edhe pasnesër 14, edhe nuk është problem. Pra, mos e thuaj në ato formë. Mos, se është e papranueshme! Është e pandershme! Është e pamoralshme!

Prandaj, po të them, vendoseni në prioritet dhe ti duhesh me qenë. Tregona një çështje, a je udhëheqës i ekipit që negocion për vaksinën? A e udhëhiqni ju atë ekip që negocion në emër të Kosovës për vaksinën? Na tregoni!

**KRYESUESJA:** Fjalën ministrit Vitia.

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Jo, zoti Tajhiri, unë nuk jam udhëheqës. Unë jam ministër i Shëndetësisë, politikan në këtë ministri për politikbërje dhe natyrisht, në këtë ekip udhëheqës është njëri nga më meritoret dhe në këtë grup, ju garantoj, janë ekipi më profesional i mundshëm nga të gjitha institucionet, të cilat mund edhe kanë bërë detyrën në mënyrën më të mirë.

Tani, ju lutem, tani ky ekip e ka dinamizuar dhe ky ekip ka sjellë në situatën e tillë që këto vaksina, edhe të rritet numri i dozave, edhe të vijnë në kohën kur është dashur, sepse s'kemi më herët të vijnë. Unë jam dakord që është dashur dje të vijnë. Më mirë ka qenë në janar, por nuk kanë ardhur, zoti Tahiri. Ata që kanë negociuar fillimisht, ata i kanë marrë fillimisht. Negociatat për vaksina fatkeqësisht kanë filluar vonë. Dinamizimin që ia kemi bërë procesit, prapë po them, po, mund të thoni që “keni durim” është jo mirë të themi tani dhe mund të keqkuptohet. Mirëpo, zoti Tahiri, unë nuk po ju flas për durim njëmuajor, as nuk po ju flas për durim dymujor, për pak ditë, zoti Tahiri.

Për sa, e thash edhe në fillim, pavarësisht sulmeve që mund të më bëhen, pavarësisht të gjitha akuzave që mund të më bëhen, unë nuk e shkel marrëveshjen e konfidencialitetit. Ka pesë ditë që unë kam nënshkruar edhe një deklaratë nën betim, që nuk do ta them as edhe një informacion,

derisa të mbarojë gjithë procesi. Dhe, unë po ju them vetëm kaq, që ky proces do të përfundojë së shpejti dhe pastaj unë e di që me padurim, edhe ju si opozitë, edhe qytetarët tanë, po i presin vaksinat. Ju thash në fillim dhe po ju them tani, me fillimin e ardhjes së dozave të vaksinave në muajin maj, nuk do të ketë më ndërprerje të procesit të vaksinimit deri në fund të vitit dhe në fund të fundit do të arrihet premtimi atë që e kemi dhënë, mbi 60 për qind të personave të grupmoshave të caktuara të cilat do të vaksinohen. Sa i përket, edhe një gjë të fundit. Miqve tanë ndërkombëtarë, nuk kam lënë asnjë pa e takuar dhe pa shikuar se cilat janë mundësitë për të na ndihmuar.

Natyrisht, është ajo që të gjithë e dimë, që po ne mund t'ju ndihmojmë, po së pari duhet t'i ndihmoni vetes dhe të jeni të sigurtë në konstatimin tuaj dhe të jeni të sigurt në këtë që po ju them se nuk kemi lënë gjë pa bërë që kjo të ndodhë që ne t'i ndihmojmë vetes, në mënyrë që të na ndihmojnë edhe partnerët tanë strategjikë ndërkombëtarë. Kurse, e fundit fare, po atë që i kam thënë secilit nga partnerët tanë, Republika e Shqipërisë ka pasur edhe zgjedhje të tjera, ka pasur edhe një vaksinë. Republika e Serbisë edhe zgjedhje të tjera. Ne edhe si Qeveri edhe si Parlament, edhe si qytetarë ne kemi zgjedhur vetëm një rrugë, ne kemi vendosur për të zgjedhur rrugën euroatlantike, Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në asnjë moment nuk besoj se ne duhet të penalizohemi, për shkakun se qytetarët tanë ky Parlament dhe Qeveria jonë ka zgjedhur këtë rrugë. Kjo është që e kam transmetuar te partnerët tanë ndërkombëtarë dhe besoj se edhe këtë do ta kenë në mendje që sa më shpejtë të na ndihmojnë në sigurimin e vaksinave shtesë, përveç atyre 60-përqindëshit të cilin ju siguroj deri në fund të vitit. Ju faleminderit shumë!

**KRYESUESJA:** Z. Uran Ismaili, replikë në emër të Enver Hoxhajt.

**URAN ISMAILI:** Faleminderit!

Realisht u bë një episod këtu i jashtëzakonshëm kur u përmend rasti i Agonit dhe mendoj që nuk i takon Kuvendit që për një çështje që ka humbur në karantinë, pra në izolim të shtetit, një lloj burgu ta quajmë ndoshta 15-ditorë, po ai ka qenë një izolim me vendim të shtetit, që të ndodhë një lloj reagimi i tillë, ku bëhen vetë gjyqtarë, vetë prokurorë, vetë e arrijnë vendimin.

Pra, rasti i Agonit është një rast i dhimbshëm dhe një rast në të cilin kemi kërkuar hetime dhe në ato hetime ne kemi konsideruar që janë bërë shkelje të procedurave, janë bërë shkelje të njerëzve të cilët kanë pasur detyrime ndaj atij karantinimi. Pra, kanë pasur detyrime ndaj asaj, sepse është marrë me vendim, për ata që nuk e dinë, vendimi për karantinë merret nëpërmjet nënshkrimit të Ministrit të Shëndetësisë. Pra ministri i Shëndetësisë vendos kush hyn dhe kush del. Kjo është ok.

Kjo ka qenë, mirëpo reagimi që po abuzohet me emrin e tij, mendoj që është reagim jo i qëllimshëm, sepse kërkesa edhe e prindërve të tij, është gjithnjë që ju lutem a keni mundësi ta



shtyni që të paktën le të ketë një epilog, të ketë një hetim, le të dihet pse më ka shkuar djali. Pra, në qoftë se ne sot si deputetë nuk përfaqësojmë kërkesat e qytetarëve, nuk di çka përfaqësojmë. Në qoftë se ne përfaqësojmë vetëm narrativen politike të partisë sonë politike, pra vetëm pse duhet ta mbrojmë partinë në çdo kohë, atëherë mendoj se jeni në pozicion të gabuar.

Zoti Vitia, vaksinat do të vijnë, ne thamë.

KRYESUESJA: Vazhdoja edhe një minutë.

URAN ISMAILI: Zoti Vitia, e keni humbur rastin pak për t'ju besuar, këtu është problemi. Nuk po është problemi pse ne s'po duam t'u besojmë. Kanë ardhur 25 mijë vakcina në Kosovë. Asnjë lloj plani për to nuk është bërë. Asnjë lloj transparence për to nuk e ke bërë. Asnjë lloj komunikate. Krejt çka kemi bërë, është disa fotografi të juaja atje, duke u ulur në gjunjë atje e duke i prekur njerëzit. Pra, ju keni humbur rastin që sot ne të jemi para një situatë ku ti na thua shiko ky ka qenë plani im, unë kam dashur t'i vaksinonjë 800 persona në ditë dhe kam arritur këtë plan.

Pra, sot po thua besomëni me Pfizer-in. Qe po të besojmë me Pfizer-in. Unë besoj që kanë për të ardhur. S'ka shans pa ardhur. Ajo është një produkt komercial që ka për të ardhur në Kosovë, por plani juaj kush do të vaksinohet, si do të vaksinohen, kur do të përfundojë vaksinimi, nuk është fare i ditur. Ti flet një retorikë: ju lutem besomëni. Ne po duam të të besojmë, veprat nuk po i ke për të të besuar. Po t'i kishe pasur vepra për të besuar, të kishim besuar.

KRYESUESJA: Z. Zemaj e keni kërkuar fjalën, jeni në listë për fjalë në fakt, jo për replikë. Në rregull, dy minuta replikë.

ARMEND ZEMAJ: Është shumë korrekte zonja nënkryetare që t'u jepet fjala sa herë apostrofohet edhe diskutimi, edhe fjalimi.

Zoti ministër,

Është në natyrën e njeriut, ndoshta dikush di ta gjuajë gurin dhe di ta fshehë dorën. Unë jam pak më ndryshe. Unë ndjehem drejtpërdrejt, nuk i shti të tjerët. Nëse duhet të kemi edhe atë përballjen personale. Po nuk ka këtu personale, janë interesat madhore.

Kur apostrofohet një çështje dhe një momentum, duhet ditur se njerëzit janë të gjallë.

Zoti ministër i Shëndetësisë, aplikimi i parë për vaksinën COVID është më 30 qershor 2020. Në korrik kemi filluar me Aleancës Gavi-Covax. Në shtator me Pfizerin. Para aplikimi deri te AstraZeneca dhe deri te viti 2021 me Modernën dhe vaksinën Johnson&Johnson.

I nderuar ministër,

Për hir të opinionit publik dhe transparencës së plotë, për këtë arsye po kërkojmë transparencë aq sa lejohet, sepse një ndër komunikimet edhe me Pfizer-in të dt. 5 janar, ne kemi pyetur në mënyrë specifike çka mund të ndajmë me publikun. Asgjë më shumë dhe më pak sesa ata na kanë adresuar me procesverbal dhe me incizim se çka mund të ndajmë me publikun. Asnjë fjalë tjetër. Qytetarët kërkojnë transparencë. Nuk kërkojnë çështje negocimit konfidencial të tij. Dhe atë prapë duhet ta ruash. Kështu që ministër, duhet të jeni korrekt në deklaratimet dhe zotimet për punët që i bëjmë. Asnjë vonesë. Krejt çka është vonesë që duhet të na thuash është pas dt. 15 çka po ndodhë, asgjë tjetër.

Sa i përket Pfizerit, të tjerat janë shumë transparente dhe nuk ka nevojë as të fshihen, as të blihen, as të gjykohen. D.m.th. kjo është e vërteta.

KRYESUESJA: Rendin tani e ka Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: E nderuar kryesuese e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot jemi mbledhur për diçka që na tejkalon neve. Jemi mbledhur për pandeminë. Po, bash allahile!

Të dashur qytetarë,

Pandeminë nuk e solli kjo Qeveri, e dimë të gjithë, por e gjeti. Më vjen keq që më duhet të flas për këtë. Më vjen keq që njerëzit po vdesin çdo ditë. Të gjithë mund të krekosen lehtë, fare lehtë, ata që nuk e kanë provuar në palcën e vetë. Më vjen keq për këta që i keni këtu në pozitë. Më vjen shumë keq që i keni votuar, sepse edhe më shumë më vjen keq që nuk po bëjnë asgjë për ju. Më vjen keq për rëndesën ekonomike që e ka kapluar vendin, gastronomët, prodhuesit, bujqit, sportistët e artistët, për shtimin e dhunës në familje dhe numrin e rritur të vrasjeve, sidomos të grave. Më vjen shumë keq për të gjithë ju që e keni humbur punën, edhe këtu pjesën më të madhe e përbëjnë gratë. Më vjen keq për 32 mijë fëmijë që nuk e kanë ndjekur mësimin online në Qeverinë Kurti 1 dhe që ende nuk ka haber se si do të kompensohen këto mësimet për ta në Qeverinë Kurti 2.

Më vjen keq për skenën e pavarur kulturore e cila u harrua dhe me ardhjen e ministri të ri edhe skema e granteve të ndara më 2021 u anulua. Më vjen keq për uljen e shtesave të pensionistëve, për thellimin e pabarazisë në qeverisjen e një partie që gjithë jetën plotë gojën ka qenë veç barazi. Më vjen keq që dje në një ditë të bukur e me diell 25 mijë vaksinat e vetme në Kosovë të dhuruara nga Covax kishin përfunduar, përderisa Kryeministri i kësaj Qeverie me besimin tuaj po bënte fushatë dhe po votonte në Shqipëri si i vaksinuar. Më vjen keq që pikërisht për shkak të

kësaj nuk i mori vaksinat donacion nga Kryeministri Rama. Sinqerisht më vjen keq që egon e tij e vendosi mbi jetët e qytetarëve të Kosovës.

Unë dhe Partia Demokratike e Kosovës nuk mund të bëjmë asgjë më shumë sesa të shprehim keqardhje për një Qeveri që i ka krejt dhe nuk bën asgjë. Ju kuptoj që nuk e keni merituar qytetarë të dashur, ju kuptoj që keni dashur të jetë ndryshe. Por, prapë më vjen që për të kuptuar këtë qeverisje duhet sakrifikuar jetën. Më vjen keq që pasi t'i humbni të dashurit tuaj një ditë do të kuptoni që për ditën që keni votuar do të jetë vetëm një nga ato të dhimbshmet në jetën tuaj. Më vjen keq që çdo ditë e re dhe çdo gjë e mirë vjen edhe pas dhimbjeve, e ajo ditë është akoma para jush. Kur këtë Qeveri do ta përcjellim së bashku me virusin.

**KRYESUESJA:** Tani radhën e ka Hykmete Bajrami.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit shumë e nderuar nënkryetare!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Më duhet, në fakt unë personalisht nuk i jap vetes shumë të drejtë të lëshohem në aspektin shëndetësor të menaxhimit të situatës pandemike, por megjithatë vetëm sa kontrollova disa shifra dhe zonja Kusari më vjen, por duhet t'ju them që nuk kemi rënie të rasteve për 30 për qind. Nëse shkoni në faqen zyrtare të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik më 22 mars kur edhe u votua Qeveria, i keni 83 012 të infektuar, i keni 68.601 të shëruar dhe i keni 12 635 raste aktive, 1 766 të vdekur. Sot kur po zhvillohet kjo seancë i kemi 104.196 të infektuar, 91 972 të shëruar, janë 12 224 raste aktive. Raste aktive ka vetëm tre për qind më pak. por më lejoni t'ju them që më 22 mars janë bërë 5049 teste, sot janë bërë 1559 teste. D.m.th. vetëm 30 për qind të atyre që janë bërë më 22 mars. Andaj, nuk është e vërtetë në fakt që situata është më e mirë, edhe për këtë unë nuk dua të hedh përgjegjësinë te dikush individualisht se para së gjithash përgjegjësinë e mbajmë të gjithë së bashku, se ishim në fushatë elektorale, por megjithatë konsideroj që ka shumë gjëra të cilat mund të bëhen më mirë.

Ditën kur u votua Qeveria, Grupi Parlamentar i LDK-së premtoi se do të presë 100 ditë Qeverinë Kurti për të parë se çfarë po punon. Por në fakt asnjëri nga ne nuk e kemi imagjinuar që Kryeministri që ka mbi 50 për qind të votave, në ditët e para të qeverisjes injoron qytetarët e vet, problemet e tyre, situatën pandemike, spitalet e stërngarkuara, mbi 12 mijë të infektuar aktiv dhe shkon e bën fushatë në Shqipëri. Mbyllja e vendit për dy javë ka qenë shumë e gabuar. Keni mbyllur vendin dhe me një pjesë kabinetit, së bashku me grupin parlamentar, keni marrë pjesë aktive në fushatën zgjedhore në Shqipëri. Rreth 30 mijë qytetarë për një vikend kanë dalë në Shqipëri, kanë shpenzuar shuma të mëdha parash dhe një numër i tyre janë kthyer sigurisht të infektuar. Mbyllja nuk ka prodhuar asnjë rezultat. Ne jemi të mendimit që sikur kjo energji të jetë shfrytëzuar në sigurim të vaksinës, sigurisht do të kishte prodhuar ndonjë rezultat. Keni

vendosur t'i ndani gjashtë milionë për tetë mijë biznese në gastronomi dhe krejt sektorët e tjerë që janë prekur nga mbyllja. Por si do të ndahen këto mjete, kur do të ndahen dhe sa do të përfitojnë bizneset e prekura nuk ka asnjë kalkulim dhe asnjë llogaritje. Gjashtë milionë për dy javë mbyllje nuk janë asgjë.

Një gjë mbajeni mend, shteti ynë dhe Qeveria juaj nuk ka kapacitet buxhetor t'i kompensojë humbjet e bizneseve, andaj edhe mbyllja siç e bëjnë vendet e tjera asnjëherë nuk është alternativë për ne. Le që gjashtë milionë nuk janë asgjë për sektorin privat edhe ashtu të prekur fort nga pandemia, por është shfuqizuar edhe vendimi i datës 14 janar 2021 për ndarjen e 222,4 milionë të Fondit të rimëkëmbjes ekonomike. Më lejoni t'ju përmend disa obligime që dalin nga Ligji për rimëkëmbje ekonomike dhe gjithashtu nga vendimi i dt. 14 janar 2021. Çka do të ndodhë me mjetet e premtuara Fondi kosovar për garanci kreditore, 3,5 milionë për mbulimin e tarifës dhe 40 milionë euro kapital? Tetë milionë euro për subvencionimin e tarifës së energjisë së ripërtitshme? KOSTT tanimë vetëm ka hyrë në obligime. 10 milionë euro kanë qenë të ndara te Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, tani Ministria e Financave dhe Transfereve për tri paga nga 300 euro për të gjithë ata që e kanë humbu vendin e punës për më shumë se tre muaj gjatë vitit 2020. Janë disa mijëra punëtorë të cilët janë në pritje të zbatimit të kësaj mase. Këto dhe obligime të tjera dalin nga Ligji për rimëkëmbje ekonomike, dhe ju pëlqeu ose jo, ky ligj është në fuqi dhe duhet të zbatohet.

Për këto 30 ditë qeverisje, më shumë jeni angazhuar në Shqipëri sesa në Kosovë. Vetëm dy muaj e gjysmë pas transmetimit të videos: Unë jam Albin Kurti dhe mbështes këtë kërkesë, derisa një i moshuar kërkonte rritje të pensionit për t'i qerasur nipat e mbesat, ju morët vendim që të mos i vazhdoni shtesat nga 30 euro për 164 885 pensionistë. Po ju rikujtoj që në atëkohë Kryeministri nuk i thoshte të moshuarit: axhë nuk kemi buxhet. As nuk i thoshte që do të shikojmë mundësitë buxhetore, as nuk i tregonte që kemi pasur rënie ekonomike 6.3 për qind. Por i thoshte, po citoj: unë jam Albin Kurti dhe e mbështes këtë kërkesë. Dhe tani çka ndodhi? Çka po ndodh me juve?

Dy milionëshin urdhëroni gjejeni, e keni policinë, e keni prokurorinë, e kemi gjyqësorin, urdhëroni gjejeni. Secilin person që është përgjegjës dënojeni, mirëpo mos manipuloni. Kanë kaluar vetëm disa muaj kur ju na akuzonit ne se nuk po bëjmë sa duhet për qytetarët dhe bizneset. Por unë pajtohem se ne nuk kemi bërë sa është dashur, sepse nuk ka pasur kapacitete buxhetore. Po tani çka po ndodh me juve me Qeverinë e referendumit? Mbështetja për biznese ra nga 60 milionë në 6 milionë. Pensionet nga 120 euro në 100 euro. Shtesa e asistencën sociale nga qind për qind shtesë, në 30 për qind shtesë. Shtesa për mjekët, nga 250 euro në 150 euro.

Dhe meqenëse brenda ditës, brenda 30 ditëve shkelët shumë premtime, ju zgjodhët strategjinë e zhvendosjes së vëmendjes, duke publikuar lista të pjesshme në emër të transparencës. Listën të cilën e bëri publike për 50 përfituesit, ministri i Financave, z. Murati nuk është transparencë. Është publikuar vetëm 0,13 për qind e listës. A e dini se në atë listë kanë përfituar 36 779 biznese

me kriterin për kokë të punëtorit. E njëjta masë është përdorë në Qeverinë Kurti 1. Pse në emër të transparencës nuk po publikohen përfituesit e masës 3A ku një pagë u është paguar direkt biznese 170 euro për kokë të punëtorit dhe një pagë u është paguar ndërmarrjeve.

Pse nuk po publikohen listat e përfitimit të qirasë 50 për qind, ku gjysmën e qirasë e ka marrë qiramarrësi dhe gjysmë qiraje ka marrë qiradhënësi. Besoni se janë të njëjtit përfitues. Janë pikërisht të njëjtit përfitues, vetëm se ju keni vendosur kritere më selektive, e neve ndërmarrjet na i ka zgjedhur softveri, duke u bazuar në kritere të qarta për kokë të punëtorit. Andaj, këto 50 kompani mos harroni që kanë qenë përfituese, mos harroni që janë edhe 50 top-kompanitë që kontribuojnë më së shumti në buxhetin e Republikës së Kosovës. Këto 50 kompani punësojnë 27 mijë punëtorë. A e dini që përfitimi i tyre në total ka qenë 7,6 milionë euro për 27 mijë të punësuar. Ky Kuvend i Republikës së Kosovës, vetëm një institucion, ne deputetët së bashku me stafin mbështetës i harxhojmë 7,6 milionë euro paga në vit. D.m.th. nëse juve ju duken shumë për 27 mijë të punësuar, unë ju bëj me dije se ky Kuvend shpenzon 7,6 milionë euro paga në vit. Andaj, luftën që e keni politike me ne dhe qërimin e hesapeve, bëjeni duke i përdorur të gjitha mekanizmat. E thashë edhe një herë, këtu jemi, prokurorinë, drejtësinë, gjyqësorin, ama të gjitha, hetuesinë. Mirëpo, mos i përdorni bizneset, sepse keni krijuar një debat bazuar në urrejtje dhe kjo nuk është aspak e mirë.

Sektori privat sot punëson 238 mijë punëtorë. 81 mijë punëtorë që punojnë në sektorin publik marrin paga pikërisht nga sektori privat. Unë e di që ata marrin pagën nga puna dhe djersa e tyre, por a e dini sa është papunësia në Kosovë. A e dini sa të rinj dhe sa gra ëndërrojnë të kenë një vend pune. Punësimi nuk krijohet në sektorin publik, sepse siç e keni parë sektori publik është i stërngarkuar. Janë pikërisht këta heronjtë e ekonomisë, heronjtë e pandemisë që punojnë dhe angazhohen në sektorin privat. Andaj, luftën bëjeni me fakte, luftën bëjeni me shifra. Listat kur t'i publikoni, publikojini të gjitha, po publikojini edhe listat e qeverisë suaj edhe listat e qeverisë sonë dhe mos zhvilloni debate e urrejtje komplet të panevojshme.

Ajo çfarë dua të them sot është që pas 30 e sa ditë pune...

**KRYESUESJA:** Znj. Mimoza Kusari-Lila, replikë.

**MIMOZA KUSARI-LILA:** Faleminderit nënkryetare!

Vetëm për rikujtim znj. Bajrami, raporti i fundit i IKSHP-së, datë 23 prill 2021 në periudhën 8. 4. 2021 - 22. 4. 2021 janë raportuar 6912 raste dhe mesatarja është 494 raste pozitive. Ndërsa, në periudhën 25. 3. 2021 deri më 7. 4. 2021 në Kosovë janë raportuar 10 878 raste. Mesatarja 777 raste pozitive. Pra nga mesatarja e numrit të rasteve ditore kemi rënie prej 283 raste ditore, apo 36,4 për qind më pak. kjo është statistikë, e para.

E dyta, testimi, të gjithë e dimë që ka ndryshuar protokollin e testimit, për arsye se nuk testohet gjithë familja e të infektuarit po vetëm ata që janë me shenja të infeksionit. Vetë z. Zemaj ditën e fundit ka lëshuar udhëzimin në të cilin testimi është dashur të kryhet vetëm me udhëzim nga mjeku i qendrës së mjekësisë familjare. Vetë jam testuar më 23 mars, kanë thënë prej dje, ditën kur ende ke qenë në zyrë, e ke lëshuar një udhëzim për t'i vështirësuar procedurat për testim.

Humbjet e bizneseve. Ajo çka u tha, lista prej 50 bizneseve të cilat është publikuar e ka mbështetur ambasadori i Bashkimit Evropian, i cili ka kërkuar, ka qenë kusht për asistencën e mëtutjeshme të Bashkimit Evropian që të zbardhet lista e bizneseve përfituese. Tash që kanë dalë ato bizneset që kanë pasur gjithë fitim, po nuk kanë pasur humbje, në top-listë, nuk është faji ynë, as faji i atyre që e kanë publikuar, po kjo është e vërteta. Nëse po ju pengon e vërteta, keni mundur ta bëni një formë tjetër të asistencës e cila është kërkuar.

Qeveri e referendumit, po se është e referendumit, se 50,2 për qind i ka fituar. Ju pëlqeu e nuk ju pëlqeu është Qeveri e referendumit, përderisa ajo krejt çka ju mund të shihni tash, është humbja juaj, është mirë edhe të reflektoni.

**KRYESUESJA:** Znj. Bajrami, kundër-replikë.

**HYKMETE BAJRAMI:** Znj. Kusari, absolutisht nuk është e vërtetë ajo çfarë tha. Unë ju lexova edhe një herë 12.635 raste aktive kanë qenë më 22 mars, sot i kemi 12 224 raste aktive. Janë të dhënat e datës 22 mars dhe të dhënat e publikuara sot.

Më 22 mars janë bërë 5 mijë e 49 teste, sot janë bërë 1 mijë e 559 teste. Edhe ty të pëlqeu ose s'të pëlqeu, këto janë shifra edhe kanë qasje të gjithë. Të mos më lexo aty raporte qysh ke qejf t'i përpunosh vet.

Standardet e dyfishta i ke specialitet. Kur ta citosh ambasadorin amerikan edhe ambasadorin e BE-së, dhe kur thua se e kanë mbështetur duhet ta dish një gjë. Duhet ta dish që ambasadori i BE-së dhe ambasadori amerikan nuk e kanë parë debatin që është zhvilluar në rrjetet sociale duke i kryqëzuar kompanitë, që e keni zhvilluar ju.

Në jeni kundër atyre kompanive, dil dhe thuaji, 27 mijë...

**KRYESUESJA:** Fjalën e ka ministri Murati. Më fal ministër Murati veç një moment! Kundër-replikë, zoti Zemaj!

**ARMEND ZEMAJ:** Me të vërtetë ndoshta edhe nuk ia vlen thënë të drejtën kundër-replika. Është e pavërtetë, tepër e pavërtetë. Nuk e di nga e posedon këtë informacion. Nuk kemi nënshkruar as nuk kam nënshkruar udhëzues as protokoll, i cili atë që deklaroi zonja Kusari.

Është shumë e pavërtetë. Këtë mund ta konfirmojë ministri aktual. Nuk ka ndodhur kjo punë para 100 viteve, janë 30 ditë që nuk jam aty. Asnjë udhëzues dhe asnjë protokoll që ka ndryshuar mënyrën e testimave nuk e kam nënshkruar dhe as nuk është nënshkruar.

Liberalizimi i testimave ka ndodhur me ngritjen e kapaciteteve edhe ato po e them me përgjegjësi të plotë, shumëfishimin e kapaciteteve në gjashtë qendrat rajonale të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe pothuajse pesëfishimin e kapaciteteve në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik në Prishtinë.

**KRYESUESJA:** Fjalën e ka zotëri Murati.

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Në lidhje me atë që u fol pak më parë për disa çështje financiare. U për përmend çështja e Ligjit të rimëkëmbjes edhe ne edhe atëherë kur ka qenë në këtë Kuvend, i kemi treguar defektet dhe i kemi treguar që është i pazbatueshëm, e aq më tepër disa amendamentet që u patën prezantuar pa vlerësim të ndikimit buxhetor.

Nëse më kujtohet saktë ka qenë edhe asokohe ministrja Bajrami, tani deputete, që i pati kundërshtuar bashkë me neve në komision. Dua të besoj që edhe më tutje e mbanë të njëjtin qëndrim.

Ishte grupi parlamentar, sidoqoftë i zonjës Bajrami asokohe, që vendosi t'i votonte ato amendamente që ishin propozuar, pa vlerësim të ndikimit buxhetor. Dhe, kur nuk ka vlerësim të ndikimit buxhetor, kur nuk ka buxhetim për ato çështje, pra s'ka buxhet, s'ka para, ato normal që s'mund të zbatohen.

Prandaj, është e padrejtë është e pasinqertë që manipulohet opinioni publik edhe të thuhet pse po paguhen 200 milionë euro për biznese. Pse s'po paguhen nga 300 për tre muaj për punëtorët. Vendimin e keni marrë, po pse s'e keni zbatuar zonja Bajrami?

Problemi është se ato 10 milionë euro, pra ai nen i atij ligji është i pazbatueshëm, ashtu siç është draftuar pa u cekur dhe pa u vlerësuar ndikimi buxhetor. Në njërin anë është lënë e hapur, pra tavan, e në anën tjetër, vendimi i Qeverisë ka qenë për 10 milionë euro.

Ekipi ka qenë i formuar, mirëpo nuk e ka kryer punën për shkak se është i pazbatueshëm. Duhet të ndryshohet ligji, në mënyrë që të specifikohet shuma, të reflektohet në buxhet, tek pastaj mund të bëhen edhe pagesat për personat që i kanë humbur vendet e punës.

Ka edhe amendamente të tjera të cilat nuk kanë vlerësim të ndikimit buxhetor dhe pastaj është detyruar Qeveria që me masa dhe vendime ad-hoc, po besoj që nuk i kanë pëlqyer fare ministres Bajrami kur i ka marrë ato vendime që t'i shpenzojë ato para.

Ta zëmë, siç është pagesa për burimet e ripërtëtitshme të energjisë, që ka qenë amendament i propozuar në këtë Kuvend, ne e kemi kundërshtuar dhe kemi thënë, s'bën të votohet. Megjithatë, partitë që e kanë pasur shumicën, pra partitë e koalicionit qeverisës së bashku me PDK-në i kanë kaluar ato amendamente. Pra, unë pajtohem që ka pasur aty amendamente të cilat nuk do të duhej të ishin. Ne në fakt i kemi kundërshtuar. Dhe, po besoj që zonja Bajrami e ka qëndrimin e njëjtë.

Sa u përket shpenzimeve nga programi i ashtuquajtur që është i reflektuar në buxhet, i rimëkëmbjes, prej mjeteve të lira në tremujorin e parë janë shpenzuar gjysma. Pra, gjysma e mjeteve të lira janë shpenzuar për 1/4 e vitit, për tremujorin e parë. Kjo i bie, sikur dikush që e ka rrogën mujore, gjysmën e rrogës ta shpenzojë javën e parë dhe gjysmën tjetër, të thotë, po lë për tri javët e ardhshme. Kjo është sa për ta sqaruar thjeshtë. Këtë e kanë bërë.

Te puna e bizneseve. Zonja Bajrami e di mjaft mirë se vet atë kontratë me Bashkimin e Evropian e kemi ratifikuar në këtë Kuvend, madje edhe ne e kemi mbështetur atë kontratë. Ka qenë kërkesë e Bashkimin Evropian që të publikohet lista nga 50 përfituesit më të mëdhenj të asaj pakoje. Ka qenë kush dhe këtë e kemi bërë.

Tash, nuk është çështja se cilat biznese figurojnë aty, sa është çështje që ne e kemi kritikuar edhe atëherë Qeverinë asokohe. I patëm thënë, kjo është qasje e gabuar, se me këtë qasje po i ndihmoni bizneset të cilat kanë punuar, të cilat s'kanë nevojë për ndihmë.

Ne vazhdimisht kemi thënë kur është bërë rishikimi i buxhetit, kur është bërë votimi i Ligjit të rimëkëmbjes, kur është bërë edhe votimi i buxhetit për këtë vit, kemi thënë, na tregoni se si po doni që t'i shpenzoni këto para. Janë transkriptet, janë incizimet.

Në këtë foltore këtu kam thënë, të nderuar, na tregoni ku po doni t'i çoni këto para, në mënyrë që ta dimë se çka po votojmë. Keni hezituuar, keni refuzuar dhe në fund doli pikërisht ajo që i jemi frikësuar. Që një vendim i tillë do të mbështeste bizneset kanë punuar dhe jo domosdo e kanë pasur nevojën që t'ju ndihmojë shteti.

Pra, kanë marrë barabartë si ai që ka punuar si ai që s'ka punuar. Këtë kritikë e kemi pasur dhe kjo doli të jetë e vërtetë. Pra, u vërtetua tash.

Tash, te shpenzimet. Janë lënë obligime dhe borxhe të papaguar gjithandej, edhe prej qeverive të kaluar, por edhe prej Qeverisë së fundit. Ta zëmë, vetëm te subvencionet në bujqësi, janë lënë fatura të papaguar mbi 10 milionë euro, nëse s'gaboju.



Po besoj, ministri e di më mirë, si është gjendja në ministrinë që e drejton. Por, janë bërë zotime për pagesa, janë nënshkruar kontrata përtej asaj që ka qenë e buxhetuar. Pra, ky është keqpërdorim. Ky është abuzim. Tash, arsyet pse janë bërë, e dinë ata që i kanë bërë.

E kemi parë që në pjesë të tyre që u arrestuan me para me kofere. Kofere e paketa të mbushura me para.

Çështja e shpenzimeve të Kuvendit apo shpenzimeve të sektorit publik, po më vjen mirë që e ngritët e nderuar ministre, edhe çmoj vullnetin edhe do të kisha pasur dëshirë që, ne si Qeveri do ta mbështesim çdo nismë që do të ketë ky Kuvend, në mënyrë që të ketë një zbritje së paku solidare.

Pra, të paktën le të fillojë prej deputetëve. Mund të bashkohemi edhe ne si Qeveri, mund ta caktojmë një prag, një tavan çfarëdo, ta bëjmë një zbritje, në mënyrë që edhe ne të solidarizohemi me qytetarët e tjerë, me sektorin privat. Ku është ajo e mirë. E keni mbështetjen tonë.

S’kam çfarë të them më tepër, përveçse ta ofroj mbështetjen dhe ndihmën tonë në këtë aspekt. Kaq kisha. Ju faleminderit!

**KRYESUESJA:** Zonja Bajrami, replikë dy minuta.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit!

I nderuar ministër,

Është interesant shumë sa ke ndryshuar prej që e ke ndërruar vendin. Para disa muajve unë kam qenë në pozitë, në atë karrigen ku jeni ju, edhe ju keni qenë ulur përballë meje.

Në atë kohë e ke pasur një kritikë, thoshe se Qeveria i ka 1 miliard euro që t’i del në ndihmë sektorit privat dhe nuk po i del në ndihmë.

Tjetra, më lejoni t’ju them që Ligji për rimëkëmbje ekonomike të pëlqeu ose nuk të pëlqeu duhet ta zbatosh. 8 milionë të tarifës së ripërtëritshme KOSTT-i ka hyrë në obligime, sepse është obligim ligjor. Ka qenë në vendimin e 14 janarit, ju e keni shfuqizuar atë vendim.

10 milionë për punëtorët që e kanë humbur vendin e punës më shumë se tre muaj. Edhe grupi ndërinstitucional, e përmendet, që ka qenë formuar edhe e keni shfuqizuar vendimin tani dhe atyre duhet t’u thoni.

Këto do të duhej që t’i kishe në program të fushatës, por më kujtohet një debat televiziv me ty, thoshe, çdo të diplomuar do ta punësojmë. Tash, nuk e ke pasur në program të fushatës që t’i

zbrisni pagat në sektorin publik, po e ke pasur që ta rrisësh punësimin. Ku ke dashur që ta rrisësh punësimin?

Tjetra, më trego me masat e pakos fiskale emergjente, pse po i publikon. Nuk kam kurrjë kundër publikimit, po 0,13% të listës, më trego a është kërkesë e Bashkimit Evropian që të publikohet 0,13% e listës?

Transparenca e juaj 0,13%. Kjo është transparencë. Kjo mund të quhet transparencë. Të njëjtat biznese që kanë përfituar atëherë, të njëjtat biznese kanë përfituar edhe tash. Nuk ka forma. Krejt bota i ka mbështetur bizneset. Nuk ke kriter, nuk mund ta matësh. Ende i ke me mijëra ankesa prej pakos fiskale emergjente.

Ju keni qenë shumë selektiv. A e dini ju që në kabinet më kanë ardhur e-mailat e ish-ministrit të Financave, duke thënë, të mos u jepni paga shkollave private se ata kanë para boll...

**KRYESUESJA:** Zotëri Murati, replikë!

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Mua sinqerisht po më vjen mirë që ministri i Financave, domethënë i kaluari, Besnik Bislimi, paska marrë një vendim të tillë dhe paska pasur një kërkesë të tillë, që ata që kanë pasur fitim të mos subvencionohen. Pra, kështu duhet të jetë. Domethënë, kjo duhet të jetë logjika.

Shteti duhet t'i ndihmojë atij është dëmtuar më shumë, jo të gjithëve barabartë. Këtu e kemi diferencën. Lista edhe për pakon e mëparshme do të publikohet. Dallimi ka qenë pse është publikuar ajo, se siç e thash, është kush ju e dini more. Pikërisht, saktë.

Në të shkruar është kërkuar që lista për 50 top përfituesit të publikohet. S'po di si ta them më qartë. Do t'i publikojmë edhe ato të pakos fiskale emergjente, vetëm se aty qysh tani e dimë të gjithë, që ka pasur kriter, ata që janë dëmtuar, pra kanë pasur dëme financiare dhe çka është subvencionuar aty, domethënë çka përfituar biznesi ka qenë...

**KRYESUESJA:** Tani e ka fjalën Fitim Uka.

**FITIM UKA:** E nderuar kryesuese,

Të nderuar kolegë deputetë,

Faktikisht po konsumojmë sot edhe një debat të çuditshëm këtu në Kuvend, prej konspiracioneve me çipa e usb, deri të kërkesat për mrekuilli.

Më duhet të them për disa kolegë të opozitës që po të mos iu kishim njohur, mbase edhe iu kishim besuar, sepse ka fakte e argumente në atë që po thoni. Mirëpo, kur një gënjeshtër e madhe mbështillet me pak të vërteta, prapë gënjeshtër e madhe mbetet.

Nëse flasim në terma klinik, atëherë është e saktë diagnoza e juaj, por etiologjinë, prejardhjen e sëmundjes nuk po e tregoni. Për shkak edhe të atij qëllimi që ne e dimë. Pra, diagnoza që shëndetësia është e sëmurë është e saktë, mirëpo shëndetësia nuk është sëmurë dje, as më 14 shkurt, por është sëmurë për një kohë të gjatë, kur unë edhe pse e di, ju mbaj në mendje që keni qenë pak më grumbull këtu nga mesi, herë ju në të djathtë e herë ju në të majtë. Keni udhëhequr me Ministrinë e Shëndetësisë. Keni deklaruar që ka prioritet mbi prioritete për shëndetësi, mirëpo tash e 21 vjet...

E di që dhemb. E di që dhemb, por nuk mund ta përdor gjuhen tuaj, zoti Kastrati, po e di që dhemb. E vërteta dhemb. Nëse ka mundësi kryesuesja që ta qetësojë këtë pjesën e vogël të opozitës në të djathtë, do të ishte mirë. A mund të vazhdoj!

KRYESUEJSA: Vazhdoni, zoti Uka.

FITIM UKA: Sot, edhe mund ta mbajnë bajrakun për moralin politik, por e vërteta është që ne ju njohim shumë mirë.

Këtu në këtë sallë ka kryeministra, ministra e ish-ministra të Shëndetësisë, të cilët kanë premtuar mrekulli në sferën e shëndetësisë. Këtu ka ministra të cilët kanë premtuar spitale anti-COVID. Ka kryeministra e ministra që kanë prerë shirita të spitaleve në Podujevë. Këtu janë premtuar vaksinat edhe në shkurt edhe në mars.

Nuk ju kemi dëgjuar që jeni kaq të zëshëm edhe në atë kohë, por nuk na kanë ardhur vaksinat. Përkundrazi, na u patën vonuar edhe vaksinat kundër gripit sezonal, por kjo opozitë s'ka qenë kaq e zhurmshme.

Ne, sot nuk kemi as sigurime shëndetësore. Nuk kemi as sistem të mirëfilltë të informimit shëndetësor. E tash na thoni se kush e ka sjellë këtë gjendje në shëndetësi? Ju edhe shefat tuaj.

Ajo që ka qenë menaxhim i pandemisë më parë, në rastin më të mirë mund të jetë shembull i keq. Pra, çka mund të mësohet prej kësaj Qeverie tani është, si të mos sillemi në raport me pandeminë.

Debati i sotëm mbase, do të kishte pasur kuptim nëse do të diskutoheshin se cilat janë modelet më të mira të daljes prej kësaj situatë. Por, edhe të diskutojmë pse modelet më të mira janë të pamundshme.

U përmend buxheti disa herë, por e di që këtë pjesën e buxhetit e kemi trashëguar dhe mbase nuk mund të përdoret shumë për justifikim, por nëse i referoheni veprimit edhe mosveprimit, a më tregoni se çfarë veprimesh po prisni prej Qeverisë?

Kjo është një lloj situatë në të cilën, kur Gjermania ndërmerri masa për izolim, ju thoni që ato masa janë joefikase. Pra, juve nuk iu pëlqen asnjë lloj mase edhe akuzoni për mosveprim. A janë masat veprim? Janë të tilla për neve, po për juve që i mbyllini sytë, mund edhe të mos jenë.

Janë 12 hapa të suksesshëm që janë të evidentuar tashmë prej hulumtimeve të mirëfillta shkencore, që kanë krahasuar modelet më të mira të menaxhimit të pandemisë në këtë periudhë. Dhe, po jua lexoj vetëm disa prej tyre, rekomandime konkrete; duhen vendime unifikuese për ta luftuar pandeminë.

Për çfarë uniteti mund të flasim në këtu, kur një pjesë e opozitës kërkon masa, e pjesa tjetër na thotë hiqni masat, hiqeni edhe orën policore? Po merruni vesh një herë si opozitë, pastaj hajdeni këtu diskutojmë.

Tjetra, forma më e mirë e luftës në raport me pandeminë thonë që ajo është njëra prej formave, të kemi sigurime shëndetësore. Ku i kemi ato sigurime shëndetësore? Duhet, thotë, një politikbërje e mbështetur në evidencë. Sa herë jua përmendim në evidencën, këtu disa i kap sikleti. Po lexoni more pak, edhe e shihni se cilat janë modelet më të mira. S'kemi nevojë që të shpikim asgjë.

Po kërkohet që këtë debat këtu, ta kufizojmë vetëm në dëshirën e opozitës. Tash, imagjinojeni, ne e dimë që këtë zhurmën që po e bëni, pra është roli i juaj edhe pozita juaj është asisoj që ju jeni opozitë për gjithçka. Tash, nëse Qeveria e mbyll vendin, ju kërkoni që të hapet vendi. Nëse hapet, ju kërkoni që të mbyllet.

Kur blihen vaksinat, ju do të thoni që janë blerë shtrenjtë. Nëse vijnë këtu kryeministri dhe krejt kabineti, ju thoni, çka po lypni këtu, shkoni punoni. Juve kurrë nuk iu rrinë tamam. Kështu që, ne ju njohim shumë mirë. Fatkeqësisht edhe pak të vërteta kur i thoni, në gojën tuaj tingëllojnë gënjeshtër të mëdha.

**KRYESUESJA:** Të nderuara kolege dhe të nderuar kolegë,  
Kam një kërkesë për juve! Duke e marrë parasysh që kemi një numër të deputetëve, po edhe stafit të Kuvendit që janë agjërueshëm dhe po i ofrohemi kohës së iftarit, nëse e kemi mirëkuptimin tuaj dhe pajtohemi të gjithë që ta shtyjmë seancën për nesër në orën 15:00.

Nëse pajtoheni? Urdhëro! Po nuk mund ta detyroj askënd që ta tërheq fjalën, por nëse pajtoheni që ta shtyjmë seancën për nesër. Atëherë, vazhdojmë me seancën nesër në orën 15:00. Faleminderit!

*E martë, 27 prill 2021*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 26 prill 2021*

*Mbledhjen e drejton nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.*

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër Vitia,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar dje, më 26 prill 2021.

Më lejoni t'ju përkujtoj lidhur me rëndësinë e respektimit të masave për mbrojtje nga pandemia COVID-19. Duke u bazuar në manualin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe rekomandimet e IKSHPK-së, përgjatë seancës është i obliguar përdorimi i maskave nga secili.

Para se të procedojmë me pikën e papërfunduar, sot, më 27 prill, është Dita Kombëtare e të Zhdukurve gjatë Luftës në Kosovë, po ashtu është edhe dita e përkujtimit të të rënëve të masakrës së Mejës në komunën e Gjakovës. Kisha lutur të gjithë të pranishmit të mbajmë një minutë heshtje ndaj respektit për të gjitha viktimat.

*(Një minutë heshtje)*

Faleminderit! Lavdi për të gjithë!

Procedojmë me pikën e papërfunduar:

## ***6. Debat parlamentar për gjendjen me pandeminë COVID-19 në Republikën e Kosovës***

Radhën për fjalë e ka Ardian Kastrati.

ARDIAN KASTRATI: Përshëndetje, e nderuar nënkryetare,

Situata për të cilën po diskutojmë në ditën e dytë s'do mend që është tepër serioze dhe shumë kërcënuese për të gjithë qytetarët e Republikë së Kosovës.

Pra, është e qartë që po jetojmë midis ankthit të vdekjes që po kërset nëpër çdo derë të çdo qytetarit të Republikës së Kosovës dhe mbipolarizimi politik, në anën tjetër. E para, po përjetojmë të gjithë si qytetarë, unë në familjen time kam përjetuar në muajin e fundit me dy njerëz, të cilët i mori COVID-i dhe të tjerët të shtrirë në spital aktualisht dhe, në anën tjetër, një paralizim politik, i cili nuk hyn në funksion absolutisht, si të thuash, kontrollit apo hedhjes së përgjegjësisë nga njëri te tjetri për momentin ku gjendemi.

Në situata si kjo, unë mendoj që është thelbësore për ne deputetët të bëjmë një pyetje: sa mund të jemi kontribues për Parlamentin, respektivisht për vetë qytetarin dhe këtu duhet të kontribuojmë që të identifikohet burimi i krizës dhe burimi i zgjidhjes. Burimi i krizës, natyrisht që është Qeveria, kjo, ndoshta e kaluara dhe është edhe ajo para kësaj që një vit, pra prej që ka filluar pandemia.

Kurse burimi i zgjidhjes është vetëm kjo Qeveri aktuale, sepse kjo i ka mekanizmat e instrumentet për ta adresuar këtë çështje si duhet.

Por, në vend që sot përpjekjet tona në themel për të adresuar COVID-in të udhëhiqen nga solidariteti, nga përgjegjësia dhe nga uniteti, në fakt ne e shohim këtë polarizim politik dhe ato argumente të kota që i hidhte edhe ministri i Shëndetësisë, edhe Qeveria juaj.

Pse ndodh kjo? Ndodh, sepse në krye të emergjencave nuk e kemi kryeministrin, në krye të emergjencave duhet të jetë kryeministri dhe kryeministri ishte në krye të tavolinave ku pihej verë dhe alkool nëpër Fier, Laç, nëpër Durrës, për fushatë të Republikës së Shqipërisë.

Tani çështja nuk është pse ishte në Shqipëri, sepse u përmend edhe dje, u përmend edhe nëpër media, po pse është në Shqipëri? Sepse zgjedh të njëjtën strategji që e ka zgjedhur edhe në Kosovë që 15 vjet të shkaktojë kaos politik, sepse është i ndërtuar përmes kaosit politik, sepse është i ndërtuar përmes koncepteve të linçimeve, sepse është i ndërtuar përmes sharjeve, mitralozave verbal dhe gjuhës toksike që e ka mbjellë mes nesh në shoqëri. Por, në Shqipëri nuk i doli ky kalkulim dhe ky formulim. Dhe, pse s'është mes njerëzish që po vdesin. Dje, përderisa keni bërë debat, 11 kanë vdekur, po më duket 11, 8 sot, okej, faleminderit.

Nuk është mes njerëzish, sepse ai nuk e ka hallin e njerëzve. Ne që e njohim atë që 20 vjet, e sidomos unë që kam punuar nja dy vjet, '97 - '99, ai kurrë hallin e njerëzve nuk e ka pasur. Njerëzit për të janë njerëz kur i duhen për vota, në momentin kur i japin votat, nëse njerëzit kanë nevojë për të, ai i lë të vdesin, siç i ka lënë të vdesin dje e pardje e që dy javë ditë, marrja e Zotit, duke u sjellë me gota të verës e me alkool nëpër Fier, nëpër Laç e nëpër Durrës.

Po tani nuk është vetëm kryeministri që do të jetë në krye të emergjencave, po në fakt, do të jetë edhe Qeveria dhe ku është Qeveria. Këtu tërë ditën dje kemi folur për vaksinën, të gjithë e dimë që vaksina do të vijë, vaksina vjen ose përmes donatorëve ndërkombëtarë ose përmes buxhetit që do ta kontraktujmë me kompanitë ndërkombëtare, por çështja është koha, 11 dje, 8 sot dhe ku di unë sa nesër dhe pasnesër, çdo ditë vdekje. Prandaj, nuk është vetëm vaksina, por janë në pyetje edhe mekanizma, instrumente të tjerë, protokolle të tjera të Ministrisë së Shëndetësisë që duhet të aktivizoheshin për të preventuar vdekjen e njerëzve. Dhe, cilat janë ato?

Nuk ka terapi, nuk ka terapi në Infektive, nuk ka terapi në Sportive, aty ku unë vetë e kam përjetuar përmes familjarëve të mi dhe duhet blerë dhe, ashtu siç tha doktor Dreshaj, të kushton një trajtim deri në 3.000 euro, aty dje ose pardje vdiq një 30-vjeçar në mungesë të buxhetit për të paguar terapinë dhe këto do të ishin çështje që duhej adresuar zoti Vitia dje dhe jo të flasë vetëm për vaksinën, sepse vaksina vjen, po derisa të vijë vaksina, sa njerëz po vdesin, fakti që ai nuk ka qenë këtu dje, sot e ka bërë prioritet numër një atë dialogun, tregon që s'e ke hallin te njerëzit.

Pra, po e përsëris, s'e ka hallin, vetëm kur është çështja te votat dhe kur njerëzit kanë nevojë për të, ai i lë të vdesin. Çka tregon kjo? Kjo tregon që ju keni krizë të legjitimitetit. A e dini pse qeshni, sepse jeni produkt i Albinit dhe nuk e kuptoni konceptin e legjitimitetit. Ta shpjegoj, veç pak, qetësohu. Logjike nuk është fare të jeni adoleshentë shumica prej juve dhe njerëz të eksperimenteve në pushtet...

KRYESUESJA: Zoti Kastrati, kthehu në temë, të lutem.

ARDIAN KASTRATI: Nuk është as patriotike, po fatkeqësisht në vullgaritetin e disa prej juve, Albini është konformist, sepse kështu dini veç të qeshni.

Krizë e legjitimitetit ne i themi jo vetëm numrave, por edhe produktivitetit të punës, efikasitetit dhe rezultatet e punës.

KRYESUESJA: Zoti Kastrati, të lutem, kthehu në temë!

ARDIAN KASTRATI: Kjo është krizë e legjitimitetit të shumicës, sepse po ju vdesin çdo ditë nga 11, nga 8, nga 10. Ju jeni të vetmit njerëz që ju kanë parë dje duke bërë duartrokitje kur këtu diskutohej për 11 viktimat, 11 njerëz ju kanë vdekur. Ju përmes atij aplauzi, unë nuk e kuptoj çka keni bërë. Do të thotë, ju doni t'i ndani tash viktimat e COVID-it edhe në PDK me përqindje, LDK dhe Vetëvendosje, apo si është puna.

Pra, ju po pyetni, pyetni edhe votuesit tuaj sa kanë vdekur dje, kjo ka qenë pasqyra juaj më e mirë, e cila tregon tash çështje tjetër, pra po e përsëris, legjitimiteti nuk është i votave, legjitimiteti është në efikasitet të punës, me rezultat të punës dhe me produktivitet politik, asnjëra nga këto, zero. Çdo ditë dhjetëra të vdekur për mungesë terapie, leni vaksinat anash, do të vijnë vaksinat, leni anash, terapia, ku është terapia.

Pra, çka tregon kjo? Kjo tregon që tash përveç atij bosit tuaj, që është me verë edhe me alkool për Fier e Laç e nëpër Durrës e gjithkrah dhe nuk është këtu kur vdesin njerëzit.

Në fakt, kjo Qeveri e ka edhe problemin tjetër, është komplet e paaftë të menaxhojë situata kritike, siç është kjo, e situata sikur kjo do të ketë sa të duash gjatë mandatit tuaj. A e dinë pse, ju

e kuptoni pushtetin vetëm për kamera e mikrofon, jo pushteti është për sfida dhe kjo është sfidë, harroni kamerën e mikrofonin.

Dje këtu dëgjova dikë që tha 30% ka ulje të vdekjeve, 11 dje, 8 sot, pyetni kë të doni, sot nuk ka një prej nesh këtu që nuk e njih dikë që s'i ka vdekur prej COVID-it e që nuk është i rrezikuar, do të thotë kjo për mua është një hipokrizi e pakonkurrueshme. Kjo i ka dy shpjegime ose vërtet dikush prej juve beson që lideri juaj suprem mund ta pezullojë edhe pandeminë me ndonjë fuqi, kështu mbinatyrore, ose ju me të vërtetë keni shpikur vaksinë dhe jeni shumë komod dhe do ta keni nesër në tavolinë për të gjithë neve.

Dëgjo, ti zotëri, ti munde të më vaksinosh mua, problemi është që, po e di çka po dua të them unë, bravo, e kuptove.

Pra, unë e them edhe një herë, me këtë lloj vullgariteti, ai shefi juaj politik ndihet shumë konformist, sepse kjo është çka dini të bëni. 11 të vdekur dje, 8 sot dhe përderisa flasim ne, ju vazhdoni të qeshni, vazhdoni të duartrokisni, të merreni me statistika dhe shefi juaj politik e shndërron dialogun në prioritet një, nga prioriteti tetë që e ka pasur.

Unë nuk di nëse kjo është serioze, po unë seriozisht juve ju marr seriozisht vetëm kur jeni joseriozë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Para se të vazhdojmë, lus secilin person që është përbrenda sallës së Kuvendit ta vendosë maskën. Fjalën e ka Albana Bytyqi.

ALBANA BYTYQI: Faleminderit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Duke e ditur që tashmë po bëhet një vit i plotë që kur në Kosovë kemi pasur raste të shumta dhe viktimat e para nga COVID-19, e që tashmë kemi raste shumë të mëdha ditore dhe vdekje, më së paku është dashur edhe një mbyllje e tillë që e përkeqësoi ekonominë, rritjen e shkallës së papunësisë dhe asnjë ndryshim nuk solli, përveç atyre negative.

E më e keqja, disa ministra e deputetë të kësaj Qeveri, të kabinetit tuaj, kryeministër, në kohën kur u morën masat e mbylljes në Kosovë, ata u gjendën në Shqipëri në fushatën zgjedhore. Marrja me zgjedhjen në Shqipëri nga ana e kryeministrit dhe ministrave të tij duhet të ndalet dhe ishte shumë papjekuri nga ana juaj, derisa në Kosovë kishte mbyllje totale.

Ato 10 ditë e keqësuan edhe më shumë gjendjen ekonomike në vend dhe fatmirësisht u pa që nuk ka ndonjë dobi nga ajo dhe ndërruan masat pak, por e gjithë kjo nuk mjafton, duhet të sigurohen



vaksina të reja, sepse me këtë ritëm po shkon shumë ngadalë dhe janë shumë pak ata që janë vaksinuar.

I tërë rajoni është para nesh. Të mos flasim për Serbinë që ka nisur të bëjë edhe turizëm shëndetësor, e ku oferta brenda saj ka edhe vaksinën Pfaizer. Andaj, te ne ka kaluar kjo gjë në ankth tashmë, duke parë që çdo ditë po vdesin edhe të rinj.

Deri tani nuk po shohim asnjë angazhim serioz në këtë drejtim, asnjë lëvizje sa i përket sigurimit të vaksinave të reja, po ashtu në Kosovë nuk po arrihet të sigurohet asnjë vaksinë tjetër përveç kësaj që në shumë vende edhe është ndaluar.

Koha e paraparë për arritjen e dozës tjetër dhe vaksinave Astra Zeneca është goxha e largët dhe kjo do të ndikojë shumë në ekonominë e vendit dhe po ashtu në qarkullimin e qytetarëve në vendet e tjera.

Prandaj, kryeministër, duhet të orientoheni fokusin kryesor drejt menaxhimit të vendit nga COVID-19, sigurimit të vaksinave, rimëkëmbjes ekonomike të vendit, e jo të kaloni kohën më të madhe në kapjen e shtetit me mençuri, ngadalë dhe sigurt, duke filluar nga pikat më të larta, nga bordet më të rëndësishme, e besa duke u munduar në kontrollimin e medias dhe mohimin e fjalës së lirë të tyre.

E gjithë ajo çka na intereson neve qytetarëve të Kosovës është vendi ynë dhe kalimi i kësaj pandemie, sigurimin e mirëqenies dhe vaksinën për COVID.

Ju kisha lutur, meqenëse zgjedhjet i rehatuat në Shqipëri dhe dhatë votën tuaj, të ktheni koncentrimin kah vendi ku ju bëri kryeministër dhe keni përgjegjësi. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Fjalën e ka deputetja Jeta Statovci.

**JETA STATOVCI:** E nderuar kryesuese,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dhe të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Përballja me pandeminë, pra përballjet edhe me pasoja direkte e indirekte, të cilat lënë pasojë si në aspektin shëndetësor, gjithashtu në ekonomik, mirëpo edhe në dimensione të tjera.

Pasi u përmendën masat, pra ne duhet të kemi parasysh që masat kanë për qëllim mbrojtjen e shëndetit qytetar, mirëpo gjithashtu dhe funksionimin e një sistemi shëndetësor, në mënyrë që institucionet shëndetësore të kenë mundësi që të abservojnë kapacitetet e pacientëve të rinj.

Është evidente që pas marrjes së mandatit nga ministri Vitia, kemi një trend në rënie në raport me persona të cilët janë pozitivë me COVID. Për shembull, me 827 raste më 22 mars, trendi bie në 154 raste dje. Pra, kjo nënkupton që kemi një rënie mes këtyre datave për 81%. Dje u përmendën gjithashtu dhe fakte se kjo mund të jetë edhe si pasojë e numrit të testeve, të cilat po realizohen.

Mirëpo, nëse i krahasojmë datat prej 4 marsit kur kishim 3 600 teste, pra kishim 781 raste. Kurse, krahasojmë datën 24 prill, pra një muaj diferencë me 3 300 teste, kemi 335 raste që nënkupton në një afat prej një muaj kemi një rënie të rasteve pozitive për 57%.

Këto janë indikacione që masat, të cilat faktikisht u vendosën në fuqi, kanë treguar një rezultat në rënie, pra të trendit pozitiv. Mirëpo, deklaratat që u thanë nga ministri Vitia dje ishin shumë shpresëdhënëse në raport me sigurimin e vaksinave dhe këto janë lajme shumë pozitive, por ne duhet të kemi parasysh edhe faktin që negociatat për vaksinat krijohen edhe realizohen në rrethana shumë specifike, të cilat shpeshherë pamundësojnë të jemi shumë të hapur dhe transparent në lidhje me kontekstin që diskutohet dhe realizohet. Mirëpo, nga sa kemi informata, pra kemi konfirmimin nga Presidentja e Komisionit Evropian për 95 mijë doza, gjithashtu kemi bërë dhe eliminimin e të gjitha pengesave administrative që mundëson faktikisht kontraktimin e vaksinave që mund të vijnë në Kosovë.

Pasi kishim edhe zotimet publike që faktikisht këto vakcina në një periudhë kohore të shkurtër do të kemi lajme pozitive në raport me këtë aspekt, ne mund të themi që jemi shumë më mirë të orientuar në drejtimin që e kemi marrë në trajtimin e këtij rasti, mirëpo pasi që po ngrihen edhe diskutime në raport me pacientët që po vdesin, edhe kjo si pasojë e medikamenteve dhe barnave, më lejoni të theksoj që po këtu kemi miratuar një projektligj, i cili ka bërë shkurtimin e buxhetit për Listën esenciale në kujdesin primar dhe programet specifike nga 11.4 milionë euro në 5.5 milionë euro dhe kjo faktikisht ka minuar skajshmërisht nivelin e furnizimit me barna në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe nga ajo që është raportuar, kemi diku rreth 12% të nivelit të furnizimit të deklaruar, që është një prej përqindjeve më të ulëta që nga periudha e pasluftës.

E, një anomali që faktikisht e hasim nga këto përqindje në raport me furnizimin me barna janë projektet kapitale dhe investimet kapitale. Pra, kemi një sërë projektesh kapitale, të cilat janë miratuar dhe marrë me vendim, kurse në anën tjetër, raportet ndërkombëtare tregojnë se diku 15 objekte të nivelit parësor janë tërësisht të pashfrytëzueshme, sepse mungesat qëndrojnë po te kuadri profesionist dhe shpeshherë edhe te medikamentet, e jo faktikisht te objektet e përgjithshme. Andaj, mendoj që ne nëse ndajmë këtë brengë në raport me furnizimin edhe funksionimin normal brenda institucioneve shëndetësore, në procesin e rishikimit duhet të marrim me shumë prioritet kthimin e buxhetit për furnizimin me barna dhe medikamente deri në një proces, kur të marrim konfirmim për ardhjen e vaksinave. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Tani fjalën e ka, Floretë Zejnullahu!

FLORETË ZEJNULLAHU: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kosova vazhdon të jetë vendi i vetëm në botë që ka qeveri pa program qeverisës. Albin Kurti dhe qeveria e tij ndër veprimet e para që mori ishin masa pa asnjë plan, madje pak kush ka mundur të kuptojë arsyen dhe efektin e këtyre masave, masa ato që vetëm thelluan dëmin ekonomik ndaj bizneseve dhe punëtorëve.

Ishte ky një vit shumë i rëndë për shëndetësinë dhe personelin shëndetësor, gjithashtu një vit i rëndë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Askush nuk mund t'i vërë faj qeverisë për shpërthimin e pandemisë, por Albin Kurti dhe qeveria e tij kanë dy përgjegjësi të mëdha: mënyrën se si janë duke menaxhuar situatën dhe, e dyta, mosnxjerrjen e mësimeve për atë që duhet bërë. Është e pafalshme që kjo gjendje abnormale trajtohet nga qeveria krejtësisht si një gjendje normale. Mjekët, infermierët dhe i gjithë personeli shëndetësor, përfshirë këtu edhe farmacistët, ndonëse në vijën e parë të frontit në përballje me pandeminë, nuk po marrin përkrahjen e merituar nga kjo qeveri pa program qeverisës.

Kjo qeveri ka lënë të vetëm si personelin shëndetësor, ashtu edhe pacientët në këtë betejë të vështirë. Sot, dua të fokusohem e të flas më shumë për një profesion, atë të farmacistit, i cili është partner i rëndësishëm në mbrojtjen e shëndetit të pacientëve, shëndetit tonë si qytetarë. Roli thelbësor i farmacistëve është i jashtëzakonshëm në sistemin shëndetësor. Ky rol vihet në pah nga ndikimi i tij jo vetëm në rrethana normale, por sidomos në kushtet e jashtëzakonshme si këto të pandemisë. Pacientët u besojnë farmacistëve shumë më tepër se sa mendohet, njerëzit u besojnë farmacistëve dhe i vlerësojnë si partnerë në mbrojtjen e shëndetit të tyre, por jo edhe Ministria e Shëndetësisë, respektivisht Qeveria e Kosovës.

Është e pashpjegueshme dhe krejt e papranueshme që një situatë të tillë pandemie farmacistët të mos i shohësh si personel me rrezik të lartë karshi virusit COVID-19, krahas kolegëve të tjerë punonjës të shëndetësisë, mjekë dhe infermierë. Në Kosovë janë rreth 1 mijë e 300 farmacistë të regjistruar në Odën e Farmacistëve të Kosovës, e 650 janë në kontakt direkt me virusin. Krahas këtyre farmacistëve, kemi edhe teknikët e farmacisë, të cilët janë në ballë të luftës kundër pandemisë çdo ditë. Për 12 muaj përballje me pandeminë, farmacistët në Kosovë në sektorin publik dhe atë privat për asnjë moment nuk patën mbështetjen e shtetit, sikurse mantelbardhët e tjerë gjatë kësaj kohe të vështirë. Kjo kategori e profesionistëve shëndetësorë duhet të mbrohet. Të shumtë janë farmacistët e infektuar në vendin e punës, mes tyre pati edhe nga ata, të cilët e humbën betejën me COVID-19. Është e vërtetë që farmacistët janë hallka e fundit e kontrollit para se pacienti të marrë barin, dora e fundit e lëshimeve të paqëllimshme që mund të ndodhin nga ana e mjekëve dhe dora e fundit e dhënies së kurajës dhe ndihmës, dora e fundit e dhënies së

buzëqeshjes dhe urimit për shërim, por kjo nuk nënkupton që farmacistët të mbesin të fundit që do të vaksinohen.

Ministri i Shëndetësisë sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me vaksinimin e profesionistëve shëndetësorë, ku edhe farmacistët bëjnë pjesë, duhet të vaksinohen në mënyrë që edhe ata të jenë të mbrojtur për të vazhduar ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe moscenimin e furnizimit të vazhdueshëm me barna dhe pajisje mjekësore për qytetarët. Ministria e Shëndetësisë duhet të bashkëpunojë me Odën e Farmacistëve, me Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, ku përfshihen edhe spitalet rajonale dhe komunat e Kosovës, në mënyrë që të gjithë farmacistët të përfshihen sa më parë në listën për vaksinim. Shpresoj që sa më parë të vijë edhe sasi të tjera të vaksinave dhe që sa më parë qytetarët e Kosovës, duke përfshirë edhe farmacistët, të kenë mbrojtje nga COVID-i.

Premtimet publike të Albin Kurtit se do të marrin veprime për të realizuar vaksinimin e 60% të popullatës janë thjesht pretime boshe dhe, për fat të keq, koston po e paguajnë edhe qytetarët. Albin Kurti dhe ministri i Shëndetësisë nuk duan që qytetarët të vaksinohen, madje nga raportimet e fundit që dolën në media, del se ka refuzuar të nënshkruajë edhe kontratën, e cila do t'i siguronte vendit tonë 500 mijë doza vaksina Pfizer. Vaksina nuk është luks e as sigurimi i saj ndonjë arritje shumë e madhe, ajo është nevojë për të siguruar jetën e qytetarëve. Krahas sigurimit të vaksinave, gjithashtu Qeveria duhet të zbatojë rimëkëmbjen ekonomike dhe kështu të stimulohen profesionistët shëndetësorë me pagë shtesë prej 300 eurosh. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Fjalën tani e ka Bekë Berisha.

**BEKË BERISHA:** Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot kur po diskutojmë për këto dy tema kaq të rëndësishme, siç janë gjendja me pandeminë e shkaktuar nga virusi korona, nga njëra anë dhe, në anën tjetër, situata e rënduar ekonomike si pasojë e pandemisë që u shfaq në vendin tonë më shumë se një vit më parë, me bindje të plotë mund të them që situata dita-ditës është duke u rënduar dhe ka tendencë të dalë totalisht nga kontrolli.

Sot, kur po flasim për çështjen e pandemisë do të duhej që së paku 50% e popullatës së Kosovës të ishte e vaksinuar, mirëpo kjo nuk ka ndodhur. Që nga 22 marsi 2021, kur ky Kuvend ka votuar dhe ka zgjedhur ekzekutivin e vendit, nga ana e Qeverisë Kurti nuk kemi vërejtur as më të voglën përpjekje serioze për të siguruar furnizimin stabil me vaksina kundër virusit korona dhe këtu sado pak të ofrojnë një lloj sigurie se edhe vendi ynë do të shkojë drejt normalitetit. Mirëpo, të nderuar deputetë, siç e dimë të gjithë ne, edhe opinioni i gjerë publik, ka ndodhur e kundërta e asaj që do të duhej të ndodhte. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, në vend se të angazhohej me

tërë qenien e tij dhe të kabinetit të tij për furnizim me vakcina, ai gjen kohë të merret me inate politike dhe kështu të mos i pranojë rezultatet që u arritën nga qeveria e kaluar.

Pra, ministër Vitia nuk pranoi të firmosë kontratën për blerjen e vaksinave në një afat sa më të shkurtër kohor, me këtë rast ai veprimi çuditshëm e befasishëm. Në orët e mbrëmjes së datës 16 prill me urgjencë ftoi mediat në një konferencë të jashtëzakonshme, por këtë konferencë nuk që në gjendje të japë lajmin e mirë për qytetarët e Republikës së Kosovës, pra se është siguruar një numër i konsideruar i vaksinave, mirëpo filloi të akuzonte, do të thotë përndjekja, persekutimi, fajësimi apo luftimi i mediave. Ministër, është shumë gabim në këtë situatë.

Siç dihet, më 15 prill, ministri Arben Vitia është dashur të nënshkruajë kontratën me kompaninë amerikane për furnizim me vakcina, këtë nuk e ka bërë dhe, si pasojë e neglizhencës së tij për t'i kthyer përgjigje kompanisë Pfizer dhe Biotech, furnizimi me 500 mijë doza vaksinash nga një kompani është shtyrë së paku deri në muajin shtator, e me gjasë reale do të dështojë si proces. Këtë e kemi folur edhe më parë, i kam dëgjuar edhe opinionet e ministrit, ti ke thënë që do të japë dorëheqje në qoftë se argumentohet kjo, mirëpo, ministër, nuk e di a mjafton nëse argumentohet që ti për ku të dihet për çka nuk i ke nënshkruar ato vakcina.

Siç e dimë, Kosova është ndër vendet e rralla në botë që ka përqindje kaq të ulët të popullsisë së vaksinuar. Sipas raportimeve zyrtare, as 50% e personelit mjekësor nuk është vaksinuar apo nuk ka pranuar të bëjë një gjë të tillë, e të mos flasim për shtresat e gjera të popullsisë që janë shumë larg realizimit të këtij procesi. Furnizimi me ilaçe nëpër spitalet tona është skandaloz. Të prekurit me virusin korona nga xhepat e tyre vazhdojnë të blejnë ilaçet e nevojshme dhe me kosto vështirë të përballueshme. Ekzistimi i terapive të nevojshme për trajtimin e sëmundjes në spitalet tona publike vazhdon të mbetet vetëm një ëndërr, por kurrsesi realitet deri më sot.

Ministër Vitia, ju dhe partia juaj gjatë fushatës zgjedhore pak më shumë se para dy muajsh patët drejtuar akuza të rënda në drejtim të qeverisë paraprake për keqmenaxhim në sistemin shëndetësor, për trajtim jo të duhur dhe joprofesional të pacientëve të prekur me virusin korona, gjithandëj qendrave spitalore të Kosovës, e që për rrjedhojë ka ardhur deri te rritja e numrit të vdekjeve. Ju fuqishëm patët premtuar se qysh në muajin e parë të qeverisjes suaj kjo qasje do të ndryshojë rrënjësisht, por nga ajo që po shohim deri më tani, rezultatet tuaja nuk janë as të përafërta me ato që i keni premtuar qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ju patët premtuar se në gjashtëmuajorin e qeverisjes suaj së paku 50% e qytetarëve të Kosovës do të kenë qasje dhe mundësi për vaksinim, por tani ku janë bërë 1 muaj nga qeverisja juaj, as 1% e popullsisë së Kosovës nuk është vaksinuar, kjo zoti ministër, është tragjedi për popullin e Kosovës, mbase për juve mund të jetë edhe ironi, sepse ironia nuk është ndryshe, përveçse moskryerje e detyrave me të cilat je i ngarkuar dhe rrjedhimisht edhe tallje me vullnetin e popullit të Kosovës. Për më tepër, shpresat për të dalë nga kjo gjendje janë tepër të venitura, për

shkak të mosseriozitetit dhe mospërkushtimit tuaj në kryerjen e detyrave dhe obligimeve që keni si qeveri e vendit. Unë e kam edhe një pyetje këtu, mirëpo që ajo e para për shkak të nënshkrimit të kontratës, e ke dhënë dje përgjigjen.

Të nderuar deputetë, ashtu siç është gjendje tepër e rëndë me pandeminë, aspak më e mirë nuk jemi as me ekonominë e vendit tonë. Krejt çka ka ndërmarrë Qeveria Kurti deri më tani është shkarkimi dhe ngarkimi i bordeve të ndryshme, pa asnjë analizë paraprake rreth punës dhe performansës së tyre, thjesht për shfryrje të mllëveve politike e për plotësim të apetiteve të militantëve politikë të Vetëvendosjes dhe satelitëve të saj. Masat restriktive kundër pandemisë të ndërmarra nga qeveria nga data 7 deri më 19 prill, siç u dëshmuar, nuk dhanë asnjë efekt pozitiv në përmirësimin e gjendjes me pandeminë. T’ju them të drejtën, kjo ishte shumë e pritshme, sepse ishin këto masa të paanalizuara profesionalisht, ishin masa vetëm sa për sy e faqe, pra formalitet koti. E them këtë, përderisa të gjithë kufijtë tokësorë dhe ajrorë të Kosovës ishin hapur dhe qytetarët tanë lirshëm mund të udhëtonin qoftë në drejtim të vendeve fqinje apo më larg.

Prandaj, me këtë ata përpos që shpenzime të caktuara realizonin në vende jashtë Kosovës, pra paraja dilte jashtë tregut tonë, ekzistonte edhe rreziku i importimit të virusit, pra i shtimit të numrit të të infektuarve. Pra, me të drejtë mund të pyesim si mund të quhen këto masa kur qysh në fillim dihej se nuk mund të jepnin asnjë rezultat. Këto mund të quhen kotësira, por siç populli, “kur s’ke çka bën, lëvizte derën”, prandaj Qeveria Kurti me masat e fundit veç e ka lëvizur derën, asgjë më shumë. Numri i personave të infektuar janë ata që ka qenë 2-3 javë më parë, ajo që ka ndryshuar është vetëm numri më i vogël i testeve dhe kjo sipas gjasave është bërë me porosi të dikujt nga pushteti dhe humbjen milionëshe në ekonominë e Kosovës.

Kur jemi te masat konkrete financiare që ka ndërmarrë qeveria për kompensimin e dëmeve nga mbyllja e famshme 12-ditore, sidomos dëmet milionëshe që janë shkaktuar në sektorin e gastronomisë dhe sektorë të tjerë, qeveria ka marrë vendim t’i kompensojë pagat e punëtorëve dhe të qirave të këtyre bizneseve në vlerë deri në 50%. Kjo i bie që një punonjës në sektorin e gastronomisë për këto 12 ditë të mbylljes si kompensim të pagës së tij maksimalisht mund të marrë 85 euro, gjithnjë referuar shkallës së pagës minimale në Kosovë, ashtu siç parashihet me ligj dhe me vendim. Merre me mend, se si dhe sa mund të ushqehet një familje kosovare me 85 euro për 12 ditë me radhë, assesi. Bile, kjo s’është e mundshme as në kohën e Migjenit. Një shtresë tjetër tepër e ndjeshme dhe tepër e nevojshme për t’u përkrahur në çdo aspekt janë edhe pensionistët. Qeveria Kurti në mbledhjen e ditës së enjte të datës 21 prill 2021 ka marrë vendim që të rrisë vlerën e pensioneve bazë për tre muajt e ardhshëm për të larguar shtesën prej 30 eurosh që ishte vendosur nga qeveria paraprake. Pra, qeveria aktuale jo që nuk i ka ngritur pensionet, por i ka ulur ato për 20 euro, ky është realiteti.

Nga ana tjetër, qeveria ka vazhduar subvencionimin apo shtesat në paga për personelin shëndetësor dhe policinë, që kjo është e mirë, mirëpo ka thelluar kështu edhe më shumë

hendekun social midis shtresave të ndryshme të popullit të Kosovës. Ajo që është më ironike, sipas mendimit tim, është deklarimi i qeverisë, saktësisht e ministrit Murati, kur tha se masat për rimëkëmbje ekonomike do të ndërmerren pas përfundimit të pandemisë. Për mua kjo qasje e qeverisë është totalisht e gabuar dhe e pakuptim, sepse sipas trendeve globale, pandemia sipas gjasave do të jetë prezente edhe për një kohë, ndoshta edhe me vite. Prandaj, zoti Murati, deri kur duhet të presin qytetarët tanë që të ndjejnë sadopak dorën e ndihmës nga shteti? Pra, ministër Murati, sipas teje, cili është ky afat, kur ju si qeveri keni vendosur të fitoni betejën me virusin korona, ta ktheni vëmendjen kah rimëkëmbja ekonomike dhe financat e parapara sipas Ligjit kundër pandemisë të jenë në funksion të mirëqenies dhe të qytetarëve tanë. Uroj që kjo të ndodhë shpejt, por me politika dhe qasjen e Qeverisë Kurti, kjo qeveri...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESJA:** Ministri Vitia, fjalën!

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Faleminderit, zonja Bogujevci!

Faleminderit deputetë të nderuar,

I nderuar zoti Berisha,

Unë nuk kam thënë dje se do të jap dorëheqje, dorëheqja është akti më i lehtë në atë që kam thënë dje. Unë kam thënë se do të bart përgjegjësi ligjore, penale, morale deri në dorëheqje. Domethënë, dorëheqja është akti më i lehtë që mund ta bëj, ajo nuk më lan nga kurrëgjë. Unë prapë po e them, me përgjegjësi të plotë, nëse kam refuzuar të nënshkruaj diçka siç pretendoni ju dhe disa nga deputetët e nderuar paraprakisht, unë do të jap përgjegjësi penale, juridike, morale, çfarëdo përgjegjësie që mund të më ngarkohet, do ta mbaj pa asnjë problem.

Në anën tjetër, zoti Berisha, sinqerisht të thuash se është dashur të vaksinohen për 30 ditë 15% e popullatës kur nuk kemi gjetur asnjë vaksinë, e disa prej negociatave nuk kanë qenë në dinamikën e duhur, faleminderit që shpresoni kaq shumë në neve, por në këtë edhe po të kishte qenë dikush, ndoshta supermen, nuk do të mund ta organizonte. Për 30 ditë 15% të vaksinohet popullata pa pasur asnjë vaksinë kur kemi hyrë në më datë 23 mars, është jashtë çdo pritjeje dhe jashtë normales.

Në anën tjetër, vetëm t'ua rikujtoj, në asnjë moment të vetëm, as gjatë fushatës, ne nuk kemi thënë "për gjashtë muaj", kemi thënë "deri në fund të vitit" dhe atë ua garantoj, edhe juve, edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, se kur të vijë vaksinat e që do të vijë shpejt, ajo do të bëhet deri në fund të vitit, 60% e popullatës grupmoshat të cilat duhet të vaksinohen sipas standardeve të OBSH-së, kjo do të bëhet.

Zonja Zejnullahu, jam plotësisht dakord për rolin e farmacistëve. Ka qenë një rol i jashtëzakonshëm gjatë gjithë kësaj kohe, përveç tjerash që i kanë kontribuar dhe po vazhdojnë t'i

kontribuojnë jashtëzakonisht shumë sistemit tonë shëndetësor. Jam shumë dakord që duhet bërë dhe do të bëjmë më shumë për ta, mirëpo unë e kam gjetur një plan të vaksinimit, të cilin derisa Komiteti i Vaksinimit të sjellë një përditësim të këtij plani unë do të jem me këtë plan deri në fund dhe do ta zbatoj në mënyrën më korrekte të mundshme, pavarësisht edhe vërejtjeve të cilat i kam.

Në anën tjetër, bashkëpunimi me Odën e Farmacistëve është i jashtëzakonshëm. Shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë farmacistët dhe Odën e Farmacistëve dhe vetëm për t'ua rikujtuar, Oda e Farmacistëve tani na ka ndihmuar që të bëjmë edhe ndryshmet në kornizën ligjore për mundësinë e importit të vaksinave, duke e rregulluar ashtu si duhet Udhëzimin Administrativ, i cili mundëson ardhjen e këtyre vaksinave në Republikën e Kosovës.

Zoti Kastrati, po, jam shumë koshient që nuk ka barna dhe nuk ka pasur barna mjaftueshëm, prandaj edhe në fjalën time dje e kam potencuar, se bashkë me Ministrinë e Financave dhe me projektin e Bankës Botërore të huamarrjes për shëndetësinë, ne jemi duke punuar për të sanuar këto probleme që vështirësojnë tepër punën e profesionistëve shëndetësor, sidomos në kujdesin parësor shëndetësor nëpër komuna dhe rrezikojnë seriozisht efektshmërinë e tyre. Domethënë, për këto tridhjetë ditë bashkë me shumë faktorë, me ministri të linjës, sidomos me atë të Financave, por edhe me miqtë tanë, jemi në rrugë të mirë që ta anashkalojmë dhe ta sanojmë edhe këtë problematikë.

Dhe për fund, dëshiroj t'i garantoj qytetarët, pavarësisht atë se disa qeveri çfarë kanë bërë, vakcina Astra Zeneca deri tani është treguar e sigurt dhe nuk ka asnjë lloj dyshimi për ta marrë vaksinën Astra Zeneca. Çdo dyshim i ngritur këtu apo kudo tjetër më besoni se nuk është mirë të ngritet, sepse nuk ka asnjë studim i cili thotë që Astra Zeneca është vaksinë që nuk duhet të përdoret. Mbi të gjitha, Organizata Botërore e Shëndetësisë akoma nuk e ka ndaluar vaksinën Astra Zeneca që të merret kudo në Botë. Edhe ne ashtu do ta marrim, sepse nuk kemi asnjë efekt serioz nga vakcina Astra Zeneca për 24 mijë doza të cilat janë marrë.

Faleminderit!

**KRYESUESJA: Replikë, Bekë Berisha.**

**BEKË BERISHA: Zoti ministër,**

Qeveria pati vendosur ato masat 12-ditore e që kjo ka qenë me kërkesën tënde, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme për Pandeminë. Po ashtu, keni vendosur orë policore. Ora policore është në funksion ende. Pse nuk e keni mbaruar këtë proces, sepse policët rrinë nga 12 ore, rrinë pas orarit, përndryshe krimi, rrahjet, therjet me thikë edhe vrasjet janë shtuar, ndërkohë që ne kemi orë policore e ora policore është veç para lufte qitet. Do të thotë, nuk ndihmon kurrëgjë në këto shëndetësore apo në luftimin për Pandeminë. Pse nuk e hiqni që tani, sepse ata policë janë të



lodhur edhe s'po mund t'i kryejnë as punët që ishte dashur t'i kryejnë, t'i ndalin këto therje e krime që po ndodhin.

Mendoj që kjo është e panevojshme dhe ishte dashur të mos maltretohen më ata policë.

KRYESUESJA: Urdhëro, zoti Vitia.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, zoti Berisha!

Të gjitha masat që merren në Ministrinë e Shëndetësisë janë masa që diskutohen shumë me shumë aktorë dhe natyrisht në bazë të rekomandimeve nga profesionistët dhe ekspertët e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

T'ua rikujtoj edhe një herë atë që e thash dje. Kërkesa për masa më rigorozë nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik janë bërë që në muajin nëntor të vitit 2020. Këto masa kur jemi ulur dhe i kemi diskutuar e analizuar, i kemi analizuar nga çdo perspektivë. Sa i përket efektshmërisë së tyre, i keni parë edhe statistikat, javën e kaluar janë me dhjetëra raste fatale më pak dhe me qindra raste më pak të hospitalizimeve. Domethënë, masat kanë dhënë efektin e tyre. Sistemi shëndetësor, spitalet tona në këtë javë që po flasim dhe në javën e kaluar kanë marrë frymë lirisht më mirë sesa një javë më herët.

Në anën tjetër, ju atë që po e ngrehni sa i përket pjesës operacionale çdo vendim që e kemi marrë në fund jemi konsultuar edhe me Policinë e Republikës së Kosovës, që në aspektin operacional sa janë të zbatueshme këto masa. Atë që më kanë thënë nga Policia nuk është ajo që po e thoni ju, është shumë më e lehtë, përveç pjesës shëndetësore, përveç pjesës së ndalimit të grumbullimit si kategorive si super-shpërndarës, siç është gastronomia edhe në aspektin operacional nga Policia kam marrë përgjigje që është shumë më lehtë të mbikëqyren masat me orë policore, siç e thoni ju, ndalimin e lëvizjes pas orës 22:30 sesa pa këtë kufizim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Vendenis Lahu e ka radhën tani.

VENDENIS LAHU: Ndoshta nuk do të duhej, por nuk kam sesi të mos e potencoj faktin këtu, se kjo seancë, ky debat parlamentar për situatën e COVID në vendin tonë është ftuar kryesisht në frymën e kritikës ndaj masave të ndërmarra nga Qeveria, përveçse për vaksinat.

Ndërsa, nga diskutimet që kam dëgjuar dje dhe sot, Qeveria sulmohet kryesisht për shkak të numrit të rasteve, domethënë numrit të hospitalizimeve, numrit të vdekjeve, që këto nuk qëndrojnë në proporcion të drejtë me atë se për çfarë është ftuar. Pra, kjo mendoj se është paksa absurde, sepse të sulmohet Qeveria, të thirret debat parlamentar për masat që ka marrë dhe në të njëjtën kohë të thuhet pse nuk po merrni masa, është paksa absurde.

E nderuar nënkryetare e Kuvendit,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju media,

Situata me shëndetin publik në vendin tonë, ashtu si në mbarë Globin, vazhdon të jetë e rënduar për shkak të Pandemisë COVID. Pra, e kemi të qartë se ka më shumë se një vit që ne nuk jemi në një situatë normale. Prandaj, edhe përgjegjësitë dhe sjelljet tona si qytetarë e si deputetë të zgjedhur, për më tepër edhe si profesionistë mjekësor, duhet të përkohet me peshën dhe rëndësinë e situatës në të cilën jemi, sepse para së gjithash është detyrë e jona që ta mbrojmë shëndetin e popullatës. Për ta bërë këtë nuk duhet të harrojmë se, ashtu siç konstruktiviteti ynë politik këtu, kur bëhet fjalë për Pandeminë, si formë kontributi në gamën e veprimeve që avancojnë luftën anti-COVID, njëjtë edhe mungesa e konstruktivitetit tonë dhe dezinformatat e lëshuara, si nga subjektet politike ashtu edhe nga mediat, ndikojnë e cenojnë rëndë shëndetin publik, përveçse shkelin kode etike.

Nga ajo se çfarë kemi dëgjuar gjatë këtyre dy ditëve këtu, për një qytetar totalisht të painformuar mund të konkludohet se virusin e ka sjellë Qeveria në Kosovë, por kjo nuk qëndron. Prandaj, edhe debati ynë, edhe fjalimet tona, mendoj se duhet të jenë më konstruktive në raport me situatën në të cilën jemi, sepse vetëm konstruktiviteti ndihmon në përmirësimin e shëndetit publik.

Të nderuar kolegë,

Në këtë debat parlamentar për situatën me Pandeminë, përtej diskursit politik, përtej politikave ditore, mendoj se më mirë flasim të dhënat shkencore.

Të nderuar qytetarë,

Që nga data 6 prill, kur kishim pikun e hospitalizimeve me rreth 960 të hospitalizuar në klinikat e SHSKUK-së, numri i tyre ka rënë në rreth 700 kur po flasim, rënie kjo rreth 25% e numrit të hospitalizimeve. Dje këtu e dëgjuam deputetin e nderuar të Kuvendit të Republikës mike të Shqipërisë, i cili tha se 975 persona janë të hospitalizuar. Kjo nuk qëndron, për shkak se 975 persona të hospitalizuar kanë qenë më herët dhe nëse diskutojmë në aspektin e fajësisë, që nuk mendoj se është formë e duhur e diskutimit në këtë situatë që jemi, atëherë ajo i takon subjektit të deputetit që e tha e që sot nuk qenka prezent këtu.

Mesatarja e vdekjeve në shtatë ditët e fundit, më datë 6 prill ka qenë 12 të vdekur për ditë, kurse mesatarja e vdekjeve në shtatë ditët e fundit kur po flasim sot është 8 në ditë. Pra, prej masave të marra nga Qeveria kemi mesatarisht katër të vdekur më pak. Kjo është një rënie prej rreth 30%, e cila përkon me rënien e numrit të hospitalizimeve nëpër klinikave të SHSKUK-së e po ashtu edhe me numrin e të testuarve pozitivë në ditët për të cilat po bëhet fjalë.

Këta dy parametra në mënyrë të pamohueshme tregojnë trendin në rënie të përhapjes së COVID-it në vendin tonë.

Pra, mesatarja shtatë ditore e rasteve të reja pozitive me datë 6 prill ka qenë 772 raste të reja për ditë, sot ka rënë në 354 raste të reja për ditë. Përqindja e testeve që rezultojnë pozitive nga mesatarja prej 18,5% më 6 prill ka rënë në 12% më 26 prill. Pra, kjo është rënie prej 35% e të testuarve pozitivë në vendin tonë. Nga mesatarje prej 5,4 testeve për një rast pozitiv më 6 prill, pra në mesataren shtatë ditore të datës 6 prill, sot jemi në 8,3 teste për një rast pozitiv në mesataren shtatë ditore. Pra, për një rast pozitiv kemi teste prej 35% më shumë, që i kundërvihet si argument, edhe shkencor, asaj që po thuhet se kemi rënie të numrit të testeve.

Këto të dhëna tregojnë se masat e ndërmarra nga Qeveria, jo që nuk kanë qenë të duhura e pa efekt siç po pretendohet, por përkundrazi, kanë dhënë rezultate të ndjeshme në përmirësimin e situatës epidemiologjike, duke zvogëluar numrin e vdekjeve dhe hospitalizimeve përveçse numrin e të infektuarve dhe kështu duke shpëtuar nga kolapsi sistemin shëndetësor në vend.

Të nderuar kolegë, mos të harrojmë se shumë vende të fuqishme evropiane në krye me Gjermaninë janë në masa restriktive që disa muaj. Ne e kuptojmë fare mirë, se është e rëndësishme edhe gjendja ekonomike në vend, prandaj konsideroj se me masat e ndërmarra është ruajtur bilanci i nevojshëm i funksionimit të ekonomisë në këtë kohë të krizës shëndetësore. Ne nuk mund të sillemi sikurse nuk ka virus.

Sa i përket çështjes së vaksinimit nuk ka dyshim se është proces i rëndësishëm, i cili do të mund të mundësonte t'i rikthehem normalitetit. E kemi shembullin e Izraelit, vend i cili ka administruar sipas të dhënave të disa ditëve më parë, 120 doza për 100 banorë dhe si rrjedhojë i është kthyer normalitetit. Po ashtu, kemi edhe Britaninë, ku nga një mesatare shtatë ditore prej 55 mijë rasteve të reja më 12 janar, në datën 12 prill ka pasur një mesatare shtatë ditore të rasteve të reja prej 2700 rasteve në ditë. Të nderuar kolegë, duhet të kemi parasysh se për një vit nuk është blerë asnjë vaksinë. Pra, unë nuk ju kam dëgjuar të diskutoni më herët për vaksinat.

Sa i përket krahasimit me vendet e rajonit, kur bëhet fjalë për krahasim me vendet e rajonit, mos të harrojmë se një përqindje shumë e madhe e vaksinave që këto vende po përdorin janë Sinovac-u kinez dhe Sputnik-u rus, vaksina këto që nuk janë të miratuara nga Agjencia Evropiane e Barnave dhe efikasiteti i tyre është dukshëm më i vogël, sesa efikasiteti i vaksinës Astra Zeneca, Pfizer dhe Moderna. Kështu që, përveçse efikasiteti i tyre është dukshëm më i ulët edhe indeksi i sigurisë së këtyre dy vaksinave, me të cilat në masë të madhe po vaksinohen qytetarët e vendeve të rajonit, ende nuk dihet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani fjalën e ka Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetare!

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolege dhe ju kolegë deputetë,

Kemi hyrë në vitin e dytë që Republika e Kosovës ballafaqohet me një krizë të rëndë dhe shumëdimensionale të shkaktuar nga Pandemia me virusin COVID-19. Kjo gjendje shoqërore tonë e ka prekur në shumë segmente të jetës, duke filluar nga humbja e jetëve deri te lufta për ekzistencë.

Masat e marra deri më tani kanë rezultuar si të paefektshme dhe janë treguesi më i mirë, se as Qeveria 50-ditëshe e Kurtit, as ajo e udhëhequr nga Hoti, nuk poseduan një plan të mirëfilltë dhe as tani kjo Qeveri aktuale nuk posedon një plan për të menaxhuar këtë situatë. Përkundrazi, veprimet e Qeverisë aktuale lënë përshtypjen se qeveritarët tanë ende janë në fushatë elektorale. Agjenda e tyre është improvizuese. Siç shihet, kjo Qeveri ende gjendet në një situatë të vetëkënaqësisë me takime rotative dhe ngarkim-shkarkime. Propagandë për konsum të brendshëm dhe viktimizim në raport me jashtë. Edhe vetë sigurimin e vaksinave, si hapi më i rëndësishëm kundër pandemisë, e kanë kthyer tërësisht në çështje të viktimizimit kombëtar.

Por, në rast se Kosovës për humanizëm i dhurohen disa vakcina, gara për të qenë protagonist i ceremonive dhe sfilatave me tapeta të kuqe para mediave na ngjanë me një tragjikomedi të shkruar keq. Këta qeveritarë praktikantë nuk e kanë as edhe një arsye për të bërë teatër me këto ndihma, prandaj unë shfrytëzoj rastin që të falënderoj secilin shtet që sot Kosovës i ofron ndihmë në çfarëdo forme. Këta praktikantë qeveritarë duhet të lidhin kontratat e blerjes e jo të presin lëmshë. T'i blejnë sa më parë vaksinat dhe të vaksinonjë popullin e jo ta lënë këtë çështje vetëm në nivel bamirësie, sepse Buxhetin e shtetit e kemi por ata që po e menaxhojnë këtë buxhet po del që të jenë, ose të paaftë, ose të papërgjegjshëm.

Është e qartë se lufta kundër Pandemisë është e vështirë dhe kërkon angazhim të secilit prej nesh. Ne jemi gati për bashkëpunim, por qasja e Qeverisë është qasje selektive dhe jo transparente, jo vetëm në raport me partitë tjera, por edhe në raport me qytetarët, votën e të cilëve e morën me një gamë të gjerë akuzash, gënjeshtërash dhe me premtime irracionale, të cilat vetëm brenda 30 ditësh qeverisje i shkelën me këmbë.

Elektorati i tyre u besoi e këta sot janë duke u tallë me ata votues dhe me të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Sot qeveritarët që janë në pushtet duhet t'i lënë anash inatet politike dhe viktimizimin, se gjoja po pendohen. Sot duhet të ulen në një tryezë me të gjithë faktorët relevantë për të krijuar një strategji të duhur, jo vetëm për vaksinat, por edhe për pasojat tjera të Pandemisë, sepse nëse diçka është e qartë, është fakti se pasojat e shkaktuara nga Pandemia janë pasoja që do të jenë evidente për një kohë të gjatë. Është e pa tolerueshme se si kjo Qeveri dështimin për të siguruar vakcina e shet në opinion si diçka sekrete, vetëm për të eliminuar transparencën dhe bashkëpunimin.

Kryeministri Kurti, ministri Vitia, ne nuk presim mrekulli për 100 ditë, por ne presim që gabimin me vaksina ta pranoni dhe të angazhoheni që ky gabim të përmirësohet me urgjencë. Ne presim menaxhim serioz të situatës, bashkëpunim dhe transparencë ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ne presim masat e aplikueshme anti-COVID, e jo orë policore natën dhe izolim selektiv të një sektori, siç bëtë me gastronominë, përderisa të gjitha bizneset e tjera mbetën të hapura dhe pa asnjë respektim të masave anti-COVID. Presim ndaljen e ngritjes së çmimeve, presim një zgjidhje racionale për festat familjare, sepse gjatë fushatës ne të gjithë i mbyllëm sytë dhe i mbushëm sallat dhe sheshet plotë.

Kryeministër, zgjedhja e vendimeve ad hoc, humbja e jetëve dhe dëmet ekonomike që po e dërgojnë shoqërinë në një presion kolektiv dhe ajo që është më e rëndë, Qeveria e udhëhequr nga ju nuk po jep shenja minimale që ka një plan për t'iu kundërvënë këtyre dëmeve. Thujse qeverisja nënkupton sfilata mediave dhe propaganda filozofike, thujse qeverisja nuk ka asnjë lidhje me ekonominë, mirëqenien dhe stabilitetin social-ekonomik. Reagimi juaj përballë situatës së pandemisë ishte mbyllja e gastronomisë, ora policore natën dhe ndalesa e 20 eurove të pensionistëve, në ndërkohë që shkalla e ankthit, depresionit dhe rraskapitjes është rritur ndjeshëm.

Zoti Vitia, ju për 30 ditë qeverisje nuk keni arritur t'i blini as 30 vaksina për të shpëtuar jetën e qytetarëve dhe për këto 30 ditë të menaxhimit të dobët të pandemisë në Kosovë kanë vdekur më shumë se 300 qytetarë. Kryeministri i vaksinuar edhe pse kishte kaluar COVID-in kuptohet, ju e dini mirë që njerëzit e infektuar me COVID, trajtimi ditor i kushton 100 deri 150 euro. A i ka bërë llogari Kryeministri sa është shuma e çdo qytetari që shpenzon për terapi deri në shërim, ndërkohë që një i infektuar si ndihmë merr vetëm 50 euro nga komuna dhe kjo është vetëm një aspekte i gjithë asaj se çfarë po përballen e vendit tonë tani më shumë se një vit.

Që nga fillimi i pandemisë kemi tri qeveri. Gjatë gjithë kohës Partia Demokratike e Kosovës që jemi angazhuar të japim propozime serioze dhe ndihmë konkrete në luftimin e pandemisë, në menaxhimin e situatës dhe rimëkëmbjes ekonomike. Fatkeqësisht, nuk kemi hasur në bashkëpunimin që do të duhej ta kishim. Në rast krizash kjo siç është tani. Pse ndodh kjo? Kjo ndodh për faktin e vetëm se këto qeveri më parë pranojnë të vdesin qytetarët sesa t'i ulin bajraçet e propagandës kundër PDK-së. Sot në vend që të paraqesin planin e tyre, këta qeveritarë vazhdojnë ta mbajnë ndezur militantizmin partiak, duke drejtuar gishtin nga PDK-ja. Por në raste krizash si kjo në të cilën gjendemi, duhet ta dimë se kemi të bëjmë me interesa nacionale e jo partiake.

Kryeministri nuk do t'ia dijë se në kohë krizash si kjo nëpër të cilën po kalojmë, qytetarët presin nga Qeveria që të bëjë të pamundurën për të kthyer situatën nën kontroll. Çdo Qeveri e ka për obligim që para interesit personal e partiak, të vërë interesin e popullit dhe të kujdeset për jetën dhe mirëqenien e tij. Fatkeqësisht kjo Qeveri nuk po e bën këtë. Prandaj, duke qenë se gjendemi

para një menaxhimi improvizues, ne të gjithë, jo vetëm politikanët, por edhe shoqëria në tërësi, duhet të ngrehemi dhe të kërkojmë më shumë përgjegjësi nga kjo Qeveri, sepse nuk guxojmë të lejojmë që qytetarët të paguajnë me jetët e tyre për narcizoizmin e një personi dhe veprimet e gabuara të Qeverisë që udhëhiqet nga ai.

Kryeministri si duket ka harruar, por në pushtet erdhi me furinë e patriotizmit, e patriotizmi i vërtetë i çdo qeverie është serioziteti dhe përkushtimi në shërim të qytetarëve. Një qeveri të cilës i vdesin me dhjetëra qytetarë çdo ditë dhe në vend që të angazhohet për ta, ajo gjen kohë të bëjë fushatë të pandërprerë, nuk ka as edhe grimcën më të vogël të patriotizmit dhe humanizmit në vete. Një qeveri e vërtetë dhe patriotike nuk do ta lejonte asnjëherë që populli i saj të ndjehet i braktisur dhe i lënë vetëm përballë një pandemie globale. Një qeveri e cila gjen kohë për gjithçka triviale, nuk e sheh të arsyeshme që në këtë Kuvend të sjellë programin qeverisës. Është një qeveri e cila si rezultat do të korrë zhgënjimit e atyre, votën e të cilëve e mori me premtime të rrejshme. Kryeministri, i tërë kabineti i tij qeveritar dhe Presidentja, qytetarët e këtij vendi i shndërruar në spektatorë të takimeve zinxhirore të kurtuazisë dhe spektakleve mediatike. Vërtetuat që nuk janë të përgatitur për punë konkrete, por tani ne kërkojmë nga ta që urgjentisht të sigurojnë vaksinat për të gjithë pa përjashtim dhe përtej kësaj janë të obliguar që të sjellin planin qeverisës dhe në veçanti planin për të luftuar pandeminë dhe problemet që do ta pasojnë. Për të qenë lider nuk duhet retorika, duhet guximi.

Andaj, kryeministër, kudo që je tani, tregohu i guximshëm dhe merr vendime të duhura sado të vështira qofshin ato, nëse janë në të mirë të qytetarëve, ne do t'ju përkrahim, sepse në fund të ditës, për ne më e rëndësishme është jeta e qytetarëve sesa të bëjmë politika ditore partiake. Në të njëjtën kohë, ne do të jemi këtu për t'ju kundërshtuar dhe për t'ju demaskuar në çdo rast që ju jetën dhe mirëqenien e qytetarit të Kosovës e largoni nga numri një në listën e prioriteteve të punës suaj.

Lëre Facebook-un kryeministër, gjithashtu edhe ti ministër Vitia. Lëre fushatën dhe sille programin qeverisës. Të ulemi dhe të gjejmë mundësinë për të dalë nga kjo krizë me sa më pak pasoja. Qytetarët po vdesin çdo ditë. Bëheni më seriozë! Vetë sot pamja e kësaj salle, pamja e kabinetit qeveritar tregon se me sa serioziteti e keni marrë çështjen e pandemisë dhe vaksinimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

**KRYESUESJA:** Tani fjalën e ka Armend Zemaj.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit nënkryetare!

**KRYESUESJA:** Më fal, më vjen keq, po ke folur dje. Nuk lejohet, më vjen keq. Jo nuk ka të bëjë me çështjen e minutave, ka të bëjë që e ke marrë fjalën më herët. Jo, ku replikë për çka. Jo më

vjen keq, replikë s'ka. Jo më fal, s'është vërtetë. Më vjen, po nuk mundem, d.m.th. atëherë duhet për secilin të vazhdoj njëjtë.

Vazhdojmë me Pal Lekajn.

**PAL LEKAJ: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!**

E nderuar nënkryetare,

I nderuar kryeministër, që prapë nuk po e shoh,

Kabinet qeveritar,

Kolegë, media,

Gjithë ju të pranishëm,

Sot ku jemi një muaj e sa ditë pas votimit të Qeverisë Kurti 2 ende nuk kemi pranuar një plan qeverisës për tejkalimin e krizës ekonomike në Kosovë, por fatmirësisht përfunduan zgjedhjet në Shqipëri dhe po shpresojmë që Qeveria Kurti do të interesohet për gjendjen e rënduar nga COVID në Kosovë.

Përderisa Shqipëria ka vaksinuar mbi 400 mijë qytetarë dhe po përgatitet fuqishëm për sezonin veror, ju z. Kurti keni mbetur duke bredhur rrugëve të Shqipërisë me shpenzimet e Qeverisë së Kosovës për të kërkuar vota e jo vakcina. Prandaj, interesi juaj është vetëm pushteti e jo gjendja e rënduar në Kosovë. Pandemia ka dëmtuar ekonominë e Kosovës, e cila përfshin rënie ekonomike me shtatë për qind, sipas Bankës Botërore. Gjithashtu, pandemia ka ndikuar në rritjen e papunësisë në vend me rreth 5 për qind. Tani për momentin në Kosovë, shkalla e papunësisë ka arritur shifrën mbi 30 për qind.

Shtrohet pyetja, a keni plan se si do ta ringjallni ekonominë? Si do ta ulni papunësinë? Si do ta menaxhoni pandeminë? Jo. Ju nuk keni plan, por nuk keni plan as për t'u përgatitur për ardhjen e diasporës, e cila është promotor i zhvillimit ekonomik të vendit. Ju nuk keni plan se si do të ringjallet gastronomia e Kosovë, kur do të hapen sallat e dasmave që në vete kanë një zinxhir të madh ekonomik. Ata janë tatimpaguesi e këtij veni. Ata kanë së paku 20 persona të punësuar, shumë prej tyre janë biznese familjare dhe ju ende nuk keni një datë se kur do të fillojë punën ky sektor i fuqishëm ekonomik në Kosovë dhe të cilët automatikisht nxisin zhvillimin dhe funksionimin e shumë veprimtarive të tjera me salla të dasmave. Andaj, i nderuar Kryeministër, nuk jemi këtu për të përfutur poenë politike, por gjatë 20 viteve keni kritikuar shumë dhe ke dhënë premtime të mëdha, atëherë tregoje vete. Ju për një muaj qeverisje i keni dëmtuar bizneset kosovare me miliona euro, duke bërë mbylljen totale pa analizë të situatës, dhe duke mos pasur një plan sesi do t'i mbuloni humbjet e tyre biznese. Me mbylljen total të bizneseve mbi 35 mijë qytetarë të Kosovës për vetëm një vikend kanë dalë jashtë shtetit, duke shpenzuar jashtë vendit të tyre. Kjo situatë ka krijuar humbje të mëdha.

Kryeministër, jemi në vitin 2021 dhe ka kaluar më shumë se një vit nga dita e parë e virusit në Kosovë. Tash edhe vaksina është zbuluar, zgjedhjet në Shqipëri i humbe, analizat i ke bërë, humbjet financiare i shkaktove, ka ardhur koha të vaksinohet populli, pasi që njerëzit dhe ekonomia e këtij vendi po vdes.

Kryeministër, ke filluar mbrapshtë duke dëmtuar shtresën më të ndjeshme të Kosovës. Ndaleja e shtesave për pensionistët ishte vendimi më i dëmshëm që ka mund t'i japë vendi pensionistëve të Kosovës, pasi që të njëjtat janë më të rrezikuarit nga pandemia dhe çdo ditë jetojnë nën ankthin e Covid-it dhe ende nuk janë vaksinuar dhe nuk kanë trajtim dinjitoz nga Qeveria juaj. Pensionistët nuk kanë nevojë për lëmoshë, por kanë nevojë që shtesa me vendimin e Qeverisë Hoti të përcaktohet si pension bazë, sepse kanë kontribuar shumë gjatë për këtë vend dhe siç edhe ju e dini, gjatë vitit 2020 ka ngritje të çmimeve të konsumit dhe ato farmaceutike. Kjo politikë është e dëmshme për ta dhe për vendin. Ne si Aleancë kërkojmë menjëherë të revokohet vendimi juaj për uljen e shtesave të pensionistëve.

Vendimi i fundit për ndarjen e subvencioneve për biznese është për t'u hedhur hi syve pasi që dëshironi të arsyetoni veten për humbjet e krijuara në dy javët e fundit, me veprimet e juaja të gabuara dhe të pamatura.

I nderuar kryeministër,

Bizneset, pensionistët, punëmarrësit, të varfrit dhe të gjithë ne kemi nevojë vetëm për një gjë, që tash botërisht dihet e ajo është vaksina. Lojërat politike siç ishte skandali i fundit me ministrin Vitia dhe presionin ndaj mediave shihet që nuk është primar shëndeti i qytetarëve, por sigurimi i shtetit autoritar siç vetëm ju e dëshironi. Prandaj, këtu, kur e kam fjalën te ministri Vitia, më duhet ta di a i ka fajet ish-ministri z. Zemaj, apo i kaf ajet ministri i tanishëm për mosnënshtrimin e kontratën. Unë mendoj se ka ardhur koha që njëri ta marrë fajin, o ish-ministri ose ministri Vitia për mosveprim.

Prandaj, zoti Kryeministër pushtetin e ke vetëm ashtu siç e ke kërkuar dhe dëshironi të vendosni, andaj tregoj popullit tuaj për zhvillimin ekonomik, për rimëkëmbjen ekonomike, kur do t'i mundësohet diasporës ardhja në Kosovë dhe më e rëndësishmja për të gjithë, kur do të vaksinohemi? Prandaj, mendoj që t'i lëmë fjalët, shkojmë në veprim dhe qytetarët presin shumë që me të vërtet qytetarët të kenë një trajtim dinjitoz dhe ata duhet të vaksinohen. Humbjet janë të mëdha, andaj duhet të veproni me urgjencë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Fjalën e ka Enver Dugolli.

ENVER DUGOLLI: E nderuar nënkryetare e Kuvendit!



KRYESUESJA: Veç një moment! Zotëri Lekaj a mund ta konfirmosh që e ke përmendur z. Zemaj? Ani, në rregull, qetësoju, tani e konfirmojmë dhe vazhdojmë. Në rregull jemi. Veç konfirmova, po të dëgjoj.

PAL LEKAJ: E kam përmendur.

KRYESUESJA: Në rregull, vazhdo z. Zemaj, në relacion d.m.th. me atë çka ka thënë Pal Lekaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Kolegë të nderuar,

Doktor Pali e bëri një pyetje, ndoshta është edhe shumë e rëndësishme për shkak të rritjes së transparencës dhe kërkesës së transparencës nga ky Kuvend për ministrin Vitia, por mbi të gjitha edhe për procesin. Unë mendoj që ka edhe dj edhe sot ministri Vitia e ka përmendur një fakt: thotë është shtuar dinamika e cila nuk ka qenë e duhur. Unë po pyes z. Vitia, cila është dinamika e duhur dhe cila ka qenë e mosduhura nga tri proceset për sigurimin e vaksinës COVID. Atë me Komisionin Evropian e cila tashmë vetëm ka marrë sinjalizimin për ardhjen e vaksinës. Pjesa tjetër me Covax, pas dorëzimit të detyrës sime më datën 23 menjëherë ka ardhur konfirmimi i dt. 17 mars dhe të dielën janë pranuar vaksinat. Cila ka qenë këtu dinamika e shtuar, përpos asaj e pritjes, e cila ka qenë e plotësuar dhe e rregulluar me të gjitha e aranzhuar. Dhe pjesa tjetër, po ashtu më dt. 30 mars në ora 17.39 kam marrë konfirmimin tjetër nga Covax, i cili është përcjellë te ju në 17.54 minuta. D.m.th. kjo ka qenë dinamika për t'ju njoftuar juve për ardhjen e kontingjentit të dytë të vaksinave. Edhe me Pfizer më dt. 30 mars ka ardhur konfirmimi që a mund t'ju dërgojmë kontratën finale. Nuk po parafranojmë sepse ka disa elemente që i dimë ose duhet t'i dimë në aspektin konfidencial. E njëjta është përcjellë më 31 mars në ora 17.03 minuta te ju me ngutinë më të madhe dhe me gëzimin më të madh për sigurimin e vaksinës. Cila është dinamika e duhur që e keni shtuar z. Vitia nga ajo ditë deri në ditën e sotme? Edhe udhëzimi administrativ ka qenë i nënshkruar.

KRYESUESJA: Z. Vitia e ka fjalën. Vetëm pak para se të vazhdosh. Kjo qe replikë në relacion me z. Lekaj. Jo nuk e pati.

ARBEN VITIA: Faleminderit znj. Bogujevci!

Tani kulturën institucionale tani besoj e dimë të gjithë që jemi në këtë vend dhe natyrisht që shumë gjëra që janë bërë më herët, unë edhe nga ish-ministri kam pranuar shumë gjëra në proces për çka edhe e kam falënderuar dhe kam vazhduar. Natyrisht edhe nga ministri paraprak kam pranuar shumë gjëra të cilin edhe e kam falënderuar dhe kam vazhduar.

Sa i përket pjesës së dinamikës së shtuar, po jam plotësisht dakord, Covax-i ka qenë të gjitha si duhet dhe ne kemi vazhduar me atë dinamikë e cila ka qenë dhe ka sjellë 24 mijë dozat e para dhe presim 76 mijë dozat e tjera shumë shpejt.

Sa i përket dinamikës me kompaninë prodhuese, e para është një keqinformim. Prapë butësisht të them, nuk është kontrata finale, e dini edhe ju. Është parakontrata. Kështu që kur thua është kontrata finale, është një keqinformim, kurse për pjesë të tjera të shtimit të kësaj dinamike, unë besoj që atë sikur thashë edhe dje, të presim vetëm edhe pak kohë dhe do ta shihni çfarë dinamike është shtuar dhe çfarë është bërë në fund. D.m.th. dinamika e shtuar.

Në anën tjetër, ju e përmendët edhe udhëzimin administrativ. Për opinionin dje nuk e sqarova, më duhet ta sqaroj sot. Udhëzimi administrativ i nënshkruar nga ministri paraprak dhe fatmirësisht jo i publikuar në Gazetën Zyrtare, me gjithë qëllimin e mirë që mund ta ketë pasur edhe Kabineti, edhe Qeveria paraprake, nuk do t'u kishte mundësuar hyrjen e vaksinave në Republikën e Kosovës, sipas atij udhëzimi.

Është shumë mirë që kemi farmacistë edhe kemi ekspertë të jashtëzakonshme te ne...

**KRYESUESJA:** Regjia, ia vazhdoni fjalën.

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Dhe është kënaqësi që kemi ekspertë të tillë që kanë identifikuar, prapë po them, nuk paragjykoj fare. Jam i sigurt që nuk është bërë me asnjë qëllim të keq, mirëpo gabimet teknike, sidomos në thirrje të neneve, të ligjit në nene të caktuara, nuk do t'i kishin hapur rrugë ardhjes së vaksinës në Republikën e Kosovës. Këtë jua garantoj, mund t'i pyesni ekspertët.

Janë për t'u krahasuar udhëzimi paraprak edhe udhëzimi i tanishëm dhe e shihni që nuk ka të bëjë me atë. Ky udhëzim ka filluar qysh në dhjetëditëshin ose pesëmbëdhjetëditëshin e parë kur është vërejtur ky gabim teknik, është ngritur grupi punues i cili e ka sanuar këtë gabim, dhe tani i hapet rrugë ardhjes së vaksinave.

Faleminderit, zonja Musliu! Natyrisht që jemi shumë të hapur për bashkëpunim dhe falënderojmë secilin deputet edhe secilin qytetar të Republikës së Kosovës që na ofrohet, dhe të më besoni, rrugët hapur edhe dyert çelë do t'i ketë secili në këtë proces kaq delikat për neve.

Ne nuk kemi lypur lëmoshë. Në asnjë moment nuk kemi lypur lëmoshe. Ne kemi biseduar me miqtë tanë ndërkombëtarë dhe do të bisedojnë dhe s'do të lëmë derë pa trokitur te miqtë tanë ndërkombëtarë për të na ndihmuar, sepse miku i mirë shihet në ditë të vështirë.

Për informimin tuaj, për Noterdam në djegien e katedrales, Qeveria jonë ka dhënë fonde. Domethënë, janë simbolika të tilla të një lloj kultivimi të miqësisë që e ka bërë çdo qeveri, për të cilin e përgëzoj, dhe do ta bëjmë edhe ne sidomos në situata si tani ku gjendemi.

Në vitin e kaluar kur ka pasur Italia problemet me pandeminë, Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ofruar infermierë për t'iu ndihmuar. Ne e kemi ditur që me ata infermierë nuk do të mund të bëhet shumë punë atje, por ai është një akt miqësie, është një akt solidar të cilin e bëjnë shtetet mike njëra me tjetrën dhe shlyqyr që kemi shokë e miq të mirë në kësi raste. Faleminderit!

KRYESUESJA: Kundër-replikë, Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Ministër, faleminderit!

Korrektësia jote e përgjysmuar prapë nuk po ndihmon në transparencën e kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ajo që e konfirmuat është që këto tri procese, qoftë në kohën nga qershori dhe qoftë në kohën e fundit, janë udhëhequr në dinamikën e duhur, të mos thuash më në dinamikën e mos-duhur. Të jemi korrekt. Duhet të jemi të sinqertë. Kjo.

Sa i përket udhëzimit administrativ, nëse ekspertët e ministrisë janë ballafaquar me ekspertët e ministrisë. Është çështje tjetër. Nuk e di që ka ekspertë të tjerë brenda atij sektori apo sektorëve që janë përgjegjës për hartimin e udhëzimeve administrative. Nuk e di se si ta kanë deleguar, apostrofuat, por unë mendoj dhe prapë mbes prapa atij qëndrimi, sa i përket lejimit të ardhjes së vaksinës ka qenë gjithçka në rregull.

Komplikimet që mund të dalin në ndonjë nen apo eliminimi i definimit të ndonjë neni të caktuar...

KRYESUESJA: Replikë, Uran Ismaili!

URAN ISMAILI: Faleminderit!

Realisht po më vjen mirë që Qeveria e Republikës së Kosovës paksa gjetur fonde dhe po ndihmon jashtë Kosovës. Ne këtë debat parlamentar e kemi thirrur për çështjen e Kosovës.

Unë çka po dëgjoj gjatë tërë kohës edhe mes juve edhe mes zotit Zemaj, jeni duke folur për tema të Ministrisë së Shëndetësisë, e në anën tjetër qytetari është i pavaksinuar i painformuar edhe asnjëherë nuk po tregohet një plan.

Ne po e dimë që po vjen vakcina, sepse do të vijë. Unë edhe dje e kam thënë, do të vijë, do të vjen, s'ka qare pa ardhur. Asnjë lloj plani se kur do të vaksinohen njerëzit. Ku do të vaksinohen. Kur janë afatet e vaksinimit. Sa njerëz i shini të vaksinuar në mua. Çfarë metodologjie të informimit do të përdorni. Sa ka pasur rezistencë në këtë mostrën e vogël, 25 mijë. Cilat kanë mësimet që i keni marrë prej këtyre 25 mijë vaksinave. Asgjë bre s'po jepni. Bash hiç kurrëgjë.

Vjen, e kam gjetur ministrinë kështu. Jo ky ka punuar, jo ky s'ka punuar. Po s'jemi bre ne këtu në pozicion...Të fundit në vaksinim e të shikohet a ka punuar Armend Zemaj apo s'ka punuar. Që s'ka punuar, ia çon gjërat në prokurori nëse ka bërë shkelje. Nëse s'ka punuar, vjen auditori dhe tregon. Nuk jeni për këtë punë që t'ia gjeni njëri-tjetrit a keni punuar apo s'keni punuar, e debatin për shëndetësi nuk e keni për qytetarët, e keni për njëri-tjetrin.

Edhe në fund kallëzoni, jo ka dhënë ndihma qeveria jonë, ka dhënë ndihma e shyqyr që kemi miq e jaranë. Jeni duke bërë shaka. Njerëzit janë në krizë shëndetësore duke vdekur. Janë në pasiguri të madhe shëndetësore, dhe krejt çka dëgjoj këtu, çfarë dinamike kam unë, çfarë autoambulance ke blerë ti. Marre për besë, marre!

Duhet të keni pak përgjegjësi dhe të vini të tregoni. Në qoftë se mund të tregosh për vaksinë se kur do të vijë, në rregull, vjen këtë javë, javën e ardhshme. Çfarë do të bëjmë me ato vakcina? Çfarë do të bëjmë, ku është plani? Kush do të vaksinohet? Sa do të vaksinohen në...

**KRYESUESJA:** Replikë, Ganimete Musliu!

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, nënkryetare!

Zoti ministër,

Ju veç sapo e vërtetuam edhe e konfirmuam atë që e thash unë. Nëse më keni dëgjuar me vëmendje, unë thashë që Qeveria e Republikës së Kosovës, shteti i Kosovës ka para të mjaftueshme, ka buxhet të mjaftueshëm për të siguruar vaksinën.

Sigurojeni vaksinën, blini vaksinën. Hajde të bëjmë rishikim të buxhetit, çka është e nevojshme sille këtu dhe do të përkrahim, por të mos lejoni që qytetarët e Kosovës të mbesin nën mëshirën e moshës.

E thashë, i falënderoj të gjitha ato shtete që ndihmojnë Kosovën në çfarëdo mënyre, por rasti i vaksinave nuk guxon të mbetet vetëm në nivel moshe. Siç duket, ju ministër jeni bërë imun ndaj vdekjeve në Kosovë.

Me vet konstatimin e paligjshëm për karantinimin për Agon Musliun, që nga atëherë e keni humbur sensin e ndjeshmërisë ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës. Andaj, edhe këto vdekje sot, për juve janë të natyrshme dhe normale. Kthjellu ministër! Vepro ministër.

Mos na mbaj ligjëratat. Nuk kemi nevojë sot për demagogji, sot kemi nevojë për të qenë konkret në veprime, për ta shpëtuar qytetarin e Republikës së Kosovës nga vdekja që po i kërcënohet çdo ditë mbi kokë.

**KRYESUESJA:** Ministri Vitia e ka fjalën.

MINISTRI ARBEN VITIA: I nderuar zoti Ismaili,

Unë fola për dinamikën e sigurimit dhe natyrisht kjo është ajo që e kemi bërë dhe po e bëjmë për t'i sjellë vaksinat ashtu siç po kërkojnë qytetarët, dhe prapë i garantoj qytetarët që shumë shpejtë do të ndodhë.

Mirëpo, i keni ndryshuar si duket pak në atë, që do të vijë një ditë. Jo, jo nuk do të vinin pa ia bërë hyzmetin. Edhe do të vijë, sepse jemi duke ia bërë hyzmetin.

Në anën tjetër plani i vaksinimit është plan publik bre zoti Ismaili. Është plan publik të cilin e dini ju edhe është plan i cili do të vazhdojë edhe do të bëhet pas asnjë problem. Në momentin që do të vijë vaksinat e nga muaji maj, prapë po them, kur të fillojë procesi i ardhjes së vaksinave, ky proces nuk do të ndalet.

Zonja Musliu, nuk kam asnjë koment. Faleminderit!

KRYESUESJA: Kundër-replikë, zoti Ismaili.

URAN ISAMILI: E para, ministër po thoni, duhet t'ia bëjmë hyzmetin. Nuk ka qeveri që s'e ka marrë vaksinën, që s'ka blerë vaksinë. Nuk ka qeveri në Evropë që s'ka blerë. Pra, s'ka qeveri që s'ka blerë.

Në realitet në jemi në anomali që s'e kemi. Nuk është e kundërta, nuk është hyzmeti i madh i juaji. Pra, këtu ka një anomali të madhe qysh ne nuk kemi kontratë. Tash, a do apo nuk do, unë nuk po dua të hy në atë.

Problemi i sigurimit të vaksinës është se është e mirë komerciale që do ta shtyjë Phizer-i vetë. Vetë do ta shtyjë Phizer-i, vetë. Tash, ti mund të thuash, unë kam bërë negociatën, por ti nuk mundesh, sepse ti s'ke qenë në negociatën hiç. Ti the vet dje këtu, unë s'i udhëheq negociatën. Qysh ia ke bërë kësaj punë? Kush e ka bërë këtë punë pra?

Në qoftë se ti s'e ke bërë punën, pse s'dilni këtu dhe të thoni, më falni me Phizer unë nuk jam duke negociuar, por është dikush tjetër dhe ai është duke bërë punën.

Si mund ta dish ti që është duke u bërë një punë e madhe kur ti vet s'je aty?

KRYESUESJA: Enver Dugolli e ka fjalën.

ENVER DUGOLLI: E nderuar nënkryetare e Kuvendit,

I nderuar ministër Vitia,

I nderuar ministër Murati,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht u shpreh ngushëllime të gjithë familjarëve që i kanë humbur të dashurit në këtë pandemi, dhe të prekurve me COVID, u uroj shërim të shpejtë dhe ta kalojnë sa më lehtë.

Të nderuar,

Debati për pandeminë është i duhur dhe i nevojshëm, aktual dhe i pashmangshëm, jo vetëm te ne, por edhe me gjerë.

Pandemia COVID-19, përveçse është vrastare dhe e padukshme është prova më e madhe e shekullit, jo vetëm te ne, por në të gjithë botën. Në kësi lloj sprovash gjëja më normale që do duhej të ishte e të ndodhte është krijimi i një fronti të përbashkët në luftën kundër kësaj të keqeje të përbashkët.

Në këtë kuptim, unë personalisht, por besoj që edhe qytetarët e këtij vendi kanë pritur që në këtë debat të shpaloseshin ide dhe propozime që do t'i kontribuonin qëllimit, pra luftës kundër pandemisë.

Por, më duhet të them se nga ajo që u dëgjua nga shumë folës këtu, po ndjehem shumë i zhgënjyer, sepse u tha shumëçka, u fol shumëçka, por më së paku rreth temës për të cilën do duhej të debatohim.

Për pandeminë dhe pasojat e saj po diskutohet e po debatohet sikur kjo e keq e madhe na erdhi tani dhe jo para një viti e më shumë. Po harrohet se tani kemi një Qeveri të dalë nga zgjedhjet e lira dhe demokratike, e cila është formuar hiç më pak se para një muaji.

Ky debat, mbase do të kuptohej edhe arsyetohej edhe nga qytetarët sikurse vërtet të reflektonim për lëshimet dhe dështimet e krijuara përgjatë kësaj periudhe njëvjeçare. Një gjë e tillë nuk po ndodhë edhe nuk po shihet që po ndodhë. Krejt çka po shihet është një mllef i akumuluar nga humbja e zgjedhjeve pa dhënë asnjë alternativë.

Qytetarët na kuptojnë dhe mirëkuptojnë atëherë kur jemi të sinqertë me ta. Nuk mund të shtiremi dhe të mos themi asgjë për pasojat e keqmenaxhimit të pandemisë nga qeveria e kaluar, sepse pandeminë nuk e solli Arben Vitia, përkundrazi, duhet të themi e ta rithemi se ishin këto parti të vjetra, bash këto parti të vjetra, që u bënë bashkë dhe e rrëzuan Qeverinë në kohë pandemie, duke e rrezikuar shëndetin e qytetarëve.

Tash, unë mund t'i kuptoj edhe mirëkuptoj të gjithë kolegët deputetë që kritikoni dhe kritikoni për veprime urgjente për sigurimin e vaksinës, sikur të gjithë ju, shumica prej jush, të bënit edhe disa veprime karshi qytetarëve.

Së pari, t'i kërkon falje qytetarëve të vendit që e rrëzuan qeverinë e vitit të kaluar bash në kohë pandemie. Së dyti, pse e formuat qeverinë e jashtëligjshme e pastaj na detyruat që të shkojmë prapë në zgjedhje në kohë pandemie? Dhe së treti, të gjithë ne këtu, po flas pa dallim, do duhej fillimisht të paktën t'ju kërkojmë falje qytetarëve tanë që me sjelljet tona në fushatë, me grumbullime të shumta, sidomos në ambiente të mbyllura, kontribuam në rritjen dhe përhapjen e infeksionit me COVID-19. Këtë duhet ta bëjmë.

Tani kur nuk ka më shumë se një muaj nga formimi i Qeverisë, unë së pari si qytetar e madje edhe si deputet, nuk kam si të mos ndjem mirë me një ministër të Shëndetësisë si Arben Vitia, i cili po u reziston të gjitha këtyre sulmeve, të gjitha këtyre nderksamseve dhe kurtheve të ndryshme, vetëm e vetëm që të mos dështojë procesi i sigurimit të vaksinës. Përgëzime, ministër Vitia!

Ministri Vitia po tregon pjekuri politike, profesionale dhe institucionale duke marrë masa konkrete të sinkronizuara dhe të domosdoshme me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të situatës me pandeminë.

Deshi apo s'deshi dikush të dhënat empirike tregojnë se masa e ndërmarra kishin dhënë dhe po japin efekt në zbritjen e numrit të të infektuarve, paçka se situata mbetet ende e rënduar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Për fund po dua që shumë shkurt të flas edhe për një çështje tjetër që për habinë time i bë top temë për shumicën e folësve në këtë debat dhe jo vetëm.

Tema e debatit të thirrur kishte të bënte me pandeminë. Ashtu e kuptova unë. Por, nga ajo që u dëgjua nuk po del të jetë kështu. Sipas jush, problemi më i madh e më i madhi që padrejtësisht po lidhet me pandeminë, qenka votimi i kryeministrit Kurti në zgjedhjet në Shqipëri.

Unë po befashem dhe po ndjem keq me këto që po dëgjoj këtu. Kam menduar që koha kur ndiqeshim e dënoheshim pse e donin Shqipërinë është kohë e shkuar, por ja që për fat të keq një qasje të tillë po e dëgjoj edhe në këtë Parlament.

Të më besoni, jam shumë i befashuar me këtë fakt, sepse këtë shqetësim nuk e shprehi as kryeministri i Shqipërisë, as presidenti i Shqipërisë, madje as lideri i opozitës në Shqipëri. Kjo çështje u bë këtu temë nga ju, disa deputetë të opozitës, e që të mos ia përmend emrin, tash së voni edhe dikush prej fqinjëve tanë.

Mosni ju lutem! Kjo është komplet një retorikë e shkuar, e mbi të gjitha e gabuar. Ne jemi shqiptarë dhe nuk kemi nevojë që ta fshehim e aq më pak ta mohojmë këtë. Po, jemi dy shteti, ashtu siç jemi një komb. Faleminderit!

KRYESUESJA: Fjalën e ka Mërgim Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

I nderuar kabinet qeveritar,

Janë bërë më shumë se një muaj nga zgjedhja e Qeverisë, dhe parimi i tolerancës së një qeverie në 100 ditët e saj të para, për dy arsye në rastin e Qeverisë aktuale, nuk duhet marrë në konsideratë.

E para, sikurse edhe shumica e vendeve të tjera të botës, edhe vendi ynë, gjendet në luftë përballë armikut të padukshëm, virusit COVID-19 që çdo ditë po merr jetë njerëzish dhe po e shkatërron ekonominë globale, e veçmas në vendin tonë.

Betejat për mposhtjen e tij, imponojnë edhe dinamikën jo të zakonshme qeveritare. Nga dita e parë të cilën qytetarët fatkeqësisht nuk po e shohin te Qeveria Kurti. Ndërsa arsyeja e dytë, është fakti se Albin Kurti dhe qeveria e tij, pushtetin nuk e kanë marrë për herë të parë e as pas shumë kohësh, por vetëm pas pak muajsh nga koha kur e kanë lënë. Pra, nga 3 shkurti deri më 3 qershor të vitit të kaluar, Albin Kurti ishte kryeministër, kohë kjo e mjaftueshme që tani në mandatin e ri të vazhdojë punën, sipas tij, punën e mirë nga aty ku e kishte lënë.

Prandaj, katër muaj në pushtet vitin e kaluar, e mbi një muaj tani, është kohë e tregues i mjaftueshëm për të kuptuar, në fakt, aftësinë e qeverisjes së tij si kryeministër i qeverisë së tij. Por, edhe vizioni edhe programi i qeverisë që e drejton. po mungon.

Fatkeqësisht, për disa javë më radhë, anëtarët e Qeverisë nuk e kanë të qartë vizionin zhvillimor për ndonjë sektor, e as idenë se nga t'ia nisin. Të përhumbur mes zyrave të Qeverisë dhe përballë sfidave të problemeve që kërkojnë adresim e zgjidhje konkrete, ata zgjedhin të zhvendosin nga vëmendja e publikut mospunën e tyre.

Dhe, duhet të shpikin tema populiste për të fituar amnisti nga kritikët e mundshme. Por, mos harroni, është e vërtetë që vendi ynë nuk ka shumë tema, mirëpo në situatën aktuale e ka vetëm një kryetëmë, ajo është situata pandemike, mospunimi i vaksinave dhe mosveprimi dhe paaftësia e Qeverisë Kurti karshi këtyre temave dhe sfidave.

Të mos harrojmë kur e përmendim paaftësinë, e kemi parasysh se është fjalë për të njëjtin kryeministër, i cili një vit më parë kurrë nuk arriti të ballafaqohet me detyrat e tij prej kryeministri, ai zgjodhi që pas 52 ditësh të shkarkojë veten nga papërgjegjësia. Nga pamundësia dhe jokompetenca e qeverisë së tij për t'u ballafaquar me sfidat e vendit, ai zgjodhi viktimizimin dhe arriti qëllimin që dëshiroi.



Vetë e dëshiroi largimin nga qeverisja dhe punoi ashtu që të shkarkohet nga ky Kuvend, duke luajtur rolin e viktimës, kjo është e vërteta dhe të tjerat janë vetëm përralla.

Po sido qoftë, rrëfimi i tij për viktimën e përhershme ai e paraqiti më së miri, e në të tjerët nuk mund ta shfaqnim atë gënjeshtër që e kishte, me të cilën ishte dhe vazhdon të jetë, e vërteta.

Zgjedhjet u organizuan, qytetarët ia dhanë një përgjegjësi shumë të madhe. Shumica e atyre kërkuan që ai të mos i ikë përgjegjësisë. Ndërsa gjysma tjetër e qytetarëve përsëri nuk i besojnë kësaj Qeverie dhe këtij projekti.

Ndërkaq Qeveria e sotme e tij karakterizohet nga kontradiktat e mëdha, erdhi në pushtet duke folur për ngjalljen e shpresës, por përmbajtja e saj tregon për mjerimin që ajo e përfaqëson. Duke sajuar fraza pompoze nëpër ringritje, po përpiqen të lënë në hijen degradimin politik, ekonomik dhe social që ata po prodhojnë në modelin e tyre të qeverisë që e kanë imponuar sot, sepse ky model është konfuz, manipulues dhe propagandistik, ashtu siç ishte e gjithë karriera e politike e Albin Kurtit.

Kjo Qeveri ditën kur u zgjodh, u krenua me programin që gjoja e prezantoi, por nga ajo që e dëgjuam atë ditë, aq sa kemi parë po këto pesë javë, ky pseudoprogram fiktiv nuk shënon asgjë tjetër, pos një pamflet dhe retorikë e zbraztë populliste. Kështu Albin Kurti pretendon të mbajë pushtetin pafundësisht, t'i mashtroje me programe fiktive qytetarët e të mos japë llogari dhe përgjegjësi për dështimet e tij. E ne do të jemi këtu, për të mbajtur fuqishëm përgjegjës para këtij Kuvendi, para qytetarëve të Kosovës, e nuk do të lejojmë t'i bishtërojë përgjegjësisë së tij.

Nuk do të lejojmë që kësaj radhe Albin Kurti të viktimizohet, ashtu siç gjithmonë ka ditur, por ne do të jemi këtu t'i mbajmë përgjegjës për propagandën, manipulimin e tij të madh dhe popullizmin e tij të dëmshëm. Në këtë funksion është edhe ky mocion për të debatuar për gjendjen e katandisur në shëndetësi në këtë periudhë pandemie që e kemi ftuar ne, Partia Demokratike e Kosovës.

Por theksi i fjalës sime në këtë temë do të fokusohet vetëm në një segment. Në mosmbështetjen financiare të profesionistëve shëndetësorë dhe mosofrimin e një pakoje mbështetëse edhe për mijëra familje që janë përballur me virusin COVID-19.

Për shumë familje në Kosovë që përballen me virusin pagesa, barnat dhe analizat ishin edhe një vështirësi shtesë.

Në mungesë të mjeteve financiare, qytetarët nuk kanë arritur të marrin terapinë e duhur edhe të bëjnë analiza të ndryshme, duke vështirësuar kështu gjendjen e tyre edhe më shumë.

Derisa plani ynë i rimëkëmbjes ka paraparë që çdo i infektuar me COVID të regjistruar në IKPSHK të marrë një ndihmë financiare deri në 250 euro për t'i bërë ekzaminimin dhe për t'i marrë ilqet e duhura, në mënyrë që të lehtësojë edhe gjendjen e tyre ekonomike, kjo Qeveri nuk ka paraparë asnjë mbështetje të tillë. Pra, zero mbështetje për këtë kategori.

Po ashtu, derisa në planin tonë të rimëkëmbjes ne kemi paraqitur rritjen e kujdesit për jetën dhe shërbimeve shëndetësore, duke ngritur ndjeshëm rrogat e personelit mjekësor, në mënyrë që të shtohet më shumë stimulimi i tyre material, kjo Qeveri javën e kaluar vendosi me vendim qeveritar t'i zvogëlojë edhe shtesat e përkohshme që personeli mjekësor ishte duke i marrë, duke i dëmtuar heronjtë e vetëm të kësaj lufte 13-mujore, fundi e së cilës nuk po shihet ende.

Pra, kjo Qeveri nuk po u kushton vëmendje të duhur punonjësve shëndetësorë, të cilët kanë luftuar dhe po vazhdojnë të luftojnë në mënyrë shembullore kundër virusit në vijën e parë të frontit, duke rrezikuar edhe vetë jetën e tyre.

Fatkeqësisht, shumë prej tyre edhe humbën jetën në luftën fisnike që bëjnë ata për të shpëtuar jetën e qytetarëve.

Ndërsa në menaxhimin e rasteve të COVID-19 në SHSKUK, në klinikat përkatëse, kanë vështirësi edhe me stafin, sepse aty ndërrohen infermierë çdo muaj, ku pastaj nuk kanë mundësi t'u shërbejnë qytetarëve të infektuar në nivelin e duhur, atyre klinikave u duhen ekipe rezidente kundër COVID-it, e jo të bëhen stimulime dhe duke dalluar nga klinikat e tjera, atyre klinikave u duhen infermierë shtesë për t'i ndihmuar qytetarëve në përballje në luftën për jetën kundër virusit.

Prandaj, duke parë se kjo Qeveri po nëpërkëmbë punën dhe mundin e tyre, i ftoj të gjithë kolegët deputetë që të përkrahin propozimet e Partisë Demokratike të Kosovës, të cilat i kemi dhënë në draftin e rezolutës që të stimulohen dhe të mbështeten financiarisht profesionistët shëndetësorë me pagesë shtesë për 300 euro, ndërsa punëtori joshëndetësor me pagesë prej 200 euro në muaj, mbi pagën bazë për muajt prill, maj dhe qershor 2021.

Gjithashtu propozoj që t'i shtohet edhe rezolutës një pikë që çdo i infektuar me COVID të regjistruar në IKSHKP të marrë një ndihmë financiare nga 250 euro. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Glauk Konjufca.)*

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Doarsa Kica-Xhelili.

DOARSA KICA-XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe media,

Realisht nuk e pata në plan ta marr fjalën sot, mirëpo për shkak të konfuzionit dhe shqetësimit që po krijohet për qytetarët e Republikës së Kosovës, për shkak të faktit që po imponohet një ide që mosnënshkruarja e kontratës më 15 prill domosdoshmërisht e vonon ardhjen e vaksinave, e kam obligim t'i sqaroj disa çështje, të cilat nuk ka nevojë të jenë as pjesë e negociatave të ardhjes së vaksinave për një ditë.

E para, vetë ish-ministri Zemaj, në fund të vitit 2020 pati deklaruar tek në fundvit është siguruar kontakti me kompaninë Pfizer. Nuk ka nevojë për të ditur shumë për të kuptuar që negociatat me një kompani të tillë gjigante marrin kohë dhe nuk janë pa komplikime, është arsyeja e njëjtë pse në janar ministri i njëjtë, ish-ministri në fjalë doli dhe tha që, në fakt, ka pasur ngecje në këto negociata.

Në janar publikisht tregoi që ata janë tërhequr përkohësisht nga negociatat dhe nuk pati dhënë arsye lidhur me këtë. Unë e kuptoj plotësisht, sepse procesi i negocimit dhe konfidencialiteti është diçka që duhet të respektohet, pa asnjë diskutim.

Çështja tjetër, vazhdimisht po ka pyetje pse nuk është nënshkruar? Kush po thotë që mosnënshkrimi më 15 prill nënkupton ardhjen e këtyre vaksinave në një kohë më të vonshme se ajo që është negociuar nga ish-ministri Zemaj, askush, askush nuk po e thotë këtë.

Për më tepër, një çështje tjetër që e ka dhënë ish-ministri Zemaj ka qenë që nuk mund të japë detaje, sepse këto çështje mbulohen nga konfidencialiteti që ke me nënshkruarësin e kompanisë Pfizer, edhe për këtë e kemi kuptuar, sepse çka ne dimë është që kontratat apo dispozitat e tilla të konfidencialitetit, ndër të tjera, mund të imponojnë nevojën që të mbahet sekret çdo detal i kontratës. Nganjëherë ndodh edhe vetë ekzistimi i negocimit të tillë të mbahet sekret.

Edhe një çështje tjetër që duhet përmendur. Ndër pasojat që parashihen shumë shpesh për zbulim të këtyre informacioneve nuk janë vetëm dëmet materiale, mund të jetë komplet anulimi i kontratës, komplet tërheqja nga partneri negociues që domethënë vetë Pfizer mund të tërhiqet, në qoftë se ne sot dalim edhe themi vaksinat do të vijnë me këtë datë.

Kështu që, shqetësimi imi është ky, në momentin kur e kemi pasur edhe një deklaram tjetër nga ish-ministri Zemaj që për shkak se dështoi ardhja në shkurt, një dritare tjetër potenciale për ardhjen e vaksinave ka qenë periudha mars-maj. Ndërsa rreth datës 20 mars, nëse nuk gaboj, u bë një prononcim tjetër që kontrata ende nuk është nënshkruar, domethënë ne po e dimë që nuk ka pasur intensifikim të tillë të negociatave që ato vakcina të vijnë në muajin prill, sepse i njëjti ka thënë që më 15 prill është dashur të nënshkruhet, sepse kërkesa është bërë në fillim të muajit prill nga ata.

Do të thotë, kush po thotë që vaksinat kanë pasur të vijnë në muajin prill, kjo është pyetja. Pse ekziston kjo nevojë e domosdoshme për fajësim, nuk po e them, në fund të fundit, për ministrin konkret, sepse nëse dritarja ka qenë mars-maj, edhe nesër kuptohet që ka dështuar, unë i them pse s'e ke nënshkruar.

Por, në qoftë se mundësia ka qenë ato të vijnë në maj, ne nuk jemi në muajin maj, është absurde qasja e këtij diskutimi, është absurde të thuhet që tendenca është për ta ndihmuar procesin e ardhjes së vaksinave, kur po kërkohet rrezikimi komplet i negociatave. Kur askush këtu nuk po i di dispozitat e konfidencialitetit, askush këtu nuk po i di saktësisht çka lejohet të ekspozohet e çka jo nga ajo kontratë.

Atëherë shtrohet pyetja: në qoftë se ne insistojmë të ekspozohen modalitetet e tilla, nëse ne insistojmë të na tregohet pse nuk u nënshkrua më 15 prill, a ndoshta arsyeja pse nuk u nënshkrua janë kushtet më të mira, ardhja e një numri më të madh të vaksinave. Atëherë pyetja ime e thjeshtë është, a po e dini që me insistim të tillë jeni duke e rrezikuar komplet procesin, sepse një lajthitje më e vogël e ministrit Vitia që të japë informacione, mund të rrezikojë komplet procesin. Edhe për mu si deputete, e cila sado pak i kuptoj aspektet e çështjeve të konfidencialitetit dhe negociatave, besoj vetë ish-ministri Zemaj i di për të gjitha vështirësitë me të cilat është ballafaquar, për mua është e papranueshme, sepse një tendencë e tillë nuk duhet lejuar.

Çka ne mund të ofrojmë janë aranzhimet, të cilët deputetë, në fund të fundit kemi edhe ish-ministra të tjerë, të cilët unë po besoj që megjithatë nuk është që s'kanë bërë ndonjëherë punë të mirë. Në qoftë se keni modalitete që mund t'i sugjeroni, konsideroni që keni këshilla që mund të merren për bazë nga ministri i tanishëm, atëherë e keni foltoren edhe ejani me ide konkrete. Krejt çka po dëgjohet është pse s'është nënshkruar, s'po mund të tregohet pse nuk është nënshkruar. E kemi një NDI të nënshkruar, e cila nuk ia lejon këtë mundësi. Po thoni është dashur të vijnë në muajin prill, a po e dimë ne kur është dashur të vijnë, a po e di ish-ministri Zemaj. Absolutisht nuk është e saktë, më 15 prill ministri Zemaj ka thënë që 15 ditë nga momenti i ardhjes së kërkesës duhet nënshkruar marrëveshja. Gazeta thotë kur ka ardhur kërkesa prej Pfizer dhe kur është dashur të nënshkruhet, gabim e keni shumë.

*(Ndërhyrje)*

**KRYETARI:** Zoti Gashi, mos i ndërhyri deputetes duke folur ajo.

**DOARSA KICA-XHELILI:** Dritarja ka qenë, po e përfundoj me kaq, sepse polemizimet e tilla nuk mund t'i pranoj dhe po e përfundoj vetëm me një fakt. Ka thënë dritarja mars-maj, ka pasur të fillojë prodhimi, në fakt, jo të vijnë në Kosovë. Kështu që në qoftë se është mundësia të vijnë në muajin maj, atëherë pse s'po e mbajmë këtë diskutim në fund të muajit maj, atëherë mund ta pyesim ministrin Vitia pse s'kanë ardhur vaksinat. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën nga Partia Demokratike e ka deputeti Memli Krasniqi. Replikë ka kërkuar në cilësinë e ish-ministrit Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Zoti kryetar, faleminderit, po, si deputet i zgjedhur i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

E nderuar deputete,

Unë e kuptoj, është edhe e natyrës, ndoshta është edhe defekt profesional, të cilin unë e çmoj që të jap një shpjegim në aspektin juridik, po edhe të trajtimit të kontratave që kanë konfidencialitet apo janë edhe kontrata afariste.

Andaj, shpjegimet që i dhatë ishin të shkëputura në tema të ndryshme, edhe në data dhe atë që e kemi thënë për tri angazhime tona për sigurimin e vaksinës dhe për këtë arsye nuk është ky proces i lehtë, mbetet kompleks, por kur t'u referohemi edhe deklarimeve, nuk qëndrojnë. Kërkoj falje, kërkoj falje, por kontakti zyrtar dallon nga kontakti i formalizuar me letra dhe ju e kuptoni shumë drejt.

Asnjëherë nuk kemi thënë dhe për këtë arsye po kërkojmë transparencë që nuk ka tërheqje nga prodhuesi në negociimin e kontratës, ka prolongim, ngecje. Ne e kemi quajtur, në gjuhë mund të përdorim çfarëdo, po nuk ka tërheqje, ka prolongim nga data të përcaktuara për ardhje të vaksinës. Atë që po insiston edhe kolegu im këtu, Arbeni, po insiston edhe ish-ministri Ismajli, domethënë dinamika e sjelljes dhe ardhjes së vaksinës. Cila ka qenë, e Covax-it, mos e përzieni Covax-it me Pfizer-in. Kështu që, ju lutem, vetëm t'i kemi definimet e qarta.

Edhe një herë po them, nëse më dëgjuat shumë drejt unë i tregova saktë kur e kam përcjellë letrën, ka qenë data 30-31 mars, 31 marsi, janë 15 ditë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Uran, nuk po e kuptoj, ti ke qenë ministër para pandemisë, nuk e di çka. A të ka rrokur pandemia pak a? Po kërkon replikë deputeti Uran Ismaili.

URAN ISMAILI: Tash këtu 90% nuk kam qenë, tre ministra jemi e krejt po flasin. Kështu që nuk i bie ajo veç pse kam qenë ministër gjatë pandemisë të flas apo jo, ai më përmendi dhe bëra replikë.

Pra, çështja është që, në qoftë se e këqyr kontratën sipas modeleve normale të kontratave, ajo që po e thua ti ndoshta ka një të vërtetë, duhet kuptuar që Pfizer në mënyrë rekorde ka bërë kontrata me krejt shtetet, pra nuk qëndron fakti që kontratat, a i dini sa kohë duhen, pra në mënyrë rekorde i kanë kryer kontratat e jemi duke folur për miliona vaksina.

Dhe, çka është një problem i madh këtu. Në asnjë moment, pra debati nuk është veç për kontratë, debati është për çka kemi bërë, është për vaksina. Neve po na duhet produkti, neve s'është duke na interesuar kontrata, as s'po më intereson. Mandej do të vijmë pyetjet sa e ke blerë, qysh e ke blerë, a ka mundur të blihet më mirë, kur e shohim kontratën. Neve po na duhet vaksinimi i popullatës.

Pra, kontratat janë bërë në mënyrë rekorde në krejt botën, veç në Kosovë nuk po mund të bëhet, po unë po pyes si ti, unë si ti jam duke pyetur: pse nuk po mund të bëhet veç në Kosovë, pse në mënyrë rekorde në krejt Evropën ka kontratë Pfizeri, në krejt botën, veç Kosova ka ekspertizë të jashtëzakonshme që nuk po mundën se aq shumë janë duke analizuar nenet e asaj kontrate që nuk po mundet Pfizer, janë duke u habitur Pfizer pse s'po mund të nënshkruajnë kontratën.

Pra, hajgare është kjo punë, silleni kontratën, sepse në krejt botën është duke u nënshkruar, të njëjtën merreni edhe te ne, qysh është nënshkruar në Gjermani, qysh është nënshkruar në Amerikë, atë të njëjtën, hiç mos e ndërroni, o veç nënshkruani më shpejt, nesër, një orë e më parë nënshkruajeni, sepse paraqiten probleme të reja. Vaksinimi i popullatës do të jetë problem. Mandej do ta kemi debatin e vërtetë. Faleminderit!

**KRYETARI:** A ke kërkuar kundër-replikë. Urdhëro, Doarsa Kica-Xhelili.

**DOARSA KICA-XHELILI:** Faleminderit!

Nënshkrimi i marrëveshjes, në fakt, nuk nënkupton me automatizëm që ato vijnë pas një jave, nuk përcaktohet ardhja e vaksinave me nënshkrim domosdoshmërisht. Plani dinamik mund të jetë pas dy jave, mund të jetë pas tre muajve, unë këtë po e them.

Në qoftë se ju jeni në gjendje të publikoni një dokumentacion të konfirmuar nga Pfizer që prapë po e rrezikon komplet procesin, prapë po them, edhe thoni që në fakt kanë pasur të vijnë më 5 maj, sepse edhe ti vetë në fund të marsit ke thënë që është e pamundur të vijnë në prill...

**ARMEND ZEMAJ:** A donë ta shohin?

**DOARSA KICA-XHELILI:** Po, mandej e shoh, po. Ti e ke thënë si dritare muajt mars-maj dhe në fund ne s'jemi në muajin maj, unë s'po e kuptoj këtë çështje. Për më tepër, nuk po flas për faktin që s'u krijua as korniza ligjore, more për të ardhur ato vaksina, qysh po mund të flisni për ardhjen...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti i PDK-së, Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: A po i ulni në vend këta, kryetar?

KRYETARI: Ju lutem, t'ia mundësoni fjalën deputetit Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Është mirë të sillemi pak më seriozë, se është turp për pozitën e deputetit të sillet kështu, sidomos këta deputetët e rinj. Le t'i shohin edhe qytetarët çka janë duke bërë, se s'po shihen, mirë është t'i shohin deputetët e t'i thonë vetes, a po di, është gjynah prej votave që i kanë marrë.

KRYETARI: Mirë është tash!

MEMLI KRASNIQI: Të lutem, a mund të ma kthesh prej fillimit kohën se shkoi 1 minutë.

KRYETARI: Zonja Xhelili, zoti Zemaj, vazhdojmë me...

MEMLI KRASNIQI: Po, faleminderit!

Shiko, ky ka qenë një debat i thirrur për shkak të nevojës dhe situatës emergjente, edhe unë mendoj që dje është diskutuar goxha shumë dhe fillimisht nuk është se kam dashur të përfshihem në këtë debat, por realisht duke dëgjuar argumente të ndryshme, por edhe diskutime të ndryshme, është e pamundur të mos them diçka dhe zhgënjimi i parë i këtij debati është që Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, as një minutë nuk ka qëndruar në debatin për temën më të rëndësishme me të cilën ballafaqohemi ne dhe kjo është një përgjegjësi e skajshme e njeriut që udhëheq Qeverinë e Kosovës. Pa dyshim ministri ka qenë këtu pothuajse gjithë kohën, po ti, ministër, po dukesh që je i vetmuar, sepse s'e ke mbështetjen e kryeministrit tënde, e besa edhe të shumicës së kolegëve, të cilët pa dyshim është dashur të jenë këtu.

Në anën tjetër, unë jam po ashtu i zhgënjyer edhe me disa prej informatave që i kemi marrë prej jush dhe më së shumti me faktin që edhe ti ke abstenuar prej udhëheqjes së betejës me pandeminë, për faktin që vetë the që nuk je në krye të procesit për sigurimin e vaksinës, që ishte për mua një befasi jashtëzakonisht e pakëndshme. Nuk është për mendimin tim normale të udhëheqësh këtë proces një sekretar i Ministrisë, edhe në qoftë jashtëzakonisht i mirë, e aq më shumë për faktin që ai është në ministri, më duket tash e ke kthyer që nja një muaj ditë.

Pra, nuk e ka as mbamendjen institucionale të muajve të fundit çka ka ndodhur, veç nëse e merr shembull Shqipërinë, kryeministri i Shqipërisë që është po ashtu edhe kryeministri i kryeministrit tonë, ai e ka udhëhequr krejt procesin edhe vetë ka shkuar në SHBA vitin e kaluar të diskutojë me Pfizer-in pikërisht për temën për të cilën ne po flasim sot. Debati për mendimin tim është dashur të jetë i fokusuar se çka mund të bëjë secili, ama përgjegjësia është juaja. Dhe, për mendimin tim, turpi i këtij debati ka qenë tendenca e deputetëve të shumicës t'i empirizojnë

vdekjet në Kosovë. Kanë vdekur 10 vend, në vend se 14 para një jave, çka po doni të thoni? Që pak janë 10 vdekje, a!

Dje keni folur ju, ministër, thoshit kemi vdekje një shifrore, thua ti është për lavd kjo punë. Nuk keni vdekje njëshifrore, dje keni pasur 11, sot 8, 16 ditët e fundit kanë vdekur 161 njerëz. Çka t'u thuhet atyre 8 familjeve që i varrosin sot njerëzit që u kanë vdekur prej COVID-it, që jeni pak, tetë jeni, s'jeni 12, 14. Jam i bindur që nuk mendon ti ashtu, kurrë s'kisha dashur të besoj që ti mendon që janë pak. Më habitin disa deputetë që ndoshta e ndjejnë veten që duhet dëshmuar që po flasin diçka dhe empirizojnë që kemi më pak ose kemi më shumë. Nuk kemi më pak, kemi njëjtë, nuk ka dallim 10% më shumë të infektuarve ose më pak, jemi keq dhe s'kanë dhënë kurrfarë rezultati masat. Trefish më pak ke sot teste se sa që ke pasur para 3 jave. Normalisht që bie numri i infeksioneve, por pyetni familjet që po ballafaqohen me këtë problem, a e kanë më lehtë, a e kanë më vështirë. E kanë njëjtë, njëjtë e kanë!

Dhe, sinqerisht ju them në emër edhe të PDK-së që e ka thënë edhe shefi i grupit parlamentar, debati ka qenë jo veç për kritikë, pa dyshim që edhe për kritikë, po ka qenë edhe për t'u shtuar ky debat dhe të shikohet çka mund të bëjmë, a ka ndonjë ndihmë të mundshme. Po, mos u habitni se dje keni thënë kjo është betejë e të gjithëve, nuk është betejë e të gjithëve, është betejë juaja dhe e qeverisë tënde, para së gjithash, sepse ju e keni pushtetin, ju po dilni dhe po na thoni na kanë votuar 50%, po ju kanë votuar 50% për ta udhëhequr këtë vend, e ju çka jeni duke bërë, jeni duke u arsyetuar, karakteristikë e kësaj qeverie që një muaj e gjysmë që jeni në pushtet është arsyetimi, veç po arsyetoheni.

Më falni, nuk është më koha e arsyetimeve, koha është e punës dhe mua po më vjen keq që edhe po krahasoheni, pse po krahasohesh me Armend Zemajn, e keni kritikuar që ai s'ka bërë kurrfarë pune të hairit, mos u krahaso me të, nëse ai ka bërë punë të keqe, tregona që je duke bërë punë më të mirë. Unë e kuptoj parimisht konfidencialitetin e kontratës, nuk mund t'ju kuptoj që s'mund të jepni as datë të përafërt. Kemi edhe ne përvojë me kontrata, me konfidencialitet, jo për vakcina, shyqyr s'na ka rënë të merremi me pandeminë në të kaluarën, ama konfidencialiteti flet për disa çështje, të cilat më vonë ndoshta mund të publikohen, ama të na japësh pak shpresë. Krejt çka po thua është, ju lutem, keni durim. Ne kemi durim, se s'bën pa pasur durim, prej zorit e kemi durimin, por nëse shkojnë edhe dy muaj, e për fat të keq vdekjet nuk janë duke u zvogëluar, minimalisht janë duke u zvogëluar, mund të jenë edhe 600 të vdekur, për ta si patën durim, si s'patën durim, ata s'mund të vaksinohen, e si rrjedhojë ndoshta të kenë tragjedi ato familje.

Tek e fundit, ju mos e shkelni konfidencialitetin, por po jua kujtoj që keni shkelur Kushtetutën dhe për këtë s'po them unë, ka vendosur Gjykata Kushtetuese, po hajt, dy raste janë të konfirmuara në Qeverinë Kurti 1, po konfidencialitetin po e ruani më shumë se sa Kushtetutën, mirë boll. Ky ministri i kaluar nuk e ka kryer punën mirë, po ti mos e merr shembull. Pse po



them që s'e ka kryer punën mirë, se me Armendin njihem në këtë Kuvend që nja 5-6 mandate bashkë, nuk e ka kryer punën mirë, personalisht në qershor kur e kemi votuar rishikimin, në fjalën time le që ia kemi shtuar buxhetin, për vaksina i kam kërkuar kështu decidivisht, lypeni në transkript, qershor ka qenë, kontakto menjëherë me Pfizer, me Moderna, me Astra Zeneca dhe lypni vaksina, se do të jetë rendi i gjatë për vaksinat.

E, tash ne jemi gati në qershorin tjetër dhe s'kemi vaksina, përveç një lëmoshe, faleminderit prej tyre që na ka dhënë Covaxi me 24 mijë vaksina. Tema është te vaksinimi, njerëzit janë të shqetësuar. Nuk dua t'ju them që ju jeni pa ndjenja, sepse s'besoj, nuk besoj që jeni bash aq pa ndjenja sa të thoni hajt të bëhet çka të bëhet. Ama, të jeni të bindur po ashtu që qytetarët nuk janë duke e parë një proaktivitet, një angazhim të mjaftueshëm dhe është shqetësim, sepse këtu figurativisht po, mundet secilin të na rrokë lotoja e vdekjes së COVID-it. Pothuajse, secili këtu kemi pasur ballafaqim ose personal, ose familjar me këtë punë dhe nuk është e lehtë dhe s'janë temë veç vaksinat, janë edhe ato që i keni thënë tërë ditën në debat, mungesa e medikamenteve, stërngarkimi i kapaciteteve mjekësore, stërlodhja e stafit shëndetësor, krejt këto lypin përgjigje, po vaksinat janë tema prioritare pa dyshim.

Suksesi i vaksinimit është jetik, sepse ajo ka efektin edhe shëndetësor, po ka edhe efektin ekonomik, sepse vendet që kanë arritur një nivel të vaksinimit, po shihni kanë filluar të rihapen, ekonomitë e tyre kanë filluar të ringjallen dhe ekonomia jonë jo që është në stagnim, po është para kolapsit dhe çdo vonesë, përveç shpëtimit të jetëve, e shpëton edhe ekonominë, për këtë arsye është ky preokupim. S'është kjo një temë që hajt, valla, të kemi thirrur për të zënë ngushtë, mos e keqkuptoni, s'është kjo punë të ziheni ngushtë, secili këtu në mënyrën e vet u mundua të ndihmojë, ose të japë një sugjerim, ama veprimet janë tuaja, për atë arsye po them, beteja është juaja. Ne mund të bëhemi pjesë si Kuvend, për këtë arsye tek e fundit është Kuvendi, se nuk kemi instrumente të tjera, bile ne në opozitë nuk kemi, ata deputetë që patën fjalime kështu të shkruara të mazhorancës që jo s'pati propozime, ata s'kanë dëgjuar, jua kanë sjellë fjalimin, po janë irelevante realisht.

Unë e kam edhe një çështje, domethënë, ministër, se po e shoh se po më shkon koha. E para, thashë jam i zhgënjyer që s'je në krye të betejës për t'i marrë vaksinat, sepse nuk mund ta kryejnë punët të tjerët. Për mendimin tim, ti duhet të jesh, mirë kishte qenë kryeministri, por nëse jo kryeministri, atëherë është dashur ti të jesh në krye të krejt procesit të sigurimit të vaksinës. Edhe, po e llogaris që po e marr me besim që vijnë vaksinat, besoj që vijnë, dhe shpresoj që do të vijnë në numër edhe më të madh se sa ato që i ka negociuar ministri Zemaj, sepse na keni lodhur duke u kritikuar ndërmjet vete që nuk po e dimë cila është e vërteta. A ka pasur t'i sjellë 500 mijë e t'ia nisin të vijnë në maj, a do të vijnë më pak a më shumë, a ka qenë e vërtetë a jo, tek e fundit, njerëzit po e dinë veç që s'ka vaksina.

Por, unë e kam edhe një çështje që lidhet me juve: njëherë dhe keni thënë, edhe keni thënë me muaj të tërë, na e keni lënë punën në gjysmë, ty të ka mbetur puna në gjysmë një herë me mocion të mosbesimit, unë druaj, ministër, që ti do ta lësh punën në gjysmë prapë, po flet që deri në fund vitit do të vaksinohen 60% të njerëzve, por unë jam i bindur që ti sot s'mund t'u premtosh qytetarëve e t'u thuash, po, do të qëndroj deri në fund të garës me pandeminë dhe nuk është fer nëse sot je këtu e merr përgjegjësi dhe në fund e lë këtë punë në gjysmë, e lë betejën me pandeminë në gjysmë, e lë edhe rrugën e vaksinimit në gjysmë. Nëse e ke marrë këtë përgjegjësi, përgjegjësia është ta kryesh deri në fund, s'ka nevojë mandej të na flisni për dorëheqje, sepse rruga që përgjysmohet me vullnet tëndin është e...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Po, ministri Vitia e ka fjalën.

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Faleminderit, zoti Krasniqi!

E para, në asnjë moment nuk kam thënë se nuk jam në krye të betejës sa i përket sigurimit të vaksinave për COVID-19. Në krye të betejës asnjëherë nuk të kam thënë, në krye të ekipit negociues, edhe shumë mirë e dini se edhe ju keni qenë ministër, se janë disa çështje të deleguara, në krye të betejës natyrisht se jam unë. Edhe, dje nëse nuk më keni dëgjuar, po e përsëris, në krye të betejës është edhe Kryeministri Kurti, edhe Presidentja Osmani, mirëpo përgjegjësitë kryesore, zoti Krasniqi, edhe ju qytetarë të nderuar, i kam unë, prandaj flas me përgjegjësi të plotë se nga maji kur të fillojnë të vijnë vaksinat, ky proces nuk do të ndalet, por do të vijnë vazhdimisht vaksinat.

Është shumë interesant, jeni shumë më të zëshëm tani se sa që keni qenë në një kohë kur sinqerisht ka qenë situata komplet e dalë jashtë kontrollit, nuk po them që është shumë më mirë tani, natyrisht unë e çmoj secilin ofrim të bashkëpunimit nga ju për të përmirësuar situatën, mirëpo çdoherë duke e pasur unë përgjegjësinë, por kjo zëshmëria juaj, ky zelli juaj tani sinqerisht është pak për t'u befasuar.

Edhe e thatë disa herë dhe po e përsëris prapë, po e thoni edhe ju janë 30 ditë, po të kishin qenë të prodhuara, po të kishin qenë në stoqe, për 30 ditë ka qenë e pamundshme të vijnë deri tani. Për 30 ditë janë bërë të gjitha ato që duhet bërë dhe për këtë qytetarëve u garantoj se janë bërë të gjitha, mbi mundësitë, në bashkëpunim me të gjithë që vaksinat të sigurohen me kohë. Duke pasur parasysh se po, është e drejtë dhe është e qartë se vaksinat tanimë nuk janë vetëm çështje shëndetësore, se do të hapin ekonominë dhe shumë sektorë të tjerë, natyrisht që kjo ma ka shtuar përgjegjësinë, natyrisht se kjo ia ka shtuar përgjegjësinë edhe Kryeministrit Kurti, duke caktuar zëvendëskryeministrin Bislimi, i cili në baza ditore mbledh ose kontaktojmë se ku jemi me këtë proces.

Përndryshe, të gjitha propozimet që ju i keni dhënë dje dhe të gjitha ato që do t'i jepni në të ardhmen, do t'i dëgjojmë, për të gjitha propozimet që ju i keni dhënë dje, të jeni të sigurt që veç i kemi filluar, çka do që mundeni ose mendoni që mund të na ndihmoni, vazhdoni edhe me propozime të tjera dhe prapë do të jemi edhe të hapur, edhe do t'ju mundësojmë që secili bashkërisht të jemi në këtë betejë që është e përbashkët. Për fund, absolutisht të gjitha ato që i kam deklaruar dhe të gjitha ato që i kam thënë, do t'u qëndroj deri në fund, zoti Krasniqi, dhe për këtë do të bindeni edhe ju bashkë me qytetarët, ashtu siç thashë disa herë deri tani. Faleminderit!

**KRYETARI:** Replikë, Memli Krasniqi!

**MEMLI KRASNIQI:** Ministër, faleminderit! Nuk ke faj, është e kuptueshme që ty të duket që jemi më të zëshëm kundër teje se sa ndaj kundër Zemajt, sepse tash i përcjell, se të drejtohen ty, atëherë nuk e di sa kemi qenë të zëshëm. Edhe Armendit i duket që kemi qenë më të zëshëm ndaj tij, e sidomos në fund të korrikut e gushtit kur ne kemi qenë në situatë të tmerrshme, të ngjashme me situatën që kemi qenë tash dhe që ende po vazhdon.

Nuk jemi më të zëshëm me ty se sa me ish-ministrin Zemaj, po është normale me ju, dukur juve, sepse ju s'keni qenë atëherë në garë, as ju s'keni qenë të zëshëm bile, mua më duket që prej kur e ke përfunduar mandatin e kaluar si ministër, deri tash që e ke marrë, nuk e di që ke folur bile për këtë punë, po ndoshta s'kam mundur që të përcjell. Është e vërtetë, unë vetë ta përmenda që janë 30 ditë, nuk po të themi ne qysh s'i bëre ti vaksinat, po nëse je duke na thënë që e ke filluar krejt prej fillimit, është gabim. Presim 30 ditë, sepse ne po presim që ke pasur një proces ta vazhdosh, edhe nëse ka pasur ai proces ndonjë të metë, të rregullohej e të shkohet tutje, kjo është arsyeja që unë nuk po mund ta arsyetoj idenë që gjithçka ka filluar prej fillimit dhe po shpresoj që s'ka filluar.

Përkundër ndryshimeve që keni mundur t'i bëni dhe përkundër faktit që unë prapë besoj dhe po të kisha qenë unë në vendin tënd, nuk isha deleguar te asnjë njeri përgjegjësinë kryesore që është sigurimi i vaksinave. Po, mos harroni, ti po fol veç për Pfizer-in, asnjë fjalë për Modernën, për "Johnson & Johnson", marrëveshjet direkte me Astra Zeneca, a ka mundësi të merren vakcina prej këtyre? Janë vakcina të aprovuara edhe në Evropë, edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, meqenëse Sinovacun nuk po doni ta merrni, përkundër që nja 10 shtete të BE-së janë duke u vaksinuar me Sinovac, shtete anëtare të BE-së, s'keni dashur ta merrni prej Shqipërisë, në rregull. Pfizeri të shpresojmë sa më shpejt, po Moderna, Johnson & Johnson-i, Novavaxi çka u bë me këto?

**KRYETARI:** Zoti ministër, i keni dy minuta për ta bërë këtë sqarim!

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Me të gjitha kompanitë prodhuese kemi kontaktuar, me të gjitha kompanitë prodhuese jemi në negociim, arsyeja pse nuk i kemi përmendur të tjerat, është se ato

nuk janë në gjendje të na sjellin më herët vaksinat se sa kompania në fjalë, arsyeja është e thjeshtë, nuk janë kontaktuar me kohë dhe tash jemi në situatën kur jemi duke kontaktuar dhe kemi hyrë në radhën e tyre, por përgjigjja e tyre është “nuk jemi kontaktuar me kohë”. Do të mund të marrim edhe nga ato vakcina, por jo shpejt sa do të marrim nga kompania që thashë më herët. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Besim Muzaqi. Zoti Zemaj, dëgjoni diçka për shkak të përgjegjësisë që e keni pasur kur ju përmendet emri edhe prej deputetëve të tjerë, mundësia ime nuk është të ta jap fjalën çdo herë. Besim Muzaqi e ka fjalën!

**BESIM MUZAQI:** I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë të respektuar,

Të dashur qytetarë të Republikës,

Thirrja për debat parlamentar në situatën me pandeminë COVID-19 më bëri që të ndihesha mirë dhe njëkohësisht më dha detyrën për t'i kontribuar këtij debati si deputet i Republikës dhe si profesionist shëndetësor, gjegjësisht si farmacist që jam. Ideja e debatit frytdhënës do të ishte analizimi i situatës socio-epidemiologjike në vend, pikat kritike që e bëjnë sistemin tonë shëndetësor të brishtë, idetë që do të mund të përmirësoheshin dhe ta përmirësonin gjendjen e kapaciteteve, qoftë resurseve humane apo atyre materiale, furnizimeve me barna, mikro dhe makro menaxhimi. Përkundrazi, nga kolegët tanë deputetë të opozitës gjatë kësaj seance dëgjuam gjuhë mllëfi e shpifjeje, të pabazuara në argumente, po që burimin e ka te frustrimi i procesit të 14 shkurtit.

Të nderuar kolegë opozitarë, në fjalimet tuaja të zhurmshme nuk kishte aspak brengë të sinqertë për situatën shëndetësore të qytetarëve të Republikës, shkaktuar nga virusi Sars cov 2, por kishte shifra e refrene, të cilat dëshpërimisht sulmonin pa asnjë argument një qeveri e një ministër që ka marrë detyrën vetëm para 34 ditësh. Jemi për t'jua dëgjuar kritikën, për t'jua pranuar edhe idetë kreative nëse i keni, por së pari duhet ta dëshmoni që e keni me zemër për qytetarin e për Republikën. Përpjekja juaj për të kritikuar udhëheqjen e shkëlqyeshme të ministrit Vitia dhe Qeverisë Kurti 2 në përgjithësi, nga ju deputetë opozitarë, e sidomos nga ju dy ish-ministra të Shëndetësisë, është e pamundshme dhe e pamoralshme.

Ministrin e Shëndetësisë e kemi një model humanisti e profesionisti dhe prapa e ka një organizatë të tërë, që i beson dhe e mbështet. Ndërsa ju, të nderuar ish-ministra Shëndetësie, duke mos qenë profesionistë të fushës, edhe pse ju perënduan mandatet thuajse asnjëherë nuk arritët që të përbrendësoni e të kuptoni as edhe termat e definicionet elementare shëndetësore. Njëri dje tha që vaksinat janë produkte komerciale, duke mos e pasur idenë çka janë produktet biologjike si nënkategori e produkteve farmaceutike. Të tillët ministra e qeveri të partive të tyre e kanë lënë Kosovën e vendin tonë të vetmin vend në Evropë pa sigurime shëndetësore e pa sistem

informativ shëndetësor, përkundër që në këtë Kuvend në vitin 2014 është miratuar Ligji për sigurime shëndetësore, por asnjë hap tutje nuk është bërë në drejtim të implementimit të tij.

Ndërsa, për sistemin informativ shëndetësor dihet se fondet janë shpenzuar, kurse SISH-i nuk është askund. Tjetri ish-ministër kur i doli Pandemia nga kontrolli filloi që t'i diagnostikojë qytetarët përmes shikimit. Halli është qytetar e megjithatë besoj që halli juaj nuk është as mungesa e vaksinave, përkundrazi. Ju tashmë shqetësim e keni ardhjen e tyre, për çka ju nuk kontribuoi derisa ishit në detyrë e si pasojë i kemi këto vonesa dhe rezultat i këtyre vonesave kemi edhe humbje jetësh të njerëzve.

Qasja profesionale që ministri Vitia pati me prodhuesit e vaksinës ka ndikuar që përkundër vonesave të qeverive paraprahe apo më mirë t'u themi me emrin e tyre të vërtetë, "qeverisë ilegale", së shpejti do të marrim kontingjentet e para të vaksinave të cilat nuk do të ndërpriten dhe ashtu siç u tha nga ministri, deri në fundvit do të kemi vaksinimin e mbi 60% të qytetarëve që duhet vaksinuar.

Analiza e bazuar në evidenca e prezantuar nga ministri Vitia lidhur me gjendjen që e ka gjetur Ministrinë e Shëndetësisë, hapat që ka ndërmarrë dhe situatën momentale epidemiologjike, tregon që masat e ndërmarra nga Qeveria Kurti 2 ishin efikase dhe kemi rënie të të infektuarve për më shumë se 30% dhe kapacitetet spitalore nuk janë të tejmbushura ashtu siç ishin.

Si pozitë ju bëjmë thirrje për bashkëpunim e konstruktivitet dhe për të dhënë ide që do të mund ta ndihmonin që të dalim nga kjo situatë. Ministri Vitia ka dëshmuar që u takon edhe atëherë kur keni për t'i dhënë vetëm adresa të kompanive farmaceutike, adresa të cilat edhe ashtu janë publike. Por sidoqoftë, ju pastaj mund edhe të fotografoheni dhe t'ua dëshmoni qytetarëve se sa shumë po i ndihmoni Qeverisë në sigurimin e vaksinës, sepse ua keni ofruar kontaktet.

Të dashur qytetarë të Republikës, respektoni masat që Qeveria Kurti ka vendosur, sepse shumë shpejt do të vijnë edhe vaksinat dhe do të vaksinoheni, sepse keni zgjedhur një Qeveri të përgjegjshme e cila nuk është asnjëherë si ato të mëparshmet. Faleminderit!

**KRYETARI:** A keni kërkuar replikë, zoti Zemaj? Replikë ka kërkuar zoti Zemaj.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryetar, edhe në mirëkuptimin tuaj në respektimin e Rregullores së punës së Kuvendit!

Sa i përket përgjigjes për deputetin Memli Krasniqi, nuk ishte dje, por në një ndër diskutimet dhe qartësimet e kësaj situatë në interesin e përgjithshëm, si po e quajmë të gjithë, aplikimi i parë zyrtar i Republikës së Kosovës dhe i Ministrisë së Shëndetësisë për sigurimin e vaksinave ka qenë 30 qershor 2020. Domethënë, nga ajo ditë ka filluar angazhimi ynë permanent për sigurimin e vaksinës në të gjitha nivelet, zoti ministër. Edhe me Modernen, edhe me Jonson &

Jonson kur kanë dalë në përdorim, jo para se me e marrë licencimin. Domethënë, vetëm duhet të jemi të sinqertë dhe korrekt, pasi prapë po them se është interesi i përgjithshëm.

Ndërsa, vetëm një fakt është evidente që neve, mund të them edhe mua, por mendoj edhe popullin e Kosovës dhe institucionet tona shëndetësore që na bëjnë krenar me dhjetë muajt tonë të qeverisjes, asnjëherë me daljen nga kontrolli të situatës pandemike. Jemi pothuajse i vetmi vend edhe në rajon, por edhe më tej, që tri elemente nuk na kanë ndodhur e që janë pozitive në menaxhimin dhe mbajtjen nën kontroll të situatës pandemike. Asnjë qytetar i Republikës së Kosovës nuk ka mbetur pa shërbime shëndetësore. Asnjë i vetëm nuk ka vdekur jashtë institucioneve spitalore dhe asnjë i vetëm nuk ka bërë vetëvrasje për shkak të situatës me Pandemi. Këto janë tri karakteristika që duhet të çmohen dhe të përcillen dhe që quhet mbajtje e situatës nën kontroll.

Sa i përket sulmeve, nëse në historinë parlamentare del një individ, një ministër, që është sulmuar më shumë sesa ministri Zemaj, atëherë nuk e di cila...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa.

**HAJDAR BEQA:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Debati i ftuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është një shqetësim i qytetarëve tanë, ku çdo ditë po rritet numri i të vdekurve si pasojë e infektimit me COVID-19.

Zoti kryetar, a po ia japim replikën zotit Krasniqi? Atëherë, ju kisha lutur t'ia jepni, se kështu s'mund të diskutojmë.

**KRYETARI:** Veç pak qetësi, ta kryejë fjalën një herë zoti Beqaj.

**HAJDAR BEQAJ:** A e merr replikën zoti Krasniqi apo vazhdojmë. E ka shkurt, pastaj vazhdojmë, se nuk mundemi replika të shkojë...

**KRYETARI:** Vazhdojmë pra me kundër replikën e zotit Krasniqi.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit, kryetar!

Të lutem, veç Rregulloren mos e riinterpretë, por interpretoje qysh është. Kur është replikë është replikë, kur është kundër replikë është kundër replikë. Unë e pata veç me i thënë zotit Zemaj,

këtu kam qenë, se tha nuk ka qenë këtu. Këtu kam qenë, Armend, edhe të kam dëgjuar që ke thënë me 30-tin, por pata qejf me e rikonfirmua ti a e ke qua përnjëmend më 30 qershor. Se, këtu ju dy, ministri dhe ish-ministri, domethënë jeni duke krijuar mjegull totale.

Unë prita që përnjëmend arsyeja është se nuk e ke bërë ti inicimin e kontraktimit me kohë, ti po thua “E kam bërë me 30 qershor”, e përmende tash edhe Modernen. Tash, diçka s’është në rregull këtu, ose i keni pasur emailat gabim, ose për mos me thënë siç thotë populli “dikush po rren”, se diçka s’është në rregull, as për Pfizer, as për këto tjerat. Nëse atij po i thonë është me vonesë, 30 qershori s’është me vonesë. Tash, a e ke qua me 30 qershor? Ti po thua po. Veç ta kemi këtë qartësi.

**KRYETARI:** Hajdar Beqa e ka fjalën.

**HAJDAR BEQA:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Debati i ftuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është një shqetësim i qytetarëve tonë, ku çdo ditë po rritet numri i të vdekurve nga infektimi me Pandeminë COVID-19 . Është një nevojë imediate që të alarmojmë për situatën reale që po mbretëron në vendin tonë, ku si vend jemi gati në kolaps shëndetësor e fatkeqësisht, vendi ynë është në gjendje të rëndë në çdo aspekt. Një ekonomi në shkatërrim e sipër, pa një vizion të Qeverisë, gjendje shumë të rëndë në sistemin arsimor në të gjitha nivelet, shto këtu edhe mungesën e strategjisë dhe programin qeverisës të kësaj Qeverie, fatkeqësisht këto pasoja do të jenë më të rënda dhe më të gjata si rezultat apo pasojë e mos kryerjes punë nga institucionet përkatëse.

Vendi ynë çdo ditë po shënon numër rekord të vdekjeve, kurse Qeveria dhe ministri i Shëndetësisë pa fije përgjegjësie dhe sikur këto shifra nuk i shqetësojnë fare, na flasin se gjoja ka përmirësime. Nuk është e vërtetë që ka përmirësime, por fatkeqësisht çdo ditë gati po kemi numër më të madh të humbjes jetë të qytetarëve të vendit tonë.

Shteti ynë, ministër i së cilit ju jeni zgjedhur, zoti Vitia, fatkeqësisht me këto sjellje që po tregon se nuk ka zot shtëpie, i keni lënë pas dore mijëra qytetarë që kanë nevojë çdo ditë të kenë përkujdesje institucionale shëndetësore, ndërsa ju si ministër bashkë me Kabinetin Qeveritar, në krye me zotin Kurti, keni qenë të angazhuar në zgjedhjet e Shqipërisë, sikur këtu çdo gjë është normale. Po gjithçka po shohim, përveç normalitet nuk po shohim.

Pas fitores që e patët këtu e që po e përmendni shpesh më 14 shkurt, që nuk po ua konteston kurrkush, por po ju kërkojmë përgjegjësi, edhe ne, edhe qytetarët, menduat që të shtrini ndikimin edhe në Shqipëri, por fatmirësisht ky mashtrim që i bëtë qytetarëve tanë nuk iu shit atje dhe e

patë edhe vet. Besoj që e keni kuptuar tani pas datës 25 prill. Për 34 ditë nga marrja e mandatit për të qeverisur ju prioritet i Qeverisë, nuk pati prioritete Qeveria, nuk e pati punën dhe hallet e qytetarëve, që ua dhanë besimin, por u morët më shumë me Bojkenin. Harruat mandej edhe qytetarët që në luftë me Pandemi, në mungesë të vaksinave të premtuara, që po humbin çdo ditë jetë njerëzish që nuk marrin trajtimin e merituar nga shteti. Siç po duket halli juaj dhe i Albinit këto ditë nuk ka qenë i harmonizuar me hallin e qytetarëve tanë, por ka qenë më shumë me fushatën zgjedhore në Shqipëri. Dhëntë Zoti që pasi atje ka përfunduar fushata, tash i përkushtoheni punës, se sikur ta kishit siguruar vaksinën edhe ky debat sot nuk do të kishte pasur kuptim.

Ju ftoj, zoti ministër, ju vetëm këto halle qysh po shihet që nuk i keni, po e shfrytëzoni privilegjin e pushtetit dhe po vaksinoheni të parët dhe atë në emër të sakrificës. Ju lus dhe ju ftoj, që të lejoni edhe të prekurit nga ky COVID me ato vaksina që i ka marrë shteti ynë si lëmshë, sikurse po vaksinoheni ju të vaksinohen edhe ata në emër të sakrificës. Hipokrizi e llojit të vet kjo nga ana juaj. Më vjen keq, por një gjë e tillë po shohim çdo ditë.

Është jo serioze të thuash që ka rënë numri i të infektuarve, derisa ju nga 6 mijë teste në ditë, diku rreth 6 mijë teste, keni zbritur testet në 1500. A kjo qenka përmirësim i situatës? Kështu e matni rënien ju? Mos e fjeni inteligjencën e qytetarëve ministër, sepse nuk munden nëse kanë qenë 6 mijë teste e tash i kemi 1500 teste të themi që ka rënë numri i të infektuarve. Ndoshta ka rënë numri i testeve, po unë këtë e them çka po thonë qytetarët dhe çka po shohim në media.

Ministër, jemi ndër vendet e vetme në botë, që nuk kemi arritur të sigurojmë vaksinat për qytetarët tanë e ju përpiqeni të silleni sikur nuk ka ndodhur asgjë. Krejt do të thotë po silleni krejt normal. Kjo është më shumë e papërgjegjësi nga ana juaj. Mandej, me mos nënshkrimin dhe vonesën, them vonesën për nënshkrimin e Udhëzimit Administrativ ju keni rrezikuar vonesën e furnizimit dhe për muaj të tërë. E obligimi juaj, zoti ministër, është i kundërt nga ajo që keni vepruar. Nuk është të bëjmë vonesa, por të gjejmë rrugë dhe të përshpejtojmë dhe t'u sigurojmë qytetarëve shërbime më efikase.

Zoti ministër, nuk e di a e keni lexuar Ligjin për Pandeminë, ligj që është në fuqi në vendin tonë, ku shprehimisht përcakton se Qeveria e Kosovës dhe ministria të cilën ju e udhëhiqni obligohet ta sigurojë vaksinën kundër Pandemisë. Ju si ministër, nuk e di a e dini se si është gjendja me furnizim me oksigjen nëpër regjione e sidomos, qysh ka qenë. Ne e dimë që nuk kemi pasur furnizim të rregullt me oksigjen.

Ministër, a e dini se është obligim i Qeverisë, që përmes SHSKUK-së të sigurojë që të gjitha spitalet të furnizohen me oksigjen? A e dini se regjionet nuk kanë shumë kapacitete, sidomos në resurse humane, infektologë, kardiologë, mjekë të anestezionit, e të tjerë? A e dini se në pjesën më të madhe të kohës u kanë munguar barnat për trajtimin e pacientëve. Sot qindra qytetarë janë



duke provuar të gjejnë zgjidhje, të cilën nuk po ua ofron ministria, nuk po ua ofron shteti? Paramendoni, gjënë më elementare nuk kemi arritur t'u ofrojmë, oksigjenin!

Unë flas për regjionin prej të cilit vij. Diku rreth 60% nuk kanë mundur të furnizohen me spital, në këtë rast spitali regional Isa Grezda, shtoja edhe pacientët e Bajram Currit dhe të Tropojës, që ka pasur një marrëveshje shteti që të trajtohen në Gjakovë. Këtë besoj që ministri e di. Ndërsa, a keni harruar që ju keni bërë një premtim publik elektoral, që brenda vitit do t'i vaksinoni 60% të popullsisë. Kjo nuk po tregon me statistikat të cilat po i shohim. Deri më tani, fatkeqësisht kemi zero vaksina, keni siguruar zero vaksina, zero medikamente shtesë për qytetarët.

Kështu, që të them të drejtën, ministër, ne nuk kemi pasur ndonjë pritje të madhe prej juve, sepse ju njohim. Fatkeqësia qëndron se ju i mashtruar qytetarët për t'ua marrë votën, ndërsa sot që morët pushtetin ju keni abstenuar nga çdo lloj i përgjegjësisë dhe keni zero transparencë për atë që bëni në emër të sigurimit të vaksinës. Të paktën mendoj se duhet të jeni më transparentë, pa rrezikuar konfidencialitetet, nëse ka, te kontrata atje të cilën mendoj që jeni ju kompetentë.

Në këto ditë pamë shou konferenca, ku përmes tyre qytetarëve tanë u treguat se keni plane sekrete për menaxhimin e Pandemisë dhe po ashtu, plane sekrete për të siguruar vaksinën. Kjo më shumë se qesharake është e dhembshme, për qasjen që po tregoni karshi sfidave me të cilat qytetarët tanë po përballen deri me humbjen e jetëve. Nuk jemi Koreja e Veriut që mbanë sekrete veprimet shtetërore në dobi të qytetarëve të vendit tonë, po nuk jemi as SHBA-ja, as Anglia, as Gjermania, që kemi kapacitete laboratorike shkencore, se kinse qenkemi duke punuar në zbulimin e vaksinës. Sikur të jemi kah zbulojmë një vaksinë ndoshta na duhet ndonjë sekret për qytetarët.

Qytetarët e kanë një pyetje të thjeshtë, a ka vaksina dhe kur i kanë vaksinat? Nuk u intereson çka ka bërë, as ministri paraprak, as ministri aktual, as ministri që vjen pas teje. Sot, siç po shihet, ju ka dalë situata nga kontrolli, nuk po thirrni më konferenca, sepse nuk po keni çfarë t'u thoni qytetarëve për asnjë arritje, pra mbi të gjitha nuk keni përgjegjësi pse nuk keni vaksina, nuk keni as përgjigje, nuk dini kurë mund t'i siguroni ato, sepse nëse thirrni tash një konferencë duhet të keni një lajm për qytetarët, të cilin fatkeqësisht nuk e keni. Mos u ankoni, ju lutem, ministër, si me qenë në opozitë. Nuk jeni opozitë. Unë ju kuptoj, keni qenë në atë opozitë dhe jeni mësuar të ankoheni. Tash, qytetari ua ka dhënë juve kompetencat. I keni krejt mekanizmat në dorë, jeni qeveri andaj punoni, se qytetarëve nuk po u interesojnë as konferencat e juaja, nuk u intereson as çka po bën atje, a po udhëheq ti a sekretari a kush udhëheq. Unë konsideroj që gjendjen e pandemisë ndoshta është dashur ministri të propozojë të rritet në nivel kryeministri me e menaxhua e jo me ra në nivel të sekretarit, por megjithatë është kompetencë e juaja.

Andaj, kërkoj për qytetarët tanë nuk është më lajm testimi. Nuk është më lajm as sa teste i bën, ministër. Lajm është kur e kanë vaksinën. Unë kam plotë raste, ku jemi afër Shqipërisë atje,

qytetarët po u shkruajnë, i shkruajnë ministrin qytetarët e Republikës së Kosovës u drejtohen organeve të shtetit Shqiptar ku ua mundësojnë edhe pse s'kanë shtetësi qysh kanë kryeministri dhe të tjerët, shtetësinë e Shqipërisë, ua mundësojnë me shkua me e marrë vaksinën atje. Kam emra, mbiemra e listë të tërë, që vetëm që u shkruajnë dhe thonë “jemi në moshë dhe kemi nevojë” që t'u ofrojnë shërbime. Kërkoj që të harmonizoni, kërkoj nga ky Kuvend që t'i harmonizojnë rekomandimet të cilat i ka bërë në këtë rast edhe Partia Demokratike si kërkuese e këtij debati dhe këto rekomandime të jenë obligative për Qeverinë e Republikës së Kosovës me të vetmin qëllim që t'u ofrojnë shërbimin, në këtë rast t'i ofrojmë vaksinën që po ofron e tërë Bota. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ministri Vitia e ka fjalën.

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Po për besë, problemi dhe problemet në sistemin shëndetësor në Republikën e Kosovës janë shumë. Kemi problem shumë të madh me korrupsionin të cilin ju e dini. Kemi shumë problem, të gjitha ato që konstatuan vetëm mund t'ua vë nga një pikë dhe nga një miratim.

Kemi probleme me nepotizmin të cilin ju veç e dini. Kemi probleme me barnat, me resurse humane, kemi probleme shumë të mëdha edhe me infrastrukturë, kemi edhe shumë probleme në të gjitha anët e sektorit shëndetësor për shkak të keqmenaxhimit njëzetvjeçar i cili i është bërë këtij sektori. Mirëpo, një çka nuk pajtohem, ne nuk i kemi mashtruar qytetarët. Qytetarët e kanë parë këtë gjë, prandaj e kanë bërë ndryshimin.

Edhe në anën tjetër, besomëni, pritjet e juaja janë shumë më të mëdha sesa të qytetarëve. Prapë po e përsëris. Nuk kam parë një qytetar që ma ka bërë që për 30 ditë ju do t'i zgjidhni këto probleme. Unë ju garantoj që për katër vite do të zgjidhen të gjitha këto probleme që janë shkaktuar nga disa, nga shumica që ju i dini këtu për këto njëzet vitet e fundit. Edhe këto probleme do t'i zgjidhim, po jo për 30 ditë. Për 30 ditë do ta zgjidhim problemin e vetëm që është duke na shqetësuar tani nga mëngjesi deri në mbrëmje edhe në Ministrinë e Shëndetësisë, edhe në Qeveri, do të sigurojmë vaksinën, edhe kjo është ajo që do ta bëjmë.

Kurse, problemet e tjera me të cilat pajtohem komplet me secilin konstatim, të jeni të sigurt se do t'i zgjidhim. Disa vetë, disa bashkërisht natyrisht.

**KRYETARI:** Z. Beqaj ka kërkuar kundër-replikë.

**HAJDAR BEQAJ:** Faleminderit, kryetar!  
Ministër,

Ju po potenconi që ka korrupsion, ka krim, ka nepotizëm. Me Kod Penal dhe me Kod të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, mosdeklarimi te organet përkatëse është vepër penale. Të inkurajoj që të gjitha ato dukuri negative t'i çoni te organet përkatëse.

Një mund të të them ministër, nuk je opozitë më. Një mund të të them ministër, kështu po ta them shumë sinqerisht. Ke qenë ministër 150 ditë në Kurti 1 e Kurti 2. Je i vetmi ministër në Republikë të Kosovës që ke shkelur Kushtetutën. Kanë shkelur ligje, janë përgjigjur. Ju keni shkelur Kushtetutën në emër të zvogëlimit të testeve, pa pasur ndonjë analizë nga ekspertët e fushës dhe e keni bllokuar ekonomin tërësisht vitin e kaluar. Edhe sot, më shumë se dënime nuk po shohin qytetarët e Republikës së Kosovës. Edhe juve me xhipa të zinj, se i përmendnit, duke shkuar në Shqipëri përditë.

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Tinka Kurti.

**TINKA KURTI:** Faleminderit i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Media të pranishme,

Dua ta rikujtoj se në Kuvend po sillet një seksist e që prej foltores së Kuvendit po na flet për moral e për gjuhën. Deputeti që mori fjalën i pari në seancë sot, e ka ngatërruar fjalimin, sepse fjalimi i tij i parë do të duhej të ishte kërkimfalja për gjuhën e dehumanizuar që ka bërë Presidentes së Kosovës dhe dorën në zemër nuk është ofendimi i tij i parë që ka bërë ndaj grave. Gjuha e tillë po bëhet nxitëse e urrejtjes ndaj grave. Cili është kriteri moral këtu që dikush që promovon haptazi gjuhën mizogjene, seksiste, antifeministe, na flet për gjuhën. Vetëm mbi kriterin e hipokrizisë mund të mbahej sot një fjalim i tillë. Ky është abuzim i hapur i foltores së Kuvendit, njëjtë siç është i çdo hapësire publike dhe mund të flasë prej pozitës së profesorit në Universitet Publik apo në atë në televizion publik. Deputeti duhet të jetë shembull e jo të bëjë diskriminime e shkelje. Unë e kuptoj që situata është e ndjeshme, ndjeshmëria është maksimale dhe i kuptoj shqetësimet, sepse është pandemi në të gjithë botën dhe të gjithë po duam të dalim sa më mirë prej kësaj situatë, dhe është mirë për të gjithë që e kanë marrë fjalën, vetëm se jo të merret fjala për hir të hipokrizisë dhe të cinizmave politike.

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Jahja Kokaj.

**JAHJA KOKAJ:** Faleminderit, kryetar!

Zonja dhe zotërinj,

Konsideroj që ky debat është shumë me vend. Është shumë me vend, meqë kemi të bëjmë me një problem jashtëzakonisht serioz siç është jetë a vdekje. Pra, kemi të bëjmë me një fatkeqësi e cila ka karakter botëror, e jo vetëm kosovar. Më lejoni me respekt të konstatoj dhe të ju lus që sipas

mendimit tim kur flitet për një situatë kaq serioze, atëherë jo vetëm që duhet të zgjidhen diskutimet, por duhet të zgjidhen edhe fjalët, edhe fjalitë.

Mendoj që ato të cilat kanë karakter politik, ato të cilat kanë karakter militant, ato të cilat kanë karakter të cilat nuk përputhen me dimensionet e koronavirusit, ato të cilat nuk kanë karakter për mbrojtjen e jetës, ato ma merr mendja që nuk duhet të përdoren në këtë situatë. Pra të shfrytëzohet një situatë për t'i thënë ato mendime politike. Kërkesa e vaksinës ma merr mendja që është e domosdoshme, meqë është shpëtimi. Kur unë jam mendimin tim personal që ministri Vitia është njeri profesionist. Doktor Vitia është njeri profesionist. Është njeri i kompletuar në mënyrë profesionale. Është njeri pedant për nga sjelljet e tij, sipas mendimit tim që e njoh prej fëmijërisë, si nxënës shembullor, student i shkëlqyeshëm dhe pastaj si qytetar që me siguri ju dini më tepër se unë, se unë isha diku 30 vjet larg Kosovës, por me siguri ka lënë gjurmë shumë pozitive dhe se në këtë situatë ai po mundohet ta bëjë më të mirën. Po mundohet me mish e shpirt që ta bëjë më të mirën, por po është aq i hapur që po akuzohet për mostransparencë, që po thotë kushdo që ka mundësi ejani më ndihmoni.

Unë kam parë edhe një deputet të PDK-së më duket që publikisht ka shkuar te ministri Vitia dhe ai e ka falënderuar për ofertën, për ndihmë të informacioneve. Tash nuk e di sa ishin kredibile ato informacione të tjera, por po duhet të them se është i hapur dhe me mish e shpirt po mundohet. Por po më duket se kjo është një situatë analoge me ditën e formimit të Qeverisë Kurti 1. Ishte aty çuditërisht një deputet më kujtohet që sipas mendimit tim ishte shumë i respektuar, ia bënte çohu Albin, çohu kape punën. Ishte dita e parë. Ku të shkojë Albini? Kape puno. D.m.th. një kërkesë stereotipe, një kërkesë të çuditshme, që shprehte mllefin, që shprehte mosrespektimin, që shprehte një antipati të veçantë. Se fundi i fundit ne jemi vëllezër, vëllezër e motra. Nuk duhet të kemi mllef ndaj njëri-tjetrit në atë nivel që t'i tejkalojmë ato për të cilat na kanë zgjedhur dhe populli dhe ata që i përfaqësojmë. Duhet t'i përfaqësojmë në mënyrë të denjë.

Ministri Vitia ka ardhur vetëm qe 30 ditë është në atë pozitë. Ne e dimë sa është problematike. Ata që janë të informuar e dinë sa është problematike sigurimi i vaksinave. Janë shtetet, janë bërrylat atje të fuqishëm d.m.th. bërrylat ekonomike, potencialeve të caktuara shtetërore e dimensioneve të tjera të atyre bërrylave për sigurimin e vaksinave. Natyrisht që ka edhe diskriminime për shtetet që janë më të varfra, por ministri Vitia po e bën çdo gjë që është e mundur në kapacitetet e tij, me sinqeritetin e tij më të madh që ta sigurojë.

Dy fjalë desha t'i them edhe për votimin në Shqipëri.

Zonja dhe zotërinj,

Lidhur me këtë dua të them, sipas mendimit tim, secili duhet të niset nga sinqeriteti. Unë fjalimin nuk e kam përgatitur, por po e them më tepër nga zemra sesa nga mendja. Unë jam shqiptar, d.m.th. babë e babagyjsh i kam të Shqipërisë. Rastësisht kam lindur në Kosovë, për arsye se

babai im ka qenë i shkolluar në Romë dhe luftëtar dhe si i tillë, mos të hyj në histori, ai ka ikur prej komunizmit dhe është strehuar në Kosovë. Tani, unë kam marrë pjesë në UÇK sipas parullës që do të bëhet bashkimi i Kosovës me Shqipërinë. Këtë e ka pasur, për këtë kanë vdekur dy xhaxhallarë të mi. Për këtë 22 vite ka qenë babai im në burg, për këtë kanë luftuar djemtë e vëllait, për këtë jam i përkushtuar. Kjo është arsyeja kryesore pse unë i jam bashkëngjitur Vetëvendosjes, meqenëse është bërë një konsekuencë e paluhatshme për bashkimin kombëtar. Kjo është arsyeja. Nuk e kuptoni, por po më çuditni si s'e kuptoni, kur një njeri që është qytetar, unë jam qytetar i Shqipërisë, d.m.th. deri vonë kam qenë emigrant në Jugosllavi, kur jam qytetar i Shqipërisë, po jam edhe qytetar i Kosovës. Prandaj, është madhështore. Unë kam jetuar në botën demokratike, kam parë që njerëzit nuk përtojnë edhe sa janë madhështorë të bien në nivel elementar.

Kryeministri Kurti ka rënë në një nivel elementar si votues në Shqipëri dhe nuk di çka shihni aty të keqe. Se fundi i fundit çdo njeri ka mundësi, ka një ditë pauze, të shkojë atje dhe kështu me radhë. Ta ekzagjeroni aq shumë, në atë masë, ta politizoni aq shumë gatishmërinë e një njeriu, se fundi i fundit unë për veten time ai është virtyti më i madh i atij i cili aludon, tenton, ëndërron, shpreson dhe mundohet me mish e shpirt që Kosova e Shqipëria të jenë një. Ky është qëndrimi im dhe se në fund desha t'i them edhe dy fjalë për t'ju përshëndetur nga zemra vëllezër dhe motra. Ju lutem mos bëni, kërkesë e imja e sinqertë vëllazërore, mos bëni opozitarizëm me një seriozitet aq të madh siç është rasti i jetës ose i vdekjes, se COVID po merr jetë njerëzish dhe me këtë nuk është mirë të bëhet politikë.

**KRYETARI:** Tash e lus iniciuesin e debatit që ta paraqesë propozim-rezolutën. Deputeti Uran Ismaili, urdhëroni.

Më fal, se nuk e paskam parë që nënkryetari i Kuvendit e ka kërkuar fjalën si i fundit prej deputetëve që ka kërkuar të flasë.

**KUJTIM SHALA:** Faleminderit zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar ministra,

Në veçanti zoti ministër i Shëndetësisë,

Unë do të flas për dy çështje, meqë vlerësoj që i gjithë ky debat i këtyre dy ditëve ka të bëjë me dy çështje. E para masat dhe e dyta çështja e vaksinave. Këto dy çështje janë të lidhura.

Për të parën unë do të përpiqem të japë një shpjegim, ndërkaq për të dytën më shumë do të pyes, sepse s'kam njohuri specifike. Po ato njohuri që i kam do t'i them këtu. Pra më intereson të pyes ministrin, meqë edhe pse e kam dëgjuar gjatë këtyre dy ditëve, mendoj që ka mjaft paqartësi për çështje krejt bazike.

E para, sa u takon masave, unë mendoj që edhe teorikisht edhe empirikisht, derisa kanë një mbështetje shkencore masat arsyetohen. Kanë dhënë edhe rezultate konkrete, i kanë aplikuar të gjitha vendet e botës, mesa di unë me përjashtim të Suedisë. Dhe kjo ka një qëllim elementar jo që të eliminojë pandeminë, po që të bëjë më të lehtë menaxhimin e saj, sepse asnjë shtet s'ishte i përgatitur, pra s'kishte kapacitete që të menaxhonte një problem kaq të madh. Kosova aq më pak. kështu që unë mendoj që për masat ne edhe mund të flasim, por duhet të flasim më shumë ata të cilët i njohin dhe duhet t'i shtrojnë profesionalisht. Tani pse lidhet çështja e vaksinës me këtë çështje? Sepse masat do të na japin pak më shumë kohë, pra që të menaxhohim këtë situatë emergjente. Meqë zgjidhje tjetër nuk ka, sepse as masat nuk janë zgjidhja finale, pra e shtyjnë problemin, prandaj më duket absurde. Nëse e heqim argumentin që duhet të fitojmë kohë që të kemi vaksinat dhe i diskutojmë masat e shifrat e statistikave e evidencat, ato s'kanë asnjë kuptim, sepse kalon një valë dhe kthehet vala tjetër. Besoj që ministri këtë e di shumë më mirë sesa unë.

Po mirë, këtë kohë që po na e japin masat, a mos po e zhbëjmë ne me vonesat në këtë procesin e dytë, që është procesi i sigurimit të vaksinës? Unë zoti ministër e kam parë një tekst, një dokument, supozoj, ose llogaris që është autentik, atë dokument të cilin ju po e quani parakontratë, të cilin ju duket që e keni marrë më 31 mars dhe kishit dy javë kohë që ta negocionit, pastaj kishit edhe dy javë të tjera që të nënshkruanit marrëveshjen finale. Besoj që jam i saktë. E pyetja në fund e debatit është pyetja fillestare. Pra që është bërë edhe në fillim të debatit. Pse nuk e nënshkruat marrëveshjen deri më 30 prill? Është e qartë pse, sepse nuk e nënshkruat paraprakisht parakontratën ose paramarrëveshjen, ose dokumentin e negocimit të termave të kontratës ose të marrëveshjes. Pra, pse? Ky është problemi themelor.

Nëse ju s'mund të na e thoni, sepse kjo do të dëmtonte procesin e negocimit, unë heq dorë, e tërheq pyetjen, se duhet t'ju japim rast që të përmbyllni çështjen. Por këtu ka një fakt, që ne s'kemi vakcina dhe që ju s'keni nënshkruar parakontratën që do të hapte udhë nënshkrimin e kontratës, e cila ka pjesë integrale të tekstit. Teksti ka pesë faqe, përfshirë aneksin apo apendaksin, që t'i referohem me saktësi dhe në trup të tekstit të marrëveshjes ju keni edhe urdhrin për shpërndarjen e stoqeve. Madje të dhëna me data relativisht të sakta, pra në tri pjesët e fundit të vitit. D.m.th. stoku i parë që do të nënkuptonte tremujorin e dytë të këtij viti, me një sasi prej 51 mijë e sa, mos të merremi me shifra, stoku i dytë tremujorin e tretë dhe i fundit tremujorin e katërt. Edhe këto të gjitha së bashku s'do të ishin të mjaftueshme as për dozën e parë, por s'do të flisnim sot për 24 mijë doza të vaksinës. Pra ky është problemi themelor.

Nëse ne dëshirojmë, pra jo dëshirojmë, e kemi të domosdoshme që të menaxhojmë këtë proces, dhe të fitojmë kohë, pse po humbim kohë. D.m.th. çfarë qëllimi keni ju? Keni qëllim që ne të marrim sasi më të madhe në kushte më të mira financiare e të tjera, të jemi ndoshta edhe më të shpejtë apo jo? Sepse unë besoj meqë nuk ka zgjidhje tjetër dhe ne na duhen vaksinat, na duhen sa më parë që është e mundur. Sa më shumë që e shtyjmë kohën, na vdesin më shumë njerëz, njerëz tanë. Pra, sa më e shkurtër që të jetë koha e sigurimit të vaksinave, edhe numri i vdekjeve

do të jetë më i vogël. Unë këtë sqarim e kërkoj nga ju. Pra pse ngeli ky proces pezull? A keni hequr dorë nga negocimi i këtij procesi për të cilin folët edhe ju? A pranoni ju që ky dokument për të cilin po flas unë është valid etj?

Pra, këto janë çështjet themelore të këtij debati dhe nëse ju do të jeni i qartë besoj që edhe rekomandimet do të mund të jenë shumë më të qarta dhe shumë më të dobishme. Kjo është çështja juaj si ministër, e Qeverisë së Kosovës në radhë të parë si ekzekutiv, është edhe çështje e të tjerëve. Unë s'mund të bëhem ekzekutiv. Pra, mund të kem një ide ose jo, mund të jem një ide të mirë ose jo, mund të kem një pikëpamje ose jo, por në rrafshin ekzekutiv duhet ta zgjidhni ju, sepse për atë punë jeni aty. Unë s'po paragjykoj rezultatet e muajve të ardhshëm ose ditëve të ardhshme. Pra, edhe në kuptimin politik edhe personal, nuk do të thotë asgjë nëse ju premtoni diçka këtu, sepse unë s'jam votues i juaj, pra unë do të vlerësoj atë që nëse ka mungesa dhe e vërej, atëherë e them. Nëse s'e vërej nuk e them, sepse s'do zë jetë korrekte. Por, një përgjigje të saktë, unë mendoj që kam të drejtë që ta kërkoj për këtë çështje, nëse s'e dëmton procesin, gjithnjë. Dhe, më duket që është domosdoshme ta kërkoj këtë, sepse për këtë punë jemi këtu.

Kualifikimi si çështje politike, t'iu duket jonormal, vërtet në vete është jonormale, se kjo është çështje politik. Pse, çfarë janë politikat ekzekutive? Çfarë bënë Qeveria? Politikë ekzekutive. Politikën më të pastër, pra më konkrete dhe empiriken.

Në flasim këtu dhe këta bëjnë politikë konkrete. Mund t'iu pëlqejnë idetë tona ose jo, është çështje e tyre. Ndonjëherë në s'kemi të drejtë dhe këta kanë të drejtë dhe atë e provojnë rezultatet. Ndonjëherë rezultate s'janë të mira edhe për shkak se nuk kanë të drejtë të provojnë që s'kanë të drejtë. Ndonjëherë varet nga situatat konkrete të cilat vijnë, por ne s'i parashikojmë e të tjera.

Nëse kam qenë i qartë zoti ministër, dëshiroj të më jepni një përgjigje të saktë për këtë çështje. Faleminderit!

**KRYETARI:** Urdhëroni ministër! E keni fjalën.

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Ju faleminderit zoti Shala edhe për korrektësinë, edhe për pyetjet konkrete!

Më lejoni edhe një herë, nga fillimi e kam përsëritur shpesh dhe e kërkoj mirëkuptim tuaj.

Në bazë të marrëveshje janë shumica, të mos të gjitha gjërat konfidenciale dhe nuk mund t'ju përgjigjem. Në anën tjetër, në atë që mund të jap përgjigje konkrete në pyetjet të cilat ju i bëtë.

Unë iu garantoj se nuk ka pasur asnjë humbje kohe gjatë këtij procesi të cilit ju iu referuat. Unë iu garantoj se asnjë dokument nuk është refuzuar të nënshkruhet. Unë ju garantoj se ky proces as

edhe një minutë nuk ka mbetur pezull. Dhe, unë ju garantoj se asnjë vonesë të asnjë lloji nuk do të ketë në këtë proces.

Kaq mund t'ju them. Kaq mund t'ju them edhe qytetarëve në raport me pyetjet tuaja shumë legjitime. Në raport me korrektësinë tuaj. Nga ato në të cilat u përgjigja, të gjitha qëndrojnë dhe prapë po e them dhe prapë jam në gjendje që ta përsëris, për të gjitha këto që po i deklaroj sot, mbaj përgjegjësi morale, por edhe ligjore. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Meqenëse duket që debati u shter, mund të kalojmë në këtë pjesën që propozuesi ta sjellë përpara jush propozim-rezolutën dhe pastaj të kalojmë në fazën e votimit. Urdhëroni, zoti Ismaili!

**URAN ISAMILI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duke e vlerësuar nevojën e madhe që të sigurohen vaksinat dhe mjetet e medikamentet mjekësore dhe shëndetësore për të mbrojtur shëndetin dhe jetën e qytetarëve në situatën e pandemisë, propozojmë një rezolutë për Kuvendin e Republikës së Kosovës:

#### R e z o l u t ë

1. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës që të marrë masa, veprime e vendime të nevojshme për sigurimin e vaksinës anti-COVID-19, si dhe mjeteve dhe medikamenteve shëndetësore për menaxhimin e situatës pandemike në afat më të largët, një muaj nga miratimi i kësaj rezolute.
2. Bazuar në Ligjin nr.07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës që të bashkëpunojë me IKSHPK-në për të miratuar planin për vaksinim të qytetarëve me vaksinën anti-COVID-19, dhe i njëjti të bëhet publik, të jetë transparent, me qëllim që qytetarët të jenë sa më shumë informata për procesin e imunizimit të qytetarëve.
3. Obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës për zgjerimin e kapaciteteve logjistike për sigurimin e regjistrave demografikë dhe krijimin e databazave dhe aplikacioneve në nivel komunal dhe qendror për qëllim të vaksinimit efektiv të qytetarëve.
4. Obligohet Qeveria e Kosovës që të zbatojë Ligjin për rimëkëmbje ekonomike me qëllim të stimulimit të profesionistëve shëndetësorë dhe stafit mbështetës.
5. Konfirmon zotimin që Republika e Kosovës nëpërmjet legjislacionit të miratuar do të angazhohet për t'i dalë në ndihmë nëpërmjet mbështetjes financiare, grupeve të caktuara



shoqërore, shëndeti i të cilëve rrezikohet si rezultat i punës së tyre në shërbim të shtetit dhe shoqërisë, e që lidhet me menaxhimin e pandemisë COVID-19.

6. Përfituesve të mbështetjes financiare nga pika 5 e kësaj rezolute, do t'u ofrohet mbështetje si në vijim; të gjithë të punësuarit në sektorin publik, të cilët me veprimtarinë e tyre përballen me menaxhimin e pandemisë COVID-19, stimulohen dhe mbështeten financiarisht.

7. Profesionistët shëndetësorë mbështeten me pagë shtesë prej 300 eurosh, ndërsa punëtorët joshëndetësorë me pagë shtesë prej 200 eurosh për muaj, mbi pagën bazë, për muajt prill, maj, qershor të vitit 2021. Burimi i financimit për mbulimin e mbështetjes financiare nga pika 5 dhe 6 e kësaj rezolute, sigurohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

8. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që në afat sa më shkurtë kohor t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e mbështetjes financiare të përcaktuar në pikën 5 të kësaj rezolute.

Të nderuar deputetë,

Pas të gjithë këtyre debateve, mendoj që të gjithë ne në opsionet tona, patëm një gjë të përbashkët, u bindëm apo të themi tentuam ta binim njëri-tjetrit se duhet të veprojmë së bashku. Duhet të veprojmë ashtu që qytetarët tanë të mos ndjehen të vetmuar dhe të jenë në gjendje edhe punëtorët shëndetësorë të përballojnë situatën të cilën e kanë para vetes.

Qytetarëve t'u krijohet një siguri më e madhe, se përpos vaksinave që po vijnë, ata do të kenë edhe një qartësi rreth vaksinimit, se kur do ndodhë, ku do të ndodhë dhe në cilat qendra do të jenë në gjendje që ata të lajmërohen për ta marrë vaksinën.

Pra, kjo rezolutë parasheh që ne të gjithë të bashkohemi, të votojmë dhe të obligojmë, por në anën tjetër edhe të inkurajojmë Qeverinë që të jetë sa më shpejtë në reagimin e saj ndaj COVID-19.

Prandaj, kërkoj votën e të gjithëve që pas debatit tonë, të paktën të ketë diçka konkrete. Pra, të mos jemi një Kuvend i cili debaton dhe nuk merr asnjë vendim, e në anën tjetër, qytetarët tanë, profesionistët tanë shëndetësorë janë në vijë të parë të luftës, dhe ajo çka ne mund t'iu dërgojmë si sinjal është se zënka politike e inatet politike janë të vetmet gjëra që ne dimë t'i bëjmë.

Kërkoj votën tuaj që të jemi të bashkuar, t'iu mundësojmë qytetarëve tanë që të na shohin që jemi të gatshëm edhe si Kuvend, por edhe si Qeveri që t'iu dalim ndihmë atyre kurdo që ata kanë nevojë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për rezolutën e propozuar. I lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozim-rezolutën.

Kush është për? Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 74 deputetë, në ndërkohë. Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatoj që për kanë votuar 20 deputetë, kurse kundër kanë votuar 54 deputetë. Konstatoj që Kuvendi nuk e miratoi rezolutën nga debati parlamentar.

Me këtë rast i mbyll punimet e kësaj seance. Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*